

NDËRTIMI DHE PËRMBAJTJA E PUNIMIT

Punimi monografik “*Vështrim morfo – sintaksor i parafjalëve të gjuhës së re greke në krahasim me parafjalët e gjuhës shqipe*” është konceptuar në shtatë kapituj, të paraprirë nga një *Hyrje* si dhe të ndjekur nga *Bibliografia e veprave të shfrytëzuara* si më poshtë:

Hyrja përmban një vështrim të përgjithshëm për historinë, pjesën paraqitëse të punimit, të punës së bërë për realizimin e tij, të bazës teorike, të literaturës së shfrytëzuar, si edhe të burimeve të lëndës. Paraqitja e qëllimit dhe objektit të studimit, metodologjia e ndjekur, si edhe përbërja e kapitujve janë pjesë e këtij kreu.

Në kreun e parë jemi ndalur në çështjen “*Historia dhe zhvillimi i klasës së parafjalëve*”, duke trajtuar nënçështje të tilla, si: *Përkufizimi i parafjalës* (Përkufizimi i parafjalës në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke parë nga autorë të ndryshëm dhe në fjalorë të ndryshëm) dhe *Vendi i parafjalës në fjali* (*Pozicionet e ndryshme që parafjala zë në fjali: të thjeshta ose të përbëra, kur ajo ndodhet para një gjymtyre ose para gjymtyrëve homogjene, rastet që ajo mund të mungojë ose mund të zhvendoset*).

Studimi ynë ka karakter përshkruar, dhe mbështetet në mendimin shkencor tashmë të qëndrueshëm për studimet në greqishte dhe në shqipe, për marrëdhëniet ndërmjet dy gjuhëve dhe për karakterin dhënës e marrës të tyre. Punimi ynë për parafjalët në gjuhën shqipe e në greqishten e re ka synuar jo vetëm të paraqesë arritjet themelore të deritanishme në këtë fushë, por edhe të sjellë një kontribut modest.

Në kreun e dytë, punimi ndalet në çështjen “*Parafjalët e gjuhës së vjetër greke*”, si dhe në nënçështje, si: *Klasifikimi i parafjalëve sipas funksionit* dhe *Parafjalët abuzive*. Nënçështja *Klasifikimi i parafjalëve sipas funksionit* jep një paraqitje të parafjalëve të gjuhës së vjetër greke dhe ndarja e tyre si më poshtë: *Parafjalë që përdoren me një rasë* (gjinore, dhanore ose kallëzore), *Parafjalë që përdoren me dy rase* dhe *Parafjalë që përdoren me tre rase*.

Punimi mbështetet në analizën e një lënde gjuhësore të gjerë. Lënda e bollshme, e vjelë nga burime të shumta, si libra letrarë dhe shtypi i përditshëm, tregon se parafjalët e greqishtes së vjetër kanë një përdorim mjaft të pasur edhe sot, në gjuhën e re greke. Dhe kjo kryesisht vihet re *shprehjet e ngurtësuara* (*παγιωμένες εκφράσεις*) që janë të shumta në numër, si dhe në formimin e fjalëve të reja me anë të përngjitjes (σύνθεση).

Në kreun e tretë, punimi ndalet në çështjen “*Parafjalët dhe sistemi rator*”, si dhe në nënçështje të tilla, si: *Sistemi rator në gjuhën greke dhe shqipen e sotme*; *Parafjalët që përdoren me një rasë*; *Parafjalët me më shumë se një rasë në greqisht dhe shqip*; *Bashkimi i parafjalëve me një shquese të emrit*.

Ky kapitull është mjaft i rëndësishëm, pasi lidhet drejtpërdrejt me rasën në të cilën vendoset emri kur ndiqet nga një parafjalë e caktuar. Me interes janë pikat kyçe ku bazohet shqyrtimi i këtij kreu. Ato janë: *Parafjalët e rasës emërore; Parafjalët e rasës gjinore të greqishtes dhe të shqipes; Parafjalë të rasës dhanore apo parafjalë që përdoren me dy rasa?; Parafjalët e rasës kallëzore në greqisht dhe shqip; Parafjalët e rasës rrjedhore në gjuhën shqipe.*

Në kreun e katërt, të titulluar **“Parafjalët dhe marrëdhëniet sintaksore”** punimi është ndalur në tre çështje kryesore si: *Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe; Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën greke; Rrethanori me parafjalë në gjuhën shqipe dhe greke.*

Këtu është trajtuar me kujdes përdorimi i parafjalëve të rasave të ndryshme si kundrinor apo rrethanor me parafjalë. Në gjuhën shqipe përdorimi i parafjalëve në këto raste është mjaft më i madh në krahasim me gjuhën greke.

Në kreun e pestë të punimit me titull **“Funksionet dhe ndërtimi i parafjalëve në gjuhën shqipe”** është bërë një *klasifikim i parafjalëve sipas prejardhjes; Klasifikimi i parafjalëve sipas strukturës morfologjike; Klasifikimi i parafjalëve sipas karakterit sintaksor.* Në të gjithashtu trajtohen parafjalët ndajfoljore, parafjalët emërore dhe parafjalët foljore.

Në kreun e gjashtë të punimit me titull **“Funksionet dhe ndërtimi i parafjalëve në gjuhën e re greke”** dhe me nënçështje: *Funksioni dhe ndërtimi i parafjalëve me përdorim të përgjithshëm; Funksioni dhe ndërtimi i parafjalëve me përdorim të kufizuar,* trajtohet me hollësi përdorimi i çdo parafjale të gjuhës greke. Në të gjithashtu trajtohen disa përdorime specifike të këtyre parafjalëve.

Në kreun e shtatë me titull **“Parafjalët abuzive”** janë trajtuar disa parafjalë të gjuhës greke që e kanë prejardhjen nga greqishtja e vjetër. Ato përdoren sot kryesisht në stilin libror e shkencor.

Te **Përfundimet** kemi dhënë një sintezë të të gjitha dukurive që zbulohen gjatë trajtimit të tyre në kapituj dhe sytha të veçantë, të përbashkëta dhe të veçantat midis dy gjuhëve, si edhe probleme e çështje të hapura e të shtruara për shtjellime dhe interpretime të mëtejshme.

KREU I

HISTORIA DHE ZHVILLIMI I KLASËS SË PARAFJALËVE

Shqipja dhe greqishtja janë dy gjuhë që i përkasin familjes së madhe të gjuhëve, asaj indoevropiane. Si rrjedhim, ngjashmëritë midis tyre janë të mëdha. Është e vështirë të përcaktohet me saktësi periudha kohore e shfaqjes së greqishtes së hershme, asaj protohelenike, por dimë që në shekullin e 13-të p.e.r, përdorej i ashtuquajtimi lineari B. Lineari B e ka prejardhjen nga lineari A, i cili u përdor nga mesi i shekullit të 18-të deri në mesin e shekullit 15-të p.e.r dhe deri më sot janë publikuar rreth 1500 tekste të shkruara në linearin A.¹ Gjuha greke është përfutur përmes një procesi transformimesh të vazhdueshme që ka pësuar gjuha mëmë indoevropiane, në një periudhë kohore tepër të gjatë. Greqishtja është rezultati përfundimtar i një sërë transformimesh në fushën e fonetikës, të prapashtesave fjalëformuese dhe të mbaresave (morfologjia), leksikut dhe sintaksës. Forma më e hershme (deri më sot) e dokumentuar e greqishtes, ajo e mbishkrimeve mikenase (mikenishtja) të shkruara në linearin B, i cili u zbulua në 1930 nga Arthur Evans dhe u transkriptua nga Michael Ventris në 1952, dëshmon se, që në mijëvjeçarin e dytë p.e.r. greqishtja ishte e ndarë në dialekte, pasi vetë mikenishtja i ishte nënshtruar ndryshimeve fonetike të cilat nuk vihen re në dialektet e tjera. Nuk mund të thuhet me siguri nëse ka ekzistuar një gjuhë tërësisht homogjene që mund të quhej gjuha greke, por mund të provohet se, shumë nga tiparet dalluese të dialekteve të ndryshme të greqishtes së vjetër, janë zhvillime gjuhësore të mëvonshme. Është e pamundur që të kemi një datim të saktë të protogreqishtes, por shumica e studiuesve e vendosin aty rreth fillimit të mijëvjeçarit të dytë p.e.r. Rishfaqja e shkrimit, pas shekujve të errët të historisë së lashtë greke, ndodhi rreth fundit të shekullit të 9-të p.e.r nëpërmjet alfabetit, i cili sipas të gjitha gjasave është huazuar nga shkrimi fenikas.² Gjuha indoevropiane ndahet në një numër nëngrupesh gjuhësore, ku si greqishtja ashtu edhe shqipja përbëjnë nëngrupe më vete.

Krahas evolucionit të strukturës gramatikore të greqishtes në përgjithësi, ka evoluar edhe sistemi i parafjalëve në veçanti. Një fushë që paraqet risi, është edhe ajo e zhvillimit të parafjalëve prej elementësh fillimisht të mëvetësishëm ndajfoljorë. Në dialektin pamfiliak parafjalët përdoren me rasën dhanore në vend të gjinore për të treguar pikënisje apo largim nga diku. Gjatë kalimit nga periudha klasike në atë elenistike vërejmë përdorimin gjithnjë e më të paktë të dhanores. Kështu ajo zëvendësohet nga rasi të tjera me parafjalë. Kjo shihet si një tendencë për ta bërë gjuhën më analitike në këtë periudhë. Ndërkaq ka filluar zëvendësimi i dhanores që tregon kundrinorin e drejtë me përcaktor me parafjalë të tipit: parafjala εις + kallëzore ose gjinore. Edhe dhanorja që

1 Y. Duhox, *Γραμμική Α, μετάφραση Ε. Τσελέντη-Α.Καραστάση, Ιστορία της ελληνικής γλώσσας*, 2007.

2 E. Βουτυράς, *Η εισαγωγή του αλφαβήτου, Ιστορία της ελληνικής γλώσσας*, 2007.

tregon mjetin me të cilin kryhet një veprim zëvendësohet gjatë shekullit të 4 p.e.s me përcaktorin me parafjalë të tipit: parafjala μετά + rasë gjinore. Dhe kjo më vonë u zëvendësua nga μετά + rasë kallëzore. Në periudhën Klasike vihet re rritje e përdorimit të parafjalëve. Një tregues i rëndësishëm në këtë pikë është zgjerimi i përdorimeve të parafjalës greke από3.

Në periudhën e Mesjetës vihet re përdorimi i parafjalëve εκ, μετά, μέχρι me rasë kallëzore në vend të rasës gjinore me të cilën ishin përdorur deri atëherë4. Parafjalët janë përdorur edhe për të formuar fjalë të reja. Sot parafjalët e gjuhës së re greke shoqërohen me një emër në rasë kallëzore, me përjashtim të disa rasteve siç janë shprehjet e ngurtësuara që kanë hyrë nga gjuha e vjetër greke.

Në gjuhën shqipe termi “parafjalë” është ndeshur qysh në lashtësi, për faktin se është ndjerë i nevojshëm krijimi i një mjeti gjuhësor për të shprehur marrëdhëniet sintaksore të emrit në fjali. Kjo ishte një fjalëz shërbyese që vendosej para një emri a përemri. Në disa gjuhë indoevropiane mund t’i gjejmë dhe të prapavendosura, por gjuhët që ne po krahasojmë, shqipja dhe greqishtja, e kanë të paravendosur. Sipas prof. Sh. Demiraj “Parafjalët vendosen rregullisht para një emri a përemri në një rasë të caktuar, për të shprehur lidhjet e tij sintaksore, përkatësisht me një gjymtyrë tjetër të shprehur nga një emër. Në rastin e parë togu *parafjalë+emër* kryen një funksion ndajfoljor (adverbal), ndërsa në rastin e dytë kryen një funksion ndajemëror (adominal)”5. Lindja e klasës së parafjalëve kushtëzohet, si çdo dukuri, nga disa faktorë. Këta faktorë veprojnë të veçuar, por shpesh edhe në bashkëveprim reciprok.

Faktorët që veprojnë në një sferë të veçantë të gjuhës sjellin pasoja edhe në sfera të tjera. “Duke theksuar rolin e madh të parafjalëve në reduktimin e treguesve rasorë të emrave dhe përemrave, duhet, nga ana tjetër, të theksojmë se edhe rënia e treguesve rasorë ka ndikuar mjaft në pasurimin e ndërtimeve parafjalore. Këto janë dy dukuri në strukturën morfologjike të shqipes që janë zhvilluar në përpjesëtim të zhdrejtë me njëra-tjetrën”.6

“Parafjalët në familjen e gjuhëve indoevropiane, - thotë prof. Sh. Demiraj, - janë përfutur në një fazë të caktuar të zhvillimit të kësaj familjeje gjuhësh. Ato janë përfutur qysh në një fazë të hershme parahistorike, për çka dëshmon prania e tyre në të gjitha gjuhët indoevropiane, përfshirë këtu edhe ato që kanë një dokumentim shkrimor relativisht shumë të hershëm, si indishtja e vjetër, greqishtja e vjetër, latinishtja etj. Krijimi i kësaj klase fjalësh, që kanë ardhur duke luajtur një rol gjithnjë e më të madh në të shprehurit e lidhjeve sintaksore të emrit (dhe të përemrit) në fjali, është bërë i

3 N. Π. Ανδριώτη, *Ιστορία της ελληνικής γλώσσας*, Selanik, 1995, f. 51.

4 Po aty, f. 79.

5 Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Parafjalët, f. 625.

6 E. Lika, *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe*, f. 14.

nevojshëm nga pamjaftueshmëria e formave rasore të emrit për të shprehur të gjitha nuancat e raporteve të tij sintaksore. Si rrjedhim, në një fazë të dhënë të zhvillimit të popujve që flisnin gjuhë a dialekt indoevropian, u ndje nevoja për një mjet të ri plotësues të sistemit rasor për t'i dhënë këtij mundësi të shprehte sa më mirë e sa më qartë funksionet më të ndryshme të emrit në fjali.”⁷

Krahas reduktimit të fleksionit, lindja dhe rritja në vëllim e klasës së parafjalëve erdhi si rezultat edhe i zëvendësimit në gjuhë të sintetizimit me analitizmin.

Parafjalët i hasim qysh në kohët shumë të lashta. Në gjuhën e vjetër greke parafjala emërtohej *prothesis*, që do të thotë e vendosur përpara. U përdor për herë të parë nga gramatikani grek, Dionis Trakasi (170-190 p.e.s). Por më pas në Francë, në shek. XVII, nga mësuesit e Port Royal-it, u hartua në vitin 1660 “Grammaire general et raisonnee”, që i dha parafjalës një kuptim më të përgjithshëm, atë të marrëdhënive dhe të lidhjeve. Termi *prothesis* i greqishtes u kthye në *praeposito* në latinisht. Ky term ruhet në të gjitha gjuhët romane, por jo në ato sllave e gjermane. Në gjuhën shqipe ky term u përkthye për së pari prej Sami Frashërit në gramatikën e tij me fjalën *parje* ose *përparje* në vitin 1886. “Gramatika a Folmarmja e Shkodrës ka përdorur termin parapris-a. Gramatika e Xanonit, e vitit 1909, e quajti paraprisë-a. Termi i sotëm parafjalë u caktua më 1920 në një mbledhje arsimitarësh, që u bë në Lushnjë, pas kongresit së ditur n’atë qytet”.⁸

Si në gjuhën shqipe dhe atë greke origjina e parafjalëve duhet kërkuar te fjalët me kuptim ndajfoljor, pasi lidhja midis ndajfoljes dhe emrit është bërë gjithnjë e më e ngushtë. Sheperi thotë: “Si parafjalë përdoren edhe shumë ndajfolje vendi, kur plotësohen me rase emërash: jashtë shtëpis, tejë malit; këtejë, afër, larg, veç, pos, pranë, mbanë, rreth, rrotull, drejt, kundrejt etj”.⁹ Gradualisht forma rasore e emrit nuk varej më drejtpërdrejt nga folja, por nga ndajfolja. “Në këtë përdorim edhe “ndajfolja” e humbi shkallë-shkallë mëvetsinë e saj si fjalë dhe u shndërrua më në fund në një fjalë shërbyese”.¹⁰ “Në gjuhën e sotme shqipe gjenden një radhë fjalësh që përdoren edhe si ndajfolje edhe si parafjalë”.¹¹ Kur ndajfoljet kthehen në parafjalë përdoren për të shprehur marrëdhënie në mes të fjalëve kuptimplota. Ky kalim shpjegohet edhe me dobësimin e theksit në rastin kur ndajfolja përdoret si parafjalë. Pra, nga një fjalë kuptimplote e me theks të plote, ajo kalon nga në një fjalë e cila mbetet e patheksuar ose me një theks më të dobët. Po të krahasojmë shembujt: *Rrinte përballë* dhe *përballë*

7 Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 625.

8 A. Xhuvani, vep. e cit., f. 264.

9 I. D. Sheperi *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*, Vlorë, 1927, f. 124.

10 Brugman, Cituar ne veprën e Sh. Demiraj, f.625.

11 E. Hysa, *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, SF 3, 1970, f. 40.

shtëpisë, do të vëmë re se fjala *përballë* në rolin e parafjalës nuk ka atë theks që ka në rolin e ndajfoljes. Edhe disa parafjalë të gjuhës greke fillimisht janë përdorur edhe si ndajfolje. Të tilla janë: *εν, αμφί, επί, μετά, παρά* etj. Fillimisht, parafjala ishte një ndajfolje e lirë, që kufizonte kuptimin e foljes, por s'ishte drejtpërdrejt e lidhur me të. Nga ky funksion ndajfoljor, parafjalët kaluan edhe në funksionin ndajemëror. Kjo i përket një periudhe më të vonë të gjuhës. Xhuvani¹² merr si shembull një frazë nga Homeri *από νηώς βαίνει* = zbret prej anijes. Emri *νηώς* në rasën gjinore-dhanore lidhet me foljen *βαίνει* dhe tregon pikënisjen e të zbriturit. Duke qenë se ndajfolja apo parafjala *από* kishte po atë kuptim të gjinore-lidhore, atëherë ajo u lidh ngushtë me emrin dhe u largua nga folja. Më pas në këtë mënyrë parafjalët u përdorën edhe në prozë. Funksioni i parafjalëve mori një zhvillim më të gjerë, por dalëngadalë u pa se s'ishte e mjaftueshme për të shprehur lidhje të tjera sintaksore “nuk kishte mbaresa që të tregonin relacione të tjera logjike”.¹³ Mbaretat që merrnin emrat gjatë lakimit nuk arrinin të shprehnin marrëdhënie dhe raporte të ndryshme logjike. Kështu lindi nevoja për zgjerimin e klasës së parafjalëve, duke e pasuruar atë nëpërmjet ndajfoljeve të përdorura me funksionin e parafjalëve, si dhe të disa lidhëzave, emrave e pjesoreve. “Kështu në greqishte u krijuan 18. Edhe shqipja ka 18”.¹⁴ Kjo klasë erdhi duke u zgjeruar edhe me anë të përdorimit të lokucioneve parafjalore. “Por me pas parafjala iu ngjiti krejt foljes, u bashkua me të duke formuar një njësi kuptimore, elementi i parë i së cilës ishte parafjala, e quajtuar pastaj proverb”.¹⁵ Në gjuhën greke ka shumë folje të formuara në këtë mënyrë, madje mund të themi që i gjithë sistemi i përngjitjes së fjalëve formohet në këtë mënyrë, p.sh *επαναλαμβάνω, ενθέτω, παραβάλλω, αμφιβάλλω, μεθίσταμαι* etj.

Denduria e përdorimit të parafjalëve në gjuhën e folu dhe të shkruar është mjaft e madhe në krahasim me pjesët e tjera të pandryshueshme të ligjëratës. Deri në vitet '50 të këtij shekulli janë trajtuar në tekstet e gramatikave për nevoja të shkollës. Si kategori leksiko-gramatikore, parafjala është trajtuar edhe në gramatika të ndryshme të shqipes dhe të greqishtes. Në tekstet e shkollave 9-vjeçare ajo zë një vend shumë të vogël. Sami Frashëri në gramatikën e tij të gjuhës shqipe, të vitit 1886, jep këtë përkufizim për parafjalën: “Parjetë janë ca fjalë të papërkthyer, të cilat vihen përpara emrave, për t'i ngjitur ata me foljet, si: *rri në shtëpi, vete me ty*.” Ai jep edhe një listë parafjalësh. Ai vë në dukje se disa nga parafjalët e mësipërme, si: *pranë-, përpara-, pas-, tej-* etj “... kur përdoren vetëm janë mifolje si: *rri pranë, shkoj tej, eja pas*; kur vihenë përpara një emëri janë parje, si: *pranë shtëpisë, tej malit, pas murit*.”¹⁶

12 A. Xhuvani, vep. e cit., 265.

13 A. Xhuvani, “*Parafjalët*”, SF, 1, 1964.

14 A. Xhuvani vep. e cit., 265.

15 A. Xhuvani, vep. e cit., 264.

16 S.Frashëri, *Vepra V*, Prishtinë, 1979, f. 269.

Në gramatikën e Ilias Jahja Përmetit përdoret termi *parapries* për të shënuar parafjalën e cila përkufizohej: “Parapries është ajo pjesë e ligjëratës e cila dëfton përkritien e marrëdhënien e dje fjalëve”.¹⁷ Ilija Dilo Sheperi, në gramatikën e tij të vitit 1927 për parafjalët thotë: “Parafjalët janë 18. Vihen para emrave, përveç parafjalëve *që* (*qysh*) dhe *gjer* (*deri*) që vihen para ndajfoljeve ose përbëjnë lokucione si: *që në, gjer në, që nga, gjer te, që kur, gjer sa* etj”.¹⁸ Këtu ai bën dhe dallimin midis parafjalës dhe ndajfoljes. Ndërsa Kostaq Cipo, në gramatikën e tij të 1949, i trajton parafjalët më gjerë se paraardhësit e tij, duke i parë ato jo vetëm në aspektin morfologjik, por edhe në atë sintaksor. Ai jep këtë përkufizim për parafjalën: “Parafjalë quhet fjalëza që hyn në punë për të lidhur dy fjalë sipas marrëdhënies që mund të kenë në lidhje me vendin, me kohën, me pronën, me mjetin, me lëndën”.¹⁹ Ai gjithashtu bën edhe një klasifikim të parafjalëve dhe jep edhe rasat që kërkojnë disa parafjalë.

Në gramatikën e vitit 1959, P. Elezi dhe L. Dodbiba japin një përkufizim më të gjerë: “Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që vihet para një emri, para një mbiemri që merret si emër dhe një përemri, për të treguar marrëdhënien që kanë këto fjalë me pjesët e tjera të ligjëratës.”²⁰

Në tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe”, I (Morfologjia), Tiranë, 1995, hartuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, parafjala është trajtuar gjerë nga ana teorike. Është bërë klasifikimi sipas prejardhjes, strukturës morfologjike, kriterit sintaksor si dhe janë dhënë kuptimet kryesore të tyre.

Për aspektin sintaksor të parafjalës gjejmë edhe në tekstin e Gramatikës së Gjuhës Shqipe, II, (Sintaksa), Tiranë, 1996. Në kapitujt ku flitet për kundrinorët me parafjalë, përcaktorët, rrethorët, togfjalëshat etj., janë dhënë edhe ndërtime të ndryshme parafjalore që shprehin raporte të ndryshme.

Për parafjalën janë bërë dhe disa punime shkencore, të cilave do t’u referohemi shpesh në këtë punim. Nga punimet më me vlerë për parafjalët është ai i Xhuvanit, “Parafjalët”, botuar në Studime Filologjike, Tiranë 1964, I. Për këtë artikull mjaft të pasur dhe të gjerë, Xhuvani ka shfrytëzuar një literaturë të pasur teorike, të folmen arbëreshe, krijimtarinë folklorike, letërsinë e vjetër shqipe dhe atë të rilindjes. Xhuvani hodhi themelet për studimin e parafjalës si kategori leksiko-gramatikore.

17 I. J. Përmeti, *Fillime të gramatikës shqipe për shkollat premetare*, Boston Massacuset, 1917, f. 217.

18 I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*, Vlorë, 1927, f. 123.

19 K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1949, f. 217.

20 P. Elezi-L. Dodbiba, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa I*, Tiranë, 1959, f. 327.

S. Prifti i quan “shprehje” e “lokucione” dhe i interpreton drejt duke i parë si një gjymtyrë bashkë me emrin pasues.²¹ Me parafjalët gjithashtu është marrë edhe M. Domi. Ai i interpreton drejt ndërtimet me parafjalë emërore duke i vështruar ato me emrin e papërcaktuar “shprehje”, si dhe ka trajtuar përdorimin e parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene.²²

Në studimin e Mehmet Çelikut “Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe”, SF, I, Tiranë, 1972, janë trajtuar kryesisht parafjalët me origjinë emërore, kalimi i emrave nga një pjesë e veçantë e ligjëratës në një tjetër. Ai është marrë edhe me “Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe” në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme”, II, Tiranë, 1975. Gjithashtu M. Çeliku ka trajtuar dhe disa parafjalë me origjinë foljore nga pjesorja e foljes, në shkrimin “Parafjalët foljore dhe disa çështje të formësimit të tyre”, botuar fillimisht në “Gjuha jonë”, nr. 4, 1990. Këto parafjalë përbëjnë një numër të kufizuar si: *lidhur me, ngjitur me, drejtuar nga, nisur nga*.

Akademiku Shaban Demiraj e trajton parafjalën në një krye të veçantë në “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1986, f. 624-653, në kapitullin “Rreth parafjalëve”. Aty flitet edhe për përfitim historik të parafjalëve të vjetra, që kanë analoget e tyre edhe në gjuhë të tjera indoevropiane si: *në, për etj.*

Edhe prof. Miço Samara ka botuar një studim për parafjalët me titull “Parafjalët në shqipen e sotme”, Tiranë, 1999. Ai analizon parafjalën e parme dhe të prejardhur në rrafshin leksiko-semantik. Autori merret edhe me lokucionet parafjalore të para gjithashtu nga ana leksiko-semantike.

21 S.Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, 1962.

22 M. Domi, *Përdorimi i parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene*. Gjuha jone, 2, 1988, f. 5-15.

1.1. Përkufizimi i parafjalës

Në monografinë e tij, Xhuvani jep këtë përkufizim për parafjalën: “Parafjala është pjesë e palakueshme e ligjëratës që tregon marrëdhënie të ndryshme midis dy gjymtyrëve të fjalisë”²³. Në “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe” parafjala përkufizohet si “pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyrë tjetër në togfjalësh”²⁴. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” të vitit 1980 dhe në “Fjalorin e shqipes së sotme” të vitit 1984 është dhënë një përkufizim në të cilin jepen më mirë elementet leksiko-gramatikore e leksiko-semantike të saj. Përveç tipareve të karakterit morfologjik si palakueshmëria dhe karakterit sintaksor të saj, pra, përdorimi me një rasë të caktuar, del edhe tipari i saj si “fjalë shërbyese”²⁵, d.m.th. si një fjalë “që nuk ka kuptim të pavarur leksikor”²⁶. Kjo gjë theksohet dhe te Xhuvani kur bën dallimin midis parafjalëve të parme dhe atyre ndajfoljore, thotë “vlera leksikore e parafjalëve caktohet nga brendia kuptimore e fjalëve të një konteksti të dhënë, ku gjenden ato”²⁷. “Kuptimi i parafjalëve sqarohet brenda togfjalëshit dhe varet si nga kuptimi i gjymtyrës përcaktuese, para së cilës rri parafjala, ashtu dhe nga kuptimi i gjymtyrës së përcaktuar prej saj”²⁸.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, i vitit 1980, parafjala përkufizohet kështu: Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që përdoret si fjalë shërbyese përpara një emri, një përemri a një numërori (në një rasë të caktuar) ose përpara disa ndajfoljeve, për të shprehur marrëdhëniet midis gjymtyrëve në një togfjalësh.

I ngjashëm me këtë përkufizim është edhe ai për parafjalën në gjuhën greke. Sipas “Fjalorit të gjuhës së re greke”, i vitit 1998, parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që përdoret përpara emrave, përemrave, mbiemrave prejpjesorë ose ndajfoljeve dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme ndajfoljore.

23 A. Xhuvani, *Vepra I, “Parafjalët”*, Tiranë, 1985, f. 7. Ky është përkufizimi i përgjithshëm që japin gramatikat e studimet e tjera për parafjalën.

24 *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II*, 1976, f. 333.

25 FGJSSH, 1980, f. 1359.

26 Po aty, f. 1836.

27 A. Xhuvani, *vep. e cit.*, f.9.

28 *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II*, 1976, f. 334.

Parafjala nuk ka kuptim leksikor të pavarur, pra ajo s'mund të qëndrojë e pavarur sikundër emri dhe folja. Për këtë arsye ato mund të quhen fjalë shërbyese dhe kanë kuptim leksikor të kushtëzuar.

Në tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe”, I (Morfologjia), Tiranë, 1995, hartuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, parafjala përkufizohet: Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyre tjetër në togfjalësh.²⁹

Tek të dy përkufizimet e sipërpërmendura del qartë pandryshueshmëria e kësaj pjese të ligjëratës, si dhe përdorimi i saj me një rasë të caktuar, pra tipari morfologjik dhe sintaksor i saj. Lyons duke u mbështetur në “kategorinë aristoteliane” thekson: “... pjesët e ligjëratës të rangut të parë (emër, folje, mbiemër, ndajfolje) ishin kuptimmbartëse... Pjesët e tjera të ligjëratës (parafjalët, lidhëzat etj), të marra në vetvete, nuk thoshin asgjë, por ndihmonin në kuptimin e përgjithshëm të fjalive, duke u dhënë atyre një formë ose një rend të caktuar”³⁰

Parafjala merr një kuptim më të qartë brenda togfjalëshit. Ajo shpreh marrëdhënie midis dy gjymtyrëve dhe kryesisht të nocionit emëror me atë foljor. Kjo është një lidhje mjaft e rëndësishme dhe prania e parafjalës mund të themi se është e domosdoshme.

1.2. Vendi i parafjalës në fjali

Në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke përdorimi i parafjalëve është mjaft i shpeshtë dhe ajo në ligjëratë pozicionohet gjithmonë para grupit emëror³¹. Në gjuhën greke nga ky rregull përjashtohen disa shprehje të caktuara të ngurtësuara me prejardhje librore, tek të cilat parafjala i prapavendoset grupit emëror, p.sh: *τιμής ένεκεν, παραδείγματος χάριν*.

Ημαστε στην πίσω πλευρά του σταθμού, είκοσι μέτρα από την πλατφόρμα.

Με κάρφωσε με τη ματιά του.

Τα παίρνουμε και οπ! Καλπάζουμε προς τη θάλασσα.

Καταφύγιο το πευκόδασος για τα ζευγαράκια.

Por, nëse grupi emëror të cilit parafjala i përket nga ana sintaksore, ka përpara tij përcaktor, parafjala shkon përpara tij: *Στο πίσω κάθισμα τα δυο παρανυμφάκια, ζευγάρι, αγόρι, κορίτσι, με λουλουδιά στα μαλλιά τους*. (E.O. 47); *Γιατί η Κατερίνα μου και ο*

²⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 1995, f. 381

³⁰ J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, f. 258

³¹ Χρ. Κλαίρης-Γ. Μπαμπινιώτης, *ver. e cit.* 932

σύντροφός της μάς νικούσαν κατά κράτος, με διάφορα πολλά μήκη. (E.O. 45); Η Κατερίνα μου κι εγώ φεύγουμε από τον Καζαμία και πάμε στα άλλα βιβλία που έχει στο τρίτο από κάτω ράφι. (E.O. 41)

Në qoftë se emri të cilit i përket nga ana sintaksore parafjala, ka përcaktor në rasë gjinore (një përemër pronor), kjo gjinore zakonisht zë vend ndërmjet parafjalës dhe atij emri: *Τράβηξε ίσια κατά του προεστού το σπίτι. Προχωρούσανε κατά το σπίτι του Ψάρου. Με της μυρτιάς τ'άνθη. Είναι ζυμωμένο με της καρδιάς μου το αίμα. Πρός της Εστίας το ναό τραβούνε. Στου κουφού την πόρτα όσο θέλεις βρόντα. Τα μέταλλα στις γής τα βάθη. Ένοιωθε ως της ψυχής τα κατάβαθα την ομορφιά εκείνη.*

Nëse përcaktori në rasë gjinore nuk ndërfutet ndërmjet parafjalës dhe emrit, atëherë zakonisht i prapavendoset grupit emëror me parafjalë: *Το καταλαβαίνω με το μυαλό μου, μα στα μύχια της καρδιάς μου μου φαίνεται τερατώδες! (T.T.Σ. 57); Υπό την καθοδήγηση της Ερασμίας, ζόδευε αφειδώς λεφτά σε φιλανθρωπίες γι' ανάξια ως επί το πλείστον υποκείμενα, ευχέλαια κι ολονυχτίες. (T.T.Σ. 59)* Në formimin e parafjalës χωρίς me fjali volitive, mundet që ndërmjet parafjalës χωρίς dhe pjesëzës *να* të ndërfuten një ose më shumë fjalë të fjalisë volitive: *Μου τα΄δινε τα γράμματα, χωρίς τάχα να καταλαβαίνει από ποιόν ήταν. Βασανίστηκε ένα χρόνο στο κρεβάτι, χωρίς οι γιατροί να καταλάβουν από τι έπασχε.*

Së fundmi, parafjala από në frazën *εκεί απ'όπου* zhvendoset përpara ndajfoljes *εκεί*: *Έλα, σύρε από κεί που 'ρθες.*

Lidhja e ngushtë që ekziston midis parafjalës dhe grupit emëror duket dhe nga vazhdimësia e drejtpërdrejtë që kanë në ligjëratë. Ndërmjet emrit dhe parafjalës ndërfuten vetëm përcaktorët e emrit të cilët janë elementë të grupit emëror:

Η Ερασμία την άκουγε, προφανώς για πρώτη φορά, να μιλάει για μάγισσες, κι είχε συγχυστεί. (T.T.Σ. 59)

Ο πεθερός της ήταν ένας από τους καλύτερους χρυσοχόους της Θεσσαλονίκης. (T.T.Σ. 122).

Θα 'ρθω μια από αυτές τις μέρες να σου διορθώσω το παλτό και θα τα πούμε. (T.T.Σ. 131)

Në gjuhën shqipe zakonisht përcaktorët vijnë pas fjalës që përcaktojnë:

Πέρpara se të çelte portën e ateliesë vështrimi iu ndal një grimë te flegra e djathhtë. (L.F.M. 22)

Nën ndriçimin e zjarrit të vatrës ajo sodit flokët dhe mollëzat e tij të bukur. (L.F.M. 21)

Lajmi për krushqinë e përçudur e shkalafiti mesin e tetorit më fort se era e veriut. (L.F.M. 29)

Mund të ndodhë që përcaktori të qëndrojë përpara fjalës që përcakton. Në këtë rast parafjala vendoset përpara përcaktorit. Kështu kemi: *për të bukurën Shqipëri, te i gjori plak, nga i madhi Kadare* etj.

Kur një përcaktor me parafjalë është i përbërë, d.m.th kur një parafjalë i përket nga ana sintaksore dy ose më shumë emrave të një fjalie, që lidhen mes tyre me bashkërenditje, zakonisht parafjala vendoset vetëm një herë përpara emrit të parë dhe nënkuptohet pastaj përpara secilit nga emrat e tjerë: *Επί τρία- τέσσερα χρόνια δε θυμάμαι τίποτ' άλλο από αρρώστιες, κηδείες και μνημόσυνα.* (T.T.Σ. 58); *Με τη ζήλια σου και τις υστερίες σου, σα να 'τανε ο μόνος άντρας στον κόσμο που είχε φιληνάδες!* (T.T.Σ. 129); *Ξεμαλλιασμένη, με ματωμένα χείλια και πρησμένα μάτια, ανακάθισα στο πάτωμα και κοίταζα την Πολυζένη σα να μην την αναγνώριζα.* (T.T.Σ. 131)

Parafjala përsëritet përpara secilës gjymtyrë homogjene vetëm atëherë kur duam të theksojmë diçka më shumë: *Νοικοκύρης άνθρωπος, με τα χωράφια του, με τα σπίτια το, με τα καλά του. Φιλοσοφία χωρίς ιδανικό, χωρίς αγάπη, χωρίς ελπίδα. Με όλα τριγύρα τα νερά και με όλα τα πουλιά... με μία πνοή, με μία ψυχή, με μία κρυφή μιλιά.*

Parafjala mund të anashkalohet dhe përpara përemrit lidhor kur ajo është përdorur një herë në fjali përpara një përemri dëftor³²: *Σπανίως ασπάσθηκα εικόνες με τόση ευλάβεια, όση τότε.* Por kur duam të theksojmë diçka, ajo edhe në këtë rast përsëritet para çdo gjymtyrë homogjene: *Έσβησε σιγά σιγά, όχι τόσο απ' τον καρκίνο, όσο απ' τον καημό της για το κατάντημα του Ντίνου.* (T.T.Σ. 57)

Por shumë herë parafjala nuk kuptohet nga konteksti dhe duhet të nënkuptohet vetvetiu: *...που πούλησα στις μαύρες μέρες της Κατοχής για μερικούς τενεκέδες λάδι.* (T.T.Σ. 58); *Όλοι να συναχτήτε μεγάλοι και μικροί, στ'Ανίνο να βρεθήτε ντουφέκι και σπαθί. Κάστρο θεμελιωμένο, κάστρο ζακουστό, μολύβι σκεπασμένο. Ράχη σε ράχη περπατεί, λημέρι. Πέτρα την πέτρα περπατούν, λιθάρι το λιθάρι. Βράχο το βράχο πήδαγε. Πέτρα σε πέτρα περπατεί, την γκέτα μη λερώσει.*

Kjo gjë vihet re dhe në shqipe. Nëse gjymtyra e parë këpujore është me parafjalë, kjo nuk përsëritet përpara gjymtyrëve të tjera. Ajo përsëritet kur kërkohet të theksohet secila gjymtyrë ose kur gjymtyrët homogjene janë të larguara disi njëra prej tjetrës³³. Parafjala përsëritet kur dy gjymtyrët të cilave u paravendoset kanë raport kundërshtie³⁴: *Dosi u drodh jo nga lëkundja, por nga kujtimi i hidhur që e mbërtheu në grykë.*

Edhe me gjymtyrët homogjene veçuese me parafjalë, parafjala përsëritet përpara çdo gjymtyrë³⁵: *Ne zgjedhim disa njerëz në senat, që vendosin për taksat, për luftën, për paqen, për tregtinë, për shkollat, për rrugët dhe për lundrimin.* (O.A.V. 24)

Për përsëritjen ose jo të parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene është shkruar edhe në “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe³⁶”. Aty thuhet se parafjalët në, te (tek), me, nga,

32 Αχιλλ. Α. Τζάρτζανου, vep. e cit., 224

33 M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe, I*, 1975, f. 12

34 Po aty, 14

35 Po aty, 16

prej e të tjera si këto zakonisht përsëriten në shkrim, sa herë që bashkërenditen dy a më shumë emra a përemra, me të cilat ato lidhen: ... në verë, në vjeshtë e në dimër; me të ngrënë e me të pirë; me thonj dhe me dhëmbë, nga Elbasani, nga Gjirokastra e nga Vlora; nga shtati, nga fjala, nga dituria nuk kishte shok.

Ndërsa në “Gjuha letrare shqipe për të gjithë” theksohet se³⁷: “Në një varg prej dy ose më shumë gjymtyrësh homogjene, të lidhura me intonacion numërimi ose me lidhëzat *e, dhe, parafjalët nga, te (tek), në, mbi, nëpër, me, prej, larg, afër* etj., mund të përsëriten ose jo për arsye kuptimore, stilistike dhe strukturore. Parafjala përsëritet para çdo gjymtyre homogjene në këto raste: a) kur çdo gjymtyrë homogjene duam ta vëmë në dukje si diçka më vete: *Sidomos pas vdekjes së gruas mendonte se duhej të kryente edhe rolin e saj të munguar duke i folur të birit për moralin, për dashurinë, për besimin, për paqen, për mirëkuptimin dhe gjëra të ngjashme, të cilat dhe atij, në jo pak raste, i kishin vlejtur dhe këtë nuk mund ta mohonte.* (O.A.V. 23); b) kur gjymtyra homogjene para saj është e zgjeruar: *Pasi u enda te plepat e hotelit të vjetër dhe te oborri manastirit të braktisur, qëndrova një kohë të gjatë te plazhi i shkretuar, sipër të cilit, zogjtë, të vetmet gjëra që nguteshin në këtë qytet, vërtiteshin me klithma të paqeta.* (I.Sh. 36)

Parafjala mund të mos përsëritet para çdo gjymtyre homogjene, kur gjymtyrët homogjene nuk janë të zgjeruara dhe kur midis tyre ka njëfarë afrie kuptimore, që krijon përshtypjen e diçkaje tërësore. Në këto raste mungesa e parafjalës, për shkak të afrisë kuptimore dhe të lidhjes së pandërmjetme, nuk sjell paqartësi dhe ngatërresë: *Kishte bërë diçka të vërtetë prej poeti, jashtë kohe, të harruar, kavalereske, të dënueshme prej komiteteve të partisë së rretheve, prej plenumëve, kongreseve, doktrinës.* (I.Sh. 22)

Ky problem, pra i përsëritjes ose jo të parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene është trajtuar edhe në “Libri i gjuhës shqipe 2 për shkollat e mesme”, ku thuhet³⁸: “Parafjala përsëritet përpara çdo gjymtyre homogjene (kunderinor ose rrethanor), kur secilën prej tyre duam ta vëmë në dukje si diçka më vete ose kur janë të zgjeruara: *Pylli oshtiu nga pushkët e nga bombat...* Parafjala mund të mos përsëritet përpara çdo gjymtyre homogjene, kur ato nuk janë të zgjeruara dhe kur midis tyre ka njëfarë afërsie kuptimore që krijon përshtypjen e diçkaje tërësore: *Populli ynë ka luftuar shekuj me radhë për liri dhe pavarësi kombëtare.*”

Çështja e përsëritjes a mospërsëritjes së parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene është trajtuar më gjerë dhe në veprën “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe”, “Sintaksa” 1, 2., ku thuhet se përsëritja a mospërsëritja kushtëzohen nga një sërë faktorësh: nga mënyra dhe lloji i mjetit të bashkimit të gjymtyrëve homogjene, nga arsye gramatikore, nga synimet stilistike³⁹.

Në përgjithësi parafjalët përsëriten kur gjymtyrët me raporte këpujore shqiptohen me një theksim të dukshëm, me pauza më të mëdha midis tyre, për të vënë më mirë në

36 *Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe*, 1973, f. 121-122

37 *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, 1976, f. 181-182

38 M. Totoni, *Libri i gjuhës shqipe 2 për shkollat e mesme*, 1979, f. 103.

39 *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Sintaksa, 1, 2, 1983, f. 119-122.

dukje secilën prej tyre më vete, ose kur gjymtyrët homogjene janë mjaft të zgjeruara. Nuk përsëriten për t'i dhënë ligjërimin një ritëm më të shpejtë ose për të shfaqur lidhjen më të ngushtë të gjymtyrëve:

Herë-herë përsëritja a mospërsëritja e parafjalëve është e detyrueshme. Kështu, përsëritet patjetër parafjala para gjymtyrëve të bashkuara me raporte veçuese, sidomos para gjymtyrëve të bashkuara me lidhëza të përsëritura. Gjithashtu përsëritet ajo para gjymtyrëve homogjene këpujore me nuanca shtesore ose shkallëzimi, përgjithësisht edhe para gjymtyrëve të tjera homogjene këpujore të bashkuara me lidhëza këpujore të përsëritura: *Zakonisht, burrat nuk zbkurohen për shkak të grave të tyre, por për shkak të grave të tjera, por nuk i humbin gratë, atëherë humbin dhe sensin e masës, pra edhe masën e bukurisë, gjë që i bën përshtypje dhe grave të tjera. (O.A.V. 31)); Dalloheshin jo vetëm nga veshja, por edhe nga të ecurit e rëndë, nga gjestet, nga fjalët gjysmake, nga hutimi. Jani u tregua i gatshëm si për ekskursione, si për korin që duhej ndihmuar. Nuk e kishte hallin aq te Rama, sa te Lejlaja. Poetët kanë nisur të mësojnë nga militantizmi i Naimit, por edhe nga ëmbëlsia e gjuhës së tij. Ai më ka ngjallur dashurinë edhe për pyllin, edhe për zogjtë, edhe për njerëzit. Kalia pikëllohej, me sy herë te zjarri, herë te Coli e herë te e bija.*

Me gjymtyrët homogjene të bashkuara asindetikisht të shumtën e herës parafjala përsëritet. Përsëritja kushtëzohet nga shkalla e lidhjes së nocioneve të shprehura prej gjymtyrëve homogjene, nga zgjerimi i tyre dhe masa e këtij zgjerimi, nga largesa e një gjymtyre homogjene prej gjymtyrës së parë, nga karakteri i ligjërimin, nga arsye të veçanta sintaksore, stilistike, ritmike. Mund të kemi edhe kombinim të përsëritjes dhe mospërsëritjes: *Biseduan gjatë për turqit, për mallrat që kishin filluar të vonoheshin për shkak të luftërave, të piratëve apo të murtajës në disa porte të Mesdheut, për blerjen e ishullit të Korfuzit dhe për punët e brendshme të Republikës së Venedikut, e cila, si thoshin ata, do të kishte monopol në det, për sa kohë që turqit nuk kontrollonin asnjë port të rëndësishëm. (O.A.V. 16); Kasnecët e princit shpallën kudo vendimin e tij për të ndaluar këndej e tutje çdo trysni e turpërim, me mjete të tilla, si martesë me gjallesa, drurë, shpendë. (L.F.M. 28); Jo me një njeri që ia kishin vënë atë nofkë për shkak të pabesisë, të pamjes, a të kushedi ç'tjetër shkaku, por me një gjarpër të mirëfilltë. (L.F.M. 21); Ata ishin mësuar të jetonin duke vizatuar ylberin e diellit mbi rroba, mbi vathë, mbi unaza, mbi karfica, mbi varëse floriri, mbi piktura dhe mbi godina të veshura me ar. (O.A.V. 292); Kur Zoti krijoi njeriun, ishte ditë e diel, si sot, dhe meqë ai donte të pushonte i ndau punët dhe vendosi që me trupin të merrej toka, me sytë të merrej hëna, me lëkurën të merrej dielli, ndërsa ai vetë do gatuante shpirtin. (O.A.V. 37)*

Pra siç e vumë re nga sa thamë më lart përsëritja ose jo e një parafjale përpara gjymtyrëve homogjene përcaktohet nga rregullsi të ndryshme. Kështu, parafjala mund të shprehet para çdo gjymtyre homogjene, ose vetëm para së parës, para së parës e të fundit ose, në kur ka shumë gjymtyrë homogjene, para disave po e disave jo. Në gjuhën e shkruar përsëritja e parafjalës para çdo gjymtyre homogjene duket si forma më e rregullt, ndërsa në gjuhën e folur duken si të tepërta.

Në gjuhën shqipe parafjalët që shoqërojnë gjymtyrët homogjene mund të përsëriten përpara çdo gjymtyre ose vetëm përpara gjymtyrës së parë. Këto përdorime

lidhen me rregullsi të ndryshme⁴⁰: *Vinin për ngushëllim, për kureshtje, për t'u dhënë zemër, për t'i dëshpëruar më keq.* (L.F.M. 21); *Të pëlqej? mendoj përvajshëm, me mlllef e shpoti përzier për veten dhe për prindërit dhe fajin që duhej të shlyhej.* (L.F.M. 30); *Gjatë atyre muajve të mbushur me dhimbje, me plagë dhe me zhgënjime gjithmonë kishte pasur mendime të përziera për doktorin.* (O.A.V. 179); *Ndoshta brenda kokës së gruas, apo te goja e saj e lëngshme, apo te veshët nga të cilët merrnin qetësinë, apo te sytë, lëvizjen e kuqe të të cilëve, kishin marrë përsipër t'ia përcillnin gjithë trupit.* (O.A.V. 30); *Këto mendime që shtyheshin nga puhizat e pranverës dhe nga dallgët e buta të detit, e kishin bindur se doktori ishte një breg, në të cilin anija e tij kishte ndaluar për t'u ngarkuar me dashuri.* (O.A.V. 173)

Përsëritja e detyrueshme e parafjalës ose lokucionit parafjalor para çdo gjymtyre homogjene ndodh në rastin e gjymtyrëve me marrëdhënie kundërshtore ose përmbyllëse. Por një gjymtyrë në marrëdhënien kundërshtore mund të dalë pa parafjalë a lokucion parafjalor⁴¹: *Duke vdekur po mbaj dy premtime: ty të thashë që nuk do vdisje, ndërsa vetë zbulova se murtaja nuk vjen nga njerëzit e zinj, si besojnë shumica, por nga kafshët.* (O.A.V. 181); *Tani fëmijët rrinin rrotull tij, në breg të detit, dhe zhurma që bënin kafshët e pashitura nuk i tërhiqnin më, ndoshta sepse e kishin kuptuar se e ardhmja, për të cilën fliste babai i tyre, nuk varej nga kafshët, por nga njerëzit.* (O.A.V. 27); *Tek i biri, Albano Contarini shihte veten e tij, të ndryshuar për shkak të kohës dhe jo për shkak të karakterit.* (O.A.V. 23); *Venediku kishte filluar t'i kursente paratë për paqen, por jo për luftën.* (O.A.V. 22)

Parafjalët ose lokucionet parafjalore përsëriten gjithmonë para gjymtyrës homogjene që është në marrëdhënie përmbyllëse me gjymtyrën a gjymtyrët e mëparshme⁴²: *Dhe ishte e natyrshme të ishte kështu përderisa bëhej fjalë për një faj, pra për një dënim.* (L.F.M. 33)

Parafjala shprehet para gjymtyrës që është në marrëdhënie këpujore shtesore me gjymtyrën para saj⁴³: *Sa për klimën në romanet tona, për të cilën jemi kritikuar shtatë vjet më parë, ne kemi qenë e jemi për zotërimin e klimës pranverore, të qiellit blu socialist, kundër mjegullës, e sidomos kundër shiut...* (I.Sh. 50)

Parafjala shprehet përpara të gjitha gjymtyrëve me marrëdhënie këpujore ose veçuese, kur këto prihen nga lidhëza e lokucione lidhëzore të përsëritura. Gjithashtu ajo shprehet edhe para gjymtyrëve homogjene këpujore të bashkuara me lidhëza a lokucione, të përbëra nga dy mjete lidhëse të ndryshme, si: jo vetëm...por edhe; si... (si) edhe; si...(po) ashtu edhe; nuk...vetëm, por edhe; aq...sa (edhe); sa...aq (edhe)⁴⁴: *Kur ajo vdiq,*

40 M. Domi, *Përsëritja a mospërsëritja e disa fjalëve dhe mjeteve trajtëformuese përpara gjymtyrëve homogjene*, Gjuha jonë, 1986, 3, f.26-33

41 M. Domi, *Përdorimi i parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene*, Gjuha jonë, 2, 1988, f.11

42 Po aty

43 Po aty.

44 Po aty, f. 12.

unë ia mora shpretkën dhe e mbajta në një nga shishet e mia, jo vetëm si kujtim, por edhe si mallkim. (O.A.V. 180); *Gratë në qytet dinin çdo gjë që bënin të tjerët sepse atë e merrnin vesh nga burrat, por dinin shumë pak për burrat e tyre sepse ata flisnin më shumë për të tjerët sesa për vete.* (O.A.V. 30); *Kjo është në fakt më e vërtetë për rrudhat, sesa për vijat e hapura nga plagët.* (O.A.V. 17); *Ai thoshte se e kishte shpëtuar Otellon jo vetëm nga vdekja, por edhe nga paragjykimi që njerëzit kishin për njerëzit e zinj.* (O.A.V. 184)

Përsëritja e parafjalës është e nevojshme përpara gjymtyrës së dytë homogjene këpujore e më tutje, kur gjymtyra e mëparshme është e zgjeruar. Kur nuk është e zgjeruar ajo përcaktohet nga synimet që kemi. Mospërsëritja është e zakonshme kur gjymtyrët homogjene janë të përafërta nga kuptimi: *Unë besoj se ne do të mbetemi më të ditur, por ata do të bëhen më të fortë dhe lufta mes dijes dhe forcës është me çmim më të lartë për dijen.* (O.A.V. 25); *Doktori kishte planifikuar edhe vdekjen, edhe ngjalljen e Otellos duke e mbajtur pasqyrën mbi vdekjen dhe jetën sepse, si një kurioz i pandreqshëm, donte t'i shihte të dyja.* (O.A.V. 184); *Nuk donte ta linte Otellon të ngatërrohej mes Zotit dhe magjisë, mes priftërinjve dhe profetëve, mes vdekjes dhe jetës, mes vrasjes dhe shkencës.* (O.A.V. 186)

Domi⁴⁵ gjithashtu thekson se parafjala përsëritet para një gjymtyre homogjene këpujore a veçuese, të dytë amë tej, kur kjo paraprihet nga një ndajfolje kohe a ndonjë fjalë a togfjalësh sqarues a saktësues, po ashtu përgjithësisht para një gjymtyre homogjene veçuese të bashkuar me lidhëzën apo: *Gjithë këto fytyra që sot shfaqen me një maskë e nesër me një tjetër, si të ishin aktorë teatri, s'parathonë asgjë të mirë, kishte vazhduar mendueshëm.* (L.F.M. 11); *Pavarësisht nga vapa e kafshëve, nga koret e zogjve apo nga kopetë e peshqve, në atë stinë, Vlora shpaloste gjithë ylberin që natyra ia kishte dhënë, duke mos i kursyer asnjë nga ngjyrat që zbukurojnë një qytet: qiellin e pastër, detin e kaltër dhe tokën e gjelbër.* (O.A.V. 173)

Në rastin e disa lokucioneve parafjalore të formuara nga *parafjalë + emër + parafjalë*, si: *në përshtatje me, në përputhje me, në lidhje me* etj. përsëritet para gjymtyrës së dytë homogjene vetëm elementi i fundit parafjalor *me*, ose lihet pa u shprehur gjithë lokucioni⁴⁶: *Nuk ishte asgjë në krahasim me çarjet dhe dhimbjet që kishte provuar dikur.* (O.A.V. 175)

Si përfundim mund të themi se në të dyja gjuhët, shqipe dhe greke, vendi i parafjalës është para emrit me të cilin lidhet nga ana sintaksore. Ka edhe raste kur parafjala mund të mungojë dhe kjo kryesisht para disa gjymtyrëve homogjene.

Në gjuhën greke përcaktori i paravendoset fjalës që përcakton dhe si rrjedhim ai i ndërfitet parafjalës dhe grupit emëror. Një gjë e tillë në gjuhën shqipe nuk ndodh sepse përcaktori e ka vendin pas fjalës që përcakton.

45 Po aty, f. 14.

46 M. Domi, vep. e cit., f. 15.

PËRFUNDIME

1. Shqipja dhe greqishtja janë dy gjuhë të ngjashme me njëra tjetrën pasi i përkasin të njëjtës familje gjuhësore, familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane. Është e vështirë të përcaktohet me saktësi periudha kohore e shfaqjes së greqishtes së hershme, asaj protohelenike, por dimë që në shekullin e 13-të p.e.r, përdorej i ashtuquajtimi lineari B. Lineari B e ka prejardhjen nga lineari A, i cili u përdor nga mesi i shekullit të 18-të deri në mesin e shekullit 15-të p.e.r dhe deri më sot janë publikuar rreth 1500 tekste të shkruara në linearin A. Gjuha greke është përfutur përmes një procesi transformimesh të vazhdueshme që ka pësuar gjuha mëmë indoevropiane, në një periudhë kohore tepër të gjatë.
2. Studimet e shumta kanë nxjerrë në pah ngjashmëritë e dy gjuhëve në rrafshin indoevropian. Studimet për gjuhën greke nuk kanë pasur probleme të diskutueshme, por kanë ndjekur zhvillimin e saj gradual, kalimin në greqishten e re dhe faktorët apo veçoritë e këtij kalimi. Ndërsa për sa i përket gjuhës shqipe ka pasur dhe ka ende diskutime lidhur me origjinën, tipin e saj gjuhësor dhe vendin që zë në familjen gjuhësore indoevropiane. I pari që vërtetoi bindshëm përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoevropiane, ishte gjuhëtari gjerman F. Bopp. Ai arriti në përfundimin se shqipja është gjuhë indoevropiane, por “në elementet e saj themelore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite (indoevropiane) të kontinentit tonë.
3. Në gjuhën shqipe dhe greke termi “parafjalë” është ndeshur qysh në lashtësi, për faktin se është ndjerë i nevojshëm krijimi i një mjeti gjuhësor për të shprehur marrëdhëniet sintaksore të emrit në fjali. Kjo ishte një fjalëz shërbyese që vendosej para një emri a përemri. Në disa gjuhë indoevropiane mund ta gjejmë dhe të prapavendosur, por gjuhët që ne po krahasojmë, shqipja dhe greqishtja, e kanë të paravendosur. Ato vendosen rregullisht para një emri a përemri në një rasë të caktuar, për të shprehur lidhjet e tij sintaksore, përkatësisht me një gjymtyrë tjetër të shprehur nga një emër. Në rastin e parë togu *parafjalë+emër* kryen një funksion ndajfoljor (adverbal), ndërsa në rastin e dytë kryen një funksion ndajemëror (adominal)”. Lindja e klasës së parafjalëve kushtëzohet, si çdo dukuri, nga disa faktorë. Këta faktorë veprojnë të veçuar, por shpesh edhe në bashkëveprim reciprok.
4. Parafjalët në familjen e gjuhëve indoevropiane janë përfutur në një fazë të caktuar të zhvillimit të kësaj familjeje gjuhësh. Ato janë përfutur qysh në një fazë të

Κανείς ασθενής όμως δεν μπορεί να ζει **επ’ άπειρον** παίρνοντας κορτιζόνη. (Τα Νέα, 9/7/96)

2. επί μακρόν – για μακρύ χρονικό διάστημα, για πολύ χρόνο

Υπήρξε φίλος και συνεργάτης μου **επί μακρόν χρόνου** και είχα την ευκαιρία να εκτιμήσω τις σπάνιες αρετές του. (Τα Νέα, 6/10/97)

3. επί σειρά(ν) ετών – για πολλά χρόνια

Η διοίκηση της Ο.Α διόρισε επικεφαλής των ιπτμαμένων συνόδων και φροντιστών έναν επί σειρά συνδικαλιστή. (Το Βήμα, 29/6/97)

4. επί της ουσίας – όσον αναφορά την ουσία, το περιεχόμενο

Επί της ουσίας, όμως, η απόφαση για την απασχόληση και την ανάπτυξη δεν ξεπερνά τα όρια της πολιτικής ρητορείας. (Η Καθημερινή, 22/6/97)

5. επί παντός (του) επιστητού – για κάθε ζητήματα, για καθετί που θα μπορούσε να γνωρίζει το ανθρώπινο μυαλό

Διάφορες διαστημότητες εκδίδουν, με τη μεγαλύτερη ευκολία βιβλία **επί παντός του επιστητού**, όπως και οι πολιτικοί. (Ελευθεροτυπία, 12/6/97)

6. εφ’ όλης της ύλης - σε όλα τα θέματα συγκεκριμένης ύλης ή γενικά, συνολικά

Το απόγευμα της Παρασκευής θα μιλήσει στην σύνοδο της Κ.Ε **εφ’ όλης της ύλης** και θα αποσαφηνίσει όσα ζητήματα ανέκυψαν μετά την πρόσφατη οργανωτική συνδιάσκεψη του ΠΑΣΟΚ. (Το Βήμα, 15/6/97)

7. επί του πρακτέου – σχετικά με το τι πρέπει να πράξει κανείς

Καλά όλα αυτά τα θεωρητικά, τώρα όμως πρέπει να αποφύσουμε **επί του πρακτέου**.

8. επί της αρχής – ως προς τις γενικές αρχές (όχι ως προς ειδικότερα, επιμέρους θέματα)

Τα τρία πρώτα σημεία έχουν γίνει απόδεκτα, **επί της αρχής** τουλάχιστον.

(Το Βήμα, 28/4/96)

9. επί του προκειμένου – σχετικά με το θέμα στο οποίο αναφέρεται κάποιος ή στην περίπτωση που αντιμετωπίζει στο προκείμενο

Τι θα είχατε να προτείνετε **επί του προκειμένου**;

10. επί τα βελτίω – λέγεται για βελτίωση, για καλύτερευση μιας κατάστασης

Η κατάσταση του ασθενούς εξελίσσεται **επί τα βελτίω**.

11. επί τα χείρω – λέγεται για χειροτέρευση, επιδείνωση κατάστασης

Η **επί τα χείρω** εξέλιξη στο μέτωπο των διπλωματικών διαπραγματεύσεων με την Τουρκία.

12. επ’ αυτοφώρω – κατά την εκτέλεση της πράξης

Συνελήφθησαν **επ’ αυτοφώρω** για υπεξαίρεση χρημάτων. (Το Βήμα, 22/5/94)

13. επί ίσοις όροις – με ίσους όρους, χωρίς να υπερέχει, να πλεονεκτεί κάποιος σε σχέση με κάποιον άλλο

Συμμετοχή όλων των εταιριών στην λήψη των αποφάσεων **επί ίσοις όροις**.

14. επί λέξει – κατά λέξη , με τις ίδιες λέξεις, όπως ακριβώς ειπώθηκε ή γράφτηκε κάτι
*Ο δικαστής που είχε αναλάβει την έρευνα συγκεντρώνει τεκμήρια για κατάχρηση κοινωνικών αγαθών, όπως αναφέρεται **επί λέξει**.* (Το Βήμα, 22/5/94)
15. επί παραγγελία – με παραγγελία
*Το φόρεμα ράφτηκε ειδικά για κείνη, **επί παραγγελία**.*
16. επί πιστώσει – (για αγοραπωλησία) με πίστωση
*Τα βιβλία αγοράζονται **επί πιστώσει** και πληρώνονται μετά από ένα μήνα.*
17. επί πληρωμή – με πληρωμή, με αμοιβή
*Ο αστέρας της ροκ έγραψε **επί πληρωμή** δύο τραγούδια.* (Το Βήμα, 22/5/94)
18. επί τροχάδην – γρήγορα, βιστικά, χωρίς ιδιαίτερη προσοχή
*Διάβασέ το **επί τροχάδην** απλώς να καταλάβεις το νόημα.*
19. επ ουδενί(λόγο) – με κανένα λόγο, με τίποτε, με κανέναν τρόπο, καθόλου
*Ένας Θεός ξέρει ότι αν ζούσε εκείνη δε θα δεχόμουν **επ' ουδενί λόγο** να πάρω το Θόδωρο.* (Ταχτση, Το τρίτο στέφανι)
20. επ' αμοιβή – με αμοιβή
*Στο μέλλον όσα ερευνητικά κέντρα παρέχουν και υπερεσίες (**επ' αμοιβή φυσικά**) θα έχουν αυξημένο τακτικό υπολογισμό.* (Το Βήμα, 22/6/97)
21. επ' ονόματι – στο όνομα κάποιου, για λογαριασμό του (προς όφελος ή εναντίον του)
*Η επιταγή εκδόθηκε **επ' ονόματι** του...*
22. επί τη βάσει – με βάση (κάτι συγκεκριμένο) βασιζόμενοι σε κάτι
*Ο υπολογισμός του επιδόματος έγινε **επί τη βάσει** του χρόνου υπηρεσίας.*
23. επί πόνου – λέγεται για κάτι στο οποίο αποδίδουμε υπερβολική σημασία ή μας στενοχωρεί υπερβολικά.
*Πήρε πολύ **επί πόνου** την αποτυχία της στις εξετάσεις.*
24. επί παραδείγματι – παραδείγματος χάρη, για παράδειγμα
*Τα εικονιζόμενα γυαλιά προστατεύουν επίσης από τις αλλεργικές αντιδράσεις που δημιουργούν συχνά στα μάτια αιωρούμενα σωματίδια, όπως είναι **επί παραδείγματι** η γύρις των φυτών.* (Το Βήμα, 1/9/96)
25. επί τούτω – για ορισμένο σκοπό, για συγκεκριμένο λόγο, ή ηθελημένα
*Η αρμοδιότητα εκλογής ανατίθεται σε **επί τούτω** συγκροτούμενο συλλογικό διοικητικό όργανο.*
26. (διατριβή) επί υφηγεσία – χαρακτήριζε άλλοτε διατριβή που εκπονούσε κάποιος με σκοπό να αποκτήσει τον τίτλο του υφηγητή
27. επ' ωφελεία – για καλό, προς όφελος, για το συμφέρον κάποιου
*Ενώ η τράπεζα δεν θα προχωρεί στην υλοποίηση των κυβερνητικών αποφάσεων, οι ενδιαφερόμενοι μάταια θα αναμένουν να πραγματοποιηθούν **επ' ωφελεία** τους τα εξαγγελθέντα.* (Το Βήμα, 29 6/97)
1. επ' αγαθώ – για το καλό κάποιου, για την ωφέλειά του
*Καλείται να αναδείξει και αξιοποιήσει όλες τις υπάρχουσες δυνάμεις της εκκλησίας και της κοινωνίας ενδυναμώνοντας την πνευματική ισχύ της εκκλησιαστικής διοίκησης **επ' αγαθώ** του λαού του Θεού.* (Το Βήμα, 29/6/97)
2. επί χρήμασι – έναντι χρηματικής αμοιβής, με σκοπό το χρηματικό κέρδος

Σχεδόν εγκαταλειμμένη η πόλη, χωρίς ελεύθερους χώρους, με την ιδιωτική εταιρεία – αίτημα να την έχει γεμίσει με **επί χρήμασι** θέσεις παρκαρίσματος.
(Η Καθημερινή, 22/6/97)

3. επ' ευκαιρία / επί τη ευκαιρία – με κάποια συγκεκριμένη ευκαιρία, παίρνοντας αφορμή από κάποιο γεγονός

Επ' ευκαιρία το υπουργείο Παιδείας έχει υπολογίσει πόσες κατά μέσο όρο ώρες το εξάμηνο διαθέτει ένας καθηγητής στην πανεπιστημιακή διδασκαλία.
(Η Καθημερινή, 22/6/97)

Μετά

*Δέχομαι **μετά χαράς**. (rasa gjinore) / Pranoj me kënaqësi.*

Μετά τον σάλο που προκλήθηκε στις εφημερίδες για παράνομους διορισμούς, έγινε δικαστική διερεύνηση του θέματος. (rasa kallëzore) / *Pas skandalit që plasi në gazeta për emërimet e paligjshme, u bënë hetimet rreth çështjes.*

Shprehje:

4. μετά βίας – με τη βία, με μεγάλη δυσκολία

*Οι τρεις αστροναύτες **μετά βίας** διατηρούν μια τελευταία δεξαμενή για την περίπτωση που θα χρειαστεί να επιστρέψουν επειγόντως στη γη. (Το Βήμα, 29/6/97)*

5. μετ' εμποδίων – με εμπόδια, με δυσκολίες – λέγεται και για αγώνισμα δρόμου στο οποίο παρεμβάλλονται για υπερπήδηση διάφορα εμπόδια, φυσικά ή τεχνητά

Μετ' εμποδίων έφθασε η ανθρωπιστική βοήθεια του Δήμου Περιστερίου στο Ντομπόι της Βοσνίας. (Το Βήμα 1/9/96)

6. μετά βαιών και κλάδων – αναφέρεται σε θριαμβευτική, επίσημη, πανηγυρική υποδοχή κάποιου

*Την ΕΟΚ το ΝΑΤΟ, της ΗΠΑ, σήμερα πισωγυρίζουμε και τα καλωσορίζουμε **μετά βαιών και κλάδων** και δημοψηφισμάτων. (Πλωρίτη, Νέα Πολιτικά Β)*

7. μετά φανών και λαμπάδων – χρησιμοποιείται για πανηγυρική, επίσημη υποδοχή κάποιου

8. μετά μυρίων βάσανων – με πολύ κόπο

Μετά μυρίων βάσανων έφτασαν στο προορισμό τους οι εργαζόμενοι εξαιτίας των απεργιών στα αστικά μέσα μεταφοράς.

1. μετά λύπης μου (του) – εκφράζοντας τη λύπη μου για κάτι

Μετά λύπης μου σας ανακοινώνω για απόλυσή σας.

2. μετά μανίας – με μανία, με παθιασμένη και επίμονη προσκόλληση

*Έτρωγε σοκολάτες **μετά μανίας**.*

3. μετά μουσικής – με συνοδεία μουσικής,

Μετά μουσικής! *Αύγουστος, κατά καλόκαιρο, χρώματα, ήχοι και θέματα. (Εγώ, 251, 19-25/8/97)*

4. μετά λόγου – λογικά, με λογική

*Ομιλεί **μετά λόγου**.*

5. μετά φόβου θεού – με μεγάλη προσοχή, σαν να πρόκειται για κάτι ιερό

Μετά φόβου Παπαδήμου. Τι λένε οι εκπρόσωποι τραπεζιών για το ενδεχόμενο υπέρβασης του όριου στα δάνεια. (Τα Νέα, 6/5/99)

6. μετά τιμής / μεθ' υπολήψεως – με τιμή (ή με υπόληψη) – τυπική έκφραση στο τέλος επίσημου εγγράφου, π.χ αίτησης
7. μετά συγχωρήσεως – ας μου συγχωρηθεί η έκφραση (που μπορεί να σκανδαλίσει, να σοκάρει)

Έχοντας – **μετά συγχωρήσεως** – το παλούκι αυτό (της Ολυμπιάδας) να επικρέμαται επί μια επταετία.(Ελευθεροτυπία. 13/9/97)

1. μετά βδελυγμίας – με βδελυγμία, με αηδία, με ακραία απόστροφη
- Τώρα δεν υπάρχει στέλεχος του ΠΑΣΟΚ που να μην αποκήρυξε **μετά εφεύρημα**. (Πλωρίτη, Νέα Πολιτικά Β)

Παρά

Πληροφορήθηκαν **παρά των αρμοδίων**. (rasa gjinore) / U informuan pranë organeve kompetente.

Είναι δικηγόρος **παρ'Άρειω Πάγω**. (rasa dhanore) / Është gjykatës i shkallës së lartë.

Μέρα **παρά μέρα**. (rasa kallëzore) / Një herë në dy ditë.

Shprehje:

2. παρά(πάσαν) προσδοκίαν – αντίθετα απ' ό,τι περιμένει κανείς
Ο υπουργός, **παρά πάσαν προσδοκίαν**, ήταν ανοιχτός προς όλους.(Το Βήμα, 27/394)
3. παρ' αξίαν – χωρίς να αξίζει κάποιος
Έγινε **παρ' αξίαν** καθηγητής πανεπιστημίου.
4. παρ' ελπίδα – χωρίς να το περιμένει κανείς, ανέλπιστα
Αν, **παρ' ελπίδα**, φτάσω νωρίτερα, θα έρθω να σας δω.
5. παρά φύσιν – αντίθετα με τη φύση, ενάντια στους φυσιολογικούς κανόνες, κατά παράβαση των νόμων της φύσης
Έκτοτε, εντός βουλής, σημειώθηκε η **παρά φύσιν** συμπαράταξη όσον αντιτάχθηκαν στην κύρωση της συνθήκης του Σέγκεν. (Το Βήμα 15/6/97)
6. παρά ταύτα – αντίθετα με ό,τι ειπώθηκε ή συνάγεται
Είχε υποσχεθεί ότι θα έρθει, **παρά ταύτα** δεν εμφανίστηκε.
7. παρ' όλα αυτά – εντούτοις
Παρ' όλα αυτά που μου είπες, σε εκτιμάω πολύ.
8. παρά τριχα (να) – με ελάχιστη διαφορά. Λίγο έλειψε να...
Το άλλο αυτοκίνητο ήρθε και έπεσε με δύναμη στο μπροστινό μου, τη γλύτωσα **παρά τριχα**.
9. παρά λίγο / παρ' ολίγον – λίγο έλειψε
Παρ' όλο το ένα δυσεκατομμύριο δραχμές για μια βραδιά φιέστας, παρ' ολίγον οι αγώνες να γίνουν με κενές φίλαθλων κερκίδες, λόγω κακής οργανώσεως. (Το Βήμα , 6/7/97)

10. παρά μια τεσσαρακόντα – λέγεται για κάποιον που έφαγε πολύ ξύλο, δάρθηκε ανήλεως, αλίπητα
*Τσακώθηκε με έναν οδηγό στον δρόμο και εκτός από το ότι βρίστηκαν άσχημα έφαγε **παρά μια τεσσαροκόντα**.*
11. στο παρά πέντε – λίγο πριν να είναι πολύ αργά κάτι
*Έφτασε στο αεροδρόμιο στο **παρά πέντε**, ενώ ήδη γινόταν η τελευταία αναγγελία της πτήσης του.*
12. παρά θιν άλος – στην ακρογιαλιά, κοντά στην ακροθαλάσσια, στην παραλία
*Φάγαμε ρομάντικα, σε ήσυχη ταβέρνα **παρά θιν άλος**.*
13. παρά ποδά – (στρατιωτικό παράγγελμα) με το στρατιώτη να φέρει το όπλο όρθιο και με τον υποκοπάνο να ακουμπάει στο έδαφος δίπλα στο πόδι του
14. παρά το πλευρόν – στο πλευρό κάποιου, για στήριξη και βοήθεια
*Σε όλη την διάρκεια της νοσηλείας της, οι φίλοι της ήταν **παρά το πλευρόν** της.*
1. παρά ποτέ – περισσότερο από κάθε άλλη φορά, όσο ποτέ άλλοτε
*Τώρα **παρά ποτέ** είναι η στιγμή να δράσω.*

Περί

*Η συζήτηση στρέφεται γύρω από το **περί ου** ο λόγος τραγούδι. (Το βήμα, 28/04/1996) (rasa gjinore) / *Biseda zhvillohet rreth këngës në fjalë.**

***Περί τα μεσάνυχτα** ακούστηκε ένας περίεργος θόρυβος. (rasa kallëzore) / *Gjatë mesnatës u dëgjua një zhurmë e çuditshme.**

Shprehje:

2. έχω (κάποιον) περί πολλού – τρέφω ιδιαίτερη εκτίμηση, τιμώ ιδιαίτερα
*Οι αναγνώστες της στήλης αυτής ξέρουν πόσο έχει **περί πολλού** την ελευθερία του τύπου. (Πλωρίτη, Νέα Πολιτική Β)*
3. περί ανέμων και υδάτων – συζήτηση για άσχετα και αδιάφορα πράγματα, χωρίς ορισμένο σκοπό και περιεχόμενο
*Μίλησαν για λίγο **περί ανέμων και υδάτων** και μετά άρχισαν να συζητήσουν για το επίμαχο θέμα.*
4. περί ονού σκιάς – αναφέρεται σε περιπτώσεις όπου γίνεται καβγάς για ασήμαντη υπόθεση, ή γενικά ασχολείται κάποιος σοβαρά με ασήμαντο θέμα
*Εδώ ήρθαμε να μιλήσουμε για το πρόβλημα μας κι όχι **περί ονού σκιάς**.*
5. περί ορέξεως ουδείς λόγος / περί ορέξεως καλοκυθόπιτα – δε χωράει συζήτηση για ατομικές προτιμήσεις, τα γούστα δηλαδή των ανθρώπων είναι διαφορετικά μεταξύ τους δεν υπόκεινται σε κανόνες
6. περί ο λόγος – γι' αυτόν για τον οποίο γίνεται λόγος
*Συζητάμε με τον ίδιο και τη σύζυγο του στο εστιατόριο αθηναϊκού ξενοδοχείου. Η συζήτηση στρέφεται γύρω από το **περί ου ο λόγος** τραγούδι. (Το Βήμα, 28/4/96)*

Προς

Προς Θεού (rasa gjinore) / *Për Zotin*

Θα σε δω προς το απόγευμα. (rasa kallëzore) / *Do të të shoh nga pasditja.*

Shprehje:

7. προς το παρόν – για την ώρα , προσωρινά

Στο ίδιο αυτό σώμα θα μετέχει και η Αλβανία, εκπροσωπούμενη προς το παρόν από την κυβέρνηση εθνικής συμφιλίωσης. (Το Βήμα , 6/7/97)

8. προς στιγμήν – για μια στιγμή

Προς στιγμήν σκέφτηκα να βιάσω το βήμα μου να τον προλάβω να δω το πρόσωπό του, μα, όπως λένε στα μυθιστορήματα, τα πόδια μου δεν με υπάκουσαν. (Ταχτσή, Το τρίτο στεφάνι)

9. προς τιμήν – για να τιμηθεί κάποιος

Το πρόγραμμα θα αρχίσει με την αποχαιρετιστήρια δεξίωση προς τιμή βρετανικής δοοίκησης. (Το Βήμα, 29/6/97)

Υπό

Πήρα το μαξιλάρι μου υπό μαλής, ένα σεντόνι και μια κουβέρτα.(Τ.Τ.Σ) (rasa gjinore)

/Mora jastëkun nën krahë, një çarçaf dhe një kuvertë.

Υπό το έδαφος (rasa kallëzore) / *Nën tokë*

Shprehje:

10. υπό μαλής – κάτω από τη μασχάλη

Πήρα το μαξιλάρι μου υπό μαλής, ένα σεντόνι και μια κουβέρτα.(Ταχτσή, Το τρίτο στεφάνι)

11. υπό τα όπλα σε ένεργο στρατιωτική υπηρεσία

Το υπουργείο πήρε την ευθύνη να καλέσει υπό τα όπλα δύο κλάσεις στρατεύσιμων.

12. υπό τα όρματα - ενόπιοι, μπροστά σε

Γινόταν λαθρεμπόριο υπό τα όρματα (μπροστά στα μάτια) της αστυνομίας.

13. υπό το κράτος – κυριευμένος από κάτι, κάτω από την επήρεια, την επίδραση (κάποιος κατάσταση)

Αλλά πώς να εμπιστευθεί κανείς τις ευκαιριακές – και υπό το κράτος πιέσεων – μεταστροφές σωφρόσυνης της τουρκικής ηγεσίας. (Τα Νέα, 30/9/97)

14. υπό κράτηση – λέγεται όταν κάποιος είναι κρατούμενος

15. υπο περιορισμό – λέγεται για τιμωρία κάποιου με περιορισμό, με υποχρέωση διαμονής σε συγκεκριμένο χώρο

Ο ψυχοπαθής κρίθηκε επικίνδυνος και τέθηκε υπό περιορισμού.

1. υπό σκέψιν – λέγεται όταν σκεφτόμαστε κάτι, υποβάλλουμε κάτι σε εξέταση, σε μελέτη.

Η πιθανότητα για σπουδές στο εξωτερικό είναι υπό σκέψιν.

2. υπό καθεστώς - κατώ από κάθε καθεστώς (με την έννοια της κατάστασης που επικρατεί κάπου).

Τα τελευταία χρόνια ζούμε αναμφίβολα **υπό ένα καθεστώς** υπερπαραγωγής τίτλων βιβλίων. (Τα Νέα, 15/10/97)

3. είμαι υπ' ατμόν _ βρίσκομαι σε αναμονή (για να φύγω, για να αναχωρήσω) ή σε ετοιμότητα για κάτι
4. υπ όρον απόλυση – η χορηγηση αναστολής σε κατάδικο, με τον όρο της απαγόρευσης εξόδου από τη χώρα, της εμφανίσεώς του στο αστυνομικό υμήμα για κάποιο διάστημα, κ.λ.π
5. υπό μορφήν / τύπον – με τη μορφή (συγκεκριμένου πράγματος), με καθορισμένα χαρακτηριστικά

Ενικός προβληματισμός **υπό μορφήν** ερωτημάτων.

1. υπό αίρεσιν – με επιφύλαξη, με πιθανότητα ανατροπής, χωρίς να υπάρχει σταθερότητα και βεβαιότητα

Ακόμη κι όταν η δικαστική κρίση φαίνεται άστοχη, κάθε επικρατικός, έστω και **υπό αίρεση**, σχολιασμός της από κυβερνητικούς παράγοντες εκλαμβάνεται από την κοινή γνώμη ως απόπειρα επηρεασμού. (Ελευθεροτυπία, 10/11/97)

2. υπό την αίρεση – με κάποιο συγκεκριμένο όρο, κάποια προϋπόθεση
Δεν θα σας επιβληθεί ποινή, **υπό την αίρεση** να μην επαναλάβετε αυτό που κάνετε.

3. υπό την σκεπή – κάτω από κάποιο συγκεκριμένο πρίσμα, κάποια άποψη
Οι περισσότεροι γάλλοι διανοούμενοι αντιμετώπιζαν το Σχέδιο Μαρσάλ με κριτικό πνεύμα **υπό το πρίσμα** της διπλωματίας του δολαρίου. (Το Βήμα, 6/7/97)

4. λαμβάνω (κάτι) υπό σημείον – διατηρώ κάτι στη μνήμη μου, προσπαθώ να μην ξεχάσω (κάτι)

1. PARAFJALË QË PËRDOREN VETËM NË NDËRTIME SINTAKSORE

Në grupin e dytë bëjnë pjesë ato fjalë që shërbejnë vetëm si parafjalë të rasave të zhdrejta, pra nuk përdoren në kompozim, si përbërës të parë. Karakteristikë sintaksore e tyre është përdorimi me rasën dhanore ose gjinore. Këto parafjalë nuk shprehin vetëm marrëdhënie sintaksore, por kanë edhe një farë kuptimi leksikor. Në rastet kur si pjesë e kundrinorit me parafjalë, janë të lidhura ngushtë me foljen, zhvishen nga kuptimi i tyre semantik dhe luajnë thjesht një funksion gramatikor. Έφυγε άνευ λόγου / Iku pa arsye. Këto parafjalë përdoren vetëm para fjalës përcaktuese: μέχρι τούδε / deri këtu.

PËRFUNDIME

5. Parafjalët e gjuhës së vjetër greke ndahen në dy grupe: **Kryesore**: janë ato fjalë që përdoren jo vetëm si parafjalë të rasave të zhdrejta, por përdoren edhe si parashtesa. Këto parafjalë janë: *αντί, ανά, από, αμφί, δια, εις, εν, εκ, επί, κατά, μετά, περί, παρά, προς, προ, υπέρ, υπό, συν*. **Parafjalë që përdoren vetëm në ndërtimet sintaksore**: janë ato parafjalë që përdoren vetëm për të shprehur përcaktorët a rrethanorët me parafjalë. Parafjalët abuzive janë: *άνευ, άχρι, ένεκα/ένεκεν, μέχρι, πλήν, χάριν, χωρίς, ώς*.
6. Parafjalët kryesore ndahen në: parafjalë që përdoren me një rasë, që përdoren me dy rase dhe që përdoren me tre rase. Kështu, parafjalë që përdoren me një rasë janë ato të rasës gjinore: *Αντί του Κώστα ήρθε ο Μανόλης. ...για να ισχύσει ο θεσμός χωρίς να δημιουργούνται από καιρού εις καιρόν παρατραγούδια. Είμαι εκ φύσεως υπομονετική και συντηρητική στις εκδηλώσεις μου, προπάντων με ανθρώπους που δεν αγαπώ. Τα μυθηστορήματά του είχαν πάψει όλα να εκδίδονται προ πολλού και ήταν εντελώς ξεχασμένος*. Disa parafjalë përdoren vetëm me rasë dhanore: *Νέα συνάντηση των υπουργών Εξωτερικών Ελλάδος και Αλβανίας βρίσκεται εν όψει. Χιλιάδες πολίτες χειροκρότησαν, συν γυναιζί και τέκνοις, τον κύριο Χ ως αυριανό πρόεδρο της χώρας τους*. Me rasën kallëzore kanë përdorim këto parafjalë: *Ανέβηκε εις το βήμα για να εκφωνήσει λόγο*.
7. Parafjalë që përdoren me dy rase janë: *ανά, δια, κατά, υπέρ*. Parafjala *ανά* i paravendoset një emri në rasë dhanore ose në rasë kallëzore: *...ανά τας οδούς ρύμας και τας αγυιάς...*(rasë dhanore) *Περίοδευε με τους συνεργάτες του ανά στην Ελλάδα*. (rasë kallëzore). Parafjala *δια* paravendoset një emri në rasën gjinore ose në rasën kallëzore: *Στην ψυχή του δεν φθάνει κανείς ούτε δια ξηράς, ούτε δια θαλάσσης*. (rasa gjinore). *Φόνος δι' ασήμαντον αφορμή*. (rasa kallëzore). Parafjala *κατά* i paravendoset një emri të rasës gjinore ose një emri të rasës kallëzore: *Επίθεση κατά του εχθρού*. (rasa gjinore) *Πάμε κατά τη θάλασσα*. (rasa kallëzore) Parafjala *υπέρ* i paravendoset një emri në rasën gjinore ose një emri në rasën kallëzore: *Τάσσομαι υπέρ της δημοκρατίας*. (rasa gjinore). *Υπέρ το εκατομμύριο*. (rasa kallëzore).
8. Parafjalë që përdoren me tri rase janë: *αμφί, επί, μετά, παρά, περί, προς, υπό*, të cilat i paravendoset një emri në rasën gjinore, dhanore dhe kallëzore. *Καθημένοι αμφί πυρ*. (rasa kallëzore) *Είμαστε συνεχώς επί ποδός πολέμου*. (rasa gjinore) *Συνελήφθησαν επ' αυτοφώρω για υπεξαίρεση χρημάτων*. (rasa dhanore). *Παρακολούθησαν τους τεχνικούς επί το έργον*. (rasa kallëzore). *Δέχομαι μετά χαράς*. (rasa gjinore). *Μετά τον σάλο που προκλήθηκε στις εφημερίδες για παράνομους διορισμούς, έγινε δικαστική διερεύνηση του θέματος*. (rasa kallëzore). *Πληροφορήθηκαν παρά των αρμοδίων*. (rasa gjinore). *Είναι δικηγόρος παρ' Άρειω Πάγω*. (rasa dhanore). *Μέρα παρά μέρα*. (rasa kallëzore) *Η συζήτηση στρέφεται γύρω από το περί ου ο λόγος τραγούδι*. (rasa gjinore). *Περί τα*

μεσάνυχτα ακούστηκε ένας περίεργος θόρυβος. (rasa kallëzore) **Προς Θεού!**(rasa gjinore). Θα σε δω **προς το απόγευμα**. (rasa kallëzore). Πήρα το μαξιλάρι μου **υπό μαλής**, ένα σεντόνι και μια κουβέρτα.(rasa gjinore). *Mora jastëkun nën krahë, një çarçaf dhe një kuvertë.*

KREU III

PARAFJALËT DHE SISTEMI RASOR

3.1 Sistemi rasor në gjuhën greke dhe shqipen e sotme

Kategoria gramatikore e rasës i jep emrit atë drejtim që kërkon funksioni i tij në fjali. Shpesh herë kjo varet edhe nga parafjalët. Kuptimi gramatikor i rasave kur përdoren me parafjalë, nuk shprehet vetëm nëpërmjet formës, por edhe me anë të parafjalës. Numri i rasave në gjuhë të ndryshme është i ndryshëm. Gjuha e re greke njih katër rase: *emëroren (Ονομαστική)*, *gjinoren (Γενική)*, *kallëzoren (Αιτιατική)*, *thirroren (Κλητική)*. Gjuha e sotme shqipe njih pesë të tilla: *emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren*. Vlen për t'u përmendur se të dyja gjuhët janë gjuhë indoevropiane dhe kanë pasur një sistem më të pasur rasor, por me zhvillimin e tyre disa rase nuk përdoren më dhe kuptimet e tyre shprehen me anë të rasave të tjera ose me anë të një rase dhe të një parafjale.

Kështu për shembull ka ndodhur me vendoren e dikurshme të shqipes, kuptimi i së cilës tani shprehet me anë të rrjedhore-dhanores si dhe nëpërmjet kallëzores me parafjalë *49 në malt* (vendorja e dikurshme); *malit* (dhanore); *në mal* (kallëzore me parafjalë).

Të njëjtën gjë e vëmë re edhe në gjuhën e sotme greke. Rase dhanore (δοτική) e gjuhës së vjetër greke nuk përdoret më dhe vendin e saj e ka zënë kallëzorja me parafjalë.

Συν γυναιζί και τέκνοις (dhanorja e dikurshme)

Με τις γυναίκες και τα παιδιά (kallëzore me parafjalë)

Rasat shihen të lidhura ngushtë me njëra –tjetrën pasi janë përbërës të një sistemi të vetëm, pikërisht atij të lakimit. Ashtu si gjuha shqipe dhe ajo greke nuk kanë forma të veçanta për të gjitha rasat. Thjeshtimi i trajtave rasore ka bërë të nevojshëm zhvillimin e parafjalëve. Në gjuhën greke, në ndryshim nga gjuha shqipe, nyjat shquese i paravendosen emrit dhe lakohen bashkë me të.

Siç e përmendëm dhe më lart rasat përdoren me parafjalë dhe pa parafjalë. Në gjuhën greke rasat që përdoren me parafjalë janë: rase kallëzore, emërore dhe gjinore.

Lidhur me përcaktimin e rasave që mund të marrin parafjalë, gjuhëtarët shqiptarë nuk kanë qenë të një mendjeje. Sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave⁵⁰ katër janë rasat në gjuhën shqipe që përdoren me parafjalë:

rase emërore, Demiraj thekson se shqipja është e vetmja gjuhë indoevropiane që zotëron parafjalë të cilat përdoren në rasën emërore.

49 *Akademia e shkencave, Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f.107.

50 Po aty, f.107.

rasa gjinore, me të cilën përdoren kryesisht lokucionet e reja parafjalore. Për herë të parë në rastin e shqipes është Çeliku ai që njeh parafjalë të rasës gjinore⁵¹.

rasa dhanore si dhe rasa kallëzore

Ka edhe gjuhëtarë që e shohin rasën dhanore si një rasë të aftë për të marrë një parafjalë. Xhuvani është një tjetër gjuhëtar, i cili dallon përdorimin e dhanores me parafjalë⁵²:

“... janë përdorur në gjuhë dhe parafjalë të tjera, të dala prej disa ndajfoljeve dhe prej disa emrave, që janë përdorur së pari si ndajfolje. Këto farë parafjalësh ndërtohen, si të parmet, me rasa, por më tepër me dhanore-rrjedhore.”

Sipas Çelikut⁵³ me këtë rasë përdoren shumë parafjalë emërore të thjeshta.

Rasën dhanore nga ndërtimet me parafjalë nuk e përjashton as Demiraj.

Ndërsa Dr. Pekmezi sipas kriterit sintaksor i ndan parafjalët në tri grupe:

parafjalë me emërore të shquar

parafjalë me kallëzore (vendore)

parafjalë me gjinore, dhanore, rrjedhore.

3.2 Parafjalët që përdoren me një rasë

Siç përmendëm dhe më lart, rasat më parë nuk janë përcaktuar nga parafjalët, por nga konteksti i gjithë fjalisë. Më pas kur u përforcuan lidhjet e fjalëve me njëra-tjetrën, parafjalët nisën të kërkonin një rasë të caktuar. Por disa parafjalë të gjuhës greke, si dhe disa parafjalë të gjuhës shqipe përdoren me më shumë se një rasë. Ja cilat janë parafjalët që përdoren vetëm me një rasë:

3.2.1 Parafjalët e rasës emërore

Rasa emërore duke qenë “casus rectus”, pra rasë e drejtë, rasa e një gjymtyre të pavarur në fjali, si rregull nuk duhet të ketë parafjalë. Në gjuhën greke ka një përdorim mjaft të paktë të tyre. Dhe pikërisht gjuhëtari i njohur Τριανταφυλλίδης njeh dy të tilla,

51 “... parafjalët emërore të përbëra të rasës gjinore kanë këtë strukturë : Parafjala e parme plus ish – emri, duke qenë “ nyja e përparme” element përbërës, formant gramatikor i emrit pasues në gjinore dhe jo iu. parafjalës” Çeliku, Mehmet, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, në : *Çështje të morfologjisë në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 1997, f. 172-173.

52 Xhuvani, A, vep. e cit., 327.

53 Çeliku, M, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, në : *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1997, f. 144.

parafjalën *για* dhe *από*. Përdorimi i këtyre parafjalëve në rasën emërore është mjaft i rrallë dhe vetëm në disa raste të caktuara. Këto përdoren me emërore kur duan të tregojnë një pikënisje, gjendje ose rezultat (përfundim), dhe emri të cilit i paravendosen luan rolin e kryefjalës. Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës emërore. Parafjalët e rasës emërore përdoren edhe në rasën kallëzore.

Το ξέρω από μικρός. / E njoh që të vogël.

Γυρεύει θέση για επιστάτης. / Kërkon vend pune si kontrollor.

Në rasën emërore përdoren edhe parafjalët *συν* dhe *δια*, kur u paravendosen numërorëve. Nuk shfaqin një formë rasore të qartë.

Δύο συν τρία /dy plus tre

Έξι δια δύο / gjashtë pjesëtim për dy

Ndërsa në gjuhën shqipe kemi vetëm dy parafjalë që përdoren me këtë rasë, pikërisht parafjalët *nga* dhe *te(k)*. Parafjala *te(k)* shfaqet në dy variante fonetiko-drejtskrimore. Varianti *te* përdoret atëherë kur shoqëron një emër apo përemër që fillon me bashkëtingëllore, ndërsa varianti *tek* përdoret kur emri fillon me zanore:

Vite me radhë isha mësuar t'i dëgjoja violinat e jevgjeve, të Peros bashkë me ato të djemve, në mbrëmje, *tek* oborri i jashtëm, në prani të gjithë familjes së madhe të babazitit.. (Kadare I., Çështje të marrëzisë, 2005, f. 15)

Do të ishte gjysma e së keqes sikur mërzia të mbetej *te* librat. (Kadare I., Çështje të marrëzisë, 2005, f. 25)

Përdorimi i rasës emërore me këto dy parafjalë është një përjashtim. Kjo shpjegohet nga përdorimi i këtyre parafjalëve si lidhëza si në fjalitë:

Shkova *te* është bodrumi.

Vij *nga* është lumi.

Nga përdorimi lidhëzor është kaluar në përdorimin parafjalor:

shkova *te* bodrumi dhe vij *nga* lumi

Në krahasim me parafjalët e tjera të gjuhës shqipe që përdoren me rasën dhanore dhe atë kallëzore, këto parafjalë kanë lindur më vonë.

Kur përdoret me parafjalë rase emërore largohet nga funksionet e saj themelore dhe afrohet me rasat e tjera me parafjalë, pikërisht me kallëzoren dhe rrjedhoren.

3.2.2. Parafjalët e rasës gjinore të greqishtes dhe të shqipes

Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës gjinore. Ka disa parafjalë që përdoren në situata të veçanta në rasën gjinore, por përdorim më të gjerë kanë në rasën kallëzore.

Triandafilidhi⁵⁴ në librin e tij “Gramatika e gjuhës së re greke” thekson se “Ka disa parafjalë që kërkojnë një emër në rasën gjinore. Kjo kryesisht shihet në shprehje dhe lokucione të ngurtësuara”

54 Τριανταφυλλίδης, Μ,

Νεοελληνική γραμματική, Selanik, 1993

Rrallë herë me rasën gjinore përdorim parafjalën *σε, σ', για, από* kur i paravendoset një emri para të cilit nënkuptohet fjala shtëpi, ose ndonjë fjalë tjetër analoge me të:

Ήμουν στον θείον μου (στο σπίτι) / Isha tek xhaxhai im. (në shtëpi)

Ήμουν στον Παπαστράτου (στο εργοστάσιο) / Isha tek Papastratu (në fabrikë)

Είμαι για του θείον μου. / Jam nisur për tek xhaxhai im.

Έρχομαι από του πεθερού μου. (το σπίτι) / Vij nga vjehri im. (nga shtëpia)

Parafjala *προς* (për, krah, nga ana e..., në drejtim të...) përdoret në rasën gjinore vetëm në shprehjet:

προς θεού / për Zotin

πάπου προς πάπου / brez pas brezi

Parafjala *κατά* (kundër, rreth) përdoret me rasë gjinore vetëm në disa shprehje të ngurtësuar:

Όλη η περιουσία μου πήγε κατά διαβόλου / E gjithë pasuria ime shkoi dëm. (për dreq)

κατ' ανέμου / si mos më keq

Parafjala *μετά* (pas, me, bashkë) përdoret në rasën gjinore vetëm në shprehjet :

μετά χαράς / me kënaqësi

μετά βίας / me dhunë, me vështirësi

Οι τρεις αστροναύτες μετά βίας διατηρούν μια τελευταία δεξαμενή για την περίπτωση που θα χρειαστεί να επιστρέψουν επιγώντως στη Γη. / Tre astronautët me vështirësi ruajtën një fuçi të fundit në rast kthimi urgjentisht në Tokë. (To Βήμα, 29/06/1997)

Parafjala *αντί* (në vend të) përdoret me rasë gjinore vetëm në fjali të tipit:

Αντί του Κώστα ήρθε ο Μανόλης. / Në vend të Kostës erdhi Manoli.

Parafjala *από* (nga) përdoret me rasë gjinore në shprehjet:

από θεού (nga Zoti)

από χρόνου (nga mot)

από φυσικού του (nga natyra e tij)

από μιας αρχής (nga fillimi)

από γεννησιμιού του (që në lindje)

το έχει από δικού του (e ka nga të tijët)

Përveç parafjalëve të mësipërme, ekzistojnë dhe disa parafjalë të greqishtes së vjetër, që në të shumtën e rasteve i paravendosen një emri në rasën gjinore. Këto kryesisht i hasim në disa fraza stereotipe.

Parafjala *δια* (për, nëpër, përmes) (sot përdoret *για*) :

δια πυρός και σιδήρου (përmes vështirësia), *δια βίου* (gjatë gjithë jetës) etj.

Προγράμματα δια βίου εκπαίδευσης. / Programe arsimimi gjatë gjithë jetës. (Ta Νέα, 13/09/1997)

Parafjala *εκ-εξ* (nga, prej) (sot përdoret *ζε*):

εκ θεού (nga Zoti), *εκ του προχείρου* (pa parapërgatitje), *εξ αίματος* (lidhje gjaku), *εξ ουρανού* (nga qielli)

Parafjala *επί* (*mbi, afër*):

επί τούτου (për këtë), *επί Καποδίστρια* (në periudhën e Kapodhistrias)

Parafjala *προ* (*para*):

προ Χριστού (para Krishtit), *προ ολίγου* (para pak kohe)

Por një përdorim të gjerë parafjalët që i paravendosen rasës gjinore, i takojmë në rastin kur këto parafjalë përdoren si parashtesa:

καταγής (në tokë), *διαμιάς* (menjëherë), *εξαιτίας* (për shkak), *εξάλλου* (veç të tjerash), *εξαρχής* (fillimisht), *εξίσου* (gjithashtu), *εξώρας* (e çastit), *επικεφαλής* (në krye), *επιταύτου* (treth kësaj teme), *επιτέλους* (më në fund), *προπάντων* (mbi të gjitha) etj.

Në gjuhën shqipe parafjalët që shoqërojnë rasën gjinore janë:

1. lokucione parafjalore të formuara nga togjet parafjalë + emër si p.sh.:

me anën, në këmbë, për faj, në kurriz, në dëm, me përjashtim, nga shkaku, për shkak, në fushën, me rastin, në drejtim, në dobi, në të mirë, në sy, në vend, në lëmin, për nder, për hir, nga ana

*Agjencitë e lajmeve ekonomike e ndërkombëtare sqarojnë se, shitjet e mëdha të dollarit erdhën **për shkak të deklaratës** së kryetarit të Rezervës Federale në SHBA... (Korrieri, 01/05/2006, f.11)*

2. lokucioni parafjalor i formuar nga parafjala *si* dhe emri *pasojë*: *si pasojë*

*Pesha e importeve të naftës është rritur ndjeshëm pas vitit 2000, kryesisht **si pasojë e krizave** energjetike që ka pasur vit për vit ekonomia vendase. (Korrieri, 01/05/2006, f.11)*

Nga këta shembuj vëmë re se parafjalët e rasës gjinore janë lokucione emërore që përbëhen nga njëra prej parafjalëve të mirëfillta: *nga, me, në* ose *për* e cila është në krye të lokucionit.

Lidhur me këtë grup parafjalësh ka pasur disa qëndrime⁵⁵:

Cipo njih vetëm parafjalët *në vend* dhe *në mes* që kërkojnë rasën gjinore.

Ndërsa Demiraj thotë: “Për sa u takon lokucioneve *me anë të* (ose *me anën e*), *në vend të*, *në mes të*, etj. ato mund të merren si lokucione të ngurosurra parafjalore, të formuara nga një parafjalë, një emër dhe një nyjë e përparme⁵⁶”

Xhuvani⁵⁷ si pjesë përbërëse të lokucionit pranon dhe nyjën e rasës gjinore që pason, por nuk thotë se me ç’rasë përdoren këto parafjalë.

Çeliku është i pari që i ka trajtuar lokucionet e mësipërme si parafjalë që kërkojnë rasë gjinore. Në shkrimin e tij të vitit 1972 ai shprehet:

55 Cipo, K, *Gramatika Shqipe*, Tiranë 1949, 183

56 Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II*, Tiranë, 1961, f. 275

57 Xhuvani, A, vep. e cit., Tiranë 1980.

“E ashtuquajtura një e përparme e emrit pasues është pjesë përbërëse e këtij emri, tregues gramatikor i rasës gjinore, dhe jo element strukturor i parafjalës emërore”⁵⁸
Këto lokucione përdoren me rasën gjinore pasi kanë dalë nga gjymtyra e parë e një togfjalëshi emër + emër në rasën gjinore. Gjymtyra e parë pësoi ndryshim me kalimin e togfjalëshit në tog. E dyta nuk pësoi asnjë ndryshim formal.

⁵⁸ Çeliku, M, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, në : Çështje të morfologjisë të gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1997, f. 142

3.2.3. Parafjalët e rasës dhanore në greqisht

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në të cilën ka mendime të ndryshme rreth rasës dhanore me parafjalë, në gjuhën e sotme greke nuk ka asnjë parafjalë që të përdoret me rasë dhanore. Përdorim të dendur parafjalët e rasës dhanore kanë pasur në gjuhën e vjetër greke. Në gjuhën e re greke dhanorja ka hyrë vetëm nëpërmjet disa lokucioneve. Këto lokucione janë formuar nga ai grup parafjalësh të gjuhës së vjetër greke, që përdoren edhe si parashtesa plus një emër në rasën dhanore. Sot ajo është zëvendësuar nga kallëzorja me parafjalë:

Ο πιλότος πήρε νέες οδηγίες εν πτήσει. / Piloti mori udhëzime të reja gjatë fluturimit. (στην πτήση) *Η στρατιωτική ζωή εν Ελλάδι.* (στην Ελλάδα) / Jeta ushtarake në Greqi.

Disa nga shprehjet e ngurtësuar që kanë hyrë nga gjuha e vjetër greke janë⁵⁹:

εν μέρει (pjesërisht)
εν διαστάσει (në distancë)
εν γνώσει (në dijeni)
εν δράσει (në veprim)
εν τέλει (përfundimisht)
εν συνόλω (në pergjithësi)
εν χρήσει (në përdorim)
εν τάχει (me shpejtësi)
εν ονόματι (në emër të)
εν σχέσει (në lidhje me)
συν γυναιζί και τέκνοις (të gjithë)
συν Θεώ (me ndihmën e Zotit)
συν το χρόνω (me kalimin e kohës)
παρ' Αρειω Πάγω (pranë Gjykatës së lartë)
επ' αυτοφώρω (në flagrancë)
επί παραδείγματι (për shembull) etj

3.2.4. Parafjalë të rasës dhanore apo parafjalë që përdoren me dy rasa?

A ka gjuha shqipe parafjalë që përdoren me rasën dhanore? Në traditën gramatikore shqiptare rasa dhanore shfaqet si një rasë që përdoret pa parafjalë. Por ka edhe disa gjuhëtarë të cilët në shkrimet e tyre pranojnë përdorimin e parafjalëve edhe me këtë rasë, megjithëse pjesa më e madhe e tyre nuk i shohin si parafjalë vetëm të rasës dhanore, por si parafjalë që përdoren dhe me një rasë tjetër:

59 Τριανταφυλλίδης, Μ,

Νεοελληνική γραμματική, Selanik, 1993

“... Edhe ndajfolja *krahas* në gjuhë të sotme të shkrimit po përdoret si parafjalë e ndërtuar me dhanoren⁶⁰...”

Pra Xhuvani e njeh parafjalën *krahas* si parafjalë të rasës dhanore ashtu sikurse dhe Çeliku e klasifikon në grupin e parafjalëve që përdoren me rasë dhanore.

Për Xhuvanin⁶¹ ekzistojnë disa parafjalë që përdoren me dhanore-rrjedhoren. Në këtë grup ai përfshin parafjalë që kanë dalë nga ndajfolje dhe emra që janë përdorur më parë si ndajfolje, si dhe parafjalën *ndaj* kur ajo tregon kohë:

ndaj mesditës
afër fshatit
përmes fshatit etj.

Emërtimin e këtyre parafjalëve si parafjalë që përdoren me dhanore-rrjedhoren, Xhuvani duhet ta ketë bërë për arsye të mbaresave të njëjta që shfaqin emrat në këto rase në të shquar njëjës e shumës: *-it, -ut, -s, -i, -u, -e; -ve*. Ndryshimi në formë midis dy rasave vihet re vetëm në të pashquarën e numrit shumës: *-sh* për rrjedhoren dhe *-ve* për dhanoren. Mbi këtë fakt Demiraj thotë se ato parafjalë që marrin emrat në shumës me mbaresën *-sh* duhet të trajtohen si parafjalë të rrjedhores, ndërsa ato që shoqërojnë emra në shumës me mbaresën *-ve*, duhet të shihen si parafjalë të rasës dhanore.

Ai i quan parafjalët “*gjatë*” dhe “*afër*” parafjalë me forma rasore jo të qarta pasi ato shfaqen të shoqëruara me emra në të dyja rasat e lartpërmendura. Pra Demiraj i sheh këto parafjalë si parafjalë që përdoren me të dyja rasat.

Për Çelikon, i cili formën rasore me *-ve* e sheh vetëm si dhanore, parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, midis, mes, majë, rrëzë, faqe, anë, bri, krahas, ballë* janë parafjalë të rasës dhanore⁶².

Gjithashtu si parafjalë të rasës dhanore ai klasifikon edhe parafjalë dhe lokucione ndajfoljore⁶³: *lart, jashtë, gjatë, rreth e rrotull, rreth e përqark* etj.

Por duke qenë se ai më poshtë bën shënimin ⁶⁴“Parafjalët e prejardhura nga emrat dhe nga ndajfoljet paraprijnë zakonisht emra në rasën dhanore, por përemra në rrjedhore” mendojmë se këto parafjalë duhet të trajtohen si parafjalë që përdoren me dy rase pra janë dhe parafjalë të dhanores dhe parafjalë të rrjedhores. Sipas Çelikut primare është forma rasore e emrit apo përemrit pasues dhe jo vetë parafjala.

(1) Kalonte *midis* maleve. (dhanore) Jetonte *midis* malesh. (rrjedhore)

(2) Qëndronte *midis* neve⁶⁵. (dhanore) Qëndronte *midis* nesh. (rrjedhore)

60 Xhuvani. A, vep. e cit., 264

61 Xhuvani. A, vep. e cit., 291, 327

62 Çeliku. M, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, në: Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1997, f. 144.

63 Çeliku e të tjerë, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, 2004, f.221.

64 Po aty, f.222.

65 Një ndërtim i tillë është i pasaktë gramatikisht.

Në shembullin e parë kemi përdorimin e parafjalës *midis* si me rasën dhanore ashtu edhe me rasën rrjedhore, ndonëse përdorimi i dytë është më i rrallë.

3.2.5. Parafjalët e rasës kallëzore në greqisht dhe shqip

Në gjuhën greke parafjalët e rasës kallëzore përdoren jo vetëm si lokucione parafjalore, por edhe si parafjalë të mirëfillta:

με, σε, από, κατά, παρά, για, προς, χωρίς

Αλλά δεν είναι το μόνο θέμα για το οποίο δεν έχω εξήγηση. / Por nuk është e vetmja temë për të cilën nuk kam shpjegim. (To Βήμα, 01/02/2003, f.40)

Ato gjejnë përdorim dhe në lokucionet parafjalore:

σχετικά με (lidhur me)

κατευθείαν από (direkt pas)

παίρνοντας υπ' όψη (duke marrë parasysht)

έχοντας υπ' όψη (duke pasur parasysht)

κατ' επανάληψη (vazhdimisht)

Ο Τύπος έχει κατ' επανάληψη εξαγγείλει ανασχηματισμούς που δεν έγιναν..... / Shtypi vazhdimisht ka shpallur reforma, të cilat nuk janë realizuar... (To Βήμα, 01/02/2003, f.40)

Rasa kallëzore është një rasë që përdoret shumë me parafjalë, madje përdorimi i saj pa parafjalë është duke u kufizuar.

Pjesa më e madhe e parafjalëve të thjeshta të gjuhës shqipe përdoret me rasën kallëzore. Xhuvani në studimin që u bën parafjalëve përmend se vihet re që të gjitha parafjalët e parme, me përjashtim të parafjalës *te*, përdoren me rasën kallëzore.

Parafjalët më kryesore me të cilat përdoret kallëzorja janë:

në, më, me, pa, mbi, nën, nëpër, ndër, përmbi, përjashtuar, përfshirë

Dr. Gjëlpera u ul në një fron prej kashte, pranë një tryeze prej druri të bardhë, të mbërthyer me gozhdë. (Konica. F, Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit, 1993, f. 289)

Gjithashtu me rasën kallëzore përdoren edhe lokucionet parafjalore që në strukturën e tyre kanë si element të fundit parafjalën *me*:

bashkë me, tok me, krahasuar me, lidhur me, ngjitur me, në lidhje me, në kundërshtim me, në krahasim me, në pajtim me, në përshtatje me, në raport me, në bashkëpunim me etj.

...kanë mbërritur kritika të shumta në lidhje me drejtimin që i bën (Korrieri, 09/06/2006, f.4)

si dhe lokucioni parafjalor formuar nga parafjala *me* dhe përemri *gjithë: me gjithë*

Me gjithë përpjekjet e policisë, i akuzuari M.A... (Korrieri, 10/12/2005, f. 9)

3.2.6. Parafjalët e rasës rrjedhore në gjuhën shqipe

Siç e përmendëm dhe më lart, në gjuhën shqipe diskutohet nëse parafjalët emërore *buzë, ballë, majë* etj. + *emër* (a *përemër*) janë parafjalë të rasës rrjedhore apo dhanore? Më parë ato janë trajtuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Edhe Gramatika e gjuhës shqipe, botim i Akademisë së Shkencave, nuk njih asnjë parafjalë që të përdoret në rasën

dhanore, duke i klasifikuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Ndërsa për Çelikon këto parafjalë janë të rasës dhanore. Sipas këtij gjuhëtari forma me *-ve*, është gjithmonë në rasën dhanore. Sipas tij, parafjalë të rasës rrjedhore janë ato parafjalë që pasohen nga emra me *-sh* në shumës, ose që funksionalisht njëjësi i përgjigjet shumësit me *-sh*, si dhe nga përemra të rasës rrjedhore.

Sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave parafjalë të rasës rrjedhore janë përveç parafjalës së mirëfilltë *prej* edhe parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, ballë, anë, faqe, kurriz, majë, mes, rrëzë, anë, bri* etj.,

buzë rrugës *faqe* nënës *rrëzë* pemës

Si dhe parafjalët me prejardhje ndajfoljore si: *lart, sipër, krahas, afër, larg, pranë, para, prapa, gjatë, poshtë, jashtë, përreth, nga, anembanë, tutje, tej, kundrejt, rrotull, drejt, krahas, veç, përmes, përballë* etj.

para shtëpisë *afër* shkollës *kundrejt* fitimit

Parafjala me prejardhje foljore *falë* si dhe parafjalët e përngjitura *sipas* e *përveç*.

falë shokëve *sipas* autorit *përveç* Mirës

Çeliku i njeh parafjalët emërore dhe ato ndajfoljore si parafjalë të rasës rrjedhore vetëm kur i paraprijnë një përemri në rrjedhore si dhe emrit me *-sh*, në të kundërt janë të rasës dhanore. Rrallë ndodh që këto parafjalë të paraprijnë një emër në rrjedhore me *-sh*. Gjithashtu Çeliku pranon si parafjalë vetëm të rasës rrjedhore parafjalën e mirëfilltë *prej* para një përemri, ndërsa para një emri ai parapëlqen si normative në vend të kësaj parafjale, parafjalën e emërores *nga*:

u nda *nga* miqtë / u nda *prej* miqsh / u nda *prej* nesh

zbret *nga* malet / zbret *prej* malesh

3.3. Parafjalët me më shumë se një rasë në greqisht dhe në shqip

Në gjuhën greke shumë parafjalë përdoren vetëm me një rasë. Por në këtë gjuhë ka edhe parafjalë të cilat përdoren me më shumë se një rasë. Këto janë parafjalë që përdoren kryesisht me dy rase dhe shfaqin kombinimet e mëposhtme rase:

- (1) gjinore / kallëzore
- (2) emërore / gjinore / kallëzore

(1) Shtatë janë parafjalët që përdoren dhe me rasën gjinore dhe me rasën kallëzore dhe të gjitha janë parafjalë të mirëfillta:

σε, για, προς, κατά, μετά, αντί, από

Përdorimi i këtyre parafjalëve me njërin apo tjetrën rasë është i kushtëzuar nga konteksti. Këto parafjalë nuk mund të përdoren me të dyja rasat në fjali që janë identike nga kuptimi. Ato përdoren në rasën gjinore kur duan të tregojnë një vendndodhje ose drejtim:

(1) (GJ.) Ήμουν *στον* θείου μου. / Isha tek xhaxhai im.

(2) (GJ.) Είμαι *για* του θείου μου. / Jam për tek xhaxhai im.

Në rasën kallëzore këto parafjalë përdoren shumë. Ato mund të tregojnë vendndodhje, kohë, drejtim, shkak, mënyrë etj.:

- (1) (K) Σε λίγες μέρες θα γυρίσω πίσω. / Për pak ditë do të kthehem.
 (2) (K) Για αυτό δεν έφυγα. / Për këtë nuk ika.
 (3) (K) Ο δρόμος πήγαινε κατά το βοριά./ Rruga vazhdonte drejt veriut.

(2) Parafjalët *για* (për) dhe *από* (nga) përdoren me tri rase. Me rasën emërore përdoren kur duan te tregojnë pikënisje, gjendje apo rezultat.

- (1) (E) Τον ξέρω από μικρός. / E njoh që i vogël.
 (2) (E) Περνά για θεός. / Mendjemadh.

Me rasën gjinore përdoren kur duan të tregojnë vendndodhje, shkak, përmbajtje, prejardhje si dhe në disa shprehje të ngurtësuar si:

- από μιας αρχής (që në fillim)*
από χρόνου (nga mot)
από θεού (nga Zoti)
από φυσικού του (nga natyra e tij)
από γεννησιμού του (që në lindje)
το έχει από δικού του (e ka të vetin)

Me rasën kallëzore, siç kemi përmendur edhe më sipër, parafjalët e gjuhës greke përdoren shumë. Ndaj edhe këto dy parafjalë i gjejmë në shumë raste të përdorura me emra a përemra në rasën kallëzore:

- (1) (K) Για όνομα του Χριστού. / Në emër të Krishtit.
 (2) (K) Πετούσε από τη χαρά της. / Fluturonte nga gëzimi.

Në gjuhën shqipe, në të shumtën e rasteve një parafjalë përdoret vetëm me një rasë. Shumë pak parafjalë bëjnë përjashtim nga ky rregull. Ndërsa për gjuhën greke nuk mund të themi të njëjtën gjë. Ka disa parafjalë që përdoren me më shumë se një rasë. Madje po t'i hedhim një sy parafjalëve të greqishtes së vjetër, të cilat kanë hyrë në gjuhën e re greke nëpërmjet shprehjeve të ngurtësuar, do të gjejmë përdorimin e të gjitha parafjalëve me më shumë se një rasë. Për këto shprehje do të flasim në një kapitull të veçantë.

Parafjalët e gjuhës shqipe që përdoren me më shumë se një rasë shfaqin këto kombinime rasore:

- (1) kallëzore / rrjedhore
 (2) gjinore / rrjedhore
 (3) dhanore / rrjedhore
 (4) dhanore / kallëzore / rrjedhore

(1) Përdorimin e saj më të zakonshëm parafjala *për* e ka me rasën kallëzore: *për shkollë, për shkollën, për ty*. Me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët emërtojnë gjymtyrë ose pjesë të trupit të frymorëve: *për këmbë, për flokësh, për dore, për hundësh, për krahu, për qafe etj.*

(2) Me këto dy rase përdoren lokucionet parafjalore emërore: *me anë, në bazë, në mes, për punë dhe për arsye*. Kur këto lokucione parafjalore i paraprijnë një përemri, atëherë përdoren me rasën rrjedhore, ndërsa kur i paraprijnë një emri përdorimi i rasës është në

varësi të trajtës në të cilën ndodhet ai. Ato përdoren me rasën gjinore kur emri është në trajtë të shquar, ose kur shoqërohet nga ndonjë fjalë përcaktuese, ndërsa kur emri është në trajtë të pashquar përdoret me rasën rrjedhore. Këto lokucione parafjalore përdoren dhe me rasën rrjedhore, e atëherë emri merr një kuptim përgjithësues.

Në mes jush kam qëndruar. (rrjedhore)

Ishte *në mes* të oborrit. (gjinore)

(3) Parafjalët që përdoren dhe me dhanoren dhe me rrjedhoren përbëjnë grupin më të madh të parafjalëve që përdoren me dy rase. Si të tilla paraqiten parafjalët emërore të thjeshta si dhe parafjalët ndajfoljore. Kur paraprijnë përemra këto parafjalë përdoren me rasën rrjedhore, ndërsa kur paraprijnë emra ato përdoren zakonisht me rasën dhanore, por kjo nuk përjashton përdorimin e tyre edhe me rrjedhoren. Në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtime paralele jo plotësisht të stabilizuara.

Po ta kërkoje e gjeje *mes* luleve. (dhanore)

I pëlqente shumë të rrinte *mes* lulësh. (rrjedhore)

Donte shumë të rrinte *mes* nesh. (rrjedhore)

Por jo Donte shumë të rrinte *mes* neve.

(4) Grupi i parafjalëve që përdoret me tri rase përbëhet nga një parafjalë e vetme, nga parafjala *ndaj*, e cila përdorimin e saj më të kufizuar e ka me rasën kallëzore, pasi me këtë rasë kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët janë emra të nyjshëm të gjinisë asnjësore: *ndaj të gdhirë*, *ndaj të ngrysur*
Parafjala *ndaj* haset më shpesh me emra dhe përemra në rasën dhanore. Ndërsa me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret kur paraprin disa përemra vetorë.

Do ikim *ndaj* të ngrysur. (kallëzore)

Kujdesi *ndaj* fëmijëve nuk duhet të mungojë. (dhanore)

Ndaj të tjerëve është më i mirë. (dhanore)

Kemi shumë detyrime *ndaj* teje. (rrjedhore)66

3.4 Bashkimi i parafjalëve me nyjën shquese të emrit

Karakteristikë e parafjalës *σε* të gjuhës greke është bashkimi dhe shkrirja e saj në një fjalë të vetme me nyjën shquese të emrave, të cilëve u paravendoset. Ky bashkim është një proces fonetik dhe shoqërohet me rënien e tingullit *-ε* të parafjalës.

Είμαι στην Αθήνα / Είμαι σε την Αθήνα (Jam në Athinë)

Πηγαίνω στο θείου μου / Πηγαίνω στο σπίτι του θείου μου (Shkoj tek daja im) (tek shtëpia e dajës tim)

66 Çeliku e të tjerë, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, 2004

Kjo është një karakteristikë vetëm e kësaj parafjale. Asnjëherë kjo parafjalë kur paraprin një emër në trajtë të shquar nuk mund të jetë e ndarë nga nyja shquese e tij. Kjo parafjalë shkrihet me një shquese të emrave të të tria gjinive, mashkullore, femërore dhe asnjëse, në numrin njëjës e shumës.

PËRFUNDIME

1. Gjuha shqipe dhe gjuha kanë numër të ndryshëm rasash. Në gjuhën shqipe kemi pesë rase: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore. Gjuha greke ka katër rase: emërore, gjinore, kallëzore dhe thirrore. Nëpër gramatika të ndryshme të gjuhës shqipe pranohet se janë katër rasat që sundohen nga parafjalë dhe pikërisht emërorja, gjinorja, kallëzorja dhe rrjedhorja. Por, prof. Çeliku mbështet idenë se edhe rase dhanore mund të sundohet nga parafjalë. Ndërsa në gjuhën greke rase më e sunduar nga parafjalët është kallëzorja dhe më pak gjinorja.
2. Rase emërore duke qenë “casus rectus”, pra rasë e drejtë, rase e një gjymtyre të pavarur në fjali, si rregull nuk duhet të ketë parafjalë. Në gjuhën greke ka një përdorim mjaft të paktë të tyre. Dhe pikërisht gjuhëtari i njohur Τριανταφυλλίδης njih dy të tilla, parafjalën *για* dhe *από*. Përdorimi i këtyre parafjalëve në rasën emërore është mjaft i rrallë dhe vetëm në disa raste të caktuara. Ky përdorim mendohet se vjen nga fjali të thjeshtuara. Këto përdoren me emërore kur duan të tregojnë një pikënisje, gjendje ose rezultat (përfundim), dhe emri të cilit i paravendosen luan rolin e kryefjalës. Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës emërore. Parafjalët e rasës emërore përdoren edhe në rasën kallëzore. *Το ξέρω από μικρός. Γυρεύει θέση για επιστάτης*. Në rasën emërore përdoren edhe parafjalët *συν* dhe *δια*, kur u paravendosen numërorëve. Nuk shfaqin një formë rasore të qartë. *Δύο συν τρία. Έξι δια δύο*. Ndërsa në gjuhën shqipe kemi vetëm dy parafjalë që përdoren me këtë rasë, pikërisht parafjalët *nga* dhe *te(k)*. Parafjala *te(k)* shfaqet në dy variante fonetiko-drejtskrimore. Varianti *te* përdoret atëherë kur shoqëron një emër apo përemër që fillon me bashkëtingëllore, ndërsa varianti *tek* përdoret kur emri fillon me zanore: *Vite me radhë isha mësuar t'i dëgjoja violinat e jevgjve, të Peros bashkë me ato të djemve, në mbrëmje, tek oborri i jashtëm, në prani të gjithë familjes së madhe të babazotit*. Kur përdoret me parafjalë rase emërore largohet nga funksionet e saj themelore dhe afrohet me rasat e tjera me parafjalë, pikërisht me kallëzoren dhe rrjedhoren.
3. Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës gjinore. Ka disa parafjalë që përdoren në situata të veçanta në rasën gjinore, por përdorim më të gjerë kanë në rasën kallëzore. Rrallë herë me rasën gjinore përdorim parafjalën *σε, σ', για, από* kur i paravendoset një emri para të cilit nënkuptohet fjala shtëpi, ose ndonjë fjalë tjetër analoge me të. Edhe në këtë rast mendohet se këto përdorime vijnë si pasojë e thjeshtimit të fjalive më të plota. *Ήμουν στον θείον μου (στο σπίτι) Είμαι για του θείον μου. Έρχομαι από του πεθερού μου. (το σπίτι)*. Parafjalët *προς, κατά, μετά, αντί, από, δια, εκ-εξ, επί, προ* përdoren me rasë gjinore vetëm në disa shprehje të ngurtësuar. Në gjuhën shqipe parafjalët që shoqërojnë rasën gjinore janë: lokucione parafjalore të formuara nga togjet parafjalë + emër si p.sh. *me anën, në këmbë, për faj, në kurriz, në dëm, me përjashtim, nga shkak, për shkak, në fushën, me rastin, në drejtim, në dobi, në të mirë, në sy, në vend, në lëmin, për nder, për hir, nga ana*. Agjencitë e lajmeve ekonomike e ndërkombëtare sqarojnë

se, shitjet e mëdha të dollarit erdhën për shkak të deklaratës së kryetarit të Rezervës Federale në SHBA. Lokucioni parafjalor i formuar nga parafjala si dhe emri pasojë: si pasojë Pësia e importeve të naftës është rritur ndjeshëm pas vitit 2000, kryesisht si pasojë e krizave energjetike që ka pasur vit për vit ekonomia vendase. Nga këta shembuj vëmë re se parafjalët e rasës gjinore janë lokucione emërore që përbëhen nga njëra prej parafjalëve të mirëfillta: nga, me, në ose për e cila është në krye të lokucionit.

4. Në ndryshim nga gjuha shqipe, në të cilën ka mendime të ndryshme rreth rasës dhanore me parafjalë, në gjuhën e sotme greke nuk ka asnjë parafjalë që të përdoret me rasë dhanore. Përdorim të dendur parafjalët e rasës dhanore kanë pasur në gjuhën e vjetër greke. Në gjuhën e re greke dhanorja ka hyrë vetëm nëpërmjet disa lokucioneve. Këto lokucione janë formuar nga ai grup parafjalësh të gjuhës së vjetër greke, që përdoren edhe si parashtesa plus një emër në rasën dhanore. Sot ajo është zëvendësuar nga kallëzorja me parafjalë: *Ο πιλότος πήρε νέες οδηγίες εν πτήσει.* (στην πτήση). *Η στρατιωτική ζωή εν Ελλάδι.* (στην Ελλάδα). Në traditën gramatikore shqiptare rasa dhanore shfaqet si një rasë që përdoret pa parafjalë. Por ka edhe disa gjuhëtarë të cilët në shkrimet e tyre pranojnë përdorimin e parafjalëve edhe me këtë rasë, megjithëse pjesa më e madhe e tyre nuk i shohin si parafjalë vetëm të rasës dhanore, por si parafjalë që përdoren dhe me një rasë tjetër. Xhuvani e njëj parafjalën *krahas* si parafjalë të rasës dhanore ashtu sikurse dhe Çeliku e klasifikon në grupin e parafjalëve që përdoren me rasë dhanore. Xhuvani pranon se ekzistojnë disa parafjalë që përdoren me dhanore-rrjedhoren. Në këtë grup ai përfshin parafjalë që kanë dalë nga ndajfolje dhe emra që janë përdorur më parë si ndajfolje, si dhe parafjalën *ndaj* kur ajo tregon kohë: *ndaj* mesditës, *afër* fshatit, *përmes* fshatit. Për Çelikun, parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, midis, mes, majë, rrëzë, faqe, anë, bri, krah, ballë* janë parafjalë të rasës dhanore.
5. Në gjuhën greke parafjalët e rasës kallëzore përdoren jo vetëm si lokucione parafjalore, por edhe si parafjalë të mirëfillta: *με, σε, από, κατά, παρά, για, προς, χωρίς. Αλλά δεν είναι το μόνο θέμα για το οποίο δεν έχω εζήγηση.* Rasa kallëzore është një rasë që përdoret shumë me parafjalë, madje përdorimi i saj pa parafjalë është duke u kufizuar. Pjesa më e madhe e parafjalëve të thjeshta të gjuhës shqipe përdoret me rasën kallëzore. Parafjalët më kryesore me të cilat përdoret kallëzorja janë: *në, më, me, pa, mbi, nën, nëpër, ndër, përmbi, përjashtuar, përfshirë* Dr. Gjëlpera u ul *në një fron* prej kashte, *pranë një tryeze* prej druri të bardhë, të mbërthyer me gozhdë. Gjithashtu me rasën kallëzore përdoren edhe lokucionet parafjalore që në strukturën e tyre kanë si element të fundit parafjalën *me*: *bashkë me, tok me, krahasuar me, lidhur me, ngjitur me, në lidhje me, në kundërshtim me, në krahasim me, në pajtim me, në përshtatje me, në raport me, në bashkëpunim me* etj. ...kanë mbërritur kritika të shumta *në lidhje me drejtimin* që i bën.

6. Në gjuhën shqipe diskutohet nëse parafjalët emërore *buzë, ballë, majë* etj. + *emër* (a *përemër*) janë parafjalë të rasës rrjedhore apo dhanore? Më parë ato janë trajtuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Edhe Gramatika e gjuhës shqipe, botim i Akademisë së Shkencave, nuk njeh asnjë parafjalë që të përdoret në rasën dhanore, duke i klasifikuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Ndërsa për Çelikon këto parafjalë janë të rasës dhanore. Parafjalë të rasës rrjedhore janë përveç parafjalës së mirëfilltë *prej* edhe parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, ballë, anë, faqe, kurriz, majë, mes, rrëzë, anë, bri* etj. Si dhe parafjalët me prejardhje ndajfoljore si: *lart, sipër, krahas, afër, larg, pranë, para, prapa, gjatë, poshtë, jashtë, përreth, nga, anembanë, tutje, tej, kundrejt, rrotull, drejt, krahas, veç, përmes, përballë* etj. në gjuhën greke rasa rrjedhore nuk ekziston dhe si për rrjedhojë as parafjalë të kësaj rase. Rrjedhorja e shqipes jepet në greqisht kryesisht me kallëzore.

7. Në gjuhën greke shumë parafjalë përdoren vetëm me një rasë. Por në këtë gjuhë ka edhe parafjalë të cilat përdoren me më shumë se një rasë. Këto janë parafjalë që përdoren kryesisht me dy rasa dhe shfaqin kombinimet e mëposhtme rase:

gjinore / kallëzore
emërore / gjinore / kallëzore

Në gjuhën shqipe, në të shumtën e rasteve një parafjalë përdoret vetëm me një rasë. Shumë pak parafjalë bëjnë përjashtim nga ky rregull. Parafjalët e gjuhës shqipe që përdoren me më shumë se një rasë shfaqin këto kombinime rase:

kallëzore / rrjedhore
gjinore / rrjedhore
dhanore / rrjedhore
dhanore / kallëzore / rrjedhore

Përdorimin e saj më të zakonshëm parafjala *për* e ka me rasën kallëzore: *për shkollë*. Me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët emërtojnë gjymtyrë ose pjesë të trupit të frymorëve: *për këmbë*. Parafjalët që përdoren dhe me dhanoren dhe me rrjedhoren përbëjnë grupin më të madh të parafjalëve që përdoren me dy rasa. Si të tilla paraqiten parafjalët emërore të thjeshta si dhe parafjalët ndajfoljore.

Po ta kërkoje e gjeje *mes* luleve. (dhanore) I pëlqente shumë të rrinte *mes* lulesh. (rrjedhore) Donte shumë të rrinte *mes* nesh. (rrjedhore)

Por jo Donte shumë të rrinte *mes* neve.

1. Grupi i parafjalëve që përdoret me tri rasa përbëhet nga një parafjalë e vetme, nga parafjala *ndaj*, e cila përdorimin e saj më të kufizuar e ka me rasën kallëzore, pasi me këtë rasë kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët janë emra të nyjshëm të gjinisë asnjane: *ndaj të gdhirë, ndaj të ngrysur*. Parafjala *ndaj* haset më shpesh me emra dhe përemra në rasën dhanore. Ndërsa me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret kur paraprin disa përemra vetorë.

Do ikim *ndaj* të ngrysur. (kallëzore)
Kujdesi *ndaj* fëmijëve nuk duhet të mungojë. (dhanore)
Ndaj të tjerëve është më i mirë. (dhanore)
Kemi shumë detyrime *ndaj* teje. (rrjedhore)

2. Karakteristikë e parafjalës *σε* të gjuhës greke është bashkimi dhe shkrirja e saj në një fjalë të vetme me një shquese të emrave, të cilëve u paravendoset. Ky bashkim është një proces fonetik dhe shoqërohet me rënien e tingullit *-ε* të parafjalës. Είμαι *στην* Αθήνα . / Είμαι *σε την* Αθήνα.

KREU IV

PARAFJALËT DHE MARRËDHËNIET SINTAKSORE

Zhvillimi i mëtejshëm i klasës së parafjalëve erdhi si pasojë e sinkretizimit dhe thjeshtimit të sistemit rasor. Numri i kufizuar i rasave si dhe paraqitja njësoj e disa formave të rasave të ndryshme, nuk mund të shprehte më me saktësi kuptimet e shumta dhe nuancat e larmishme sintaksore që solli zhvillimi i gjuhës.

Parafjalët kanë aftësinë për të shprehur në mënyrë më të diferencuar dhe specifike se rasat, marrëdhëniet dhe lidhjet midis gjymtyrëve të fjalisë, aftësi kjo që lidhet me kuptimin e tyre apo me kuptimin që ato marrin në sintagmë.

Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, e cila nuk mund të jetë gjymtyrë më vete, por formon gjymtyrë fjalië në marrëdhënie me pjesë të tjera të ligjëratës, kryesisht me emra.

Fakti që parafjalët nuk mund të përdoren si gjymtyrë më vete lidhet me semantikën e tyre të kushtëzuar. Kuptimi leksikor i parafjalëve ka qenë një temë e debatuar, pasi disa gjuhëtarë e shohin atë të zhveshur nga ana leksikore. Sipas Janakopulos parafjalët e mirëfillta shprehin vetëm marrëdhënie sintaksore, dhe nuk kanë asnjë kuptim⁶⁷.

Është e vërtetë që disa parafjalë kanë një kuptim shumë të përgjithshëm, i cili konkretizohet brenda togfjalëshit dhe varet nga të dyja gjymtyrët e tij:

1. *Αυτή πάει στο Λονδίνο.* / Ajo shkon në Londër. (marrëdhënie hapësinore)
2. *Αυτή πάει σε δύο μέρες.* / Ajo ikën për dy ditë. (marrëdhënie kohore)
3. *Αυτός σκέφτεται για την οικογένειά του.* / Ai mendon për familjen e tij. (marrëdhënie objektore)
4. *Αυτός δουλεύει για την οικογένειά του.* / Ai punon për familjen e tij. (marrëdhënie shkakore)⁶⁸

Zbehja e kuptimit të tyre leksikor ka bërë që të përdoren me shumë kuptime, pra të jenë polisemantike. Ndërsa parafjalët të formuara nga fjalë të tjera të ligjëratës veçanërisht parafjalët ndajfoljore dhe ato emërore, kanë një kuptim më të qartë, i cili lidhet me atë të fjalëve nga ato kanë ardhur. Këto parafjalë kanë lindur për të shprehur në mënyrë më të diferencuar dhe më të përpiktë marrëdhëniet e shprehura nga parafjalët polisemantike, ndaj dhe pjesa më e madhe e tyre shpreh një marrëdhënie të caktuar:

⁶⁷ Γιαννακόπουλου Π. Ε. *Συντακτικό της νεοελληνικής γλώσσας*, 1996.

⁶⁸ Akademia e Shkencave, *Gramatika I*, Tiranë 1995, f. 382.

1. ...κάθισε *πλάι στην κυρία του*,.../...u ul përbri zonjës së tij... (marrëdhënie hapësinore) (Πολίτης.Κ., Στου Χατζηφράφγου, f.153)

2. *Te tremja, përbri dhomës së tezes së vogël.* (marrëdhënie hapësinore)
(Kadare. I, Çështje të marrëzisë, f. 65)

Në marrëdhënien parafjalë/raporte sintaksore të të dyja gjuhëve, vihet re një dukuri e dyfishtë: nga njëra anë e njëjta parafjalë shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore, të tilla janë parafjalët polisemantike:

1. *Βγήκε από το καφενείο.* / Doli nga kafeneja. (vend)
2. *Τα έπιπλα είναι από ξύλο.* / Mobiliet janë prej druri. (material)
3. *Αρρωστήσαμε από το κρύο.* / U sëmurëm nga të ftohtët. (shkak)

1. *Shkova në shtëpi.* (vend)
2. *Do të niset në Dhjetor.* (kohë)
3. *Ishte thelluar në diçka.* (kufizim)
4. *Tha në mënyrë të shpenguar.* (mënyrë)⁶⁹

dhe nga ana tjetër të njëjtat marrëdhënie sintaksore mund të shprehen me parafjalë të ndryshme:

1. *Γύρισαν κατά τα μεσάνυχτα.* / U kthyen rreth mesnatës. (kohë)
2. *Τον περιμέναμε ως το πρωί.* / E pritëm deri në mëngjes. (kohë)
3. *Φεύγω για πάντα.* / Po iki përgjithmonë. (kohë)
4. *Θα σε περιμένουμε προς το βράδυ.* / Do të presim nga darka. (kohë)

1. *Nuk trembej prej asgjëje.* (shkak)
2. *Për një pe, vajti dëm një gunë e tërë.* (shkak)
3. *Fëmija ishte tretur nga ethet.* (shkak)⁷⁰
4. *... dhe shoqërisë në përgjithësi, për shkak të ndikimit të padiskutueshëm të arsimit...* (shkak) (Korrieri, 26/04/2006, f. 11)

Gjuha greke nuk njihet asnjë parafjalë që të shprehë vetëm një marrëdhënie të caktuar. Në gjuhën shqipe ndodh e kundërta. Kështu kemi:

Parafjala *për shkak* shpreh vetëm marrëdhënie shkakore:

...*për shkak të veshëve të ungit të madh* ... (Kadare. I. Çështje të marrëzisë, 2005, f. 32)

Parafjala *me gjithë* shpreh vetëm marrëdhënie lejore:

Me gjithë përpjekjet e bëra ky rezultat nuk i justifikonte shpenzimet.

⁶⁹ Shembujt marrë nga Çeliku e të tjerë, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, 2004, f. 227.

⁷⁰ Shembujt marrë nga Akademia e Shkencave, *Gramatika I*, Tiranë 1995, f. 389 – 395.

Parafjalët shprehin marrëdhënie sintaksore të ndryshme:

a) marrëdhënie objektore

Nëpërmjet këngës dhe recitimit ai mishëroi... (Korrieri, 20/04/2006, f. 19)

b) Apo rrethimore si: hapësinore, kohore, shkakore, qëllimore etj

... **me qëllim njohjen** dhe përkthimin.. (marrëdhënie qëllimore) (Korrieri, 24/04/2006, f. 20) ... **para vitit 1944**, sa shkrimtarë ... (marrëdhënie kohore) (Korrieri, 29/04/2006, f. 16)

Parafjalë të mirëfillta janë parafjalët që shprehin marrëdhënie të shumëllojshme, karakteristikë kjo e parafjalëve të të dyja gjuhëve. Lokucionet parafjalore në veçanti shprehin një numër më të kufizuar marrëdhëniesh, madje shumë prej tyre një lloj marrëdhënie të vetme.

1. *Και τελικά νομίζω πως, αν κάποια στιγμή εξ ανάγκης αποχωριστώ όσα αγαπώ, θα το μετανιώσω την επόμενη στιγμή.* / Dhe përfundimisht mendoj se nëse detyrimisht humbas ato çka dua, do të pendohem në moment. (marrëdhënie shkakore) (Τα Νέα, 7/10/1997, f. 33)

2. “*Matura shtetërore*” **në krahasim me format e tjera** ... (Korrieri, 12/05/2006, f. 15)

Një pjesë e mirë e parafjalëve si në gjuhën greke ashtu edhe në gjuhën shqipe shprehin marrëdhënie vendore dhe kjo ndodh për dy arsye: Së pari parafjalët e mirëfillta kanë lindur nga ndajfoljet e vendit, dhe si të tilla fillimisht kanë shprehur marrëdhënie hapësinore (*σε, προς, κατά, μετά, από; në, për te(k), më, mbi, nën*).

1. *Ο Τζώνης, πάντα στην ίδια θέση, γονατιστός, με το κεφάλι σκυφτό.* (Πολίτης. Κ. Στου Χατζιφράγκου, 1964, f.76) / Xhoni, gjithmonë në të njëjtin vend, i gjunjësuar, kokëulur.

2. ... *памја e tij kur u ngjit në foltore s’na u duk e keqe.* (Kadare. I. Çështje të marrëzisë, 2005, f. 28)

Së dyti, një pjesë e mirë e parafjalëve jo të parme është formuar kryesisht nga ndajfolje vendi. Të tilla janë shumë parafjalë ndajfoljore të gjuhës greke si dhe të gjitha

parafjalët ndajfoljore të gjuhës shqipe me përjashtim të parafjalëve *krahas* dhe *veç*, të cilat janë formuar nga ndajfolje mënyrore dhe parafjalës *gjatë*, e cila ndonëse është formuar nga një ndajfolje kohe shpreh dhe marrëdhënie hapësinore:

δίπλα (përbri, afër), *μακριά* (larg), *κοντά* (afër), *κατά* (kundër, drejt), *μετά* (pas), *προς* (kundrejt), *ανάμεσα* (ndërmjet, midis), *afër*, *larg*, *pranë*, *para*, *prapa*, *gjatë*, *poshtë*, *jashtë*, *përreth*, *sipër*, *lart*, *rreth e rrotull*.

1. ...*με μια τρύπα ανάμεσα στα φρούδια*. (Θεοτοκας. Γ, Αργώ, 1933 f. 123) / ..me një vrimë midis vetullave.
2. *Arifeja, e fshehur prapa derës, nxori përsëri zërin e hollë të saj*. (Konica. F. Dr. Gjilpëra kërkon rrënjët e dramës së Mamurrasit, 1924, f. 143)

Në gjuhën greke marrëdhënie hapësinore shprehin dhe disa parafjalë mbiemërore: *βόρεια* (në veri), *δυτικά* (në perëndim), *ανατολικά* (në lindje), *νότια* (në jug).

Βρίσκεται νότια της Ευρώπης. / Gjendet në jug të Evropës.

Marrëdhënie hapësinore shprehin të gjitha parafjalët emërore të thjeshta të gjuhës shqipe të cilat kanë dalë drejtpërdrejt nga rasat e zhdrejta të emrave, si dhe ndonjë lokucion: *buzë*, *ballë*, *anë*, *faqe*, *kurriz*, *majë*, *mes*, *rrëzë*, *anë*; *në mes*, *në drejtim* ... *shëtitore buzë liqenit*, *kuvende katolike*... (Konica. F. Vepra, 1993, f. 394)

Në të dyja gjuhët parafjalët shërbejnë për të shprehur marrëdhënie të ndryshme sintaksore. E njëjta parafjalë mund të shprehë marrëdhënie të ndryshme si për shembull parafjala *nga* në shqip dhe parafjala *από* (nga) në greqisht. Gjithashtu e njëjta marrëdhënie sintaksore mund të shprehet nga parafjalë të ndryshme. Një pjesë e mirë e parafjalëve si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke shprehin marrëdhënie vendore.

PËRFUNDIME

1. Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, e cila nuk është në gjendje të formojë gjymtyrë fjalie, por është pjesë e saj dhe kryen një funksion të caktuar,

atë të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore brenda togfjalëshit. Ato kanë aftësinë për të shprehur në mënyrë më të diferencuar dhe specifike se rasat, marrëdhëniet dhe lidhjet midis gjymtyrëve të fjalisë, aftësi kjo që lidhet me kuptimin e tyre apo me kuptimin që ato marrin në sintagmë. Fakti që parafjalët nuk mund të përdoren si gjymtyrë më vete lidhet me semantikën e tyre të kushtëzuar. Kuptimi leksikor i parafjalëve ka qenë një temë e debatuar, pasi disa gjuhëtarë e shohin atë të zhveshur nga ana leksikore. Sipas Janakopulos parafjalët e mirëfillta shprehin vetëm marrëdhënie sintaksore, dhe nuk kanë asnjë kuptim. Disa parafjalë kanë një kuptim shumë të përgjithshëm, i cili konkretizohet brenda togfjalëshit dhe varet nga të dyja gjymtyrët e tij:

Αυτή πάει στο Λονδίνο. / Ajo ikën në Londër. (marrëdhënie hapësinore)

Αυτή πάει σε δύο μέρες. / Ajo ikën për dy ditë. (marrëdhënie kohore)

Αυτός σκέφτεται για την οικογένειά του. / Ai mendon për familjen e tij. (marrëdhënie objektore)

Αυτός δουλεύει για την οικογένειά του. / Ai punon për familjen e tij. (marrëdhënie shkakore)

2. Në marrëdhënien parafjalë/raporte sintaksore të të dyja gjuhëve, vihet re një dukuri e dyfishtë: nga njëra anë e njëjta parafjalë shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore, të tilla janë parafjalët polisemantike:

Βγήκε από το καφενείο. / Doli nga kafeneja. (vend)

Τα έπιπλα είναι από ξύλο. / Mobiliet janë prej druri. (material)

Αρρωστήσαμε από το κρύο. / U sëmurëm nga të ftohtët. (shkak)

Shkova në shtëpi. (vend)

Do të niset në Dhjetor. (kohë)

Ishte thelluar në diçka. (kufizim)

Tha në mënyrë të shpenguar. (mënyrë)

dhe nga ana tjetër të njëjtat marrëdhënie sintaksore mund të shprehen me parafjalë të ndryshme:

Γύρισαν κατά τα μεσάνυχτα. / U kthyen rreth mesnatës. (kohë)

Τον περιμέναμε ως το πρωί. / E pritëm deri në mëngjes. (kohë)

Φεύγω για πάντα. / Po iki përgjithmonë. (kohë)

Θα σε περιμένουμε προς το βράδυ. / Do të presim nga darka. (kohë)

Nuk trembej prej asgjëje. (shkak)

Për një pe, vajti dëm një gunë e tërë. (shkak)

Fëmija ishte tretur nga ethet. (shkak)⁷¹

... dhe shoqërisë në përgjithësi, për shkak të ndikimit të padiskutueshëm të arsimit... (shkak)

71 Shembujt marrë nga Akademia e Shkencave, *Gramatika I*, Tiranë 1995, f. 389 – 395.

1. Gjuha greke nuk njih asnjë parafjalë që të shprehë vetëm një marrëdhënie të caktuar. Në gjuhën shqipe ndodh e kundërta. Kështu, parafjala *për shkak* shpreh vetëm marrëdhënie shkakore: ...**për shkak të veshëve të ungjit të madh** ...

Parafjala *me gjithë* shpreh vetëm marrëdhënie lejore: **Me gjithë përprjekjet e bëra ky rezultat nuk i justifikonte shpenzimet.**

Parafjalët shprehin marrëdhënie sintaksore të ndryshme:

a) marrëdhënie objektore: **Nëpërmjet këngës dhe recitimit ai mishëroi...**

b) Apo rrethore si: hapësinore, kohore, shkakore, qëllimore etj

... **me qëllim njohjen** dhe përkthimin.. (marrëdhënie qëllimore) ... **para vitit 1944**, sa shkrimtarë ... (marrëdhënie kohore)

2. Ndërsa parafjalët e mirëfillta shprehin marrëdhënie të shumëllojshme, karakteristikë kjo e parafjalëve të të dyja gjuhëve, lokucionet parafjalore në veçanti shprehin një numër më të kufizuar marrëdhëniesh, madje shumë prej tyre një lloj marrëdhënie të vetme:

Και τελικά νομίζω πως, αν κάποια στιγμή εξ ανάγκης αποχωριστώ όσα αγαπώ, θα το μετανιώσω την επόμενη στιγμή. / Dhe përfundimisht mendoj se nëse detyrimisht humbas ato çka dua, do të pendohem në moment. (marrëdhënie shkakore)

“Matura shtetërore” në krahasim me format e tjera ... (marrëdhënie mënyre)

3. Një pjesë e mirë e parafjalëve si në gjuhën greke ashtu edhe në gjuhën shqipe shprehin marrëdhënie vendore dhe kjo ndodh për dy arsye: Së pari parafjalët e mirëfillta kanë lindur nga ndajfoljet e vendit, dhe si të tilla fillimisht kanë shprehur marrëdhënie hapësinore (*σε, προς, κατά, μετά, από; në, për te(k), më, mbi, nën*).

Ο Τζώνης, πάντα στην ίδια θέση, γονατιστός, με το κεφάλι σκυφτό. / Xhoni, gjithmonë në të njëjtin vend, i gjunjësuar, kokëulur.

... *παμja e tij kur u mgjit në foltore s'na u duk e keqe.*

Së dyti, një pjesë e mirë e parafjalëve jo të parme është formuar kryesisht nga ndajfolje vendi. Të tilla janë shumë parafjalë ndajfoljore të gjuhës greke si dhe të gjitha parafjalët ndajfoljore të gjuhës shqipe me përjashtim të parafjalëve *krahas* dhe *veç*, të cilat janë formuar nga ndajfolje mënyrore dhe parafjalës *gjatë*, e cila ndonëse është formuar nga një ndajfolje kohe shpreh dhe marrëdhënie hapësinore: *δίπλα* (përbri, afër), *μακριά* (larg), *κοντά* (afër), *κατά* (kundër, drejt), *μετά* (pas), *προς* (kundrejt), *ανάμεσα* (ndërmjet, midis), *afër, larg, pranë, para, prapa, gjatë, poshtë, jashtë, përreth, sipër, lart, rreth e rrotull.*

...*με μια τρύπα ανάμεσα στα φρύδια.* / ..me një vrimë midis vetullave.

Αριφεja, e fshehur prapa derës, nxori përsëri zërin e hollë të saj.

4. Në gjuhën greke marrëdhënie hapësinore shprehin dhe disa parafjalë mbiemërore: *βόρεια* (në veri), *δυτικά* (në perëndim), *ανατολικά* (në lindje), *νότια* (në jug). *Βρίσκεται νότια της Ευρώπης.* / Gjendet në jug të Evropës.

Marrëdhënie hapësinore shprehin të gjitha parafjalët emërore të thjeshta të gjuhës shqipe të cilat kanë dalë drejtpërdrejt nga rasat e zhdrejta të emrave, si dhe ndonjë lokucion: *buzë, ballë, anë, faqe, kurriz, majë, mes, rrëzë, anë; në mes, në drejtim ... shëtitore **buzë liqenit**, kuvende katolike...*

KREU V

FUNKSIONET DHE NDËRTIMI I PARAFJALËVE TË GJUHËS SHQIPE

Në këtë kapitull do të shqyrtojmë në mënyrë të detajuar funksionet dhe ndërtimin e secilës parafjalë të gjuhë shqipe, bazuar në librin “Vepra I” të Aleksandër Xhuvanit.

Parafjala shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyre tjetër në togfjalësh⁷². Në shumicën e rasteve parafjalët lidhin një emër me një folje. Por ato mund të vendosen edhe përpara ndajfoljeve: *u nis për atje, nga poshtë lart, më foli për mirë, mendoj për më vonë*.

Parafjalët, gjithashtu, mund të përdoren edhe para mbiemrave me kuptim kufizues: *Për trim s’e kishte shokun*. Parafjala mund të vihet edhe para një fjalie të tërë dhe kështu ajo emërzohet, domethënë nga kuptimi shndërrohet në emër: *U mërzita aq shumë sa u bëra për hapu dhe të futem*.

Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *në*

Parafjala *në* është përdorur me këtë formë që nga fundi i shekullit të 19-të. Tek Buzuku e gjejmë në trajtën *ëndë*, ndërsa Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani, De Rada dhe Argjirokastriti kanë përdorur trajtën *ndë*. Kjo formë është përdorur edhe nga shkrimtarët e Rilindjes.

Sipas Bopp-it tek parafjala *ndë* tingulli i parë *n* është element eufonik. Rrokja *dë* lidhet me sanskritishten *yadi = në*, aty, ku rrokja e parë ka rënë.

Meyeri mendon se parafjala *ndë* e ka prejardhjen nga sllavishtja e vjetër *do*, lituanishtja *sa*, ose e nxjerr nga latinishtja *intus*.

M. La Piana parafjalën *në* e nxjerr nga një metatezë e trajtës *ën* të Buzukut. Tingulli nistor *n*, në të shqiptuarit e sipër të tij, përfordhet me një shtesë të çfaqur në grupin *nd*, a *nn*, ose *ënd(ë)*.⁷³ Është parafjalë e rasës kallëzore.

Parafjala *në* tregon:

⁷² Akademia e shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, f. 381.

⁷³ A. Xhuvani, vep. e cit., 279

- Vendin ku qëndron a ndodhet një njeri a send: *Në Tiranë të gjithë e bëjnë këtë*. 74(L.F.M. 15) - *Έτσι κάνουν όλες εκεί στα Τίρανα*. Emri që e ndjek mund të jetë në rasën kallëzore të pashquar ose mbiemër asnjës.

- Vendin ku ndodh një lëvizje a veprim. Përdoret me folje që tregojnë lëvizje a drejtim. Emri që e ndjek mund të jetë në rasën kallëzore të pashquar, mbiemër asnjës ose pjesore e substantivuar: *Një herë e kishte pyetur se a do të donte të shëtiste me të në ndonjë rrugë të mënjanuar mbasditeve, kur ai ishte gjarpër, por djaloshi kishte ngritur supet*. (L.F.M. 34) - *Μια μέρα τον ρώτησε αν θα του άρεσε όταν ήταν φίδι, να περπατούσαν μαζί ένα απόγευμα σε κάποιο παράμερο μονοπάτι, αλλά ο νεαρός σήκωσε τους ώμους*.

- Gjithashtu mund të tregojë dhe vendin me kuptim metaforik, pra një vend që merret me mend. “Kemi pra një kuptim hapësinor metaforik ose një kuptim të figurtë vendi”.⁷⁵ *Marku pati dëshirën t’i thërriste: Ik në punën tënde, shef!* (L.F.M. 11) - *Ο Μαρκ μίηκε στον πειρασμό να του φωνάξει: Τράβα τον δρόμο σου, μεγάλε!* Me këtë kuptim figurativ parafjala në përdoret shumë dhe në disa shprehje frazeologjike të cilat i përgjigjen një foljeje të vetme. Më poshtë po përmendim disa nga këto shprehje frazeologjike apo siç mund t’i quajmë ndryshe shprehje foljore:

bie në gjak- armiqësohem me dikë për shkak të një vrasje të bërë; bie në gabim – bëj gabim; bie në lëngim – lëngo, sëmurem; bie në faj – bëj faj; e la në baltë – nuk e ndihmoi; e zhdëpi në dru – e rrahu; më hyn në punë një gjë – më duhet; bie në mendime – mendoj; e vë në gjumë – e bëj të flejë; zë në gojë – përmend; e luajti në litar – e sorollati; u la në lot – qau pa pushim; e priti me lot në sy – u përmallua etj.

- Mënyrën me të cilën shfaqet një veprim konkret a një gjendje e jashtme. Emri që prihet nga parafjala në mund të jetë në kallëzore të shquar ose të pashquar: *Qysh në shikimin e parë Marku e kuptoi se gjarpri s’ishte as i gjallë, as i ngordhur*. (L.F.M. 5) - *Με την πρώτη ματιά ο Μαρκ κατάλαβε ότι το φίδι δεν ήταν ούτε ζωντανό ούτε ψόφιο*.

74 Shembujt janë vënë për arsye ilustrimi. Përkthimi i tyre është dhënë po për të njëjtën arsye, dhe jo për të gjykuar mbi përkthimin.

75 A. Xhuvani, vep. e cit., 272

- Mënyrën me të cilën shfaqet një gjendje shpirtërore si: dëshirë, ndjenjë etj.: *Kaq u bëra, s'kisha parë të nxirret gjarpri në gjumë.* (L.F.M. 10)- *Έζησα τόσα χρόνια, και πρώτη φορά που βλέπω να ξεθάβεται κοιμισμένο φίδι. Dy-tri herë zgjati duart dhe i tërhoqi në çast sikur t'i digjeshin.*(Gj.U.V. 207) – *Άπλωσε δύο – τρεις φορές τα χέρια του και τα μάζεψε στη στιγμή σαν να του καίγονταν.*

- Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar: *Si përherë, pas çdo shkëputjeje ishte gjithë kureshtja të hetonte ndryshimet në trupin e saj.* (L.F.M. 13) - *Όπως πάντοτε ύστερα από κάθε χωρισμό τους, τον έτρωγε η περιέργεια να παρατηρήσει τυχόν αλλαγές στο σώμα της.* Xhuvani thekson se “Në gjuhë të sotme të shkrimit me parafjalën *në* tregohet edhe kuptimi i afërt me të kufizimit, kuptimi “*sa për*”, “*për sa i përket*”⁷⁶: *Ishte koha e gjarprit që zotëronte në tri të katërtat.* (L.F.M. 33) - *Ο φιλόχρονος κυριαρχούσε κατά τα τρία τέταρτα.*

- Kohën kur bëhet a ndodh diçka. Parafjala *në* kur përdoret me këtë funksion zakonisht prin një emër abstrakt foljor në rasën kallëzore të shquar ose të pashquar: *Në mesnatë ai u shfaq vërtet në trajtën e dëshiruar.* (L.F.M. 33) - *Τα μεσάνυχτα εκείνος ζαναπήρε πράγματι την πολυπόθητη μορφή. Dhe në mëngjes ngrihej e lodhur dhe e bukur, si një ditë më parë.* (L.F.M. 26) - *Και το πρωί σηκωνόταν κουρασμένη μεν, αλλά το ίδιο όμορφη όπως την προηγούμενη. Ç'kishte ndodhur natën e parë të martesës, në mes të Tetorit?* (L.F.M. 29) - *Τι είχε συμβεί, λοιπόν, την πρώτη νύχτα του γάμου στα μέσα του Οκτωβρίου; Pyetja se a kishte spriunuar dikush në vitet e shkuara i erdhi prapë qetësisht në mendje.* (L.F.M. 13) - *Το ερώτημα αν τον είχε καταδώσει κάποιος στα χρόνια που πέρασαν ζανάρθε ήσυχα στο νου του.*

- Idenë e kalimit të një frymori a diçkaje nga një gjendje në një tjetër: *E hodhi në supe lëkurën dhe aty për aty u kthye në gjarpër e u mblodh kutullaç në fund të shtratit.* (L.F.M. 32)- *Έριξε το φιδοπουκάμισο στους ώμους του και, στη στιγμή, ξανάγινε φίδι και κουλουριάστηκε στην άκρη του κρεβατιού.*

Disa emra, që me parafjalën në tregojnë rregullisht një vend, për lehtësi a shpejtësi shprehje nuk e marrin këtë parafjalë dhe duke u thënë pa të marrin funksionin e parafjalës dhe plotësi i shprehur kështu me një rasë oblike bën funksionin e një plotësi vendi a kohe; p.sh. në vend që të themi: *shqiponja po qëndronte në majë të shkëmbit* themi: *shqiponja*

76 A. Xhuvani, vep. e cit., 275.

po qëndronte majë shkëmbit; ajo shtëpi është faqe dielli në vend të: ajo shtëpi është në faqe të diellit⁷⁷.

Por mund të ndodhë edhe e kundërta. Pra, parafjala në mund të jetë përdorur pa vend dhe me tepri. Kjo ndoshta për shkak të influencës që kanë gjuhët e huaja; p.sh. *tundi kokën në shenjë mohimi = për shenjë a si shenjë mohimi; në kërkim të së resë = për kërkim të së resë; bisedimet u zhvilluan në frymën e mirëkuptimit reciprok = me frymën e mirëkuptimit të njëri tjetrit; ai u thirr në raport = për raport; i kanë vënë çdëmtim në të holla = me të holla; gropat nuk janë çelur në thellësin' e duhur = me thellësin' e duhur; kjo është në dëm të interesit të tyre = për dëm të interesit të tyre⁷⁸. Xhuvani⁷⁹ është i mendimit se këtu bëjnë pjesë edhe shprehje si: *e kaloj në heshtje*, që është një përkthim nga frëngjishtja *passer en silence*; shqip thuhet: *e kaloj heshtazi, pa e zënë ngoje, pa folur, pa e përmendur*; p.sh. *duroi në heshtje të qeshurat = duroi heshtazi ose pa folur të qeshurat*. Gjithashtu edhe shprehja *në ngarkim*, që është përkthim nga italishtja *a carico*, mund të thuhet shqip: *mbi rruzë, mbi vehte, përsipër, për ngarkim e si ngarkim*; p.sh. *ajo brigadë ka marrë në ngarkim tri parcella të rendimenteve të larta = ajo brigadë ka marrë mbi rruzë a përsipër tri ngastra të rendimeteve të larta; ai ka në ngarkim gjashtë veta = ai ka mbi vehte a si ngarkim gjashtë veta; i dhanë në ngarkim dhjetë lopë = i dhanë për ngarkim a si ngarkim dhjetë lopë*.*

Është vënë re se parafjala *ndë* apo *në* është përdorur me kallëzore të pashquar nga shkrimtarët e vjetër, si Buzuku, Bogdani Budi, etj. Edhe shkrimtarët e Rilindjes e kanë përdorur po në këtë mënyrë. Por që nga fundi i shekullit 19-të e deri në ditët tona, parafjalën e gjejmë dendur të përdoret me një emër a përemër në rasën kallëzore, trajta e shquar. I ati i nuses, që e priste atë vizitë, i ftoi brenda, pastaj i futi *në dhomën* e çiftit. (Kadare.I, Lulet e ftohta të Marsit, f.25) Ky nuk është një përdorim i rregullt i kësaj parafjale. Këtu bëjnë pjesë edhe disa shprehje që tregojnë një emër gjeografik si p.sh *në malin e Korabit* në vend të *në mal të Korabit*; *në qytetin e Tiranës* në vend të *në qytet të Tiranës* etj. Sipas sintaksës këtu kemi një *genitivus explicativus* = gjindore fillëzuese.⁸⁰

Pra nga sa thamë më lart, forma e rregullt e përdorimit të parafjalës *në* në gjuhën e sotme shqupe është: parafjala në + emër në numrin njëjës në rasën kallëzore të trajtës së pashquar.

Kjo parafjalë përdoret edhe si parashtesë dhe ka ndihmuar në formimin e disa pjesëve të ligjëratës si emra, mbiemra, ndajfolje, folje: *ngrackë, i ndritëm, ngoje, ngjall* etj.

77 A. Xhuvani, vep. e cit., 276.

78 Shembujt janë marrë nga A. Xhuvani në "Vepra I".

79 A. Xhuvani, vep. e cit., 277.

80 A. Xhuvani, vep. e cit., 278.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalën në

1. Kur varet nga folje që shprehin shndërrim, si: *ndryshoj, shndërroj* etj., tregon objektin në të cilin është shndërruar sendi i shprehur nga kundrina e drejtë a kryefjala: *Ndoshta vuajtja e Kasit shumë shpejt do të kthehej në zhgënjim.*
2. Kundrina me parafjalën *në*, kur varet nga folje që shprehin të puqur me diçka, si: *afroj, bashkoj* etj., shpreh objektin që kufizon objektin e shprehur nga kundrina e drejtë a kryefjala: *Afrohen shumë në mendime megjithëse me moshë jo.*
3. Kundrina me parafjalën *në* shpreh veglën a instrumentin me anë të të cilit realizohet veprimi kur varet nga foljet *ndikoj, kopjoj, imitoj* etj.: *Flas shpesh në telefon me djalin që kam larg.*
4. Kur varet nga foljet *gdhend, skalit* etj., tregon lëndën me të cilën përgatitet objekti i shprehur nga kundrina e drejtë: *Ai gdhendte në dru.*

Parafjala në shërben edhe për të shprehur rrethanorin e vendit: *Në Vlorë nuk kishin parë kurrë një njeri me ngjyrë dhe fëmijët që dolën në port u frikësuan*; Rrethanorin e kohës: *Në fund të javës së tetë Kasi filloi të kthehej më shpejt nga senati*; Rrethanorin e mënyrës: *Kaq u bëra, s'kisha parë të nxirret gjarpri në gjumë.*


Sintagmat me parafjalën **në** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Ndërsa kapërcente udhëkryqin, Mark Gurabardhi i tërhoqi vëmendjen grumbulli i njerëzve që sa vinte **rritej në të djathtë** të tij.*

Emër + parafjalë + përemër ***Gjarpër në këtë** stinë?*

Emër + parafjalë + emër *Ti do të veshësh uniformën e policisë, ashtu si unë, ashtu si gjyshi yt, që e grinë **banditët në kohën** e mbretërisë.*

Ndajfolje + parafjalë + emër *Në mesnatë ai u shfaq **vërtet në trajtën** e dëshiruar.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *më*

Parafjala *mbë* sipas Franc Bopit lidhet me sanskritishten *abi*, me greqishten *αμφί*, e me latinishten *amb*.

Por siç e dimë kjo formë e kësaj parafjale nuk përdoret më dhe është zëvendësuar me parafjalën *në* dhe vetëm kur shënojmë datën përdoret parafjala *më*: më 3 Korrik. Buzuku ka përdorur një formë akoma më të vjetër të saj *ënbë* dhe *ëm*. Por ai ka përdorur edhe trajtën *më*. Shkrimtarë si Budi, Bogdani, Matrënga, Argjirokastriti e De Rada, kanë përdorur formën *mbë*. Edhe shkrimtarët e Rilindjes kanë përdorur format e ndryshme të kësaj parafjale. Ndërsa që pas Rilindjes dhe deri në ditët tona është përdorur trajta *më*. Është parafjalë e rasës kallëzore.

Kjo parafjalë tregon:

- Kur shoqërohet me folje që tregojnë të qëndruar diku, tregon vendin ku ndodhet dikush a diçka: *Qëndroi më një vend të lartë. Ai qëndroi drejt më këmbë. Qilimi me rrota i arnuar më dy vende.*

Të tre këta shembuj në greqisht do të jepeshin me parafjalën *σε* (στον, στην, στο, στους, στις, στα): *σε ένα μέρος, στα πόδια, σε δύο μέρη (πλευρές).*

- Kur shoqërohet me folje që tregojnë lëvizje, tregon vendin ku ndodhet një e lëvizje: *E doli jashtë më rrugë. Hyri brenda më një shtëpi. Trokëlliti më derë.*

Edhe këta shembuj në greqisht do të jepeshin me parafjalën *σε* (στον, στην, στο, στους, στις, στα): *στον δρόμο, σε ένα σπίτι, στην πόρτα.*

- Vendin me kuptim metaforik: *Vëllezërit e tjerë i vuri më bukë. Çdo yll rrotullohet më vetëhe.*

Edhe këta shembuj në greqisht do të jepeshin me parafjalën *σε* (στον, στην, στο, στους, στις, στα): *στο ψωμί, στον εαυτό του.*

- Mënyrën me të cilën shfaqet një veprim konkret: *Pinin duhan duke ndenjtur më bisht. Donte që t'i binja më gjunjë. I qëndroi drejt më këmbë.*

Edhe këta shembuj në greqisht do të jepeshin me parafjalën *σε* (στον, στην, στο, στους, στις, στα): *στον δρόμο, στα γόνατα, στα πόδια.*

- Mënyrën me të cilën shprehet një gjendje e brendshme shpirtërore: *Iku ajo mbë ditë të keqe. Έφυγε σε μια κακή μέρα.*

- Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar: *Gjuha shqipe është më e lehtë më të shkruar.* – *Ο προφορικός λόγος είναι πιο εύκολος στην αλβανική γλώσσα.*

- Kohën kur bëhet, ndodh a mbaron diçka: *Ndërsa në një pllakë guri qenë gdhendur fjalët: “Këta ushtarë të huaj ranë heroikisht krahas partizanëve shqiptarë në përprjekje me forcat e Batalionit Blu më 17 Mars 1943”.* (Gj.U.V. 50) – *Ενώ σε μια πέτρινη πλάκα ήταν σκαλισμένες οι λέξεις: «Εδώ ξένοι στρατιώτες έπεσαν ηρωικά στον πλευρό των αλβανών ανταρτών σε συμπλοκή με τις δυνάμεις του Τάγματος των Μελανοχιτώνων στις 17 Μάρτη 1943».*

- Vazhdimin ose përsëritjen e një pune. Parafjala më vendoset midis së njëjtës fjalë që përsëritet për të treguar mënyrë, kohë a vend. *Ndërtohet me rasë kallëzore të pashquar: Ajo turmë e llahtarshme që mbushte bulevardin cep më cep dhe lëvizte nën neonet e zbehta e ndarë në dy rryma të kundërta.* (J.K.Sh. 153) – *Αυτός ο φοβερός όχλος που πλημμύριζε τη λεωφόρο, απ’ άκρου εις άκρον, σχηματίζοντας δύο αντίθετα ρεύματα, κάτω απ’ το αχνό φως των γλόμπων φθορίου. Ai buzëqeshi i kënaqur vesh më vesh.* (I.Sh. 31)

- Pjesëtimin e një gjëje a një të tërë. Në këtë rast kjo parafjalë i prin një emri në rasën kallëzore të pashquar ose në rrjedhore: *E preu më dy. Kjo udhë të ndahet më dy degë. Gjuha i ndan njerëzit më kombe. E ndante jetën e saj më dy pjesë. Rruga ndahet më dysh.* – *Το έκοψε στα δύο. Αυτός ο δρόμος χωρίζεται σε δύο κατευθύνσεις. Η γλώσσα χωρίζει τους ανθρώπους σε έθνη. Χώριζε τη ζωή της σε δύο μέρη. Ο δρόμος χωρίζεται σε δύο.*

Duke parë përdorimet e parafjalëve të mësipërme, pra të parafjalëve *ndë* e *në* dhe *mbë* e *më*, vemë re se ato janë mjaft të ngjashme. Pra, tregojnë pothuajse të njëjtat gjëra dhe i prijnë zakonisht një emri në rasë kallëzore të pashquar. Për këtë rast Pedersen i thotë se ato janë sinonime.⁸¹ Në disa raste parafjala *mbë* e gjuhës së vjetër shqipe mund të zëvendësohet me një parafjalë tjetër që përdoret më shumë në gjuhën e sotme. Kjo parafjalë shërben edhe si parashtesë për të formuar emra, mbiemra, folje e ndajfolje.

81 A. Xhuvani, vep. e cit., 283.

Siç e vumë re nga shembujt e mësipërm parafjala *mbë* e *më*, jepet në greqisht me parafjalën *σε* (στον, στην, στο, στους, στις, στα). Pra, si parafjala *në* edhe parafjala *më* jepen në greqisht me këtë parafjalë.

Sintagmat me parafjalën *më* formohen:

Folje + parafjalë + emër *Trokëlliti më derë.*

Mbiemër prejpjesor + parafjalë + emër *Qilimi me rrota i arnuar më dy vende.*

Folje + parafjalë + numëror *E preu më dy.*

Ndajfolje + parafjalë + emër *I qëndroi drejt më këmbë.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *te, te(k)*

Parafjala *te* që merr formën tek para emrave e përemrave që fillojnë me zanore⁸², sipas Joklit⁸³ e ka prejardhjen nga rrënja përemërore indoevropiane *to* dhe lidhet me asnjanesin e vjetër *tod*, si dhe asnjanesin e greqishtes *to*. Mund të jetë edhe një rrjedhore e këtij përemri asnjanes. Ajo ka ndryshuar trajtë me kalimin e kohëve. Në autorë të ndryshëm është përdorur në trajta të ndryshme. Kështu, Buzuku, Budi, Bogdani, Argjirokastriti, De Rada etj., përdorin trajtat *te, tek, nde, ndek*. Pedersen përdor *ne* dhe *nek*. Në Shqipërinë e Veriut përdoret më shumë trajta *tu* e *tuk*, në të Mesmen trajta *ke*. Kristoforidhi, Naimi e Samiu përdorin trajtat *te* dhe *tek*. Këto trajta përdoren edhe sot në gjuhën e shkruar e të folur. Madje trajta *te* përdoret edhe nga arbëreshët e Italisë. Atje ka përdorim mjaft të gjerë, madje duke zëvendësuar shpesh herë parafjalët *në* dhe *më*. Sot kjo parafjalë përdoret me emër në rasën emërore zakonisht në trajtë të shquar. Kjo

⁸² Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976, f. 648.

⁸³ A. Xhuvani, vep. e cit., 288.

shpjegon edhe prejardhjen e saj ndajfoljore. Megjithëse Xhuvani vë re se kjo parafjalë është gjetur e përdorur tek Argjirokastriti me rasën rrjedhore të përemrit vetor. Kjo ndoshta për shkak të ndonjë influence të mundshme nga greqishtja.⁸⁴

Kjo parafjalë përdoret në disa raste edhe si lidhës shkakore, vendore e kohore. Xhuvani është i mendimit se kur parafjalët te, tek, etj., ndërtohen me një përemër a emër personi, tregojnë shtëpinë a banesën e tij, i përgjigjen parafjalës së frengjishtes *chez*.⁸⁵

Kjo parafjalë tregon:

- Vendin ku bëhet a gjendet diçka a dikush: *Përpara se të çelte portën e ateliesë vështrimi iu ndal një grimë te flega e djathtë.* (L.F.M. 12) - *Προτού ανοίξει την πόρτα του ατελιέ, το βλέμμα του καρφώθηκε για μια στιγμή στο δεξιό φύλλο της. Τë riu e zeza, po mora vesh gjë, të vara te kulmi i pullazit.* (Gj.U.V. 103) - *Καταστράφηκες, έτσι και καταλάβω κάτι, σε κρέμασα απ' την κορυφή της στέγης.*
- Vendin për ku drejtohet një lëvizje a dikush: *Të futej prapë te vrima nga e kishin nxjerrë për të pritur ngrohjen e motit si e ka bërë natyra, apo të vihej pranë vatrës për t'u shkrirë, veç për këtë të fundit duhej shumë kujdes.* (L.F.M. 10) - *Να το ζανάχωναν στη τρύπα απ'όπου το 'βγαλαν, περιμένοντας να ζεστάνει ο καιρός, όπως το θέλει η φύση, ή να το 'βαζαν κοντά σε καποιο τζάκι - πράγμα που θα απαιτούσε μεγάλη προσοχή - για να ξεπαγώσει. Nganjëherë ajo ulej kaq shumë saqë dukej sikur do të ngecej te kulmaku i tendës.* (Gj.U.V. 80) - *Μερικές φορές κατέβαινε τόσο χαμηλά που έμοιαζε ν' ακουμπάει την κορυφή της σκηνής. Specialisti shqiptar u përkul prapë te gropra dhe të tjerët u afruan.* (Gj.U.V. 23) - *Ο Αλβανός επιστάτης είχε σκύψει ζανά προς το λάκκο και οι άλλοι πλησίασαν κοντά του.*

Kundrina me parafjalën *te(k)* shpreh objektin të cilit i drejtohet veprimi dhe marrëdhënie hapësinore: *Ndërsa po i afrohej ndërtesës ku ndodhej atelieja, mendja i shkoi prapë te historia e çuditshme, ashtu siç ia kishte treguar Zefi.*

Parafjala *tek* shpreh marrëdhënie vendore: *Ajo kërcëu nga trangu i Otellos te degët e Kasit dhe duke i uruar mirëseardhjen, qepallat iu njomën nga vesa që gjeti në sytë e tij të bukur.*


84 A. Xhuvani, vep. e cit., 287.

85 A. Xhuvani, vep. e cit., 288.

Sintagmat me parafjalën **tek** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Me shpirtin e harlisur nga ngjyrat e Venedikut dhe zemrën e përvëlur nga nevoja për të gjetur një rrahje, Kasi shpejtonte hapat dhe **kthehej te Desdemona**.*

Emër + parafjalë + emër *U hodh nga **pema tek çatia**.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *ndaj*

Sipas Joklit kjo parafjalë është e përbërë nga *nd-ani*, me lokativin e moçëm të *anë-s*.⁸⁶ Kjo parafjalë është përdorur në trajta të ndryshme nga autorë të ndryshëm.

⁸⁶ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI, Tiranë 2002, f. 10

Buzuku ka përdorur formën *ëndaj*. Shkrimtarë të tjerë të vjetër, si edhe ata të Rilindjes, kanë përdorur trajtën *ndaj*, trajtë e cila përdoret edhe sot në gjuhën letrare shqipe. Më parë është përdorur me rasë kallëzore, vendore e rrjedhore. Përdorimin e saj me rasë kallëzore e gjejmë më shumë në gegërisht. Kjo si ndikim i përdorimit me kallëzore të parafjalëve latine *ad* e *apud*: *ad urbem*, *apud fontem*. Ndërsa ndërtimi me rrjedhore, që e gjejmë të përdorur më së shumti edhe sot, është një ndikim nga përdorimi i parafjalës gjeqjese të greqishtes *παρά* me dhanore: *παρά τη πηγή*, *παρά της αρχαίας*.⁸⁷ Përdoret me kallëzore dhe me dhanore-rrjedhore kur tregon kohë: *ndaj të gdhirë*, *ndaj mesditës*.

De Rada parafjalën *ndaj* e përdor edhe si ndajfolje dhe e vendos pas foljes. Xhuvani është i mendimit se ky duhet të jetë një ndikim nga parafjalët e italishtes *appresso*, *d'intorno*, *al fiançe*, të cilat vihen pas foljes.⁸⁸

Kjo parafjalë tregon:

- Të qenurit afër një vendi a personi. Me këtë kuptim përdoret për të treguar dhe kohë: *Ndaj të gdhirë* duhet të futem prapë në trajtën time. (L.F.M. 31) - *Τα ξημερώματα πρέπει να ξαναπάρω την προηγούμενη μορφή μου.*
- Me kuptim figurativ përdoret me një emër për të treguar qëndrimin e tij për një gjë a për një veprim: *Ta merrni për akuzë dhe ta radikalizoni qëndrimin tuaj shpërfillës ndaj meje.* (J.K.Sh. 264) – *Να το εκβάλετε ως κατηγορία και να ταϊσέτε κι άλλο την περιφρόνησή σας προς το πρόσωπό μου.*

Kundrina me parafjalën *ndaj* shpreh objektin, të cilit i drejtohet veprimi: *Otello vinte nga shkretëtira dhe ishte i ndjeshëm ndaj fatkeqësive.*

Parafjala *ndaj* shpreh marrëdhënie kohore: *Ndaj të gdhirë* ai u zgjua i trembur.


Sintagmat me parafjalën *ndaj* formohen:

Folje + parafjalë + emër *Erdhi ndaj të gdhirë.*

⁸⁷ A. Xhuvani, vep. e cit., 289

⁸⁸ A. Xhuvani, vep. e cit., 289

Mbiemër + parafjalë + emër *I kujdesshëm ndaj vështirësive.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *mbi*

Sipas Fr. Bopp-it, parafjala *mbi* nga origjina është identike me greqishten *επί*.⁸⁹ Kjo parafjalë është përdorur në trajta të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Tek Buzuku gjejmë të përdorur trajtën *ënbii*. Trajtat që përdorim sot janë përdorur nga Kristoforidhi, Vreto, Naimi e Samiu. Midis trajtës së thjeshtë *mbi* dhe asaj të përbërë *përmbi*, nuk ka ndryshim kuptimor. Janë parafjalë që përdoren me rasë kallëzore të shquar, megjithëse tek shkrimtarët e vjetër dhe tek Rilindasit i gjejmë të përdorura me kallëzore të pashquar dhe me rasë vendore, gjë që mbështetet dhe nga Xhuvani.⁹⁰

Kjo parafjalë tregon:

- Të qenurit në sipërfaqe ose më lart se diçka: *Sytë iu ndalën mbi njollat e ngjyrave mbi kavalet.* (L.F.M. 14) - *Το βλέμμα του σταμάτησε στις κηλίδες των χρωμάτων πάνω στο καβάλέτο. Mbasdite vonë, hipur mbi kuaj mbërritën pronarët e gjjarprit, gjithë dihatje e kërcënim.* (L.F.M. 25) - *Αργά το απόγευμα, καβάλα στ'άλογα, κοντανασαίνοντας και άκρωσ απειλητικοί, κατέφθασαν οι κύριοι του φιδιού.*
- Vend me kuptim figurativ: *Tek e zhvishja, mbi fytirën e saj pasqyroheshin ca lëkundje, si lëvizjet valore të një tërmeti me epiqendër diku thellë.* (J.K.Sh. 271) – *Το πρόσωπό της σαν να παλλόταν από κάτι αναταράξεις, σαν τις κυκλικές δονήσεις ενός σεισμού με εστιακό βάθος.*
- Idenë e një drejtimi me qëllim kundërshtimi: *Mungesa e madhe e Poetit midis njerëzve dhe përmbi njerëzit, përmbi kohën dhe hapësirën, mungesa e tij e gjatë...* (I.Sh. 105) – *Η μεγάλη απουσία του Ποιητή ανάμεσα στους ανθρώπους και πάνω από τους ανθρώπους, πάνω από τον καιρό και τον χώρο, η μακριά του απουσία...*
- Epërsi a teprim: *Ishin mbledhur për ta dëgjuar përmbi gjashtëqind veta.* – *Είχαν μαζευτεί πάνω από εξακόσια άτομα για να τον ακούσουν. Epërsia e socializmit mbi kapitalizmin.* – *Η υπεροχή του σοσιαλισμού εναντίον του καπιταλισμού. Nga shiu u dëmtuan mbi dyzet hektarë perime.* – *Από τη βροχή έβλαπτε πάνω από σαράντα εκταρίων λάχανα.*

⁸⁹ A. Xhuvani, vep. e cit., 294

⁹⁰ A. Xhuvani, vep. e cit., 292

- Një kohë të caktuar: *Ka mbi gjashtë muaj që punon në këtë kompani. – Έχει πάνω από έξι μήνες που δουλεύει σ' αυτή τη εταιρεία.*
- Diçka për të cilën flitet, shkruhet a merret vendim: *U bisedua mbi nevojën e një organizimi më të mirë të punës. – Συζητήθηκε για την ανάγκη για μια καλύτερη οργάνωση της δουλειάς. U botuan të dhëna konkrete mbi zhvillimin e arsimit e të kulturës. – Δημοσιεύτηκαν συγκεκριμένα στοιχεία για την ανάπτυξη της παιδείας και του πολιτισμού.* Ky përdorim mendohet të jetë si shkak i influencës nga gjuhët e huaja, pasi gjuha shqipe për këtë rast përdor parafjalën për: *U fol për veprimtarinë e saj.*

Kjo parafjalë ka përdorim të gjerë edhe si parashtesë duke formuar kështu disa kategori fjalësh si emra, ndajfolje, folje, mbiemra.


Kundrinori i zhdrejtë me parafjalën mbi

1. Kur varet nga folje që shprehin të ndikuar a të mbështetur, si: *ndikoj, rëndo, mbështetem, bie etj.*, kjo kundrinë shpreh objektin mbi të cilin kryhet veprimi: *Bota do ta respektonte dhe nën udhëheqjen e tij, masakra mbi të zinjët do të quhej një fitore e shkencës.*
2. Kur varet nga folje që shprehin veprimtari mendore ose nga folje të perceptimit, si: *mendoj, arsyetoj, lexoj, mësoj etj.*, shpreh objektin në lidhje me të cilin zhvillohet veprimi: *U bisedua mbi nevojën e një organizimi më të mirë të punës.*

Rrethanori me parafjalën *mbi* shpreh marrëdhënie hapësinore: *Flokët e verdha i binin mbi supe dhe shëndeti që trashëgonte nga e ëma ia kishte skuqur faqet që edhe nëse turpëroheshin nuk e ndryshonin ngjyrën*; marrëdhënie kohore: *Ka mbi pesë muaj që nuk e shoh.*

Sintagmat me parafjalën *mbi* formohen:

Folje + parafjalë + emër *Librat ranë mbi tavolinë*
Folje + parafjalë + numëror *Punoi mbi tre muaj në kompaninë tonë.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *nën*

Sipas Fr. Bopp-it parafjala *ndën* lidhet me sanskritishten *adās*.⁹¹ Është përdorur në trajta të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Buzuku ka përdorur trajtën *ëndënë*, Budi, Bogdani, Argjirokastriti e shkrimtarët e Rilindjes trajtën *ndënë*. Sot përdoret trajta *nën* dhe *nënë* e më rrallë *ndën*. Dikur përdorej me rasë kallëzore të pashquar e me rasë vendore, ndërsa sot e gjejmë më shumë të përdorur me kallëzore të shquar. Tek De Rada e gjejmë të përdorur edhe si ndajfolje.

Kjo parafjalë tregon:

- Idenë e të qenit ulët: *Nën ndriçimin e zjarrit të vatrës ajo sodit flokët dhe mollëzat e tij të bukura.* (L.F.M. 34) - *Κάτω από τη λιγοστή λάμψη της φωτιάς, στο τζάκι, το κορίτσι θαυμάζει τα μαλλιά και τα υπέροχα ζυγωματικά του. Kishte kaq shumë raste për ta humbur në kushtet e familjeve të mëdha, ku djemtë dhe vajzat kushërira jetonin nën një pullaz.* (L.F.M. 37) - *Υπήρχαν τόσες ευκαιρίες να τη χάσει στις συνθήκες των πατριαρχικών οικογενειών, όταν ξαδέλφια, αγόρια και κορίτσια, ζούσαν κάτω από την ίδια στέγη.*
- Nënshtrim, të mposhtur: *Ajo deshi ta pyeste se a mendonte si njeri nën trajtën gjarpërore, por me sa dukej, ishte ashtu.* (L.F.M. 31) - *Εκείνη θέλησε να τον ρωτήσει αν σκεφτόταν σαν άνθρωπος κάτω από τη φιδίσια μορφή, αλλά, κατά τα φαινόμενα, έτσι ήταν. Kur do të thyhet ky zakon i pështirë që gjeneralët të jenë vazhdimisht nën përgjim?* (Gj.U.V. 206) – *Πότε θα κοπεί αυτή η αποκρουστική συνήθεια οι στρατηγοί να είναι συνεχώς υπό παρακολούθηση;*

Xhuvani⁹² vëren edhe disa përdorime pavend të saj si p.sh: *nën udhëheqjen në vend të me udhëheqjen e.*

Kundrina me parafjalën *nën* kur varet nga foljet: *hetoj, analizoj, mësoj, studioj*, etj., ndërtohet me një rreth të ngushtë emrash, si: *frymë, dritë, aspekt, kënd, prizëm*, shpreh drejtimin a orientimin: *Venediku priste duke lexuar fatin e botës, nën dritën e vet tekanjoze.*

Kjo parafjalë shpreh marrëdhënie mënyre: *Kur do të thyhet ky zakon i pështirë që gjeneralët të jenë vazhdimisht nën përgjim?*

Kjo parafjalë përdoret edhe si parashtesë duke iu paravendosur disa kategorive fjalësh si emra, mbiemra, folje.

Sintagmat me parafjalën *nën* formohen:

⁹¹ A. Xhuvani vep. e cit., 297


⁹² A. Xhuvani vep. e cit., 296

Ndajfolje + parafjalë + emër *Është vazhdimisht nën kujdesin tim.*

Mbiemër prejppjesor + parafjalë + emër *I struktur nën çati.*

Folje + parafjalë + emër *I foli nën zë.*

Emër + parafjalë + emër *Ishte një ditë e nxehtë korriku dhe rëra e bregut shtypej si miell nën këmbët e tij të zeza.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës nga

Parafjala *nga* është parafjalë e rasës emërore. Për origjinën e kësaj parafjale Pedersen duke kundërshtuar Meyerin ka thënë: “Gjithë kështu *nga-* (që ka shpesh edhe trajtën *ngaha*) përdoret si fjalë lidhore: *në udhë ngaha vijn...* Kuptimi origjinar është ai pyetës: *ngaha vjen tie, pjeti ngaha ish...* Pra, kuptimi origjinar është *prej ku... nga shtëpia është*, pra në të vërtetë “*prej atje, ku shtëpia*”⁹³. Ajo ka ardhur prej ndajfoljes *kaha-*. Kjo parafjalë është përdorur në forma të ndryshme nga Buzuku, Budi, Bogdani, De Rada, etj. Më pas e gjejmë të përdorur me formën që kemi sot nga Kristoforidhi. Trajta *nga*,

⁹³ Pedersen. H, Studime për gjuhën shqipe, Prishtinë, 2003, f. 22.

popullore në Jug e në Shqipëri të mesme, e përdorur në të shkruar të Jugut që prej Argjirokastritit e tehu, është përgjithësuar sot në gjuhë të shkrimit duke dalë krejt sipër trajtave të tjera⁹⁴, thekson Xhuvani.

Kjo parafjalë tregon:

- Drejtim tek një vend: *Kjo përzihej me një epsh djegës, të një shijeje të veçantë, sidomos këtë herë që vajza kthehej nga kryeqyteti.* (L.F.M. 13) - *Αυτό προπάντων τώρα που το κορίτσι επέστρεφε από την πρωτεύουσα, συνυφαινόταν με μια καυτερή λαγνεία, μια ηδυπάθεια που είχε πολύ ιδιαίτερη γεύση.*
- Largësinë, distancën midis dy pikave: *Mjaftonin njëzet minuta, e shumta njëzet e pesë, të përshkoja largësinë nga pallati ku banoj, deri te shtëpia e fëmijërisë.* (J.K.Sh. 142) – *Σε είκοσι, το πολύ είκοσι πέντε λεπτά, μπορούσα απ’ το διαμέρισμά μου, να βρεθώ στην οικία των παιδικών μου χρόνων.*
- Prejardhje nga një vend: *Dy fëmijët që s’dihej sesi e kishin nxjerrë nga toka, pasi vështronin me krenari turmën e vogël, për të treguar se gjarpri u përkiste atyre.* (L.F.M. 9) - *Τα δύο παιδιά που είχαν ζετρωπώσει – ποιος ξέρει πώς- το φίδι από τη γη, έριχναν τριγύρω περίφανες ματιές, και θέλοντας να δείξουν ότι ήταν οι κάτοχοι του ερπετού το άγγιζαν κάθε τόσο με ένα ραβδί. Με këtë kuptim përdoret edhe për të treguar origjinën: Ajo klithmë vjen ndërkaq nga larg.* (L.F.M. 37) - *Τώρα η κραυγή του έρχεται από κάπου μακριά.*
- Largim: *Me atë mendim në kokë, me një miratim të heshtur në sy, dolën edhe vetë të çliruar nga e keqja.* (L.F.M. 25) - *Με την ιδέα έντονη στο μυαλό και με μια σιωπηρή επιδοκιμασία στα μάτια, έφυγαν ζαλαφρωμένοι κι οι ίδιοι από το βάρος του κακού.*
- Kalimin për në një vend: *Dihej veç që kishin qenë prej gjëkund, që nga trevat ku në rast vdekjeje qanin vetëm gratë, gjer te bjeshkët veriore ku gjëmën bënin burrat ...*(Gj.U.V. 157) - *Δεν ήταν γνωστό τίποτε άλλο, παρά μόνο πως είχαν έρθει από παντού, από περιοχές που στους θανάτους κλαίνε μόνο οι άντρες...*

⁹⁴ Xhuvani. A, Vepra I, Tiranë, 1980, f. 297

- Shkakun nga i cili rrjedh një veprim: ... edhe mërzitja **nga fshehja**, edhe lodhja prej këtij dyzimi... (L.F.M. 34) - ...και η πίκρα της που έπρεπε να κρύβει το μυστικό, και η κούραση από αυτή τη δυαδική ζωή...
- Personin a frymorin veprues ose sendin të përfytyruar si veprues: *Atij i dukej se sa më tepër çlirohej nga petkat aq më i saktë bëhej rrëfimi i saj.* (L.F.M. 14) - Εκείνος είχε την εντύπωση ότι η διήγησή της γινόταν όλο και πιο σταθερή όσο εκείνη ξελάφρωνε **από τα ρούχα της**. *Qëllonte që e vështroja në mesnatë të ndriçuar nga drita e ftohtë dhe e bardhë dhe thosha me vete: Kjo urë do të na e hajë kokën me radhë të gjithëve.* (Gj.U.V. 166) – Όταν την κοίταζα τα μεσάνυχτα φωτισμένη **απ’ το κρύο άσπρο φως**, μονολογούσα: Αυτή η γέφυρα θα μας το φάει το κεφάλο όλων μια μέρα.
- Nisjen e një pune: *Pas dy- tri minutash, ndoshta pas dy-tri orësh, ai doli nga topitja.* Του πήρε δυο-τρία λεπτά, ίσως και δυο-τρεις ώρες, για να βγει **απ’ την αποχαύνωση**. (J.K.Sh. 18)

Xhuvani thekson këtu se këto shprehje kanë një përdorim më të gjerë në të folmen e Jugut, dhe kjo si ndikim i gjuhës greke. Gjuha greke si foljen άρχομαι (filloj) të gjuhës së vjetër dhe foljen αρχίζω (filloj) të gjuhës së re greke, i përdor me parafjalën από. άρχομαι από των προβλημάτων (po filloj nga problemet) αρχίζω από τη δουλειά (po filloj nga puna)

- Sasinë e një gjëje të ndarë për çdo njësi⁹⁵: *Në të dy anët e bodrumit, në nivelin e tokës, kishte nga një dritare në formë frëngjie, për ajrim dhe ndriçim.* (J.K.Sh. 67) - Στις δύο πλευρές του υπογείου, στο επίπεδο του οδοστρώματος, υπήρχε **από ένα παραθυράκι** υπό μορφή φεγγίτη για εξαέρωση και φωτισμό.

95 M. Domi në “Gramatika e gjuhës shqipe”, Sintaksa, Tiranë, 1957, f. 42 shprehet se: Kundrina mund të shoqërohet nga parafjala nga, kur ka kuptim përndarës. Për shembull: U dhashë fëmijëve nga dy portokaj – U dhashë fëmijëve dy portokaj; në “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 1954, f. 344 gjejmë kuptimin dy nga dy – u dha nga dy mollë – dy mollë për shoq; në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1980, f. 1238, jepet si kuptim i njëzetepestë i parafjalës **nga** dhe në “Fjalori i shqipes së sotme”, Tiranë, 1984, f. 779 jepet si kuptim i njëmbëdhjetë i parafjalës **nga**.

- Tërësinë, grumbullin nga i cili merret një pjesë: *Me njërën nga furçat përzjeu ngjyrat në pëllhurën e zbrazët, siç bënte shpesh për të shkruar dorën, ose kur ndihej nervoz.* (L.F.M. 13) - Πιάνοντας ένα πινέλο, ανακάτεψε πάνω σ' έναν κενό καμβά κάποια από τα χρώματα, όπως έκανε κάθε φορά που ήθελε να ξεμουδιάσει το χέρι του ή να καταπραΰνει τον εκνευρισμό του. *Dy prej tyre ndezën prapë nga një cigare, i treti thithte ende llullën kurse tjetri, më i riu, vazhonte të qëndronte mbështetur mbi bishtin e mohësës dhe dukej që e kishte mendjen gjetkë.* (Gj.U.V. 20) – Ο άλλος, ο νεότερος, στηριζόταν στο στείλιάρι του φτυαριού και έμοιαζε σαν να είχε αλλού το μυαλό του.

- Anën ose pjesën e një vendi a gjëje: *Sidoqoftë, jo nga telefoni mbi mur, zilja e të cilit tringëlliu pikërisht në atë çast.* (J.K.Sh. 17) - Πάντως, όχι απ' το κρεμασμένο τηλέφωνο στον τοίχο, που τη στιγμή εκείνη άρχισε να χτυπά.

- Krahasim midis dy elementëve të një fjalie: *Është e vërtetë se kjo pritje ndryshonte pak nga ajo pritja tjetër, kur ato shpresoni t'u ktheheshin gjallë bijtë e tyre, por, sidoqoftë, edhe të vdekurit priten.* (Gj.U.V. 17) - Είναι αλήθεια πως αυτή η αναμονή διέφερε κάπως από την άλλη αναμονή, όταν δηλαδή αυτές έλπιζαν πως θα γύριζαν πίσω ζωντανά τα παιδιά τους, αλλά, όπως και να είναι, αυτές θα περιμένουν ακόμα και νεκρά.

- Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar: *Me fjalë të tjera, deshi të më komunikonte diçka që kohët e fundit ma përsëriste shpesh: unë nuk isha në rregull nga trutë.* (J.K.Sh. 55) - Μάλλον ήθελε να μου ανακοινώσει κάτι που τελευταία το 'χε κάνει ψωμοτύρι: ότι χάνω τα λάδια.

Kohë: *Nga ora dy e natës ai krijoi bindjen se ishte çasti më i përshtatshëm për të nxjerrë kufomën.* (J.K.Sh. 22) - Ήταν δύο μετά τα μεσάνυχτα όταν πείσθηκε πως αυτή ήταν και η κατάλληλη ώρα να βγάλει το πτώμα.


Sintagmat me parafjalën *nga* formohen:

Folje + parafjalë + emër *Kasi hynte dhe dhoma **kundërmonte nga afshi** që sillte.*

Mbiemër prejppjesor + parafjalë + emër *Me shpirtin **e harlisur nga ngjyrat e Venedikut dhe zemrën e përvëluar nga nevoja** për të gjetur një rrahje.*

Mbiemër + parafjalë + emër *Kasi ishte **i ndryshëm nga djemtë** që kishte njohur.*

Folje + parafjalë + ndajfolje *Shpesh, të varfërit që **vijnë nga larg**...*



Kundrinori i zhdrejtë me parafjalën nga

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë të rasës emërore është një dukuri shqiptare, një albanizëm, një idiomë shqiptare⁹⁶. Rasa emërore sundohet vetëm nga dy parafjalë: **nga** dhe **te(k)**. Këto janë parafjalë vetëm të rasës emërore.

1. Kundrina me parafjalën **nga**, kur varet nga foljet: *kam, them, bëj, dua, zgjedh, ftoj, ndaj, marr, blej etj.*, mund të shprehë atë pjesë të së tërës mbi të cilën shtrihet veprimi: *Shpatat do të skuqeshin në emër të shkencës dhe vrasjet të justifikoheshin duke lexuar biblën e murtajës, shkruar nga Stefan Gjika dhe profet i të cilës ishte Otello.*
2. Kundrina me parafjalën *nga* pranë foljesh me kuptimin e gjerë të të prekurit, si: *kap, mbërthej, marr, tërheq etj.*, shpreh gjymtyrë të trupit: *E kapi nga krahu.*
3. Kur varet nga një folje me kuptimin e gjerë të përbërjes, si: *përbëhem, formohem etj.*, kundrina shpreh objektin prej të cilit përbëhet një objekt tjetër: *Uji përbëhet nga oksigjeni dhe hidrogjeni.*
4. Kundrina me parafjalën *nga*, kur varet nga folje, si: *dëshiroj, marr, njoh, dalloj, kuptoj, dëgjoj, heq etj.*, shpreh objektin që shërben si pikënisje: *Flokët e verdha i binin mbi supe dhe shëndeti që trashëgonte nga e ëma ia kishte skuqur faqet që edhe nëse turpëroheshin nuk e ndryshonin ngjyrën.*
5. Kundrina me parafjalën *nga*, kur varet nga folje me kuptim të gjerë largimi, si: *largohem, shpëtoj, shkëputem, ndahem, heq etj.*, shpreh objektin nga i cili nis veprimi: *Si dy motra të ndara nga deti, por të bashkuara nga dielli, Vlora dhe Venediku kanë mbetur njëra në Lindje dhe tjetra në Perëndim.*

Kjo parafjalë përdoret me rrethorë që shprehin marrëdhënie kohore: *Nga mesi i verës, shumica e pleqve që lëngonin kishin vdekur, ndërsa fëmijët dhe të rriturit jetonin duke tharë gjymtyrët e lodhura në plazh*; Marrëdhënie vendi: *Kjo përzihej me një epsh djegës, të një shijeje të veçantë, sidomos këtë herë që vajza kthehej nga kryeqyteti*; Marrëdhënie

⁹⁶ R. Përnaska, *Kundrinori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, f. 65.

mënyre: *E kapi nga krahu*; Marrëdhënie shkakore: ... *edhe mërzitja nga fshehja, edhe lodhja prej këtij dyzimi...*; Marrëdhënie sasiore: *Në të dy anët e bodrumit, në nivelin e tokës, kishte nga një dritare në formë frëngjie, për ajrim dhe ndriçim*

Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës prej

Parafjala *prej* në shqipe është parafjalë e rasës rrjedhore. Është një parafjalë e hershme dhe kjo kuptohet nga përdorimi i saj në mbarë shqipen, si nga autorë të Veriut edhe nga ata të Jugut. Sipas Demirajt “prej është një fjalë polisemantike, pra me origjinë ndajfoljore⁹⁷”. Ajo tregon:

- Pikënisjen nga një vend: *T’u shpjegonte se ato bodrume nuk ishin mall pa zot, duhej t’i nxirrnin prej andej familjet e tyre dhe të largoheshin në paqe.* (J.K.Sh. 276) – *Να τους εξηγήσει πως τα υπόγεια είχαν αφέντη, έπρεπε να πάρουν από κει τις οικογένειές τους και να απομακρυνθούν ήρεμα.*
- Drejtimin për në një vend a njeri. Me këtë kuptim përdoret kryesisht në të folmet e Veriut. Në të folmen e Jugut me këtë kuptim është më i shpeshtë përdorimi i parafjalës nga. *Prej andej vajti në dhomën e gjumit.* (J.K.Sh. 13) – *Ευθύς αμέσως πήγε στην κρεβατοκάμαρα.*
- Prejardhjen: *Ideja për të vajtur në bodrum më lindi kur te dera e hapur e dhomës së pritjes, prej nga vinte zëri kumbues i Krimbit Bas, u shfaq Anila.* (J.K.Sh. 64) – *Σκέφτηκα να πάω στο υπόγειο όταν στην ανοιχτή πόρτα του χώρου υποδοχής, απ’ όπου ερχόταν η καμπανιστή φωνή του Μπάσου Σκόληκα, ξεπρόβαλε η Ανίλα.*
- Largimin: *Ndoshta, ata senatorë që mendojnë kështu kanë të drejtë, por nëse ne i humbim ishujt dhe portet që kemi pasur, do të varfërohemi shpejt sepse prej andej nuk do vijmë më mallra, ushqime, gurë të çtuar dhe kafshë.* (O.A.V. 25) – *Ισως,*

⁹⁷ Demiraj. Sh, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1969, f. 270.

εκείνοι οι γεριουσσαστές που σκέφτονται έτσι έχουν δίκιο, αλλά αν εμείς χάνουμε τα νησιά και τα λιμάνια που ήδη έχουμε, θα γίνουμε σύντομα φτωχοί γιατί **απ' εκεί** δεν θα έρχονται πια εμπορεύματα, τρόφιμα, πολύτιμες πέτρες και ζώα.

- Shkakun e ndonjë veprimi: *Kishte dëgjuar diku në një bisedë, ose kishte lexuar në kronika të vjetra, ose e kishte menduar vetë më pas, i nxitur prej bisedës a leximit, se përpara djegies së Voskopojës, zjarri ishte parandierë së pari në pëlhurat e piktorëve.* (L.F.M. 14) – Είχε ακούσει σε κάποια συζήτηση ή είχε διαβάσει σε παλιά χρονικά, ή το είχε σκεφτεί ο ίδιος αργότερα **κάτω από την επίδραση της συζήτησης** ή της ανάγνωσης ότι προτού καεί η Μοσχόπολη, τη φωτιά την είχαν προμαντέψει οι καμβάδες των ζωγράφων.
- Personin a frymorin veprues: *Pluhuri i ngritur prej saj shtëllunga-shtëllunga, i zi e plot zemërim nga ai zgjim i beftë, mezi po shtrohej e po binte përsëri mbi rrugën e përgjumur.* (L.F.M. 11) – Το σύννεφο της σκόνης που σήκωσε το αυτοκίνητο – σύννεφο σκοτεινό και οργισμένο εξαιτίας του αιφνίδιου εκείνου ζυπνήματος – μετά βίας καλμάριζε και ξανάπεφτε πάνω στο κοιμισμένο δρόμο.
- Pjesën e një grumbulli a një të tëre: *Për të hequr mendjen prej saj u vërtit prapë rrotull kavaletit: renditi furçat, shqyrtoi tubetat e ngjyrave, provoi me gishta dy prej tyre.* (L.F.M. 13) – Προσπαθώντας να απομακρύνει τη σκέψη του από κείνη, άρχισε να περιφέρεται ξανά γύρω από το καβαλέτο: Τακτοποίησε τα πινέλα, περιεργάστηκε τα σωληνάρια με τα χρώματα, δοκίμαζε **δύο από αυτά** με τα δάχτυλά του. *I mbërthyer nga njëri prej kolegëve të pranishëm, - tjetri mbajti kryeredaktorin, - e pashë veten jashtë derës së zyrës.* (J.K.Sh. 54) – Με άρπαξε ένας **απ' τους συναδέλφους** – ο άλλος κρατούσε τον αρχισυντάκτη – και μ' έβγαλε σηκωτό έξω.
- Anën ose pjesën e një gjëje a të një vendi: *E kapi prej krahu.* – Τον έπιασε **από το μπράτσο**. *E kapi prej flokësh.* – Τον έπιασε **από τα μαλλιά**. *I ra unaza prej gishtit.* – Της έπεσε το δαχτυλίδι **από το δάχτυλο**.
- Sasinë ose të maturit e një gjëje: *Nga kjo pronësi vilte një qira mujore prej dy mijë eurosh, hollësi që Dina, e dinte apo jo, nuk ia zuri me gojë.* (J.K.Sh. 6) – Η

ιδιοκτησία αυτή του άφηνε μηνιαίο μίσθωμα 2.000 ευρώ, μια λεπτομέρεια που η Ντίνα, είτε τη γνώριζε είτε όχι, δεν την ανέφερε καν.

- Krahasim mes dy elementëve të fjalisë: *Me fjalë të tjera, në qoftë se në një mbrëmje vallëzimi të qëllonte të njiheshe me dy vajza, me tërheqje pak a shumë të njëjtë, njëra prej të cilave quhej Ana e tjetra Svjetllana... (I.Sh. 11) – Με άλλα λόγια, εάν σε μια διασκεδαστική βραδιά τύχαινε να γνώρισες με δύο κορίτσια, με την ίδια περίπτωση έλξη, η μία από τις οποίες λεγόταν Άννα και η άλλη Σβιετλάνα...*
- Prej sa kohësh ka ndodhur një veprim a një ngjarje: **Prej kohësh** kishte vënë re se syri i mbetur vetëm, e jepte ndryshe edhe gëzimin, edhe brengën. (L.F.M. 38) – *Είχε ήδη παρατηρήσει από καιρό ότι το μοναδικό αυτό μάτι του πατέρα του την έκφραζε αλλιώς και τη χαρά, και την πίκρα. Afër mbrëmjes ajo ia behu në shtëpi, një apartament ku ne jetonim prej dy vjetësh, mblodhi një pjesë të plaçkave të saj, i futi në një valixhe dhe para se të zbriste poshtë, ku kishte parkuar makinën, më tha që krimbat gjendeshin në kokën time. (J.K.Sh. 55) – Ήταν απόβραδο όταν εμφανίστηκε στο σπίτι, ένα διαμέρισμα που μας συστήγαζε επί δύο χρόνια, συμάζεψε ένα μέρος απ' τα πράγματά της, τα έβαλε σε μιαν αποσκευή και πριν κατέβει κάτω, όπου είχε παρκάρει το αυτοκίνητό της, μου είπε πως τα σκουλήκια ήταν στο κεφάλι μου.*
- Lëndën prej së cilës ndërtohet diçka: *Ato kohë unë vazhdoja të flija në një dhomë me prindërit, në një krevat prej druri, që tundej, i vendosur pranë shtratit të tyre bashkëshortor, nga krahu i nënës. (J.K.Sh. 27) – Τότε μοιραζόμουν την ίδια κρεβατοκάμαρα με τους γονείς μου, κοιμόμουν δίπλα τους, σε μια ξύλινη κούνια, απ' την πλευρά της μάνας.*
- Karakteristikë a cilësi të një personi. Ky përdorim gjendet kryesisht në të folmet e Jugut. Në të folmet e Veriut përdoret rrjedhorja e thjeshtë. *Po kthehem prapa, me një lëvizje prej këmilli. (J.K.Sh. 56) – Γυρίζω πίσω, σαν σαλιγκάρι. Turp, më tha qortueshëm, ç' ishte ajo e qeshur prej budallai? (J.K.Sh. 64)– Τι χαχανητό ηλιθίου ήταν αυτό;*

Siç e pamë dhe më lart përdorimi i këtyre parafjalëve në greqishte dhe shqipe është mjaft i shpeshtë. Parafjala από e greqishtes ka gjegjëset e saj në shqipe nga dhe prej. Ndërsa në gjuhën greke ajo prin një emër në kallëzore, dhe rrallë në emërore apo gjinore, në shqipe parafjala nga përdoret me emër në rasën emërore, ndërsa parafjala prej me emër në rrjedhore. Nga shembujt e mësipërm vumë re pikërisht këto formime, por ka

edhe raste kur parafjala από e greqishtes mund të mos përkthehet ose të jepet me forma të tjera. E njëjta gjë ndodh edhe me parafjalët e gjuhës shqipe. Për sa i përket kuptimeve të tyre kanë pothuajse të njëjtat kuptime, me disa përjashtime të vogla si p.sh: Përjashtim (=εκτός από). Zakonisht pas përemrit άλλος: Άλλος απ'τον θεό τον πόνο μου δεν ζέρει. Δεν είχε άλλη φροντίδα απ'αυτή.

Parafjala prej përdoret për të formuar rrethanorë që shprehin marrëdhënie kohore: *Ai kishte lindur në shkretëtirë ku rëra ishte më e fortë, sepse, **prej mijëra vjetësh**, asnjë det nuk e zbuste shkretëtirën, e cila nuk lagej, por vetëm thahej;* Marrëdhënie shkakore: *Kishte dëgjuar diku në një bisedë, ose kishte lexuar në kronika të vjetra, ose e kishte menduar vetë më pas, i nxitur **prej bisedës** a leximit, se përpara djegies së Voskopojës, zjarri ishte parandierë së pari në pëlhurat e piktorëve;* Marrëdhënie sasiore: *Nga kjo pronësi vilte një qira mujore **prej dy mijë eurosh**, hollësi që Dina, e dinte apo jo, nuk ia zuri me gojë.*


Sintagmat me parafjalën **prej** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Janë prej floriri.*

Mbiemër prejpjesor + parafjalë + emër *I hutuar prej ngjarjes.*

Emër + parafjalë + emër *Lëvizje prej kërmilli.*

Ndajfolje + parafjalë + emër *Ndodhet larg prej shtëpisë.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *ndër*

Buzuku ka përdorur trajtën *ëndër*, ndërsa shkrimtarë të tjerë dhe ata të Rilindjes kanë përdorur trajtën që kemi dhe sot. Kjo parafjalë përdoret me rasë kallëzore shumë. Përdoret me emërore për të treguar emfazë.


Kjo parafjalë tregon:

- Të qenurit a të ndodhurit e një personi a gjëje në mes të tjerash: *Një kuqëlim i lehtë, si t'i pasqyrohej nga qelqe të padukshme i lodronte në fytyrë, bashkë me një nënqeshje, si vesë ndër qepalla.* (L.F.M. 24) - Ένα ελαφρύ ρόδισμα, που το αντιφέγγιζαν θαρρείς κάποια σόρατα γυαλικά, παιχνιδίζε στο πρόσωπό της, σε συνδυασμό με ένα σαν δροσιά μειδίαμα **πάνω στα ματόκλαδά της.**
- Të lëvizurit e një personi a gjëje në mes të tjerësh: *Nuses së re i duhej të gëlonte njëkohësisht ndër dy kohë.* (L.F.M. 33) - Η νεαρή γυναίκα ήταν πια αναγκασμένη να περνάει τη ζωή της **σε δύο χρόνους.**
- Të qenurit më lart në krahasim me të tjerë: *Nëse ishte arritur cilësia, përse u ripunua, madje jo pak, por, ndër të tjera, duke shtuar disa faqe, konkretisht, skenën e rishfaqjes së Lasgushit në mbledhjen e shkrimtarëve dhe skenën imagjinative të mbikëqyrjes policore të heroit rrëfyes?* (I.Sh. 92) – Αν η ιδιότητα είχε καταφερθεί, γιατί ξαναέγινε, και όχι λίγο, αλλά **πάνω απ' όλα**, προσθέτοντας μερικές σελίδες, συγκεκριμένα...>
- Reciprocitet: *Nisi e ftohta dhe shirat, u ndezën vatrat dhe gjindja, si në çdo prag dimri, mbledhej ndër veti.* (L.F.M. 25) - Άρχισαν τα κρύα και οι βροχές, άναψαν οι φωτιές στα τζάκια, και οι άνθρωποι, όπως πάντοτε στα πρόθυρα του χειμώνα, μαζεύονταν στα σπίτια τους.

Sintagmat me parafjalën *ndër* formohen:

Emër + parafjalë + emër *Si vesë ndër qepalla.*

Ndajfolje + parafjalë + numëror *Nuses së re i duhej të gëlonte njëkohësisht ndër dy kohë.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *gjer, deri*

Kjo parafjalë është përdorur me shumë trajta nga shkrimtarët e vjetër dhe ata të Rilindjes. Buzuku ka përdorur trajtën *ndjerie*, Budi e Bogdani *ndjerë*, Argjirokastriti trajtën *ngjera*, Kristoforidhi trajtat *deri* e *ngjer*, Samiu e Naimi trajtat *gjerë* e *gjer*, Pedersenit trajtën *njera*, arbëreshët trajtat *njera* e *njer*. Sot përdorim të gjerë kanë trajtat *deri* e *gjer*.

Parafjala *deri* tregon kufirin e një vendi a kohe: *Ajo që shumëkush e quajti trill, duf për ta shkelur tjetrin gjer në fund, marrëzi shqiptare, lodër pa shije, turp e tmerr bashkë, u krye gjer në fund.* (L.F.M, I.Kadare, 22) - *Εκείνο που πολλοί το αποκάλεσαν καπρίτσιο, τυφλό πάθος για συντριβή του άλλου, αλβανική παραφροσύνη, κακόγουστο παιχνίδι, αίσχος και φρίκη μαζί, προχώρησε μέχρι τέλος.* Ajo formohet me emra dhe ndajfolje. Në më të shumtën e rasteve kur formohet me emra, shoqërohet dhe me parafjalë të tjera. Ka edhe raste kur nuk shoqërohet me parafjalë të tjera, por ajo është e

nënkuptuar. Kur shoqërohet me ndajfolje. Mund të shoqërohet ose jo nga parafjalë të tjera. E gjejmë të përdorur para numrave për të treguar sasinë maksimale të diçkaje, p.sh: *kërcente deri dhjetë metra*.

Si përfundim mund të themi se parafjala *deri* është korelativi i parafjalës *nga* a *prej* në kohë e në hapësirë për të treguar mbarimin: *prej malit deri në breg të detit*.⁹⁸

Kjo parafjalë shërben për të formuar rrethana që shprehin marrëdhënie vendore, sasiore e kohore.

Sintagmat me parafjalën *deri* formohen:

Folje + parafjalë + ndajfolje *Lëvizi deri poshtë*.

Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *pas* e *mbas*

Këto trajta janë përdorur kryesisht që nga shkrimtarët e vjetër, ata të Rilindjes e deri në ditët e sotme. Me përjashtim të disa rasteve kur është përdorur dhe trajta mes. Këto dy parafjalë sinonime përdoren me rasë rrjedhore.

Kjo parafjalë tregon:

- Të qenurit a të vepruarit prapa një gjëje, vendi a personi: *Një pjesë ishin përdhe, të mbështetura, pas murit kurse shumica ishin kthyer mbrapsht*. (L.F.M. 12) - *Κάποιοι άλλοι πίνακες βρίσκοντας καταγής, ακουμπισμένοι στον τοίχο. Οι περισσότεροι είχαν τοποθετηθεί ανάποδα*.
- Mënyrën e të vepruarit me anë të një mjeti ose jo: *Dhe, meqë bluza ishte shumë e ngushtë, ngjitur pas trupit, të shihja sutienat dhe ngjyrën e mishit*. (J.K.Sh. 151) - *...εφόσον ήταν πολύ στενή, κατάσαρκα βαλμένη, να χαζέψω το σουτιέν και το χρώμα της σάρκας της*.
- Personin a sendin pas të cilit shkon një person a send tjetër: *Shpesh hutohej pas grave që ecnin në rrugë si mushka, apo vajzave të reja që vraponin më shpejt se*

98 A. Xhuvani, vep. e cit., 311

kuajt... (O.A.V. 32) – Συχνά χάζευε **με τις γυναίκες** που περπατούσαν στον δρόμο σαν μουλάρια, ή με τις νέες κοπέλες που έτρεχαν πιο γρήγορα και από τα άλογα...

- Vazhdimin e një veprimi: **Pas pijes** më vinte të zhdukesh nga kjo botë. (J.K.Sh. 267). – Όταν μου έβαινε το ποτό, δεν ήθελα πλέον ζωή.

- Të vepruarit sipas një situate a sipas mendimit të ndokujt: *Nisi të tregonte se si e vjehrra donte që me çdo kusht të porosiste priftin, nga ana e saj për të birin, se si ajo mundi ta gjente më në fund **pas adresës** dhe vjehrra u qetësua dhe ...* (Gj.U.V. 87) – Αρχισε να του λέει πως η πεθερά της ήθελε με κάθε τρόπο να βρει τον συγκεκριμένο ιερέα, για το γιο της, πως αυτή μπόρεσε τελικά να τον βρει, **έχοντας τη διεύθυνσή τους**, πως η πεθερά της ησύχασε και πως ...

- Tendencë a dëshirë pas një gjëje a një personi: *E përzier me të m'u kujtua një novelë e botuar kohë më parë në Moskë, ku tregohej për një vajzë sovjetike, të dashuruar **pas Aleksandër Bllokut** të vdekur. (I.Sh. 71) – Ανακατωμένα μ' αυτό, μου έρχονταν στην μνήμη αποσπάσματα ενός διηγήματος δημοσιευμένου παλαιότερα στην Μόσχα, για μία νεαρή Σοβιετική, που ερωτεύτηκε **τον Αλεξάνδρο Μπλοκ** μετά τον θάνατό του.*

- Kohë të afërt ose të largët: *Si përherë **pas çdo shkëputjeje** ishte gjithë kureshtje të hetonte ndryshimin në trupin e saj. (L.F.M. 13) - Όπως πάντοτε ύστερα **από κάθε χωρισμό** τους τον έτρωγε η περιέργεια να παρατηρήσει τυχόν αλλαγές στο σώμα της.*

Këtë parafjalë e gjejmë të përdorur edhe si ndajfolje, p.sh: *e ndiqte pas, i vinte pas*, etj. Gjithashtu përdoret edhe si parashtesë për formimin e fjalëve të tjera si emra, mbiemra e folje.

Kundrina me parafjalët *pas* e *mbas* shpreh objektin tek i cili synon veprimi: *Duke u ngazëllyer **pas kënaqësisë** që të jep ringjallja e jetës, duke humbur arsyen **pas suksesit** të pamundur dhe duke harruar se në fund të fundit nuk ishte Zot, ai kishte plagosur dhe veten me besimin se duke qenë Zot, mund ta ringjallte dhe atë.*

Rrethanori me parafjalët *pas* e *mbas* shpreh marrëdhënie vendore: *E pa gjarprin që po ngrihej **pas fundit** të shtratit, me një lëkundje të lehtë, përherë e më lart; Marrëdhënie*


mënyre: *Dhe, meqë bluza ishte shumë e ngushtë, ngjitur **pas trupit**, të shihja sutienat dhe ngjyrën e mishit*; Marrëdhënie kohore: *Si përherë **pas çdo shkëputjeje** ishte gjithë kureshtje të hetonte ndryshimin në trupin e saj.*

Sintagmat me parafjalën **pas** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Ngrihej pas fundit.*

Pjesore + parafjalë + emër *Ngjitur pas trupit.*

Emër + parafjalë + emër *Reklamat pas filmit.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *për*

Në gjuhën shqipe parafjala *për*- ka vetëm një formë dhe kështu është përdorur në çdo kohë. Xhuvani thotë: “... me këtë është përdorur në gjuhë të shkrimit prej gjithë shkrimtarëve, të vjetër e të rinj në çdo kohë”⁹⁹ Lidhur me etimologjinë e kësaj parafjale Çabej thekson: “... do thënë se afrimi me indishten e vjetër *pari-*, greqishten *peri-*, latinishten *per-* etj, që bëri së pari Boppi, mbetet i drejtë. Ndërkaq ka shumë të ngjarë dhe

⁹⁹ A. Xhuvani, vep. e cit., 44.

mendimi i Joklit , që te *për-* përveç *per-*it të ketë përfunduar edhe ndonjë tjetër parafjalë indoevropiane, e veçanërisht *pro-*.”¹⁰⁰

“Për Pedersenin *për-*, që drejton vendoren dhe që nuk duhet shkëputur nga *prej-* është me siguri thjesht shqip, ashtu siç ishte i prirur ta pranonte edhe G. Meyer-i”.¹⁰¹

Në gjuhën shqipe, një parafjalë përdoret vetëm me një rasë të caktuar. Ndërsa parafjala *për* bën përjashtim dhe përdoret me dy rase, kallëzoren dhe rrjedhoren. Përdorim më të dendur kjo parafjalë e ka me rasën kallëzore, ndërsa me rrjedhoren përdoret me një numër të kufizuar emrash (*për flokësh, për dore* etj): *E kapi për flokësh*¹⁰². Shumë rrallë mund ta hasim të përdorur dhe me një emër të rasës emërore: *Ai mbahet për trim*.

Gjymtyra e prirë nga parafjala *për* tregon:

- Vendin ku gjendet a bëhet diçka: *Ishte e mundur që njeriu të mos e dinte përse nisej për rrugë?* (I.Sh. 58) – *Είναι δυνατόν ένας ταξιδιώτης να αγνοεί τον λόγο για τον οποίο ταξίδευε;*
- Mënyrën si shfaqet një veprim ose një gjendje: *Tani ashtu dhe e thërrisnin “vejusha e gjarprit”, por ato fjalë nuk shqiptoheshin më me hidhësi dhe ajo vetë nuk i merrte për keq.* (L.F.M. 28) - *Ετσι και θα την αποκαλούσαν από ’δω και πέρα, «η χήρα του φιδιού», αλλά στο παρανόμι αυτό δεν υπήρχε πια κακία, ενώ η ίδια δεν το ’βρισκε διόλου προσβλητικά.*

Me këtë funksion lidhet dhe funksioni i betimit si p.sh: *Për atë Zot! Mh, για το Θεό!*

- Kohën e kryerjes së një pune: *E përballoi etjen e sime motre për të më dhënë këshilla dhe shpërfilljen time të heshtur, për gati dy orë.* (J.K.Sh. 147) – *Επί δύο ώρες ανέχτηκε, δίχως να βγάλει κιχ, το πάθος της αδερφής μου να μου κάνει τα συμβουλάτορα, αλλά και τη σιωπηρή μου περιφρόνηση.*
- Cilësinë e dikujt kur lidhet me një mbiemër me kuptim cilësor: *Në pranverë e kërkuan dy herë rresht për nuse dhe të dy herët kërkesa u kthye mbrapsht.* (L.F.M. 28) - *Την άνοιξη της έγινε δύο μέρες πρόταση γάμου, αλλά τις απέρριψε και τις δύο.*

100 E. Çabej, *Studime gjuhësore, II*, Prishtinë, f.24.

101 Sh. Demiraj, *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe*, f.632.

102 *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë 1995, f.389.

- Shkakun për të cilin ndodh diçka: *S'mbetej veç një ditë t'i thoshte të atit: të falem, Zoti atë, për këtë martesë.* (L.F.M. 26) - Σ'ευχαριστώ, καλέ μου πατέρα, για την παντρεία ετούτη. Në urrejtjen e tij për banditët nuk kuptohej ku mbaronte mendësia e oficerit të vjetër të policisë, dhe ku niste hakmarrja për syrin e humbur. (L.F.M. 39) - Στο μίσος του για τους κακοποιούς, δεν ήταν ξεκάθαρο πού τελειώνει η νοοτροπία του παλιού αξιωματικού της αστυνομίας, και που αρχίζει το αίσθημα της εκδίκησης για το χαμένο μάτι του. *Ata iu afruan, hetuan me kujdes, pastaj i kërkuan ndjesë të zotit të shtëpisë për dyshimin.* (L.F.M. 25) - Εκείνη το πλησίασαν, το εξέτασαν προσεκτικά, κατόπιν ζήτησαν συγνώμη από τον σπιτονοικοκύρη για την καχυοψία τους.

- Qëllimin për të cilin bëhet një punë: *Vinin për ngushëllim, për kureshtje, për t'u dhënë zemër, për t'i dëshpëruar më keq.* (L.F.M. 21) - Πήγαιναν για παρηγοριά, από περιέργεια, για να τους δώσαν κουράγιο, για να τους στεναχωρήσουν περισσότερο. *Flitej se Ministria e Drejtësisë kishtë dhënë leje për krijimin e shoqatës së Gay-ve dhe lesbikeve, por kryesia e tyre mbetej ende e fshehtë.* (L.F.M 15) - Σύμφωνα με τις φήμες, το Υπουργείο Δικαιοσύνης είχε επιτρέψει την ίδρυση συλλόγων ομοφυλόφιλον, ανδρών και γυναικών, αλλά τα προεδρεία τους παρέμειναν κρυφά.

- Dobinë, fitimin: *Jo për të, por për shpëtimin e vetes sonë.* (I.Sh. 22) – Όχι τόσο για το καλό του, αλλά για τη δική μας σωτηρία!

- Objektin mbi të cilin shtrihet një veprim a një gjendje: *Keni dëgjuar për hakmarrjen e tyre?* (Gj.U.V. 36) – Έχετε ακούσει για τις βεντέτες τους;

- Argumentin për të cilin flitet, shkruhet a mbahet një qëndrim: *Dy javë më parë, ndërsa po flisnin për ndryshimet e kohës e të njerëzve, Zefi kishte thënë se këto përcudnime të befta i kujtonin atij historinë e vajzës që u martua me gjarprin.* (L.F.M. 11) - Δύο βδομάδες πριν, ενώ συζητούσαν για τις αλλαγές των καιρών και των ανθρώπων, ο Ζεφ του είχε πει ότι οι απρόσμενες ετούτες τερατωδίες του έφερναν στον νου την ιστορία του κοριτσιού που παντρεύτηκε το φίδι. *Dhe ishte e natyrshme të ishte kështu përderisa bëhej fjalë për një faj njerëzor, pra për një*

dënim. (L.F.M, I.Kadare, 33) - *Ki αυτό ήταν φυσικό, εφόσον επρόκειτο για ανθρώπινο σφάλμα, δηλαδή για τιμωρία.*

- Pjesën a anën e një të tëre, ku bie veprimi: *Lajmi për krushqinë e përçudur e shkalafiti mesin e tetorit më fort se era e veriut.* (L.F.M. 22) - *Η είδηση για την τερατώδη εκείνη συμπεθεριά ταρακούνησε τα μέσα του Οκτωβρίου χειρότερα κι από τον άγριο βοριά.*

- Kufizim në lidhje me foljet, emrat, mbiemrat që tregojnë tendencë, dëshirë, prirje: *Turbull po zbulonte se kjo farë keqardhjeje ishte, me sa dukej, shpërblimi i fundit për dështakët.* (L.F.M. 16) - *Έτσι θολά, υποψιαζόταν ότι τούτο το είδος συμπόνοιας, καθώς φαίνεται, δεν συνιστά παρά την αποζημίωση που προσφέρεται στον αποτυχημένο.*

- Përsëritjen a vazhdimin e një pune: *Është e rëndë, e kishte paralajmëruar i ati, por ajo për të dytën herë i kishte thënë: çka do që të jetë, unë do të bindem, baba.* (L.F.M. 21) - *Είναι βαρύ, την είχε προειδοίσει ο πατέρας, ενώ εκείνη για δεύτερη φορά είχε απαντήσει: Ό,τι κι αν είναι, θα το αποδεχτώ, πατέρα.*

Parafjala për ka dhe disa funksione të tjera veç atyre që u lartpërmendën si atë të ndarjes a të pjesëtimit, të zëvendësimit, të shpërblimit, të nevojës a të mungesës.

Ajo përdoret në shprehje ndajfoljore me kuptime të ndryshme. Të tilla janë: *ditë për ditë, ballë për ballë, fije për fije*, etj. Gjithashtu me këtë parafjalë janë formuar dhe disa shprehje foljore si: *i dal për zot*.

Ka raste kur parafjala për mund të mungojë, p.sh: *e zgjodhën kryetar dhe jo e zgjodhën për kryetar, fare në vend të për fare*, etj. Parafjala për ka një përdorim mjaft të dendur si parashtesë në formimin e shumë emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalën për

1. Zakonisht shpreh objektin në të mirë a në dobi të së cilit kryhet veprimi: *Jo për të, por për shpëtimin e vetes sonë.*

2. Kur varet nga një shprehje e përbërë nga folja vij dhe nga një ndajfolje *mirë, keq* etj., duke u paraprirë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor në rasën dhanore, kjo kundrinë shpreh objektin e ndjenjave tona: *I vinte keq për gjyshen.*

3. Kundrina me parafjalën për shpreh edhe personin a sendin në vend të cilit vepron dikush tjetër: *Nuk mendonte **për qytetin**, por **për dështimin** e vet.*
4. Kundrina me parafjalën për mund të shprehë objektin që shërben si kufizues: *Por **Desdemona** nuk ishte rritur duke menduar **për Vlorën**.*
5. Kjo kundrinë tregon shkak me foljet *qahem, mburrem, krenohem* etj.: *Vuante **për bukën** e gojës.*
6. Kundrina me parafjalën për shpreh marrëdhënie vendore kur përdoret me rasën rrjedhore: *Ikim, tha vajza e madhe duke marrë të motrën **për dore**.*

Kjo parafjalë përdoret për të formuar rrethorë që shprehin marrëdhënie shkakore: *S'mbetej veç një ditë t'i thoshte të atit: të falem, Zoti atë, **për këtë martesë***; Marrëdhënie kohore: *Vij **për dy ditë***; Marrëdhënie qëllimi: *Vinin **për ngushëllim, për kureshtje**, për t'u dhënë zemër, për t'i dëshpëruar më keq*; Marrëdhënie mënyre: *Tani ashtu dhe e thërrisnin "vejusha e gjarprit", por ato fjalë nuk shqiptoheshin më me hidhësi dhe ajo vetë nuk i merrte **për keq***; Marrëdhënie sasiore: ***Për disa çaste** u vendos një qetësi sa nuk dëgjoheshin as frymëmarrjet e tyre.*


Sintagmat me parafjalën **për** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Luftoi për liri.*

Mbiemër prejpjesor + parafjalë + emër *I etur për dituri.*

Emër + parafjalë + emër *Dhomë për miq.*

Folje + parafjalë + ndajfolje *E marr për keq.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *nëpër*

Kjo parafjalë është përdorur dhe në trajta të tjera si *ndërpër* nga Buzuku, *ndëpër* nga shkrimtarë të Rilindjes. Trajta *nëpër* që përdoret gjerësisht në shqipen e sotme është përdorur qysh nga Naimi e Samiu. Është parafjalë e rasës kallëzore.

Gjymtyra e prirë nga parafjala *nëpër* tregon:


- Lëvizjen a drejtimin për mes një vendi: *Ishte një mbasdite gri, nga ato prej të cilave s'priten veç gjëra të përsëritura dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, ndërsa ecja nëpër Rrugën e Pishës, në anën tjetër të trotuarit pashë R.P., njeriun më të mërzitshëm që mund të mendohej. (I.Sh. 41) - Ήταν ένα γκριζό απόγευμα, από εκείνα που δεν περιμένουμε τίποτα, παρά κάποιες επαναλαμβανόμενες στιγμές. Και σαν να μην έφτανε αυτή κατσούφικη ατμόσφαιρα, δρασκελώντας την οδό Πευκών, αντίκρις να έρχεται από το απέναντι πεζοδρόμιο, τον Δ.Τ., το πιο φορτικό πλάσμα που μπορεί να φανταστεί κανείς. Pasi zura vend në hotel, u vërtita një copë herë nëpër rrugën e vetme kryesore. (I.Sh. 62) – Αφού εγκαταστάθηκα στο ξενοδοχείο, άρχισα να περπατώ στο μεγάλο δρόμο.*
- Lëvizjen a drejtimin në një sipërfaqe pak a shumë të madhe: *Banditët e armatosur i sulmonin njerëzit e pambrojtur natën, u futeshin nëpër shtëpi, plaçkisnin, flitej për rrëmbime vajzash, përdhunime të tyre në pranë të familjarëve. (J.K.Sh. 274) – Οι ένοπλοι συμμορίτες επιτίθεντο νύχτα στους ανυπεράσπιστους ανθρώπους, έμπαιναν στα σπίτια, λεηλατούσαν, φημολογούνταν απαγωγές κοριτσιών, βιασμοί μπροστά στα μάτια των μελών της οικογένειας.*
- Mjetin me anë të të cilit bëhet a ndodh diçka: *Nëpër dritë shohim sendet. – Στο φως βλέπουμε τα πράγματα.*

Me anë të kësaj parafjale janë formuar edhe shprehjet foljore *e marr nëpër këmbë* dhe *e marr nëpër gojë*.

Sintagmat me parafjalën *nëpër* formohen:

Folje + parafjalë + emër *Kasi endej nëpër rrugë.*

Mbiemër prejpjesor + parafjalë + emër *Endej i lodhur nëpër rrugë.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *me*

Meyer është i mendimit se kjo parafjalë ka hyrë në gjuhën shqipe nga parafjala $\mu\epsilon$ e greqishtes së re. Profesor Demiraj kur e analizon këtë parafjalë thotë: “Me të vërtetë është shumë e vështirë, në mos e pamundur, që një parafjalë e tillë nga greqishtja e re, fillimet e së cilës mendohen të vërviten aty rreth shek. XII, të ketë depërtuar kaq thellë edhe në gegërishte, ku huazimet greke, në përgjithësi, i takojnë një faze më të hershme. Për më tepër do pasur parasysh se parafjalët janë nga fjalët më pak të huazueshme. ... Në këto rrethana, ndofta, nuk duhet përjashtuar mundësia e një bashkëpërkimi të pjesshëm midis parafjalës greke dhe asaj të shqipes.”¹⁰³

K.Topalli jep një tjetër mendim. Sipas tij parafjala *me* lidhet për nga burimi me *mjet*, *ndërmjet*, *mes* e të gjitha këto me ie. medio (lat. Medium, gr. Μέσσοϋς) . Ndërsa emrat dhe ndajfolja ruajtën trajtën e plotë, te parafjala ka rënë bashkëtingëllorja fundore.¹⁰⁴

Por sipas M. Karagjozi “bashkëpërkimi i kësaj parafjale me atë të greqishtes së re ndoshta e ka burimin te një fazë më e hershme i.e. e përbashkët, e cila reflektoi në të dyja gjuhët njësoj”.¹⁰⁵

¹⁰³ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1987, f. 634.

¹⁰⁴ K. Topalli, *Fonetkë historike e gjuhës shqipe*, f. 85.

¹⁰⁵ M. Karagjozi, *Parafjalët në “Mesharin” e Gjon Buzukut*, Tiranë 2005, f. 49.

Ndërsa në gjuhën greke trajta e saj ka ndryshuar nga **μετά** në **με**, në gjuhën shqipe ajo ka pasur gjithmonë këtë trajtë. Në shqipe ajo nuk ka trajta të tjera dialektore. Për sa i përket kuptimeve që kjo parafjalë ka, ato janë shtuar me kalimin e kohës. Është bërë pjesë e disa togefjalëshave apo shprehjeve parafjalore që janë karakteristike për gjuhën e sotme, si: *me anën, me anë të, të lodhur me, paralelisht me, në lidhje me, në krahasim me, në pajtim me*, etj, ose e gjejmë në ndërtime të tipit, *me një fjalë, me të ardhur, me të parë*.

Si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke parafjala **me** është parafjalë e rasës kallëzore. Gjymtyra që pason parafjala **me** mund të tregojë:

- Shoqërim, bashkim, lidhje, përcjellje: ... *si kishte shkuar në klub dhe qe ulur në tryezë me ca fshatarë, ç' i kishin treguar vendësit për zhdukjen e kolonelit, dhe se si ai dyshonte për gjithçka.* (Gj.U.V. 195) - ... *πως είχε πάει στη λέσχη και είχε καθίσει μαζί με μερικούς χωριάτες, πως τον είχαν πει για την εξαφάνιση του συνταγματάρχη, και πως ο ίδιος αμφέβαλλε για όλα αυτά.*
- Marrëdhënie, sjellje, qëndrim: *Jemi therur me njëri-tjetrin egërsisht, - vazhdoi gjenerali.* (Gj.U.V. 35) - *Αλληλοσφαχτήκαμε άγρια, συνέχισε ο στρατηγός. Ατα janë vrarë me njëri tjetrin kur nuk kanë pasur me kë të luftojnë.* (Gj.U.V. 36) – *Σκοτώνονταν μεταξύ τους όταν δεν είχαν κανέναν άλλον να πολεμήσουν.*
- Mjetin me të cilin kryhet një punë: *Ai doli më pas nga gropa dhe pushoi ndanë saj për aq kohë sa shoku i tij hoqi me lopatë baltën e gërmuar.* (Gj.U.V. 20) - *Βγήκε ύστερα από λίγο απ' το λάκκο και στάθηκε δίπλα του μέχρι ο άλλος εργάτης να βγάλει με το φτυάρι το σκαμμένο χώμα.*
- Mënyrën se si shfaqet një veprim apo një gjendje e brendshme: *Sepse atje pranë me këmbë të varura në një hulli me ujë, ishte shtrirë përmbys shoku im më i ngushtë.* (Gj.U.V. 22) – *Γιατί εκεί κοντά ήταν πεσμένος μπρούμυτα, με τα πόδια κρεμασμένα σ' ένα αυλάκι, ο καλύτερός μου φίλος.*
- Kohën kur bëhet a ndodh diçka: *Suelën e prita si zakonisht te hyrja e hotelit dhe ajo, si zakonisht, mbërriti me dhjetë minuta vonesë.* (J.K.Sh. 270) – *Περίμενα τη Σουέλα στην είσοδο του ξενοδοχείου, ως συνήθως, και εκείνη, το ίδιο όπως πάντα, ήρθε με δέκα λεπτά καθυστέρηση.*
- Lëndën me të cilën është ndërtuar ose është zbukuruar një send: *Ashtu të duket o peshk, o thnegël që mbartje një unazë me diamant, pa ditur ç' mbartje, o zero, o tmerr?* (I.Sh. 52) – *Να λοιπόν τι σκέφτεσαι, σάλιαγκα, κοπρίτη, που κουβαλάς χωρίς να το ξέρεις ένα διαμάντι! Αι, munguesi i madh, gjysmë i harruari, gati – gati fantazma, dhe tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatat që gëlonin me*

- bojë, me bar , me gurë, me trupa njerëzish** gjatë manifestimeve sportive. (I.Sh. 55) – Εκείνος, ο Μεγάλος Απών, μισοξεχασμένος, ένα είδος φαντάσματος και ο άλλος, ο Πανταχού Παρών, με τα αμέτρητα πορτρέτα του και τ' αποφθέγματά του κρεμασμένα παντού, φτιαγμένα **από μελάνι, χορτάρι, χαλίκια ή ανθρώπινα σώματα** στα στάδια, στις αθλητικές εκδηλώσεις.
- Shkakun për të cilin bëhet një punë: *Ndërkaq, emrat e njerëzve, në një fare mënyre, e kanë krijuar dhe ato një traditë, për të bërë më të lehtë lidhjen e personazhit letrar **me lexuesin**.* (I.Sh. 12) – Εντομεταξύ, τα ονόματα των ανθρώπων, κατά έναν τρόπο, έχουν δημιουργήσει και αυτά μια παράδοση, για να κάνουν πιο εύκολη την σχέση **ανάμεσα** στον λογοτεχνικό χαρακτήρα και **τον αναγνώστη**. *Dhe unë s'i kisha kundërshtuar, vetëm kisha qeshur së brendshmi, ashtu siç më vinte të qeshja tani **me atë fjalë** të marrë.* (I.Sh. 20) – Και εγώ δεν το είχα αντιταχθεί, μόνο που είχα γελάσει από μέσα μου, όπως θέλω και τώρα να γελάσω **με αυτή την παράλογη λέξη**.
- Tipar, karakteristikë apo cilësi të një personi, të një kafshe a të një sendi: *Nga mënyra se si gërmonte dukej që ishte një punëtor **me përvojë**.* (Gj.U.V. 16) – Απ' τον τρόπο που έσκαβε, έμοιαζε να ήταν **έμπειρος εργάτης**. *Një burrë **me borsalinë** kërkonte me sy dikënd, për të shfryrë mllëfin.* (L.F.M.) *Pra, dhe kjo mbrëmje, ndonëse një mbrëmje **me dasmë**, do të kishte shkuar si çdo mbrëmje tjetër, sikur gjenerali t'i kishte menduar të gjitha këto dhe pastaj të dëgjonte ç' rrëfente prifti rreth kolonelit Z...* (Gj.U.V. 195) – έτσι λοιπόν κι αυτή η βραδιά, αν και **βραδιά γάμου**, θα περνούσε όπως κι όλες οι άλλες, αν ο αρχηγός αφού είχε κά'νει αυτές τις σκέψεις δεν άκουγε τον ιερέα να διηγείται για το συνταγματάρχη Z...
- Kusht: *Dhe shkaku ishte se atij i ishte dukur se misioni i tij mund të kryhej vetëm **me shi**.* (Gj.U.V. 13) - Και ο λόγος ήταν ότι αυτός πάντα πίστευε πως η αποστολή του μπορούσε να εκτελεστεί μόνο **με βροχή**.
- Kundërshtinë me ndonjë a gjësend: *Në një ditë të tillë, kaq të pashpresë për mua, kur kisha kaq nevojë për diçka të kundërt **me monotoninë**, ç' shans ogurzi të nxori përpara meje?* (I.Sh. 18) – Μια τέτοια μέρα, που μου φαινόταν μαύρη και άραχλη και είχα τόσο ανάγκη να συμβεί κάτι να σπάσει **την μονοτονία**, η κακή τύχη διάλεξε να βρεθεί αυτός ακριβώς μπροστά μου!
- Këmbim: *Nevoja për një send të dobishëm dhe të bukur po zëvendësohej **me nevojën** për t'i vënë një çmim çdo gjëje të bukur dhe të dobishme, e cila nuk mund të ishte e bukur dhe e dobishme pa një çmim të bukur dhe të dobishëm.* (O.A.V. 28) – Η ανάγκη για κάτι χρήσιμο και ωραίο αντικαθιστούσε **με την ανάγκη** να βάζεις μια τιμή σε κάθε ωραίο και χρήσιμο πράγμα, το οποίο δεν θα μπορούσε να ήταν ωραίο και χρήσιμο χωρίς μια ωραία και χρήσιμη τιμή.

- Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar: *Ai ishte përpjekur t'i shpjegonte se s'lidhej vetëm me shijet e tij mashkullore, por në radhë të parë me artin.* (L.F.M. 13) – *Εκείνος είχε προσπαθήσει να της εξηγήσει ότι δεν επρόκειτο τόσο για τα αντρικά του γούστα, όσο για την ίδια την τέχνη.*
- Qëllimin për të cilin kryhet një veprim: *Pse e depozituat në Francë tregimin “Ikja e shtërgut”, përderisa kishit guxuar të botonit në Shqipëri “Pallati i ëndrrave” me një kundërtotalitarizëm të fuqishëm e të shumëanshëm?* (I.Sh. 9) – *Γιατί είχατε καταθέσει στην Γαλλία το διήγημα «Το παλάτι των ονείρων» με ένα δυνατό και πολύπλευρο ανθολοκλωτισμό;*
- Sasinë a çmimin e diçkaje: *Brenda një kohe të shkurtër ia doli të grindej me shumicën e fqinjëve dhe kjo është arsyeja që s'mund ta shmang.* (J.K.Sh. 156) – *Μεγάλος καβγατζής, μέσα σε λίγο χρονικό διάστημα τσακώθηκε με τους περισσότερους γειτόνους – αυτός είναι και ο λόγος που δεν μπορ'ν να τον αποφύγω.*

Por Xhuvani thekson se ka edhe raste kur kjo parafjalë mund të mungojë p.sh një shtëpi plot lagështirë në vend të një shtëpi me plot lagështirë¹⁰⁶.

Edhe lokucionet që kanë si element të fundit parafjalën me: *në lidhje me, në krahasim me, bashkë me* etj., kanë kuptimin e marrëdhënies, të bashkimit, të shoqërimit, por sipas kuptimit të emrit a ndajfoljes përkatëse, lokucioni fiton ngjyrimë të reja. Lokucioni *me gjithë* përveç kuptimit të shoqërimit mund të shprehë dhe marrëdhënie lejimi, p.sh: *Me gjithë punën e bërë, nuk ia doli mbanë.*

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalën me

1. Kundrina me parafjalën *me* shpreh objektin që shoqëron sendin e shprehur nga kryefjala: *Të martohem me një gjarpër?*
2. Mund të shprehë mjetin me të cilin kryhet veprimi: *Që pas qelqeve ai e ndoqi me sy.*
3. Kur varet nga folje që shprehin *përlllogaritje, matje*, shpreh njësitë e kësaj përlllogaritjeje e matjeje: *Dëbora matet me metra.*
4. Kundrina me parafjalën *me* kur varet nga folje si: *vesh, mbështjell, stolis, zbukuroj, ujit, pudros* etj., shënon sendin me të cilin kryhet veprimi: *Lëkura e tyre*

106 A. Xhuvani, vep. e cit., 326

- ishte e bardhë e megjithatë ato e lyejin me shumë pudër dhe me vaj për ta zbardhur edhe më shumë, sado dukeshin të gjitha njësoj si maska me madhësi të ndryshme.*
5. Kur varet nga folja me kuptimin e përfitimit, si: *bëj, ndërtoj, gatuaj, përgatit, përbëj, përftoj, formoj* etj., kundrina shfaq sendin nga i cili është përfutuar objekti i shprehur nga kundrina e drejtë ose kryefjala: *Ai, munguesi i madh, gjysmë i harruari, gati – gati fantazma, dhe tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatat që gëlonin me bojë, me bar , me gurë, me trupa njerëzish gjatë manifestimeve sportive.*
 6. Kundrina me parafjalën *me*, kur varet nga folje të diatezës mesore, si: *merrem, tallem, gajasem,* etj., ose të diatezës veprare, si: *qesh, luaj, kaloj* etj., shpreh objektin mbi të cilin shtrihet veprimi: *Sytë e mëdhenj nuk i fshihnin as kapriçot dhe as virgjërinë e një vajze që shkonte e sigurt drejt një moshe tjetër, kur femrat duan të kontrollojnë çdo lojë dhe sidomos ato lloj lojërash që luhen me sytë e burrave.*
 7. Kur varet nga folje që tregojnë ndryshim në gjendjen e objektit të shprehur nga kundrina e drejtë ose nga kryefjala, shënon objektin që sjell këto ndryshime: *U habit me ndryshimin që kishte pësuar pas operacionit.*
 8. Kundrina me lokucionet parafjalore *bashkë me, së bashku me* shpreh objektin që shoqëron sendin e shprehur nga kryefjala ose nga kundrina: *Kur u afrua, era e saj prej kajsie të njomë u përhap nëpër shtëpi dhe Kasi bashkë me Otellon u ngritën në këmbë si dy pemë që tundin gjethet në ajër.*
 9. Kundrina me lokucionin parafjalor *në kundërshtim me* shpreh objektin, kryesisht vetën, në kundërshtim me të cilin kryhet veprimi: *Ata vepruan në kundërshtim me udhëzimet.*

Kjo parafjalë shërben për të formuar rrethanorë që shprehin marrëdhënie shkakore: *Ndërkaq, emrat e njerëzve, në një fare mënyre, e kanë krijuar dhe ato një traditë, për të bërë më të lehtë lidhjen e personazhit letrar me lexuesin;* Marrëdhënie kohore: *Me kalimin e viteve bëhej më i dashur;* Marrëdhënie qëllimi: *Pse e depozituat në Francë tregimin “Ikja e shtërgut”, përderisa kishit guxuar të botonit në Shqipëri “Pallati i ëndrrave” me një kundërtotalitarizëm të fuqishëm e të shumanshëm?* Marrëdhënie mënyre: *Sikur babai im të ishte më trim dhe mos ta linte Otellon në Vlorë, ju me siguri do më kishit sjellë një dhuratë tjetër, tha Desdemona duke e parë Kasin me qepallat ulur;* Marrëdhënie sasiore: *Brenda një kohe të shkurtër ia doli të grindej me shumicën e*

*fqinjëve dhe kjo është arsyeja që s'mund ta shmang; Marrëdhënie kushtore: Dhe shkaku ishte se atij i ishte dukur se misioni i tij mund të kryhej vetëm **me shi**; Marrëdhënie lejimi: Punonte sa për dy veta **me gjithë moshën** e kaluar.*


Sintagmat me parafjalën **me** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Punoi me vështirësi.*

Mbiemër prejppjesor + parafjalë + emër *I dashur me shokët.*

Emër + parafjalë + emër *Babai me mamanë.*

Ndajfolje + parafjalë + emër *Larg me punën.*



Funksioni dhe ndërtimi i parafjalës *pa*

Kjo parafjalë është përdorur gjithmonë me këtë trajtë nga të gjithë shkrimtarët dhe mendohet se është një parafjalë e trashëguar. Meyeri e nxjerr atë nga një trajtë më e vjetër *po dhe e krahason me greqishten apo, me indishten e vjetër apa, me gjermanishten e lartë të vjetër fana dhe me latinishten po-. Deri më sot nuk është bërë asnjë shpjegim i kundërt me këtë lidhur me këtë parafjalë. Ndërrimi i o>a- është një dukuri e njohur në fjalët e trashëguara të shqipes. Kjo parafjalë ka kuptim mohor, gjë që nuk vihet re në asnjë nga gjuhët e tjera të lartpërmendura. Demiraj mendon se “kjo fjalë duhet të ketë humbur theksin në një fazë të evolucionit të shqipes, kur zanorja e patheksuar nuk reduktohej më, dhe që kuptimi mohor i saj do të jetë përfutur në kushte sintaksore që mbeten për t’u hulumtuar. Sidoqoftë, mbetet jashtë çdo dyshimi që pa është, në thelb, një fjalë e hershme, e trashëguar, e gjuhës shqipe”¹⁰⁷. Ajo ka kuptim të kundërt me parafjalën *me*. Është parafjalë e rasës kallëzore. Tregon të paqenët ose mungesën e diçkaje.


Parafjala *pa* mund të formojë shprehje ndajfoljore kur bashkohet me disa fjalë si: *pa anë*, *pa masë*. Kjo parafjalë është përdorur edhe si parashtesë për të formuar një numër të madh mbiemrash. Ajo përdoret edhe si ndajfolje me kuptimin *pastaj*, *prandaj*. Me anë të kësaj parafjale në rolin e parashtesës formohen një varg mbiemrash: *i pabesë*, *i paanë*, *i pandarë*, *i pakursyer*.

Parafjala *pa* tregon:

- Mungesë shoqërimi a bashkimi: *Me erën e alkoolit dhe parfumit përzier, më dha përshtypjen e një qenieje të braktisur. Pa sigurinë, pa sharmën që rrezatonte në emisionin “Kaleidoskop”*. (J.K.Sh. 266). – *Με την ανάκτηση μυρουδιά αλκοόλ και αρώματος που ανέδιδε, μου έδωσε την εντύπωση ενός εγκαταλειμμένου πλάσματος. Δίχως τη σιγουριά, δίχως τη λάμψη που εξέπεμπε στην εκπομπή «Καλειδοσκόπιο»*.
- Mënyrë: *Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti*. (Gj.U.V. 142) - *Κάποιοι άνοιξαν τους τάφους πριν έρθουμε εμείς, είπε ο στρατηγός*.

Kundrina me parafjalën *pa* shpreh personin a sendin pa të cilin kryhet ose jo një veprim. Ajo shpreh marrëdhënie objektore dhe rrethanore: : *Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti*. Kjo parafjalë shërben edhe për të shprehur rrethanorin e kushtit: *Pa pjesëmarrjen aktive të popullit demokracia nuk mund të jetojë*.

¹⁰⁷ Sh. Demiraj, vep. e cit. 634.



PËRFUNDIME

1. Klasifikimi i parafjalëve sipas karakterit të tyre sintaksor konsiston në ndarjen e tyre sipas rasave me të cilat përdoren. Në gjuhën shqipe parafjalët përdoren vetëm me një rasë të caktuar. Nga ky rregull bëjnë përjashtim parafjalët *ndaj* dhe *për*, të cilat përdoren me dy rase. Parafjala *ndaj* përdoret kryesisht me rasën rrjedhore dhe më pak me rasën kallëzore: *ndaj teje* (rasë rrjedhore) dhe *ndaj të gdhirë* (rasë kallëzore). E kundërta ndodh me parafjalën *për*, që përdorimin më të gjerë e ka me rasën kallëzore dhe përdoret më pak me rasën rrjedhore: *për punë* (rasë kallëzore) dhe *për dore* (rasë rrjedhore).

2. Parafjala *në* është përdorur me këtë formë që nga fundi i shekullit të 19-të. Është parafjalë e rasës kallëzore. Ajo tregon: vend, mënyrë, kohë etj. në gjuhën greke ajo jepet me parafjalën *σε*, edhe kjo e rasës kallëzore: *Në Tiranë të gjithë e bëjnë këtë*. - *Έτσι κάνουν όλες εκεί στα Τίρανα. Qysh në shikimin e parë Marku e kuptoi se gjarpri s'ishte as i gjallë, as i ngordhur*. - *Με την πρώτη ματιά ο Μαρκ κατάλαβε ότι το φίδι δεν ήταν ούτε ζωντανό ούτε ψόφιο*. Kur kjo parafjalë tregon kohë, në gjuhën greke nuk përdoret dhe jepet vetëm me nyjën e emrit në kallëzore: *Në mesnatë ai u shfaq vërtet në trajtën e dëshiruar*. - *Τα μεσάνυχτα εκείνος ζαναπήρε πράγματι την πολυπόθητη μορφή. Dhe në mëngjes ngrihej e lodhur dhe e bukur, si një ditë më parë*. (L.F.M. 26) - *Και το πρωί σηκωνόταν κουρασμένη μεν, αλλά το ίδιο όμορφη όπως την προηγούμενη*.

1. Parafjala *te* që merr formën *tek* para emrave e përemrave që fillojnë me zanore, sipas Joklit e ka prejardhjen nga rrënja përemërore indoevropiane *to* dhe lidhet me

asnjanësin e vjetër *tod*, si dhe asnjanësin e greqishtes *το*. Ajo ka ndryshuar trajtë me kalimin e kohëve. Xhuvani vë re se kjo parafjalë është gjetur e përdorur tek Argjirokastriti me rasën rrjedhore të përemrit vetor. Kjo ndoshta për shkak të ndonjë influence të mundshme nga greqishtja. Është parafjalë e rasës emërore dhe tregon vend. Në gjuhën greke jepet me parafjalën *σε* dhe *προς* (të dyja të rasës kallëzore), kur tregon drejtim për në një vend: *Πέρpara se të ζελτε portën e ateliesë vështrimi iu ndal një grimë te flega e djathtë.* - *Προτού ανοίξει την πόρτα του ατελιέ, το βλέμμα του καρφώθηκε για μια στιγμή στο δεξιό φύλλο της.* *Specialisti shqiptar u përkuul prapë te gropra dhe të tjerët u afruan.* – *Ο Αλβανός επιστάτης είχε σκύψει ζανά προς το λάκκο και οι άλλοι πλησίασαν κοντά του.*

2. Sipas Fr. Bopp-it, parafjala *mbi* nga origjina është identike me greqishten *επί*. Është parafjalë që përdoret me rasë kallëzore të shquar. Ajo tregon vend, kohë, epërsi: *Ishin mbledhur për ta dëgjuar përmbi gjashtëqind veta.* – *Είχαν μαζευτεί πάνω από εξακόσια άτομα για να τον ακούσουν. Κα mbi gjashtë muaj që runon në këtë kompani.* – *Έχει πάνω από έξι μήνες που δουλεύει σ' αυτή τη εταιρεία.* Në gjuhën greke jepet me lokucionin parafjalor *πάνω από*. E kundërta e saj është parafjala nën dhe jepet në greqishte me lokucionin parafjalor *κάτω από*: *Nën ndriçimin e zjarrit të vatrës ajo sodit flokët dhe mollëzat e tij të bukura.* - *Κάτω από τη λιγοστή λάμψη της φωτιάς, στο τζάκι, το κορίτσι θαυμάζει τα μαλλιά και τα υπέροχα ζυγωματικά του.*

3. Parafjala *nga* dhe *prej* janë të ngjashme nga kuptimi dhe funksionet. Ndërsa *nga* është e rasës emërore, *prej* është e rasës rrjedhore. Të dyja jepen në greqisht me parafjalën e rasës kallëzore *από*. Parafjala *nga* është përdorur në forma të ndryshme nga Buzuku, Budi, Bogdani, De Rada, etj. Më pas e gjejmë të përdorur me formën që kemi sot nga Kristoforidhi. Kjo parafjalë tregon vend, shkak, personin veprues, sasi, kohë etj. *Kjo përzihej me një epsh djegës, të një shijeje të veçantë, sidomos këtë herë që vajza kthehej nga kryeqyteti.* - *Αυτό προπάντων τώρα που το κορίτσι επέστρεφε από την πρωτεύουσα, συνυφαινόταν με μια καυτερή λαγνεία, μια ηδυπάθεια που είχε πολύ ιδιαίτερη γεύση. Τ' u shpjegonte se ato bodrume nuk ishin mall pa zot, duhej t' i nxirrnin prej andej familjet e tyre dhe të largoheshin në raqe.* – *Να τους εξηγήσει πως τα υπόγεια είχαν αφέντη, έπρεπε να πάρουν από κει τις οικογένειές τους και να απομακρυνθούν ήρεμα. Νε të dy anët e bodrumit, në nivelin e tokës, kishte nga një dritare në formë frëngjie, për ajrim dhe ndriçim.* - *Στις δύο πλευρές του υπογείου, στο επίπεδο του οδοστρώματος, υπήρχε από ένα παραθυράκι υπό μορφή φεγγίτη για εξαέρωση και φωτισμό. Nga ora dy e natës ai krijoi bindjen se ishte çasti më i përshtatshëm për të nxjerrë kufomën.* - *Ήταν δύο μετά τα μεσάνυχτα όταν πείσθηκε πως αυτή ήταν και η κατάλληλη ώρα να βγάλει το πτώμα. Kishte dëgjuar diku në një bisedë, ose kishte lexuar në kronika të vjetra, ose e kishte menduar vetë më pas, i nxitur prej bisedës a leximit, se përpara djegies së Voskorojës, zjarri ishte parandierë së pari në*

pëlhurat e piktorëve. – Eίχε ακούσει σε κάποια συζήτηση ή είχε διαβάσει σε παλιά χρονικά, ή το είχε σκεφτεί ο ίδιος αργότερα κάτω από την επίδραση της συζήτησης ή της ανάγνωσης ότι προτού καεί η Μοσχόπολη, τη φωτιά την είχαν προμαντέψει οι καμβάδες των ζωγράφων. Nga kjo pronësi vilte një qira mujore prej dy mijë eurosh, hollësi që Dina, e dinte apo jo, nuk ia zuri me gojë. – Η ιδιοκτησία αυτή του άφηνε μηνιαίο μίσθωμα 2.000 ευρώ, μια λεπτομέρεια που η Ντίνα, είτε τη γνώριζε είτε όχι, δεν την ανέφερε καν. Prej kohësh kishte vënë re se syri i mbetur vetëm, e jepte ndryshe edhe gëzimin, edhe brengën. (L.F.M. 38) – Eίχε ήδη παρατηρήσει από καιρό ότι το μοναδικό αυτό μάτι του πατέρα του την έκφραζε αλλιώς και τη χαρά, και την πίκρα. Afër mbrëmjes ajo ia behu në shtëpi, një apartament ku ne jetonim prej dy vjetësh, mbledhi një pjesë të plaçkave të saj, i futi në një valixhe dhe para se të zbriste poshtë, ku kishte parkuar makinën, më tha që krimbat gjendeshin në kokën time. (J.K.Sh. 55) – Ήταν απόβραδο όταν εμφανίστηκε στο σπίτι, ένα διαμέρισμα που μας συστήγαζε επί δύο χρόνια, συμμαζέψε ένα μέρος απ' τα πράγματά της, τα έβαλε σε μια αποσκευή και πριν κατέβει κάτω, όπου είχε παρκάρι το αυτοκίνητό της, μου είπε πως τα σκουλήκια ήταν στο κεφάλι μου. Një përdorim i veçantë i kësaj parafjale është të treguarit e lëndës prej së cilës ndërtohet diçka: Ato kohë unë vazhdoja të flija në një dhomë me prindërit, në një krevat prej druri, që tundej, i vendosur pranë shtratit të tyre bashkëshortor, nga krahu i nënës. – Τότε μοιραζόμουν την ίδια κρεβατοκάμαρα με τους γονείς μου, κοιμόμουν δίπλα τους, σε μια ξύλινη κούνια, απ' την πλευρά της μάνας.

4. Në gjuhën shqipe parafjala *për-* ka vetëm një formë dhe kështu është përdorur në çdo kohë. Parafjala *për* përdoret me dy rasa, kallëzoren dhe rrjedhoren. Përdorim më të dendur kjo parafjalë e ka me rasën kallëzore, ndërsa me rrjedhoren përdoret me një numër të kufizuar emrash (*për flokësh, për dore* etj). Shumë rrallë mund ta hasim të përdorur dhe me një emër të rasës emërore: *Ai mbahet për trim*. Në gjuhën greke jepet kryesisht me parafjalën e kallëzores **για**. Gjymtyra e prirë nga parafjala *për* tregon: vend, mënyrë, kohë, shkak, qëllim *E përballoi etjen e sime motre për të më dhënë këshilla dhe shpërfilljen time të heshtur, për gati dy orë. – Επί δύο ώρες ανέχτηκε, δίχως να βγάλει κιχ, το πάθος της αδερφής μου να μου κάνει τα συμβουλάτορα, αλλά και τη σιωπηρή μου περιφρόνηση. S' mbetej veç një ditë t' i thoshte të atit: të falem, Zoti atë, për këtë martesë. - Σ' ευχαριστώ, καλέ μου πατέρα, για την παντρεία ετούτη. Vinin për ngushëllim, për kureshtje, për t' u dhënë zemër, për t' i dëshpëruar më keq. - Πήγαιναν για παρηγοριά, από περιέργεια, για να τους δώσαν κουράγιο, για να τους στεναχωρήσουν περισσότερο.*

5. Parafjala me ka hyrë në gjuhën shqipe nga parafjala *με* e greqishtes së re. Profesor Demiraj kur e analizon këtë parafjalë thotë: “Me të vërtetë është shumë e vështirë, në mos e pamundur, që një parafjalë e tillë nga greqishtja e re, fillimet e së cilës mendohen të vërviten aty rreth shek. XII, të ketë depërtuar kaq thellë edhe në

gegërishte, ku huazimet greke, në përgjithësi, i takojnë një faze më të hershme. Për më tepër do pasur parasysh se parafjalët janë nga fjalët më pak të huazueshme. ... Në këto rrethana, ndofta, nuk duhet përjashtuar mundësia e një bashkëpërkimi të pjesshëm midis parafjalës greke dhe asaj të shqipes.” Si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke parafjala **me** është parafjalë e rasës kallëzore. Gjymtyra që pason parafjala **me** mund të tregojë: shoqërim, mjetin, mënyrën, kohën, lëndën, shkakun, kushtin, qëllim, sasinë etj. *Ai doli më pas nga gropa dhe pushoi ndanë saj për aq kohë sa shoku i tij hoqi me lopatë baltën e gërmuar.* - Βγήκε ύστερα από λίγο απ’ το λάκκο και στάθηκε δίπλα του μέχρι ο άλλος εργάτης να βγάλει **με το φτυάρι** το σκαμμένο χώμα. *Sepse atje pranë me këmbë të varura në një hulli me ujë, ishte shtrirë përmbys shoku im më i ngushtë.* – Γιατί εκεί κοντά ήταν πεσμένοι μπρούμυτα, **με τα πόδια κρεμασμένα** σ’ ένα αυλάκι, ο καλύτερός μου φίλος. *Ai, munguesi i madh, gjysmë i harruari, gati – gati fantazma, dhe tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatet që gëlonin me bojë, me bar, me gurë, me trupa njerëzish gjatë manifestimeve sportive.* – Εκείνος, ο Μεγάλος Απών, μισοξεχασμένος, ένα είδος φαντάσματος και ο άλλος, ο Πανταχού Παρών, με τα αμέτρητα πορτρέτα του και τ’ αποφθέγματά του κρεμασμένα παντού, φτιαγμένα **από μελάνι, χορτάρι, χαλίκια ή ανθρώπινα σώματα** στα στάδια, στις αθλητικές εκδηλώσεις. *Dhe shkaku ishte se atij i ishte dukur se misioni i tij mund të kryhej vetëm me shi.* - Και ο λόγος ήταν ότι αυτός πάντα πίστευε πως η αποστολή του μπορούσε να εκτελεστεί μόνο **με βροχή**. *Brenda një kohe të shkurtër ia doli të grindej me shumicën e fqinjëve dhe kjo është arsyeja që s’mund ta shmang.* – Μεγάλος καβγατζής, μέσα σε λίγο χρονικό διάστημα τσακώθηκε **με τους περισσότερους** γειτόνους – αυτός είναι και ο λόγος που δεν μπορ’ν να τον αποφύγω.

6. Parafjalët shërbejnë edhe për të formuar kundrinën me parafjalë. Në gjuhën shqipe kundrina me parafjalë formohet me anë të parafjalëve të rasave emërore, kallëzore dhe rrjedhore. Në gjuhën greke parafjalët që shërbejnë për të formuar kundrinën me parafjalë janë më të pakta në numër dhe janë të rasës kallëzore. *Shpatat do të skuqeshin në emër të shkencës dhe vrasjet të justifikoheshin duke lexuar biblën e murtajes, shkruar nga Stefan Gjika dhe profet i të cilës ishte Otello. Ndërsa po i afrohej ndërtesës ku ndodhej atelieja, mendja i shkoj prapë te historia e çuditshme, ashtu siç ia kishte treguar Zefi. Të martohem me një gjarpër? Ikim, tha vajza e madhe duke marrë të motrën për dore. Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti. Nëpërmjet librave marrim shumë informacione lidhur me probleme të ndryshme që na shqetësojnë. Nuk është mirë të flasësh kundër miqve të tu të vërtetë. Mbaj qëndrim të ashpër kundrejt gabimeve të miqve të mi. Otello vinte nga shkretëtira dhe ishte i ndjeshëm ndaj fatkeqësive.*
7. Në gjuhën shqipe dhe greke dallojmë këta rrethanojë: vendi, kohe, shkak, qëllimi, mënyre, sasi. Rrethanojë i vendit shpreh marrëdhënie hapësinore, tregon vendin e kryerjes së veprimit ose të shfaqjes së tiparit. *Flokët e verdha i binin mbi*

*supe dhe shëndeti që trashëgonte nga e ëma ia kishte skuqur faqet që edhe nëse turpëroheshin nuk e ndryshonin ngjyrën. Rrethanori i kohës tregon karakteristikë kohore të veprimit, të gjendjes e të tiparit. **Ndaj të gdhirë** ai u zgjua i trembur. Rrethanori i shkakut: *Kishte dëgjuar diku në një bisedë, ose kishte lexuar në kronika të vjetra, ose e kishte menduar vetë më pas, i nxitur prej bisedës a leximit, se përpara djegies së Voskopojës, zjarri ishte parandierë së pari në pëlhurat e piktorëve. Rrethanori i qëllimit: **Vinin për ngushëllim, për kureshtje**, për t'u dhënë zemër, për t'i dëshpëruar më keq. Rrethanori i mënyrës: *Sikur babai im të ishte më trim dhe mos ta linte Otellon në Vlorë, ju me siguri do më kishit sjellë një dhuratë tjetër, tha Desdemona duke e parë Kasin me qepallat ulur. Rrethanori i sasisë: Në të dy anët e bodrumit, në nivelin e tokës, kishte nga një dritare në formë frëngjie, për ajrim dhe ndriçim. Rrethanori kushtit: *Dhe shkakut ishte se atij i ishte dukur se misioni i tij mund të kryhej vetëm me shi. Rrethanori i lejimit: Punonte sa për dy veta me gjithë moshën e kaluar.****

KREU VI

FUNKSIONI DHE NDËRTIMI I PARAFJALËVE TË GREQISHTES SË RE

Parafjalët e gjuhës së re greke kanë një përdorim mjaft të madh jo vetëm si parafjalë, por edhe në fjalëformim. Me anë të tyre formohet një numër i pafund fjalësh si emra, mbiemra, folje e ndajfolje. Kjo shpjegohet me mjetet e kufizuara që sistemi rasor i greqishtes disponon¹⁰⁸. Në këtë kontekst parafjalët bëhen mjaft të nevojshme. Parafjalët që gjuha e re greke ka trashëguar nga gjuha tradicionale popullore janë të pakta. Mund të përmendim *από, για, με, σαν, σε χωρίς (ose δίχως), ως*. Të gjitha këto parafjalë janë të rasës kallëzore dhe Mackridge i quan “parafjalë bazë”¹⁰⁹. Në këtë grupim bëjnë pjesë dhe disa parafjalë si: *αντί, κατά, μετά, μέχρι, παρά, προς*¹¹⁰, që kanë hyrë në gjuhën e re greke nga katharevusa¹¹¹.

Parafjalët e greqishtes mund t’i ndajmë edhe në¹¹²:

- Një rrokëshe: *με, σε, για, ως, προς*.
- Dy rrokëshe: *κατά, μετά, παρά, αντί, από, δίχως, χωρίς*.
- Tre rrokëshe: *ίσαμε*.

Parafjalët e greqishtes së re janë kryesisht të mëposhtmet: *αντί(ς), από, για, ίσαμε, κατά, με, μετά, παρά, σε (σ’, είς), πρός-δίχως, χωρίς, ως (έως)*. Por përveç këtyre, në shprehje të gjuhës të folur që e kanë prejardhjen nga gjuha e kishës, e administratës dhe të njerëzve të arsimuar, janë të përdorshme dhe disa parafjalë të gjuhës së vjetër greke: *διά, εκ ose εξ, εν, ένεκα, επί, μέχρι(ς), περί, πρό, σύν, υπέρ* dhe *υπό*.¹¹³

Fillimisht parafjalët ishin ndajfolje, shumica e tyre vendore, gjë që është vënë re që nga poetët e lashtë grekë si Homeri dhe Herodoti. Ky kuptim i tyre fillestar duket

108A. Mirambel, *Η νέα ελληνική γλώσσα – Περιγραφή και Ανάλυση*, Selanik 1978, f.159-162.

109 P. Mackridge, *Η νεοελληνική γλώσσα*, Athinë 1987, f.301.

110 Po aty

111 Katharevusa është një trajtë e gjuhës greke e cila mbizotëroi gjatë shekullit të 18-të dhe që u përdor në Greqi nga shkrimtarë, gazeta dhe nga institucionet shtetërore dhe intelektuale të vendit, d.m.th. nga kasta drejtuese edhe gjatë shekujve të 19-të dhe të 20-të.

112 Π.Ε. Γιαννακοπούλου, *Συντακτικό της νεοελληνικής γλώσσας*, Εκδόσεις Δημ.Ν. Παπαδήμα, Athinë 1996, f.381.

113 Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Νεοελληνική σύνταξις, Τόμος Α*, Εκδοτικός οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Selanik 1991, f. 181.

akoma dhe tani, sidomos tek foljet e përbëra me parafjalë, si p.sh: **κατακαθίζω** (=καθίζω **κάτω-κατασταλάζω**), **παραστέκω** (=στέκω **κοντά, πλήσιον**) etj.

Zakonisht tani përdoren si ndajfolje parafjalët e mëposhtme:

a) **μετά** (=κατόπιν, ύστερα): *Έχω δει πολλές φορές αυτή την πόλη και πριν και μετά.* – *E kam parë shumë herë atë qytet dhe para dhe pas.* *Καθίζαμε στο τραπέζι και τρώγαμε μετά πέφταμε στον ύπνο.* – *U ulëm në tavolinë dhe hëngrëm, më pas ramë në gjumë.* *Χρόνια μπρός, χρόνια μετά.* – *Vite para, vite pas.*

b) **κατά** (*pro*) dhe **υπέρ** (*kundër*), kryesisht në gjuhën juridike dha politike: *Είχε το δικαίωμα να μιλήσει, όταν είχε να προσθέσει κάτι νέο υπέρ ή κατά.* – *Kishte të drejtë të fliste, kur duhej të shtonte diçka të re pro ose kundra.*

c) **υπό** (*nën*) në fraza të formuara kryesisht me foljen είμαι (*jam*): *Εγώ δεν μιλώ γιατί είμαι υπό* (=υποδεέστερος, κατώτερος). – *Unë nuk flas se jam poshtë.* (*si pozitë shoqërore*)

Ky përdorim i *υπό* ndoshta e ka prejardhjen fillimisht nga gjuha ushtarake, nga fraza si këto: *Είναι υπό τις διαταγές μου.* – *Është nën urdhrat e mi.*

d) **παρά** (*më*), kur haset me ndajfolje vendore. *Κατέβα παρά κάτω!* (=ακόμη πιά κάτω) – *Zbrit më poshtë!* *Ας προχωρήσουμε ακόμη παράέρα.* – *Të vazhdojmë më tutje!* *Έλα πάρα δω!* (=λίγο πιά edώ) – *Haide më këtej!*

Shumica e parafjalëve të greqishtes së re zakonisht përdoren me emra në rasën kallëzore. Rrallë, dhe vetëm në disa shprehje, përdoren disa prej tyre dhe me gjinore. Por:

1) parafjalët *από* (*nga*), *για* (*për*), *ως*(*deri*) dhe *αντί* (*në vend të*) rrallë përdoren dhe me emërore.

2) parafjalët *από* (*nga*), *για* (*për*), *ίσαμε* (*deri*), *κατά* (*kundër*) dhe *ως* (*deri*) përdoren dhe me ndajfolje vendore ose kohore: *Από δω, από κεί, από κάτω, από μέσα μου, από τότε, από πριν, για δω, για κεί, για πού, για τώρα, ίσαμε δώ, ίσαμε κεί, ίσαμε χτές, κατά δώθε, κατά κείθε, ως edώ, ως κάτω, ως τότε, ως σήμερα.*¹¹⁴

3) parafjalët *αντί*(ς), *για*, *δίχως*, *ως*, *χωρίς* dhe *ίσαμε*, përdoren dhe si lidhëza për të formuar fjali, kur shoqëron nga pjesëza *na*¹¹⁵: *Αντί να προχωρήσει προς το σπίτι, πήγε προς του επισκόπου. Βγήκαν κλέφτες στα βουνά για να κλέψουν άλογα!. Ωσπου τα μάζεψα όλα στην ποδιά μου / δίχως να βηματίσω προχωρούσα. Κι όταν είμαστε μόνες μας, τον βρίζει πατόκορφα και αυτόν και το σόι του, χωρίς να της έχει δώσει ο καημένος την παραμικρή αφορμή. Κάθισε edώ ίσαμε να γυρίσω. Έμεινε edώ, ως πού γύρισα πίσω. Περίμενε, ως πού να τελειώσω.*

6.1. Funkzioni dhe ndërtimi i parafjalëve me përdorim të përgjithshëm

¹¹⁴ Τζάρτζανος. Αχιλλ, vep. e cit., f. 182.

¹¹⁵ Τζάρτζανος. Αχιλλ, vep. e cit., f. 182.

Me qëllim që të lidhë një element emëror me foljen, folësi përdor kryesisht parafjalët *me (me)*, *se (në)*, *gja (për)*, *apó (nga)*. Këto parafjalë dallohen për larminë që shfaqin në përdorim, si dhe për ndërfutjen e plotësuesve të foljes.

Pra, këto parafjalë kanë një përdorim mjaft të gjerë si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Kuptimet e tyre do të realizohen më poshtë në mënyrë analitike, por po përmendim këtu kuptimet e tyre kryesore. Kështu, kuptimi kryesor i këtyre parafjalëve është:

1. Parafjala *me* tregon mjetin me të cilin kryhet një veprim: *Μα ό,τι έκανα εγώ με την υπομονή μου και τις φροντίδες μου, το ζέκανε η κόρη μου με τη γλώσσα της.* (T.T.Σ. 18) – *Por atë që bëja unë me kujdesin tim e zhbënte vajza ime me gjuhën e saj.*
2. Parafjala *se* tregon qëndrim në një vend ose destinacionin e një lëvizjeje: *Τις βλέπω στο δρόμο και τρομάζω.* (T.T.Σ. 10) – *I shikoj në rrugë dhe më zë llahataria. Πήγαινε στην Κερατέα με την οσία Μαριάμ!* (T.T.Σ. 13) – *Shko në Qeratea me murgeshën Mariam!*
3. Parafjala *gja* tregon qëllimin e kryerjes së një veprimi: *Είχε μούτρα να μιλάει για δικές μου αμαρτίες.* (T.T.Σ. 22) – *Kishte edhe fytyrë të fliste për mëkate të miat!*
4. Parafjala *apó* tregon origjinën e një lëvizjeje: *Αν ζούσε τον καιρό που γύρισε ο Θόδωρος απ' τη Μέση Ανατολή, δε θα μου περνούσε καν η ιδέα απ' το μυαλό να τον πάρω και να γίνω νύφη της.* (T.T.Σ. 15) – *Po të jetonte në kohën që u kthye Theodhoriu nga Lindja e Mesme, as që do më shkonte ndërmend ta merrja për burrë dhe të bëhesha nusja e tij.*

Me këto kuptime këto parafjalë përdoren edhe për të shprehur rrethorë të ndryshëm si: vendi, kohe, qëllimi, shkaku, etj., si dhe kundrinorin e zhdrejtë me ose pa parafjalë¹¹⁶:

1. *Σκοπεύαμε να γυρίσουμε σε καμιά δεκαριά μέρες.* – *Mendonim se për nja dhjetë ditë do të ktheheshim pas.*
2. *Κι όταν μαθεύτηκε πως ο «κυρ-Αντώνης» μοίραζε στους φτωχούς λεφτά, είδα πως είχε έρθει η στιγμή να πατήσω πόδι. - Dhe kur u përhap lajmi se “zoti Andon shpërndante para për të varfrit”, e kuptova se kishte ardhur momenti për të vendosur.*
3. *Δύο δωμάτια και κουζίνα, χωρίς παράθυρα στο δρόμο, με την αυλή στο βάθος τριγυρισμένη από ψηλά σπίτια. - Dy dhoma dhe një kuzhinë, pa dritare nga ana e rrugës dhe me një oborr në thellësi, të rrethuar nga shtëpi të tjera.*

¹¹⁶ Xp. Κλαίρης – Γ. Μπαμπινιώτης, *vep. e cit.*, 919.

4. *Περίεργες προκηρύξεις, πρωτόγνωρες για την πόλη μας, από άγνωστο αυτοκίνητο. - Disa proklamata të çuditshme, të para për herë të parë në qytetin tonë, të lëshuara nga një automobil i panjohur.*

6.1.1. Funkzioni dhe ndërtimi i parafjalës με

Parafjala με (me) e gjuhës së re greke e ka prejardhjen nga parafjala e gjuhës së vjetër greke μετά. Ajo sot përdoret me dy rasa dhe ka dy kuptime. Kur përdoret me rasën kallëzore ka kuptimin pas: Ἦρθα μετά τον Κώστα. (Erdha pas Kostës). Kur përdoret me rasën gjinore ka kuptimin bashkë me: Ἦρθα μετά του Κώστα. (Erdha bashkë me Kostën). Kjo trajtë e vjetër gjendet sot e përdorur në dialekte të ndryshme si dhe në këngët popullore.

Gjymtyra e prirë nga parafjala με tregon:

- Bashkekzistencë midis dy personave a sendeve: *Μαζί με τον Πήγασο είναι τα λογοτεχνικά περιοδικά στην πόλη μας, αρκετά για επαρχιακή πόλη 55000 περίπου κατοίκων.* (Ev onόματι, 13) – *Bashkë me Pikaso, janë dy revistat letrare në qytetin tonë, të njaftueshme për një qytet provincial me rreth 55.000 banorë. Oi επίσημοι όπου φύγει-φύγει, πρώτος ο διευθυντή της αστυνομίας, ακολουθούν οι άλλοι, ο Μητροπολίτης με τον Πρωτοσύγκελλο μπουρδουκλώνονται στα ράσα τους.* (Ev onόματι, 93) – *Në fillim ikën drejtori i policisë, pas tij vijojnë të tjerët, Mitropoliti me zëvendës mitropolitin ngjishen në rasot e tyre.*
- Marrëdhënie, sjellje, qëndrim: *Κάθε φορά που είχε άδεια, ερχόταν λιγότερο για να δει εμάς και περισσότερο για να παίξει με τη Χιόνα.* (T.T.Σ. 114) – *Sa herë që merrte leje nga ushtria, rrinte pak me ne, pastaj fillonte të luante me Hionën.*
- Mjetin me të cilin kryhet një punë: *Η αστυνομία μάταια παλεύει να αντιδράσει με πιστολιές στον αέρα.* (Ev onόματι, 94) – *Më kot policia përpriqet të reagojë, duke shtënë në ajër me pistoletat. Πήγε στο σπίτι, βρήκε την πόρτα κλειδωμένη, την άνοιξε κατά το σύστημά του μ' ένα καρφί, μπήκε μέσα...* (T.T.Σ. 120) – *Ai shkoι në shtëpi, e gjeti derën të mbyllur dhe pasi e hapi me metodën e tij me anë të një gozhde, u fut brenda.*
- Mënyrën se si shfaqet një veprim apo një gjendje e brendshme: *Σήμερα βρέχει σιγά, απαλά, σμίγει ο ουρανός με τη γη με άπειρη τρυφεράδα.* (B.Π. 101) – *Bie shi i shtruar, i qetë. Toka bashkohet me qiellin me një pëlhurë të rrallë e të njomë. Ki ενώ ως τότε ούτε ο νοικοκύρης ούτε η γυναίκα του είχαν πει λέξη, όταν έκλεισε στο σπίτι μας δυο μήνες, μ' έπιασε μια μέρα εκείνος, και, με πολλή ευγένεια, μου λέει...* (T.T.Σ. 117) – *Deri atëherë, i zoti dhe zonja e shtëpisë, nuk na kishin thënë asgjë.*

Po kur Eleni mbylli dy muaj që kishte ardhur, më kap një ditë i zoti i shtëpisë dhe me shumë takt më thotë...

- Kohën e kryerjes së një veprimi: *Θα φύγουμε το απόγευμα με τη δύση του ήλιου. – Do të ikim kur të perëndojë dielli.*
- Lëndën me të cilën është ndërtuar ose është zbukuruar një send: *Το σπίτι χτίστηκε με πέτρες. - Shtëpia është ndërtuar me gurë.*
- Tipar, karakteristikë apo cilësi të një personi, të një kafshe a të një sendi: *Δύο νέα παιδιά, το αγόρι με τα γαμπριάτικά του και λεμοανθό στο πέτο, το κορίτσι με κατάλευκο νυφικό, σε αμαζάκι με άσπρα άλογα, του παλιού καλού καιρού που λένε, με τα στέφανα στα μαλλιά του, και τα άλογα στεφανωμένα κι αυτά, κάνουν τη βόλτα τους στο πευκοδάσος, να γιορτάσουν τη χαρά τους. (En onómati, 47) – Dy të rinj, djali veshur me kostumin e dhëndërisë, vajza me fustanin e nusërisë borë të bardhë, në një automobilth me kuaj të bardhë, të kohës së shkuar, si i thonë, me kurorat e vendosura në flokët e tyre, me kurora dhe kuajt, gjithashtu, bëjnë shëtitjen e tyre në pyllin me pisha për të festuar harenë e tyre.*
- Kundërshti: *Καθόμουν σε μια γωνιά, κρύωνα, παράγγειλα και δεύτερο φασκόμηλο· νύσταξα· πάλευα με τον ύπνο, την κούραση και την πρωινή θλίψη της ημέρας.(B.Π. 16) – Isha mbledhur e bërë shuk në një kënd të kafenesë. Të ftohtit më kish hyrë në palcë. Më kish mundur gjumi, bëja çmos që t'i bëja ballë. Dhe sfilitjes. Dhe mërisë së ditës së re.*

Këtu bëjnë pjesë edhe lidhëzat kundërshtuese *μόλον που, μολονότι, μολαταύτα*, që e kanë prejardhjen nga bashkëshqiptimi i fjalëve *με όλον που, με όλον ότι, με όλα ταύτα*.

- Shoqërim, d.m.th kushtet dhe rrethanat, që shoqërojnë një veprim ose gjendje: *Έτσι, η Φιλαρμονική του Δήμου με τη συνοδεία της χορωδίας της Ιεράς Μητροπόλεως, παραταγμένες στον αγωνιστικό χώρο, ανοίγουν την εκδήλωση με το «Υπερμάχω» και το «Σώσον Κύριε τον λαό σου». (En onómati, 81) – Kështu, orkestra filarmonike e bashkisë, e shoqëruar nga kënga e grupit koral të Mitropolisë, të vendosur aty në fushën e sportit, e çelin manifestimin e shumëpritur me “Qëndroj pasues besnik” dhe “Shpëtoje, Zot, popullin tënd”.*
- Përmbajtje: *1113 φάκελοι με ονόματα και διευθύνσεις, από τον τηλεφωνικό κατάλογο τα είχαν πάρει.(En onómati, 63) – 1113 zarfa me emra dhe adresa të plota, I kishin marrë nga numërori telefonik.*

- Përmasat e një sipërfaqeje: Στο σπίτι του έχει έναν διάδρομο **τρία με πέντε**. – Në shtëpinë e tij ka një korridor **tre me pesë**.
- Kusht ose marrëveshje: Για να ζήσω, πήγα να στα σπίτια κι έραβα **με το μεροκάματο**.(Τ.Τ.Σ. 88) – Që të mbaja frymën gjallë, shkoja nëpër shtëpira dhe qerja **me ditë pune**.
- Shkëmbim: Άλλαξα λίρες **με δολάρια**.- Shkëmbeva lira **me dollarë**.
- Shkak: Αχ, ας όψεται εκείνο το τέρας, η Ερασμία, που την κατέστρεψε **με τις κατηχήσεις της**. (Τ.Τ.Σ. 9) – U shoftë Erazmia, që e shkatërroi **me mësimet e saj fetare**.
- Personin a frymorin veprues ose sendin të përfytyruar si veprues: Είχα συγκλονιστεί **με το θάνατό του**. (Ev onόματι, 102) – U trondita **nga vdekja e tij**.

Këtu bëjnë pjesë dhe lidhëzat kundërshtuese *μόλον που, μολονότι, μολαταύτα* që e kanë prejardhjen nga bashkëshqiptimi i fjalëve *με όλον που, με όλον ότι, με όλα ταύτα*.

- Kufizim: Έχω μανία **με το κνήγι**. – Kam mani **gjuetinë**.

Përdorime të tjera të parafjalës **με**

- Shumë herë kundrinori në gjuhën e re greke shprehet me parafjalë. Kjo ndodh për shkak se shumë folje përdoren në gjuhën e vjetër greke me rasi të cilat mungojnë në gjuhën e re greke. E tillë është rasi dhanore (η δοτική). Kundrinat e rasës gjinore dhe dhanore të greqishtes së vjetër shprehen me rasë kallëzore me parafjalë në greqishten e re. Kundrinor me parafjalë marrin një grup i madh foljesh që tregojnë: prejardhje, ndarje, fillim, ndryshim, ngjashmëri, miqësi, armiqësi, parandalim, ndërrim, largësi. Kundrinor me parafjalë marrin foljet që pranojnë **vetëm një kundrinor (μονόπρωτα ρήματα)** dhe foljet që pranojnë **dy kundrinorë (δίπρωτα ρήματα)**. Në të tilla raste kundrinori i zhdrejtë është ai që shprehet me parafjalë. Kjo parafjalë përdoret për të shprehur kundrinorin me parafjalë: *Μαλώνει με τον αδερφό του*.(Zihet **me vëllanë e tij**)
- Parafjala **με** shërben për të formuar rrethana që shprehen marrëdhënie kohore: *Θα φύγουμε το απόγευμα με τη δύση του ήλιου*; Marrëdhënie shkakore: *Αχ, ας όψεται εκείνο το τέρας, η Ερασμία, που την κατέστρεψε με τις κατηχήσεις της*;

Marrëdhënie mënyre: *Έκοβε με το τσεκούρι τα ξύλα;* Marrëdhënie kushtore: *Θα μου θερίσετε το χωράφι με το μεροκάματο.*

- Parafjala με përdoret për formimin e lokucioneve parafjalore :

σύμφωνα με, αντίστοιχα με, ανάλογα με

- parafjala με përdoret për ndërfutjen e plotësit foljor që tregon marrëdhënien ndërmjet dy pjesmarrësve ose foljeve që shprehin komunikim:

αναλογεί με	επικοινωνεί με	μοιάζει με	συμφωνεί με
αντιστοιχεί με	ισοδυναμεί με	συγκρίνει με	σχετίζεται με
διαφωνεί με	μιλάει με	συζητάει με	ταιριάζει με

- mbiemrat dhe emrat përkatës përdoren gjithashtu me parafjalën με :

ανάλογος με	επικοινωνία με	σύγκριση με	σχετικός με
αντιστοιχία με	ισοδύναμος με	συζήτηση με	ταιριαστός με
διαφωνία με	όμοιος με	σύμφωνος με	

- shprehje të ngurtësuar me parafjalën με :

με καλό μάτι	με το στανιό	στήθος με στήθος
μελίγα λό για	με χίλια βάσανα	χέρι με χέρι

με την καρδιά μου

πρόσωπο με πρόσωπο

(χρήμα) με ουρά


Sintagmat me parafjalën **με** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Είχα συγκλονιστεί με το θάνατό του.*

Emër + parafjalë + mbiemër *γη με άπειρη τρυφεράδα*

Emër + parafjalë + emër *ο ουρανός με τη γη*

Ndajfolje + parafjalë + emër *Μαζί με τον Πήγασο.*



6.1.2. Funkzioni dhe ndërtimi i parafjalës *από*

Parafjalën *από* (nga) mund ta gjejmë dhe me format e saj të shkurtuara *απ'*, *'πό*, *π'*. Kuptimi i saj fillestar është ai i largësisë: *από-τραβείωμαι*, *από-φεύγω*.

Gjymtyra e prirë nga parafjala *από* tregon:

- Pikënisjen prej një vendi a gjësendi: *Στα κατάμαυρα από την κορφή ως τα νύχια.* (Ev onόματι, 15) – *I zhytyr në të zeza që nga maja e flokëve deri tek thonjtë.*

Këtu bëjnë pjesë dhe shprehje si: *Έρχομαι από του Θεού μου* (=απ' το σπίτι του θεού μου). Εφύγαμε *από του Απέργη* (απ' το ξενοδοχείο του Απέργη), ashtu si dhe shprehjet stereotype: *Από φυσικού του*, *από λόγου του*, *από καρδιάς* (αναστενάζω, κλαίω, γελώ), ku *από* formohet me gjinore: *Οι χωριάτες είναι από φυσικού τους κρυφονόητοι. Αναστέναξε μέσ' από την καρδιά του. Ο Γιάννης εγέλασε από καρδιάς.*

- Distancë: *Το περίπτερο είναι 50 μέτρα από το σπίτι μου. – Dyqani është 50 metra larg shtëpisë sime.*

- Anën ose pjesën e një gjëje a të një vendi: *Μα ο Αντώνης την έπιανε απ' τον ώμο και τη κάθισε κάτω με το ζόρι.* (Τ.Τ.Σ. 62) – *Po Andoni e kapte nga mënga dhe e ulte poshtë me zor.*

- Të kaluarit midis, nëpërmjet. Me këtë kuptim parafjala *από* mund t'i paraprijë edhe një emri në gjinore ose një ndajfoljeje vendi.

- Të qenurit afër. Ky përdorim haset kryesisht me foljen *περνώ* (kaloj): *Στο δρόμο περάσαμε από το φαρμακείο που δούλευε η Πολυζένη και της είπαμε πού θα 'μασταν για να 'ρθει να μας βρει να γυρίσουμε μαζί στο σπίτι.* (Τ.Τ.Σ. 120) – *Rrugës kaluam nga farmacia ku punonte Polikseni. Dhe i lamë pikëtakimin që të ktheheshim sëbashku në shtëpi. Θα πέρασε από δω σίγουρα, είπε ο Γιαννακός, κι άναψε τη λαμπάδα...* (Χ.Ξ. 159) – *Do të ketë kaluar patjetër këtej – tha Janakua, - ai e ka ndezur llambadhën...*

- Tërësinë, grumbullin nga e cila merret një pjesë: *...οπότε, ένας από τους δύο Χριστούς, απέναντι ο ένας τον άλλο.* (Ev onόματι, 36) - *...ndërkaq, njëri nga të dy Krishitët, njëri përballë tjetrit. Ο πεθερός της ήταν ένας από τους καλύτερους*

χρυσόχρους της Θεσσαλονίκης. (Τ.Τ.Σ. 122) – Ai kishte qenë njëri nga argjendarët më të mirë të Stambollit.

- Shkakun nga i cili rrjedh një veprim: *Από νοσταλγία για το Παρίσι με τους πολλούς σταθμούς τον ονομάτισε έτσι. (Εν ονόματι, 21) – E ragëzoi kështu atë stacion nga nostalgjia që kishte për Parisin. Φαρμάκι ο αργός αποχωρισμός από τους ανθρώπους που αγαπάς. (Β.Π. 16) – Helm e shkuar helmit kjo ndarje e ngadalhtë prej njerëzve që i ke dashur. Αχ, θέε μου, αναγνωρίζω ότι αμάρτησα σ' αυτή τη ζωή κι ας ήταν από κουταμάρα, κι ότι δικαίως με τιμώρησες, μα τώρα φτάνει πια! (Τ.Τ.Σ. 121) – Ah, Zoti im! E di se kam bërë mëkat në jetën time, dhe le ta kem bërë nga budallallëku. Ti me të drejtë më dënove, po tani mjafton me kaq.*
- Personin a frymorin veprues: *Θα κατάσχω τις προκηρύξεις και θα λάβω καταθέσεις από όλους. (Εν ονόματι, 17) – Do të sekuestroj proklamatat dhe do të marr denoncime nga të gjithë. Αγαπητοί ακροατές, γίνεται χαμός από πολίτες που θέλουν να πουν την άποψή τους. (Εν ονόματι, 76) – Të dashur dëgjues, po bëhet një katrahurë nga qytetarët që duan të shprehin pikëpamjet e tyre.*
- Krahasimin midis dy elementëve: *...που εμείς τα λέμε περιφρονητικά «ζώα», και όμως δεν είναι πιο ανθρώπινα από εμάς τους δήθεν ανθρώπους. (Εν ονόματι, 19) – ...të cilat me përbuzje dhe përçmim ne i quajmë “kafshë”, por që, në të vërtetë, janë më humane nga ne gjoja njerëzit.*
- Kufizimin e kuptimit të fjalës së përcaktuar: *Ένα πρωί οι μπουλντόζες άνοιξαν τα σαγόνια τους, δεν ξέρουν από έρωτα. (Εν ονόματι, 22) – Dhe kështu, një mëngjes buldozerët ia nisën nga puna për çrënjosjen e pishave, ata nuk kanë haber nga punët e dashurisë.*
- Shndërrim apo ndryshim. Në këtë rast από formohet dhe me rasë emërore (të një emri apo mbiemri), kur fjala e prirë nga parafjala i referohet kryefjalës të fjalisë: *από δήμαρχος κλητήρας, από φτωχός πλούσιος.*
- Përmbajtjen apo përbërësit e diçkaje: *Έρχεται στο νου μου ένα ινδιάνικο ανάγλυφο, από σκούρα γκρίζα πέτρα: ο άντρας έχει ρίξει τη μπάτσα του γύρω από τη γυναίκα και σμίγει μαζί της με τόση απαλάδα κι εγκαρτέρηση ... (Β.Π. 101) – Më bëhet në sy një reliev indian në një gurrë murrash: një burrë i ka hedhur krahet një gruajë dhe të dy bashkohen kaq thjeshtë e kaq përjetësisht ...*

- Kohën e kryerjes së një veprimi: *Όλα αυτά συνέβαιναν τη νύχτα της Πέμπτης 5 Νοέμβρη 98, λίγο πριν από τα μεσάνυχτα.* (Εν ονόματι, 13) – *Të gjitha këto ndodhnin natën e së enjtes, 5 nëntor '98, fare pak kohë përpara mesnatës.* Ο σκληρός λόγος αυτός του φίλου μου κουφοδρομούσε μέσα μου, κι **από τότε** γύρευα αφορμή να παρατήσω τα χαρτιά και να ριχτώ στην πράξη. (Β.Π. 20) - *Kjo fjalë e sertë e mikut tim bënte shteg e hynite drejt e në shpirtin tim e unë që në kryeherë kërkoja sebeb të lija mënjatë letrat e të hidhesha në aksione konkrete.*

Për të treguar kohë përdoret edhe shprehja stereotype *από μίας αρχής - nga fillimi.*

Në disa raste kjo parafjalë është e tepërt: **Από το βράδυ** είχαμε τελειώσει την δουλειά. – *Nga darka e kishim mbaruar të gjithë punën.* Këtu fare mirë parafjala από mund të shmanget dhe atëherë do të kishim: *Το βράδυ είχαμε τελειώσει την δουλειά.* – *Në darkë e kishim mbaruar punën.*

Me kuptimin e pikënisjes kohore parafjala από formohet dhe me mbiemra ose emra, që kanë të bëjnë kryesisht me moshën. Dhe atëherë formohet dhe me emërore, kur fjala me parafjalë përcakton kryefjalën e fjalisë: **Με** γνωρίζει **από μικρό.** **Την** είχε αρραβωνιασμένη **από μικρή.** **Τη γυναίκα** που **από παιδί** είχε δούλα. Ορφάνευε **από μικρός.** **Από μικρό παιδάκι** έχασε την μητέρα της. Τέτοια ζωή κάνει **από νέος.** Είναι μια συνήθεια που την έχουν **από αρραβωνιάσμενοι.**

Ky formim i από me emërore ndoshta e ka prejardhjen nga thjeshtimi i fjalive më të plota: 117 Ορφάνευε **από τότε που ήταν** μικρός. Τέτοια ζωή κάνει **από τότε που ήταν** νέος. Εγώ, **από μικρό παιδί που ήμουνα,** δεν είχα πατήσει ούτε μια φορά στο σπίτι τους.

- Prejardhje nga një vend: **Από το παράθυρο** βλέπω σύννεφα, μαύρα. (Εν ονόματι, 24) – *Nga dritarja shikoj re. Re të zeza. Άκουσα μάλιστα σ'ένα δικό μας ραδιόφωνο ότι κλιμάκιο της αντιτρομοκρατικής υπηρεσίας ετοιμάζεται να 'ρθει από την Αθήνα.* (Εν ονόματι, 67) – *Madje, në një stacion radioje dëgjova se një njësit i shërbimit antiterrorist përgatitet të vijë këtu nga Athina.*

Sipas Xarxanos 118 këtu bëjnë pjesë edhe shprehje si: *Παίρνω από φόβο κάτι, Είναι από Θεού.*

- Lëndën prej së cilës ndërtohet diçka: *Γαλήνη γύρω μας, μόνο το τακ-τακ από τα πέταλα των αλόγων, που όμως πνιγόταν στο παχύ στρώμα από αγριόχορτα.* (Εν ονόματι, f. 45) – *Rretherrotull nesh qetësi, dëgjohej vetëm tak-taku i trokut të kuajve, që gjithsesi mbytej në tokën e mbuluar nga barërat e egra.*
- Përjashtim (=εκτός από). Zakonisht pas përemrit άλλος: *Άλλος απ'τον θεό τον πόνο μου δεν ζέρει.* – *Veç Zotit, askush nuk e di dhimbjen time. Δεν είχε άλλη φροντίδα απ'αυτή.* – *Nuk kishte kujdes tjetër veç atij.*

117 Τζάρτζανος, Αχιλλ., ver. e cit., f.185.

118 Po aty, 186.

- Largësi me kuptimin fillestar të fjalës dhe me kuptim metaforik për të treguar mbrojtje apo shpëtim nga diçka: *Για πότε ξεμπουκάρουν όλοι αυτοί οι κουκουλοφόροι, οι καλσονοφόροι, οι μασκοφόροι, χύνονται στις κερκίδες από πάνω ως τον αγωνιστικό χώρο, ξεφυντώνουν από τα αποδυτήρια, από τις τουαλέτες, μερικοί έχουν καλάσνικοφ, άλλοι έχουν πιστόλια, άλλοι καπνογόνα, και τι δεν έχουν ... (En onómati, 92) – Të gjithë ata që mbajnë veshur maska dhe çorape-maskë derdhen me shpejtësi nga shkallët drejt e në fushë, plot të tjerë mbijnë nga dhomat e zhveshjes dhe nga banjat, disa kanë kallashnikovë, të tjerë kanë pistoleta, ndërsa plot të tjerë kanë raketa tymuese. Çfarë nuk kanë!*
- Ndarje apo shpërndarje. Zakonisht me numërorë ose përemra, që tregojnë sasi: : *Και με την κουβέντα πέρασ' ευχάριστα η ώρα, ήρθε η Πολυζένη και μας βρήκε, μας αγόρασε από 'να παγωτό χωνάκι και ύστερα πήραμε τα παιδιά και κινήσαμε όμορφα κι αγαπημένα να γυρίσουμε στο σπίτι. (Τ.Τ.Σ. 121) – Dhe duke biseduar kaloi ora pa e kuptuar. Atje na gjeti edhe Polokseni e cila na kishte blerë nga një akullore të madhe me kaush. Pasi hëngrëm akulloren, u nisëm mirë e bukur për në shtëpi. Κάθε φορά λοιπόν που του 'πεφταν λεφτά στα χέρια, αγόραζε και από κάνα-δύο στρέμματα. (Τ.Τ.Σ. 65) – Sa herë që i binin para në duar blinte nga dy-tre dynymë.*

Me këtë kuptim *apó* formohet dhe me emërore, kur fjala e prirë nga parafjala i referohet kryefjalës të fjalisë: *Να μπαίνουν μέσα οι εργάτες από ένας.*

- Një tërësi e pjesëtuar ose e pjesëtueshme: *Υστερα, σκηνές από το φιλμ που θα βγει λίαν προσεχώς, ένα ψυχοπλακωτικό από τον βρόμικο πόλεμο του Βιετνάμ και τις ολέθριες συνέπειές του σε Αμερικανούς βετεράνους, εν ειρήνη πια. (En onómati, 54) – Pastaj skena nga një film nga lufta e ndyrë në Vietnam, si dhe nga pasojat fatale dhe shkatërrimtare të veteranët amerikanë, tashmë, në paqe.*
- Referim për dikë a diçka: *Από υγεία είμαστε καλά. – Nga shëndeti jemi mirë. Είναι ορφανός από πατέρα. – Është jetim nga babai. Από ηλικία φαινόταν μεγαλύτερη από την αδελφή της. Nga mosha dukej më e madhe se e motra. Κάτι ξέρουν από μουσική. – Dinë diçka për muzikën.*

Sic e pamë, parafjala *apó*, formohet dhe me ndajfolje vendi, kohe, mënyre: *Λοιπόν, τούτων ούτως εχόντων, από αύριο η μεν Κατερίνα θα παραμείνει στο Β2. Τον κλαίω και εγώ από κρυφά. Τις έρευνες για τα συνταρακτικά γεγονότα αναλαμβάνει από σήμερα ο αστυνόμος Β' Χαβιαράς Γεώργιος. Χύνονται στις κερκίδες από πάνω ως τον αγωνιστικό χώρο. «Εσύ!» φωνάζει από μέσα. Μα οι ζαλάδες εξακολουθούσαν, και μάλιστα δυνατότερες από πριν.*

Por mund të ndodhë edhe që ndajfolje vendi, kohe dhe më rrallë mënyre, të paraprihen nga parafjala *apó* + *emër në kallëzore*: *Σύνολο: πάνω από 2500, το γήπεδο έχει φρακάρει, ενώ πάρα πολλοί είναι και στην πλατεία Ανεξαρτησίας μπροστά από το γήπεδο. Μακρυνά από το σπίτι μας. Τη λυπόμουνα μέσ' απ' την καρδιά μου. Εμπρός απ' το βουνό. Παράθυρα κλείνουν, άλλα ανοίγουν, μερικοί πίσω από τις κουρτίνες*

κοιτάζουν έξω, να δουν τι; Εδώ είναι **κάτω από** τον κίτρινο φάκελο. Η ένταση κορυφώθηκε, **γύρω από** το όραμα των παιδιών του Πολυτεχνείου. Ένα σπυργιτάκι μάς περιεργάζεται **έξω από** το ανοιχτό παράθυρο, το μισό είναι ανοιχτό, τρυπώνει μέσα. Πολύ **πριν από** την ώρα της έναρξης ο κόσμος έχει αρχίσει να καταφθάνει. Τόσο πολύ την αγάπησες τη γυναίκα αυτή; **Ρώτησα ύστερα από λίγο. Μετά από** σένα ήρθε ο Πέτρος. Μήπως το τραβάς **κρυφά από** τους γονείς σου; **Εξαιτίας από** το μηχανισμό.

Përdorime të tjera të parafjalës από

- Parafjala από përdoret për të formuar kundrinorin me parafjalë: *Απομάκρυναν το Γιάννη από το σχολείο.* (Janin e larguan nga shkolla)
- Parafjala από shërben për të formuar rrethanorë që shprehin marrëdhënie hapësinore: *Προσπαθώντας να απομακρύνει τη σκέψη του από κείνη, άρχισε να περιφέρεται ξανά γύρω από το καβαλέτο;* Marrëdhënie kohore: *Όλα αυτά συνέβαιναν τη νύχτα της Πέμπτης 5 Νοέμβρη 98, λίγο πριν από τα μεσάνυχτα;* Marrëdhënie shkakore: *Από νοσταλγία για το Παρίσι με τους πολλούς σταθμούς τον ονομάτισε έτσι.*
- Parafjala από përdoret edhe përpara përcaktorit kallëzuesor. Në këto përdorime të saj, rasa e emrit kushtëzohet nga kryefjala ose kundrinori: *Από μεγαλύτερος διαμαντιών κατάντησε στον δρόμο.*
- Parafjala από përdoret edhe në disa shprehje të ngurtësuar: από απόψεως, από μόνος μου, από καταβολής κόσμου, από στήθους, από πάσης απόψεως.


Sintagmat me parafjalën **από** formohen:

Folje + parafjalë + emër *Το κόστος υπερκαλύπτεται από την αύξηση των επιπλέον εσόδων που δημιουργήθηκαν.*

Emër + parafjalë + mbiemër *Λουλούδια από τον ωραίο κήπο.*

Emër + parafjalë + emër *Προσφορά αναμνηστικών δώρων από το ταξίδι...*

Ndajfolje + parafjalë + emër *Εξω από την τάξη.*



6.1.3 Funkzioni dhe ndërtimi i parafjalës *για*

Parafjala *για* (*për*) e greqishtes e ka prejardhjen nga parafjala e vjetër greke *διά*. Ngjyrimet semasiologjike të *διά* si ndajfolje-parafjalë, luhaten mes kuptimit të ndarjes, të ndërmjetësisë, të mjetit për realizimin e një veprimi. Por parafjala *για* e gjuhës së re greke ka ndryshime nga këto kuptime. Mund të themi se ka ruajtur kuptimin e kohës, p.sh: *διά νυκτός / διά χρόνου πολλού*.

Sipas Andhreitit¹¹⁹, parafjala *για* e ka prejardhjen nga një formë *για* e periudhës së mesjetës. (e formuar dhe kjo në bazë të parafjalës së vjetër *διά*). Xarxano¹²⁰ vëren se paralelisht me parafjalën *για*, ekziston dhe një formë e saj që funksionon si lidhëz. Por ai thekson se mund të jetë një formë dialektore e këngëve popullore.

Andhreoti vëren se *για* mund të jetë lidhëz veçuese, funksion ky i marrë nga fjala turke *ya*: *για βρέχει για χιονίζει, για εγώ για εσύ*, ose si lidhëz shkakore/pyetëse e formuar nga rënia e rrokjes fundore të *γιατί*: *Αγάπη μου, για δεν έρχεσαι*;

Nga sa përmendëm më lart, mund të themi se *για* nuk ka funksionin e lidhëzës në gjuhën e re greke, përveç rasteve kur ndiqet nga pjesëza *va*. Duhet të jetë kjo arsyeja që Xarxano veçon një lidhëz *γιανά* (një fjalë e vetme) nga bashkimi i pjesëzave *για* dhe *va*.

Kjo parafjalë përdoret me rasë gjinore kur emri të cilit i paravendoset tregon referim për diçka a dikë: *Όσο για τη θεία Κατίγκω με τη σεμνοτυφία της και τις γελοίες περί ηθικής αρχές της, ήταν φυσικό να τη βλέπει σαν την προσωποποίηση του διαβόλου επί της Γης.* (T.T.Σ. 16) – *Përsa i përket hallë Katingos, me të shtirurat e saj dhe me romuzet për parimet e moralit, ishte e natyrshme që ta shikonte si një shëmbëllim të Djallit mbi tokë. Μα τα περί ερωμένων και τα λοιπά ήταν, μου φαίνεται περισσότερο αποκυήσεις της φαντασίας της μαμάς που τον ζήλευε τρομερά, παρά πραγματικότητας.* (T.T.Σ. 47) – *Po fjalët rreth dashnoreve të tij e të tjera, qenë më tepër fantazira të mamasë, e cila e kishte tmerrësisht zili, se sa ngjarje reale.*

Shprehje të ngurtësuar me parafjalën *περί*:

περί ανέμων και υδάτων	περί όνου σκιάς	περί τίνος
περί αυτού	περί πολλού	

Parafjala *πλην* (*përveç*) fillimisht është përdorur me kuptimin e të qënurit afër. Më pas u përdor me kuptimin që ka dhe sot për të treguar përjashtim apo heqje. Sot përdorimi më i shpeshtë është ai që tregon veprimin e zbritjes në aritmetikë: *Πόσο κάνει τέσσερα πλην δύο;* - *Sa bën katër minus dy?*

Πλην της μαμάς και του μπαμπά που χρειάζοντουσαν ντάντεμα σα μωρά παιδιά και δεν μπορούσα να τους εμπιστευτώ εντελώς στα χέρια της Ερασμίας. (T.T.Σ. 37) – **Përveç**

mamasë dhe babait, që donin shërbime si bebet e vogla (nuk mund t'i lija plotësisht në duart e Erazmisë).

Parafjala *pro* (*para*) është e rasës gjinore dhe shërben për të treguar kohën dhe vendin e kryerjes së një veprimi: *Οι εργασίες της κοινοβουλευτικής ομάδας θα διακοπούν έναν μήνα προ των εκλογών.* – *Runimet e grupit parlamentar do të ndërpriten një muaj para zgjedhjeve.* *Ο Αννίβας έφτασε προ των πυλών της Ρώμης.* – *Aniva mbërriti para portave të Romës.*

Shprehje të ngurtësuar me parafjalën *pro*:

προ ημερών	προ ολίγου	προ πάντων	προ Χριστού
προ μακρού	προ παντός	προ πολλού	


Kuptimi fillestar i parafjalës *πρός* (*për nga, tek*) është ai i të qenurit përballë. Përdoret kryesisht me një emër a përemër në rasë kallëzore. Por në disa fraza stereotipe parafjala *πρός* formohet dhe me rasë gjinore: ***Πρός Θεού!*** *Μη το κάνεις αυτό!* – ***Πër Zotin!*** *Μος e bëj këtë!* *Κληρονομιά το είχαμε παππού προς παππού.* – *E kishim pasuri gjysh pas gjyshi.* (*brez pas brezi*)

Gjymtyra e prirë nga parafjala *πρός* tregon:

- Drejtim për diku a për tek dikush: *Την κοιτάζω γιατί, ενώ έχει ωραία πόδια, όλο τραβάει προς τα κάτω το μίνι.* (En onómati, 72) – *Unë po e shikoj, sepse ajo ka këmbë të bukura, por bën ç'bën dhe e ul fundin poshtë.* *Κασσάνδρα, αλλά, φευ, προς τα εκεί με ωθούν τα διαδραματιζόμενα.* (En onómati, 88) – *Nuk dua që të jem Kasandra, por, mjerisht, drejt gjërave të këqija po na çojnë ato që po ndodhin.* *Όλα τα κακά το βαζ' ο νους μου καθώς ανέβαινα προς το κάστρο, εκτόα απ' αυτό που 'χε συμβεί.* (T.T.Σ. 24) – *Duke u ngjitur me nxitim për në kala, më vinin ndër mend tërë të këqijat me përjashtim të asaj që kishte ndodhur.*
- Të qenurit përpara a përballë me dikë ose me diçka: *Μάς χαιρέτησε έναν προς έναν.* – *Na përshëndeti një nga një.* *Βλέπω, κομμάτι προς κομμάτι, στα μεταφράσματά του ένα προοδευτικό ζετύλιγμα.* – *Pjesë pas pjese shikoj në përkthimet e mia një pështjellim përparues.* *Άρχισε να το διαβάζει λέξη προς λέξη.* – *Filloi ta lexojë fjalë për fjalë.*
- Kundërshtim: *Μισεί την αντίθεση προς την παράδοση.* – *Urren kundërshtimin e traditës.* *Πέφτει σε αντίφαση προς τον εαυτό της.* – *Bie në kundërshtim me veten.*

- Kohën e kryerjes së një veprimi: **Πρός τα ζημερώματα.** – Në të gdhirë.
- Qëllim: **Πρός χάριν** της Ερασμίας ίσως καταδεχόταν ο θεός να σώσει και μας τους αμαρτωλούς! (Τ.Τ.Σ. 27) – **Për hir** të Erazmisë, ndoshta Perëndia pranonte të na shpëtonte edhe ne mëkatarët! ...είχα ξαφνικά το ευχάριστο συναίσθημα ότι κάτι είχε αλλάξει στη ζωή μας **προς το καλύτερο.** (Τ.Τ.Σ. 59) - ...unë kisha ndjenjën e gëzueshme se më së fundi diçka e mirë po ndodhte në jetën tonë.
- Kufizimin e një veprimi: Αυτά **πρός το παρόν** σου φτάνουν. – **Këto për momentin** të mjaftojnë.

Zakonisht, kur ka këtë kuptim, parafjalës *πρός* i paravendoset pjesëza *ώς*: *Ο Πέτρος ως προς αυτό έχει δίκιο.* – *Për këtë* Petro ka të drejtë. *Κανείς δεν ξεγελιέται ως προς το ζήτημα* αυτό. – *Asnjë nuk tallet për sa* i përket kësaj çështjeje.



Kjo parafjalë shërben dhe për krijimin e disa shprehjeve të ngurtësuar:

βήμα προς βήμα	πάππου προς πάππου	προς τιμήν
ένα προς ένα	προς Θεού	προς το παρόν

λέξη προς λέξη προς στιγμήν

Όσο το γύριζα στο μυαλό μου, τόσο περισσότερο μου 'ρχόταν τρέλα, και προς στιγμήν σκέφτηκα ν' αυτοκτονήσω. (Τ.Τ.Σ. 50) – Sa më shumë që e mendoja, aq më tepër çmendesha dhe për një çast mendova të vrisja veten.

6.2.11. Funkzioni dhe ndërtimi i parafjalës *υπέρ, υπό, χάριν*.

Parafjala *υπέρ* (*pro, mbi*) përdoret në greqishten e re në raste specifike. I paraprin një emri në kallëzore dhe në gjinore. Fjala të cilës i paravendoset tregon:

1. Mbështetje : *Έβγαζαν αποφάσεις – συνήθως υπέρ του Φώτη – κι είχαν την αναίδεια να θέλουν να τις εφαρμόσω. (Τ.Τ.Σ. 28) – Ato merrnin vendimet e tyre (përgjithësisht pro Fotit) dhe kishin paturpësinë të më thonin t'i zbatoja. Htan υπέρ της αμοιβαίας κατανόησης, ή τουλάχιστον της αμοιβαίας ανοχής των συζύγων. (Τ.Τ.Σ. 79) – Ajo ishte pro mirëkuptimit reciprok ose të paktën për tërheqjen e ndërsjellë të bashkëshortëve.*
2. Tejkallim sasie: *Η εκδήλωση συγκέντρωσε υπέρ τους χίλιους οπαδούς.- Aktiviteti mbloodhi mbi një mijë ihtarë.*

Shprehje te ngurtësara: *υπέρ βωμών και εστιών, υπέρ το δέον, υπέρ πίστεως και πατρίδος.*

Parafjala *υπό* (*nën*) përdoret në greqishten e re më së shumti në shprehje te ngurtësuar. Ajo përdoret me rasë kallëzore dhe gjymtyra të cilës i paravendoset tregon kusht: *Υπ' αυτό το πνεύμα κίνησα να πάω να γνωρίσω την οσία Ευφημία. (Τ.Τ.Σ. 31) – Në bazë të kësaj taktike shkova që të takohem me "të përhirshmen" Eftimia. Υπό την καθοδήγηση της Ερασμίας, ζόδευε αφειδώς λεφτά σε φιλανθρωπίες...(Τ.Τ.Σ. 59) – Nën udhëzimet e Erazmijes ai nisi të harxhonte para andej-këndej duke bërë filantropira...*

Shprehje te ngurtësuar:

υπ' ατμόν	υπό σκιάν
υπ' όψιν	υπό συζήτηση
υπό εκδίκαση	υπό την αιγίδα
υπό κράτηση	υπό την αρχηγία
υπό μορφήν	υπό την επήρεια
υπό περιορισμό	υπό την επίβλεψη
υπό σκέψη	υπό την πίεση

Parafjala librore *χάριν* (*për hir të*) përdoret me rasë gjinore për të treguar përfitim si dhe në disa shprehje te konsoliduara : *Συνιστώ υπομονή χάριν τού συμφέροντος όλων. – Bëj durim për hir të interesit të të gjithëve.*

Shprehje te ngurtësuar:

λόγου χάριν	χάριν ευκολίας	
παραδείγματος χάριν	χάριν ευφωνίας	χάριν συντομίας
χάριν αστεισμού	χάριν παιδιάς	

PËRFUNDIME

3. Me qëllim që të lidhë një element emëror me foljen, folësi përdor kryesisht parafjalët *me, se, για, από*. Këto parafjalë dallohen për larminë që shfaqin në përdorim, si dhe për ndërfutjen e plotësuesve të foljes.

Pra, këto parafjalë kanë një përdorim mjaft të gjerë si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Kuptimet e tyre kryesore janë:

Parafjala *me* e gjuhës së re greke e ka prejardhjen nga parafjala e gjuhës së vjetër greke *μετά*. Kjo trajtë e vjetër gjendet sot e përdorur në dialekte të ndryshme si dhe në këngët popullore. Gjymtyra e prirë nga parafjala *me* tregon: bashkekzistencë, mjet, mënyrë, kohë, lëndë *Η αστυνομία μάταια παλεύει να αντιδράσει με πιστολιές στον αέρα. – Më kot policia përpiqet të reagojë, duke shtënë në ajër me pistoleta. Κι ενώ ως τότε ούτε ο νοικοκύρης ούτε η γυναίκα του είχαν πει λέξη, όταν έκλεισε στο σπίτι μας δυο μήνες, μ' έπιασε μια μέρα εκείνος, και, με πολλή ευγένεια, μου λέει... – Deri atëherë, i zoti dhe zonja e shtëpisë, nuk na kishin thënë asgjë. Po kur Eleni mbylli dy muaj që kishte ardhur, më kap një ditë i zoti i shtëpisë dhe me shumë takt më thotë... Θα φύγουμε το απόγευμα με τη δύση του ήλιου. – Do të ikim kur të perëndojë dielli.*

Trajta fillestare e parafjalës *σε* është *είς*, trajtë e cila gjendet jo rrallë në këngë popullore si dhe ndonjëherë tek përrallat popullore. Parafjala *σε* i bashkangjitet njëjës shquese të emrit në rasën kallëzore njëjës dhe shumës. Ndaj shpesh ajo del me trajtat *στον, στην, στο, στους, στις, στα*. Gjymtyra e prirë nga parafjala *σε* tregon: vend, kohë, referim, qëllim, shkak, mjet, mënyrë

Πήρε να βρέχει τώρα δυνατά. Φτάναμε στο χωριό. – Shiu kishte shtruar mirë. Po hynim në fshat. Σε πρώτη ευκαιρία θα δηλώσω συμμετοχή. ...κι ο πατέρας του επειδή απ' όλα τ' αγόρια μόνο αυτός ήταν καλός στα γράμματα, κι είχε καημό να σπουδάσει ένα του γιο αρχαιολόγο. - ...dhe babai e donte shumë se ai ishte i vetmi që vinte mirë me mësim dhe babai e kishte merak të madh të bënte njërin nga fëmijët arkeolog. Δια ταύτα καλούμε τον νομοταγή λαό της πόλης μας σε ευρεία συγκέντρωση και ανταλλαγή απόψεων με στόχο την επαγρύπνηση και λήψη μέτρων για την έγκαιρη και αποτελεσματική αντιμετώπιση των τεκταινομένων. – Për të gjitha këto ftojme popullin e qytetit tonë në një meeting të madh, por edhe në një debat të madh, ku të rrahim mendimet, duke patur si objektiv vigjilencën, si dhe marrjen e masave për përballimin me sukses të garantuar të ngjarjeve të tilla të padëshiruara. Η καρδιά του είναι σε κακά χάλια. - Zemra e tij është keq e mos më keq.

Parafjala *για* e greqishtes e ka prejardhjen nga parafjala e vjetër greke *διά*. Por parafjala *για* e gjuhës së re greke ka ndryshime nga këto kuptime. Mund të themi se ka ruajtur kuptimin e kohës, p.sh: *διά νυκτός / διά χρόνου πολλού*. Ajo është parafjalë e rasës kallëzore, por rrallë mund ta gjejmë të përdorur dhe me emërore apo gjinore si shkak i thjeshtimit të disa fjalive më të plota. Gjymtyra e prirë nga parafjala *για* tregon: vend, kohë, shkak, qëllim, objektin mbi të cilin bie veprimi etj. *Για πρώτη φορά είχαμε έρθει εδώ, πηγαίναμε σε άλλα σνακ μπαρ. – Ishte hera e parë që vinim këtu, shkonim në të*

tjera snak bar. Eίχαμε μπει στον παράδεισο, αλλά σ'έναν παράδεισο με πάθος για ζωή, με σάρκα, με ανθρώπινο, πολύ ανθρώπινο πρόσωπο, και με ψυχή.– Kishim hyrë në parajsë, veçse në një parajsë me patos e zjarrmi për jetën, me fytyrë shumë njerëzore, natyrisht, edhe me shpirt. Για καφέ θα μιλάμε τώρα; – Për kafënë do të flasim tani?

4. Parafjalën από mund ta gjejmë dhe me format e saj të shkurtuara απ', 'πό, π'. Kuptimi i saj fillestar është ai i largësisë: από-τραβείωμαι, από-φεύγω. Gjymtyra e prirë nga parafjala από tregon: vend, shkak, frymorin veprues, përmbajtjen, kohë, lëndën: *Στα κατάμαυρα από την κορφή ως τα νύχια. - zhytyr në të zeza që nga maja e flokëve deri tek thonjtë. Από νοσταλγία για το Παρίσι με τους πολλούς σταθμούς τον ονομάτισε έτσι. – E ragëzoi kështu atë stacion nga nostalgjia që kishte për Parisin. Φαρμάκι ο αργός αποχωρισμός από τους ανθρώπους που αγαπάς. – Helm e shkuar helmit kjo ndarje e ngadaltë prej njerëzve që i ke dashur. Erxhetai στο νομ μου ένα ινδιάνικο ανάγλυφο, από σκούρα γκρίζα πέτρα: ο άντρας έχει ρίξει τη μπάτσα του γύρω από τη γυναίκα και σμίγει μαζί της με τόση απαλάδα κι εγκαρτέρηση ... – Më bëhet në sy një relief indian në një gurrë murrash: një burrë i ka hedhur krahët një gruaje dhe të dy bashkohen kaq thjeshtë e kaq përjetësisht ... Όλα αυτά συνέβαιναν τη νύχτα της Πέμπτης 5 Νοέμβρη '98, λίγο πριν από τα μεσάνυχτα. – Të gjitha këto ndodhnin natën e së enjtes, 5 nëntor '98, fare pak kohë përpara mesnatës. Γαλήνη γύρω μας, μόνο το τακ-τακ από τα πέταλα των αλόγων, που όμως πνιγόταν στο παχύ στρώμα από αγγιόχορτα. – Rretherrotull nesh qetësi, dëgjohej vetëm tak-taku i trokut të kuajve, që gjithsesi mbytej në tokën e mbuluar nga barërat e egra.*
5. Greqishtja e re zotëron një numër të madh parafjalësh me kuptim specifik. Këto parafjalë kanë prejardhje të ndryshme. Kështu, parafjalët ανά, αντί, κατά dhe μετά konsiderohen si parafjalë kryesore të gjuhës librore dhe εκτός, εντός, μεταξύ dhe μέχρι, konsiderohen si abuzive¹²⁵. Parafjalët εξαιτίας, ίσαμε dhe σαν dikur kanë qenë perifrazike dhe më pas evoluuan deri sa u bënë një fjalë e vetme. Parafjalët λόγω dhe μέσω janë përdorime të ngurtësuara të dhanores së emrave përkatës: λόγος dhe μέσος. Parafjalët πριν, εναντίον dhe ενώπιον kanë prejardhje ndajfoljore. Janë shndërruar si të tilla nga përdorimi i shpeshtë me elementë emëror. Këto parafjalë përdoren për të shprehur disa marrëdhënie specifike si:

Marrëdhënie hapësinore: Ας διδάξουμε πρώτα τα Ελληνικά στους πρόσφυγες εντός Ελλάδος και μετά διδάσκουμε και τους εκτός Ελλάδος. Το καλλυντικό περνάει στον οργανισμό μέσω των μεμβρανών των κυττάρων.

¹²⁵ Parafjalë kryesore quhen ato që krahas përdorimit të tyre si parafjalë, përdoren edhe si parashtesa gjatë procesit të fjalëformimit. E kundërta ndodh me parafjalët abuzive që përdoren vetëm me funksionin e parafjalës.

Marrëdhënie kohore: **Μετά** το 1870 άρχισαν οι ανασκαφές στην ελεύθερη πια Ελλάδα. Εάν ο εργοδότης δεν εκπληρώσει την υποχρέωσή του αυτή **εντός** διαμήνου, η καταβολή τής εργοδοτικής εισφοράς και τής εισφοράς τού ασφαλισμένου βαρύνει τον εργοδότη.

Mënyrë ose mjetin: Ας ψάξουμε να βρούμε το δικό μας πρόσωπο, το οποίο εμείς οι μουσικοί προσφέρουμε **μέσω** τού έργου μας. Όσοι επιχειρηματολογούν **χωρίς** προκαταλήψεις αντιλαμβάνονται τον πολιτικό τους ρόλο.

Marrëdhënie shkakore: **Εξαιτίας** ταραχών στην πόλη, είναι απαραίτητο να μεταφέρουμε την οικογένεια κάτω. Το ταξίδι τού Οδυσσέα, **λόγω** εμποδίων, κράτησε δύο χρόνια.

6. Marrëdhënie sasiore: Στήριξε τελικά τον **κατά** πενήντα κιλά βαρύτερο δοκό κι έτσι επιτύχθηκε η αποσυναρμολόγηση τού παλιού σκελετού. Τα ρολά μελάνης προσφέρονται **ανά** δύο και το σετ κοστίζει 25.000 δρχ.

7. Referim: Πόλεμος πατήρ πάντων **κατά** τον Ηράκλειτο.

KREU VII

PREJARDHJA E PARAFJALËVE DHE SHPREHJEVE PARAFJALORE NË SHQIPE DHE NË GREQISHTE TË RE

7.1. Klasifikimi i parafjalëve të shqipes sipas prejardhjes

Pjesa më e madhe e parafjalëve nuk janë të parme, por janë formuar prej pjesësh të tjera të ligjëratës siç është emri dhe ndajfolja. Për sa i përket prejardhjes ato ndahen në:

1. Të parme: *mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, prej, te(k)*. Tek këto parafjalë vihet re se përdorimet e tyre kanë shumë kuptime. Më shumë kuptime kanë parafjalët *për, në, prej, me*. Këto kuptime janë disi të përgjithshme dhe konkretizohen më shumë brenda togefjalëshit. Kuptimi leksikor tek parafjalët *mbi, nën, pa, me*, është më konkret e më i kapshëm në krahasim me të tjerat kuptimi i të cilave është më abstrakt. Në “Fonetika dhe gramatika...” thuhet se në togefjalësha të caktuar “Parafjalët e parme janë të zhveshura nga kuptimet leksikore”¹²⁶ ose “paraqiten pa ndonjë semantikë leksikore” ose “ e humbasin plotësisht kuptimin leksikor”¹²⁷. Por, M. Samara nuk është i këtij mendimi. Ai është i mendimit se “Do të ishte më drejt të thuhej se të gjitha ato nuk janë të zhveshura “plotësisht” nga kuptimi leksikor, se dhe ato kanë një kuptim leksikor pak a shumë të përgjithshëm, edhe po të vështrohen jashtë togefjalëshit¹²⁸”.
2. Jo të parme d.m.th. që janë formuar nga pjesë të tjera të ligjëratës: *afër, rrotull, rreth, larg, pranë, brenda, jashtë, lart*, etj. këto parafjalë ruajnë lidhje të ngushta kuptimore me fjalët prej të cilave vijnë. Rrallë mund të ndodhë që kjo lidhje kuptimore të mos jetë shumë e qartë. Këto parafjalë ndahen në dy grupe kryesore:
 1. Parafjalë ndajfoljore që kanë prejardhjen prej ndajfoljesh.
 2. Parafjalë emërore që kanë prejardhje prej emrave.

Ekzistojnë edhe disa parafjalë të tjera që formohen nga bashkimi i dy parafjalëve ose nga bashkimi i lidhëzës si me parafjalët *pas* e *mbas*. Të tilla parafjalë janë *përmbi, nëpër, përveç, sipas, simbas* dhe quhen **parafjalë të përngjitura**. *I vinte turp të zhvishej përpara një njeriu të panjohur*. (O.A.V. 279) *Sipas tyre, lufta me turqit nuk duhej të*

¹²⁶ Fonetika dhe ... vep. e cit., f.382.

¹²⁷ M. Çeliku, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, SF, I, 1972, f. 89.

¹²⁸ M. Samara, *Parafjalët në shqipen e sotme*, Tiranë, 1999, f. 15.

bëhej vetëm për mallrat, por për të ndarë një herë e mirë kufijtë mes lindjes dhe perëndimit. (O.A.V. 283) Këmbët i dridheshin dhe flokët ecnin **nëpër** jastëk si një dorë që e tërhiqte drejt derës. (O.A.V. 298) Por plagët e dashurisë kanë një veti: ato nuk i shëron asnjë ilaç, **përveç** dashurisë. (O.A.V. 298) Me gjithë shpejtësinë e makinës, Marku arriti të kapte vështrimin e zëvendëssefit të policisë, që rrinte **përbri** shoferit, madje iu duk se tjetri ktheu pak kryet për ta parë më mirë. (L.F.M. 11). Po pse ka njerëz me lëkurë të zezë, vazhdoi vajza duke thirrur me dorë të motrën që ishte ende **përballë** burrit me muskuj. (O.A.V. 37). Doktor kishte thënë se aty, **përveç** mjaltit të dashurisë, kishte edhe djegie xhelozie dhe ndoshta prandaj xixëllonjat mblidheshin rreth shtëpisë, duke nuhatur erën e zakonit të vet. (O.A.V. 187). Gruaja, që kishte ardhur **përtej** detit, nuk ngjante me asnjë, që ato kishin parë deri ato ditë. (O.A.V. 30).

Këto parafjalë përdoren për të formuar kundrinorin me parafjalë. Kundrina me parafjalën **nëpërmjet** shpreh sendin, me ndërmjetësinë e të cilit realizohet veprimi: **Nëpërmjet librave** marrim shumë informacione lidhur me probleme të ndryshme që na shqetësojnë. Kundrina me parafjalën **kundrejt** shpreh objektin të cilit i drejtohet veprimi: **Mbaj qëndrim të ashpër kundrejt gabimeve** të miqve të mi.

7.1.1. Parafjalët ndajfoljore

Në gjuhën shqipe ekzistojnë një sërë fjalësh që përdoren edhe si ndajfolje edhe si parafjalë. Kur këto ndajfolje kthehen në parafjalë humbasin përbërësit e tyre semantikë¹²⁹. Të tilla janë ndajfoljet e vendit dhe të kohës: *rrotull, para, anash, përkundrejt, përpara, prapa, afër, larg, brenda, jashtë, përjashtë, drejt, kundër, kundrejt, pranë, ndërmjet, nëpërmjet, përmes, përqark, përpjetë, poshtë, si, posi, sipër, përsipër, veç, përveç, tej, përtej rrotull*, etj. “Duhet ta kuptoni, unë s’mund të rri pa folur për të, megjithëse, siç i kishte thënë një të njohurës sonë të përbashkët **para ca javësh**, tani nuk më sheh dot me sy”. (F. Kongoli, J.K.Sh. 85). “Kur ra zilja e derës së jashtme, ai po rrinte **pranë tryezës**”. (F. Kongoli, J.K.Sh. 5). “Ndonjëherë rrinte gjatë, gjithmonë në pjesën ku shërbente Dina, në një tryezë **afër faqes së xhamtë**”. (F. Kongoli, J.K.Sh. 85). “Pak më vonë, **jashtë apartamentit**, duke pritur ashensorin për të zbritur poshtë, e mblodhi të mos kthehej më atje”. (F.Kongoli, J.K.Sh. 9). “Me gotën në dorë vajti **drejt derës**”. (F.Kongoli, J.K.Sh. 9). “Me një shishe Jack Daniel’s të çuar **përtej gjysmës**”. (F.Kongoli, J.K.Sh. 5). Kur pazari I kafshëve mbaroi me blerjen e tre qenve, disa dhjetëra kanarinave, shumë fluturave të ngordhura, një gjarpri jeshil me sy të kuq dhe pasi askush nuk e bleu tigrin, megjithëse çmimi i tij **gjatë ditës** u përgjysmua, njerëzit hodhën sytë mbi njerëzit që ishin në shitje. (O.A.V. 20). **Brenda pikturës** nuk kishte asnjë

¹²⁹ M. Samara. vep. e cit., f. 65.

*dorë që mund të lëvizte për ta hequr fijen, sepse duart e gjyshes nuk lëviznin për asnjë arsye prej gati njëqind vjetësh. (O.A.V. 15). E dija që ti do të vije një ditë dhe e kam ruajtur poshtë **jastëkut** tim. (O.A.V. 282). Kur isha i ri, babai më detyroi të merresha me tregtinë e tij dhe harrova një pjesë të jetës time **larg Venedikut**. (O.A.V. 290). Sytë e mëdhenj nuk i fshihnin as kapriçot e as virgjërinë e një vajze që shkonte e sigurt **drejt një moshe tjetër**, kur femrat duan të kontrollojnë çdo lojë dhe sidomos ato lloj lojërash që luhen me sytë e burrave. (O.A.V. 274).*

Këto parafjalë përdoren për të shprehur kundrinorin me parafjalë. Kundrina me parafjalën *kundër* shpreh objektin në dëm të të cilit realizohet veprimi: *Nuk është mirë të flasësh kundër miqve të tu të vërtetë*. Kundrina me parafjalët *para*, *përpara*, shpreh vetën ose sendin, në raport me të cilin realizohet veprimi: *Para Otellos, me miliona njerëz të të gjitha ngjyrave, racave, moshave dhe besimeve kishin vdekur pa e ditur pse*. Kundrina me parafjalën *drejt* shpreh objektin drejt të cilit synon veprimi: *Ajo ndoshta po flinte me shaminë e tij poshtë jastëkut, ndërsa lëngu i dashurisë priste që të mbushte një vjeç dhe të ecte drejt saj, si një fëmijë mbi një pjatë me fruta*.

Sipas E. Hysës¹³⁰, kalimi i ndajfoljeve në parafjalë lidhet me disa veçori:

1. Kur ndajfoljet kalojnë në parafjalë ato humbasin kuptimin e tyre për të shprehur rrethana të ndryshme të veprimit të foljes dhe fitojnë një kuptim të ri, atë të shprehjes së marrëdhënieve në mes të fjalëve kuptimplote.
2. Kalimi i ndajfoljeve në parafjalë është i lidhur dhe me dobësimin në maksimum të theksit, ndajfolja është një fjalë e mëvetësishme me theks sit ë gjitha fjalët kuptimplote, por kur kalon në parafjalë ajo mbetet pothuajse e patheksuar ose me theks mjaft të dobësuar. Krahaso: *Dil jashtë* dhe *dil jashtë shtëpisë*. *U ul pranë* dhe *u ul pranë meje*. Fjalët *jashtë* dhe *para* në rolin e parafjalëve nuk e kanë theksin aq të fuqishëm sa kur përdoren si ndajfolje.

Sipas V.V.Vinogradov¹³¹, “kalimi i ndajfoljes në parafjalë, shkalla e afërsisë së saj me parafjalën kushtëzohen nga kuptimi leksikor dhe gramatikor i ndajfoljes. Ato varen nga afria kuptimore që kanë ndajfoljet me parafjalët. Ndajfoljet *para*, *prapa*, *larg*, *afër*, *sipër* shprehin rregullisht rrethana vendore dhe kohore.

Parafjalët shërbejnë për të shprehur marrëdhënie të ndryshme midis gjymtyrëve të fjalisë. Duke qenë se parafjalët janë shumë afër në kuptim me ndajfoljet, atëherë këto të fundit kthehen lehtë në parafjalë. Po kjo s’do të thotë që çdo ndajfolje mund të kthehet në parafjalë. Për sa i përket anës gramatikore, duhet thënë që ndajfoljen dhe parafjalën i bashkon i njëjti tipar: karakteri i pandryshueshëm i tyre; kështu që edhe nga pikëpamja morfologjike ndajfolja s’paraqet vështirësi për t’u shndërruar në parafjalë¹³².

¹³⁰ E. Hysa, *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, SF 3, Tiranë, 1970, f. 40.

¹³¹ E. Hysa, po aty, V.V.Vinogradov, *Ruskij jazyk. Grammatičeskoje učenije o slove*, Moskva, 1947, f. 395.

¹³² E. Hysa, po aty.

Duhet theksuar se ndajfolja shërben edhe si një “urë lidhëse” për kalimin e pjesëve të tjera të ligjëratës në parafjalë.

7.1.2. Parafjalët emërore

Kalimi i emrave në parafjalë ose është i drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndajfoljeve. Për sa i përket origjinës së këtyre parafjalëve nga emrat, prof. Sh. Demiraj është i mendimit se “kur një emër kalon në klasën e parafjalëve, nuk shërben më si fjalë emëronjëse, por si fjalë shërbyese; kuptimi i tij zbehet mjaft dhe theksimi i dobësohet”¹³³. Kështu emrat *rreth*, *rrotull* kanë kaluar në parafjalë pasi janë shndërruar më parë në ndajfolje¹³⁴. M. Çeliku është i mendimit se “parafjalët *rreth*, *rrotull* e *qark* duhet të trajtohen si parafjalë ndajfoljore dhe jo si parafjalë emërore”¹³⁵. Ai quan parafjalë emërore si ato që janë formuar “drejtpërdrejt nga rasat e zhdrejta të emrave” edhe ato që janë formuar “nga bashkimi i emrave me parafjalë të mirëfillta”¹³⁶, ndaj ai krahas parafjalëve të vërteta emërore (*buzë*, *mes* etj), që i quan “të thjeshta”, edhe lokucionet e tipit *në drejtim*, *në bazë* etj., që i quan “të përbëra”¹³⁷. Sipas S. Priftit “këto parafjalë janë të njëjta me shprehjet ose lokucionet”¹³⁸. Por ka edhe emra si: *anë*, *bri*, *buzë*, *ballë*, *bythë*, *faqe*, *krah*, *majë*, *mes*, *midis*, *rrëzë*¹³⁹ që kanë hyrë në kategorinë e parafjalëve në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa kaluar më parë në kategorinë e ndajfoljeve. Të gjitha këto parafjalë shprehin marrëdhënie vendore: *anës* detit, *buzë* greminës, *rrëzë* malit, *faqe* teje, *midis* shtëpive etj. *Profeti kishte lindur buzë detit dhe prandaj kjo pjesë e botës i takonte pushtetit të tij.* (O.A.V. 284). *Atë nuk e dimë, tha djali, i cili nuk kishte asnjë dobësi për forcën fizike dhe prandaj mes një tigri dhe një gjarpri zgjidhte të dytin.* (O.A.V. 54). *Të kishte qenë Zefi me siguri do të gjente ndonjë lidhje simbolike midis gjarpërit të ngrirë dhe asaj çka po ndodhte përreth.* (L.F.M. 10). *Tani fëmijët rrinin rrotull tij, në breg të detit, dhe zhurmat që bënin kafshët e pashitura nuk i tërhiqnin më, ndoshta sepse e kishin kuptuar se e ardhmja, për të cilën fliste babai i tyre, nuk varej nga kafshët, por nga njerëzit.* (O.A.V.

133 Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II*, 1961, f. 271.

134 *Gramatika e gjuhë shqipe*, vep. e cit., 382.

135 M. Çeliku, *Parafjalët emërore...* vep. e cit., f.94.

136 Po aty, f.88.

137 M. Çeliku, vep. e cit., f.92.

138 S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1959, f. 153.

139 Të gjithë këta emra kanë kaluar në parafjalë në formën e kallëzores së pashquar. Kur janë në rasën rrjedhore të trajtës së pashquar dhe ndiqen nga një emër në rasën gjinore, ata nuk konsiderohen si parafjalë.

27). Në krye u vërtitën **rreth** shtëpisë gjithë kujdes, pastaj e lanë drojën dhe trokitën drejt e në portë. (L.F.M. 24). Dhe për të mos ia rrëzuar këtë bindje, u mbështet **anës** shtratit, si një kukull që e mbajmë poshtë jastëkut, derisa dëgjoji zhurmën e krehrut që i ra doktorit nga dora. (O.A.V. 186).

Shumica e parafjalëve emërore dalin si lokucione parafjalore dhe ndërtohen:

1. **Parafjalë + emër.** Lokucionet që formohen në këtë mënyrë janë: *me anë, me anën, me përjashtim, me rastin, në bazë, në drejtim, në këmbë, në mes, në sajë, në vend, nga ana, nga shkaku, për arsye, për hir, për punë, për shkak* etj. Këto lokucione përdoren me rasë gjinore sepse kanë dalë nga gjymtyra e parë e një togfjalëshi *emër + emër në gjinore*. Por disa prej tyre mund të përdoren edhe me rrjedhore si p.sh.: *me anë miqsh, në bazë qyteti, më mes dy jetësh, për punë kokëfortësie. Ç'kishte ndodhur natën e parë të martesës, në mes të tetorit?* (L.F.M. 29) *Por në vend të zemërimit ndien frikë.* (O.A.V. 36) *E hodhi në supe lëkurën dhe aty për aty u kthye në gjarpër e u mblodh kutullaç në fund të shtratit.* (L.F.M. 32) *Marku kërkoi cigaret me atë ngut që do të nxirrte revolverin për t'u mbrojtur në rast rreziku.* (L.F.M. 37). *Ndoshta me kalimin e ditëve, ai do të kërkonte të shpëtonte nga kjo barrë që ia kishte kërrusur shpinën duke e shëmtuar.* (O.A.V. 289).
2. **Parafjalë + emër + parafjalë.** Lokucionet e këtij tipi parafjalën e parë e kanë gjithmonë në dhe të dytën gjithmonë *me: në krahasim me, në kundërshtim me, në lidhje me, në pajtim me, në përputhje me* etj. Duke qenë se fjala e fundit është parafjala *me* që përdoret me rasë kallëzore, i gjithë lokucioni do të përdoret me rasë kallëzore.

Emrat që bëjnë pjesë në këto lokucione kanë kuptim abstrakt si: *anë, përputhje, pajtim, drejtim, përjashtim, punë, shkak, arsye, krahasim, kundërshtim, lidhje*. Kuptimet e këtyre lokucioneve parafjalore varen nga kuptimet e emrave që kanë në përbërjen e tyre. Kështu parafjalët *për arsye, nga shkaku, për shkak, nga puna, për punë* shprehin marrëdhënie shkakore, lokucionet parafjalore *në drejtim, në mes* shprehin marrëdhënie vendore. Në kuptimin e këtyre lokucioneve ka të bëjë edhe parafjala e parë përbërëse e tyre. Kështu, lokucionet parafjalore që kanë si parafjalë të parë parafjalët *për* e *nga*, tregojnë shkak. Ato lokucione që kanë parafjalën *në* tregojnë vend, ato që kanë të parën parafjalën *me* tregojnë mënyrë. Ndërsa parafjalët ndajfoljore shprehin marrëdhënie vendore sepse formohen prej ndajfoljesh vendi, parafjalët emërore shprehin marrëdhënie të ndryshme. Secila parafjalë shpreh një marrëdhënie të caktuar, të diferencuar. Pikërisht, nevoja për të shprehur marrëdhënie të tilla të diferencuara ka qenë edhe arsyeja e lindjes së këtyre parafjalëve¹⁴⁰. Kjo klasë parafjalësh pasurohet vazhdimisht me formime të reja¹⁴¹. Parafjalët dhe lokucionet parafjalore janë karakteristikë e stilit letrar. Këto mund të tingëllojnë sit ë huaja, por përdoren për të karakterizuar ndonjë personazh.

¹⁴⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 1995, f. 386.

¹⁴¹ Në rrugën e shndërrimit në lokucione parafjalore janë edhe togjet si: *me ndihmën, në dëm, në dobi, në fushën, në lëm ose në lëmin, në pamundësi* etj.

Veç parafjalëve emërore të lartpërmendura ka edhe tri parafjalë që janë formuar nga përngjitja e një parafjale me një emër dhe që përdoren me rasë rrjedhore: *ndërmjet* = *ndër* + *mjet*, *nëpërmjet* = *nëpër* + *mjet*, *nëpërmes* + *nëpër* + *mes*.

Këto parafjalë përdoren edhe për të formuar kundrinorin me parafjalë dhe rrathanorë që shprehin marrëdhënie vendore, kohore etj. Kundrina me parafjalën *rreth* marrin foljet që shprehin veprimtari mendore, si: *mendoj*, *arsyetoj*, etj. në këto ndërtime kjo parafjalë përdoret kryesisht në stilin shkencor: *Në krye u vërtitën rreth shtëpisë gjithë kujdes, pastaj e lanë drojën dhe trokitën drejt e në portë.*

7.1.3. Parafjalë foljore

Sipas A. Xhuvanit parafjalë foljore në gjuhën shqipe është vetëm një. Ajo e ka origjinën tek pjesorja e foljes falem dhe është *falë* që ka zëvendësuar me sukses parafjalën me prejardhje të huaj *në saje (në sajë)*¹⁴². Përdoret gjithmonë me rasë rrjedhore: *Falë* punës tënde jemi këtu. *Falë* mësueses ia arrita qëllimit. *Falë* Zotit gjithçka shkoi mirë. Por M. Çeliku thekson se “Parafjalë foljore janë disa parafjalë të formuara nga foljet, kryesisht nga pjesoret e foljeve”¹⁴³. Ato janë: *lidhur me*, *ngjitur me*, *krahasuar me*, *falë*, *përfshirë*, *përyjashtuar*, *shkuar*, *kaluar*. Këto parafjalë kanë kuptime të veçanta dhe shprehin marrëdhënie të përcaktuara mirë. Parafjalët foljore *lidhur me*, *ngjitur me*, *krahasuar me*, të formuara nga pjesoret përkatëse dhe parafjala *me*, kërkojnë rasën kallëzore.

7.2. Klasifikimi i parafjalëve sipas strukturës morfologjike

Sipas strukturës morfologjike parafjalët ndahen në:

1. Parafjalë të thjeshta. Të tilla janë të gjitha parafjalët e parme: *mbi*, *me*, *më*, *ndaj*, *në*, *nën*, *pa*, *për*, *prej*, *te(k)*. Këtu bëjnë pjesë dhe një numër parafjalësh jo të parme që janë formuar prej pjesëve të tjera të ligjëratës si emra e ndajfolje: *afër*, *brenda*, *gjatë*, *jashtë*, *kundër*, *larg*, *lart*, *para*, *pas*, *tutje*, *veç*, *anë*, *ballë*, *bri*, *buzë*, *faqe*, *majë*, *mes*, *rrëzë*.
2. Parafjalë të përngjitura. Në këtë grup bëjnë pjesë parafjalët që janë formuar nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta: *nëpër*, *përmbi*, *përveç*, *simbas*, *sipas*, *ndërmjet*, *nëpërmjet*, *matanë*, *përballë*, *përkrah*, *përbri*, *përmes*, *përpara*, *përreth*.

¹⁴² A. Xhuvani. “Parafjalët”, “Studime filologjike”, 1964,1, f.8-9.

¹⁴³ M. Çeliku, *Parafjalët foljore dhe disa çështje të formësimit të tyre*, f. 64-65.

3. Lokucione parafjalore. Të tilla quhen parafjalët që përbëhen prej dy a më shumë fjalësh të veçanta megjithëse ende nuk është dhënë një mendimi përfundimtar e unik mbi këtë çështje. Sipas Z. Daci, pikëpamjet rreth kësaj çështje mund të ndahen në dy grupe: lokucion quhet çdo lloj bashkimi dy-a-trifjalësh duke përfshirë dhe njësitë frazeologjike dhe lokucion quhen vetëm bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore, duke përjashtuar njësitë frazeologjike¹⁴⁴. Edhe A. Xhuvani mbështet grupin e parë dhe i quan këto parafjalë “lokucione prepozicionale” ose “shprehje parafjalore”¹⁴⁵. Ky term është përdorur edhe nga Ilija Dilo Sheperi¹⁴⁶, K. Cipo¹⁴⁷, M. Domi¹⁴⁸, Sh. Demiraj¹⁴⁹ e M. Çeliku¹⁵⁰. Ndërsa grupin e dytë të pikëpamjeve e mbështesin A. Kostallari¹⁵¹ dhe J. Thomai¹⁵². Janë formuar me konversion nga lokucione parafjalore: *ballë për ballë, rreth e qark, rreth e rrotull* etj., si dhe ato që kanë dalë nga togjet ndajfolje + parafjalë, parafjalë + emër, parafjalë + emër + parafjalë: *bashkë me*¹⁵³, *tok me, me përjashtim, në bazë, për arsye, në kundërshtim me, në lidhje me. Tani, bashkë me fjalët e ëmbla, i tha fjalë turpe, nga ato që përdorin djemtë e katundit, te*

144 Z. Daci, *Lokucionet foljore në gjuhën e sotme shqipe*, dorëshkrim, 1985.

145 A. Xhuvani, vep. e cit., f.56.

146 I.D. Sheperi, vep. e cit., 139.

147 K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 133.

148 M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1954, f. 88.

149 Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 270.

150 M. Çeliku, vep. e cit., f. 92.

151 A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, në “Studime mbi leksikun”, II, 1972, f. 40.

152 J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, f. 268.

153 M. Samara qorton futjen e këtij lokucioni parafjalor në këtë grup sepse sipas tij nuk përdoret kurrë si ndajfolje. M.Samara, vep. e cit., f. 21-22. Ai është i mendimit se gjatë klasifikimit të parafjalëve duhet të merret parasysh dhe aspekti i tyre leksiko-semantik, duke I ndarë parafjalët në dy grupe të mëdha: A. Parafjalë njëfjalëshe (ku përfshihen parafjalët e thjeshta ose të parme dhe parafjalët jo të parme. Këto të fundit ndahen më pas në a)parafjalë të formuara me përngjitjet (nëpër, nëpërmjet); b)në parafjalë të formuara me konersion, ku përfshihen edhe parafjalët ndajfoljore (afër), edhe parafjalët emërore (buzë), dhe B. Parafjalë dy-a-disafjalëshe, ku përfshihen shprehjet parafjalore ose ato që quhen lokucione.

porta e kishës, të dielave. (L.F.M. 32) Ai ishte përpjekur t'i shpjegonte se s'lidhej vetëm me shijet e tij mashkullore, por në radhë të parë me artin. (L.F.M. 13)

Veç emrave dhe ndajfoljeve, lokucionet parafjalore mund të formohen edhe prej pjesësh të tjera të ligjëratës, por këto janë shumë të pakta në numër. Të tilla janë: parafjala *me gjithë* që formohet nga bashkimi i parafjalës *me* dhe përemri *gjithë*, dhe parafjala *lidhur me* që formohet nga pjesorja *lidhur* dhe parafjala *me*.


Këto lokucione nuk shfaqen të gjitha njësoj. Disa prej tyre që janë formuar nga një ndajfolje dhe një parafjalë ose nga një parafjalë dhe një emër janë më të gramatikalizuara. Disa të tjera janë më pak të gramatikalizuara. Sipas “Gramatika e gjuhës shqipe, I”, një lokucion parafjalor dallohet nga një bashkim sintaksor i lirë me po atë ndërtim, sepse:

1. Ka një lidhje kuptimore më të ngushtë ndërmjet elementeve të tij përbërëse. Emri që bën pjesë në të tilla lokucione e humbet kuptimin e tij leksikor si fjalë emërtuese dhe merr një kuptim abstrakt. Për shkak të njësisë kuptimore të tij, një lokucion mund të jetë shpesh herë sinonim me një parafjalë të njëfjalëshe, të parme: *me anë = me, në drejtim = drejt, në bazë = sipas, nga shkak = nga*.
2. Si pasojë e dobësimit të kuptimit konkret leksikor të fjalës emërtuese të lokucionit, ajo nuk përbën më një gjymtyrë të pavarur fjalie, por formon një gjymtyrë të vetme me fjalën ndjekëse: ***Për shkak të stinës, Otello ishte euforik si një zog, ndërsa Stefan Gjika ishte i menduar, si një profet që pret një shenjë të vonuar, pasi ia ka krijuar të gjitha kushtet. (O.A.V. 175) (rrethanor shkak), Pranvera e kuqe e Vlorës ia largoi mendimet e zymta për jetën, ndërsa vera e djegur ia përthau shpirtin e plagosur, si një tullë e përvëlur që plakat ua vënë fëmijëve në fund të barkut. (O.A.V. 171) (rrethanor vendi).***
3. Emri ose një fjalë tjetër shënuese, që bën pjesë në lokucion, si rregull, nuk mund të marrë një fjalë tjetër përcaktuese. Në rast të kundërt në vend të lokucionit do të kishim një lidhje të lirë sintaksore fjalësh.
4. Trajta e emrit që bën pjesë në lokucion, si rregull, është e pandryshueshme. Ajo është zakonisht e pashquar. Bëjnë përjashtim lokucionet *me anën, me rastin*, si dhe lokucionet e ndërtuara me parafjalën *nga*, pas së cilës emri vihet rregullisht në trajtën e shquar: *nga ana, nga shkak, nga puna*. Ndryshimi i trajtës nga e pashquar në të shquar e shndërron lokucionin në togfjalësh të lirë, p.sh.: me përjashtim – me përjashtimin, në bazë – në bazën, në mes – në mesin, në vend – në vendin. Fjala emërtuese që hyn në përbërjen e një lokucioni, ka formë të ngurosur.

7.3. Klasifikimi i parafjalëve të greqishtes së re sipas prejardhjes

Në gjuhën greke kemi parafjalë të thjeshta, pra që jepen me një fjalë të vetme. Këto parafjalë mund t'i ndajmë në dy kategori.¹⁵⁴ Në kategorinë e parë futen ato parafjalë që kanë një përdorim të gjerë dhe përdoren si plotësuese të foljes. Këto parafjalë quhen **parafjalë me përdorim të përgjithshëm**. Me këtë kuptim përdoren kryesisht parafjalët *με, σε, για, από*.

Përveç këtyre parafjalëve bazë, përdoren dhe një grup tjetër parafjalësh me kuptim më specifik si: *μέχρι, δια μέσου* etj., të cilat karakterizohen si **parafjalë të përdorimit specifik ose të kufizuar**. Me të njëjtin funksion përdoren edhe disa lokucione parafjalore si *μαζί με, αντί για*, etj. Parafjalët me përdorim të përgjithshëm dhe ato me përdorim të kufizuar mund t'i përkufizojmë edhe si parafjalë monolektike¹⁵⁵.



7.3.1. LOKUCIONET PARAFJALORE NË GREQISHTE

Lokucionet parafjalore janë elementë të përbërë që kanë në tërësinë e tyre të njëjtin funksion si parafjalët e thjeshta, d.m.th përdoren për ndërfutjen e një plotësi në fjali.

Gjuha greke ka disa parafjalë të përbëra, që u vendosen përpara shprehjeve emërore ose përemrave pronorë. Këto ndahen në:

1. Parafjalë të përbëra që përdoren vetëm me shprehje emërore dhe përemra pronorë
2. Parafjalë të përbëra që formohen nga një ndajfolje vendi + parafjalë

¹⁵⁴ Χρ. Κλαίρης – Γ. Μπαμπινιώτη, *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 2004, f. 917.

¹⁵⁵ Monolektike do të quajmë ato parafjalë që jepen me një fjalë të vetme përkundrejt parafjalëve perifrazike, pra lokucioneve parafjalore.

Në grupin e parë bëjnë pjesë një numër i vogël parafjalësh të përbëra si: *αντί για, εκτός από, πριν από, ανάλογα με, μετά από, όσο για, σχετικά με, σύμφωνα με, ύστερα από*156:

Në grupin e dytë bëjnë pjesë parafjalët kryesore që ndiqen nga një frazë emërore ose përemër në kallëzore ose mund të ndiqen nga një trajtë e shkurtër e përemrit në gjinore. Këto kombinime janë më të zakonshme kur ndajfolja shoqërohet nga një parafjalë. Kështu kemi: *ανάμεσα σε, απέναντι σε/από, γύρω από/σε, δίπλα σε, έξω από, κάτω από, κοντά σε, μαζί με, μακριά από, μέσα σε/από, μπροστά από/σε, πάνω σε/από, πίσω από, πλάι σε*157.

Αντί για τον Γιάννη θα έρθει ο Κώστας στη συνεδρίαση. – Në mbledhje të vijë Kosta **në vend të Janit**.

Όλα αυτά συνέβαιναν τη νύχτα της Πέμπτης 5 Νοέμβρη 98, λίγο **πριν από** τα μεσάνυχτα. (Ev onómati, 13) – *Τë gjitha këto ndodhnin natën e të enjtes, 5 nënëtor '98, fare pak kohë **përpara** mesnatës.*

Μαζί με τον Πήγασο είναι τα λογοτεχνικά περιοδικά στην πόλη μας, αρκετά για επαρχιακή πόλη 55000 περίπου κατοίκων. (Τ.Τ.Σ. 13) – **Bashkë me** Pikaso, janë dy revistat letrare në qytetin tonë, të mjaftueshme për një qytet provincial me rreth 55000 banorë.

Έφυγε **πριν από** μένα. – Iku **para** meje.

Σταματήσανε **ανάμεσα** στον Ισθμό και στην Κόρινθο. – Ndaluan **midis** Istmo dhe Korinthit.

Οι εκλογές θα επαναληφθούν **μετά από** τρεις μήνες. – Zgjedhjet do të përsëriten **pas** tre muajsh.

Παράθυρα κλείνουν, άλλα ανοίγουν, μερικοί **πίσω από** τις κουρτίνες κοιτάζουν έξω, να δουν τι; (E.O. 67) – Disa dritare hapen, të tjera mbyllen, shumë njerëz **nga pas** perdeve vështrojnë tërë kureshtje jashtë, po çfarë shikojnë?

Μια εξέλιξη **πέρα από** κάθε πρόβλεψη. (E.O. 67) – Një zhvillim **tej** çdo parashikimi.

7.3.2. PARAFJALË NDAJFOLJORE DHE EMËRORE NË GREQISHTE

Ndarjen në parafjalë ndajfoljore dhe në emërore gjuha greke nuk e ka aq të specifikuar sa gjuha shqipe. Si para fjalë emërore njihen *μέσω, λόγω* dhe *χάριν*. Parafjala *μέσω* (*nëpërmjet*) e ka prejardhjen nga dhanorja e konsoliduar e emrit *μέσον* dhe përdoret për të treguar vendin dhe mjetin apo mënyrën e kryerjes së një veprimi. Përdoret me rasë gjinore: *Το τρένο πάει Λάρισα **μέσω** Λαμίας.* – *Treni shkon në Larisa **nëpërmjet** Lamias.* Parafjala *λόγω* (*për shkak të*) vjen nga dhanorja e konsoliduar e emrit *λόγος*. Ajo i paraprin një emri në rasë gjinore dhe përdoret për deklarinimin e shkakut : *...όχι μόνο ήταν εξαναγκασμένος **λόγω** της αρρώστιας του, να εξαρτάται όλο και περισσότερο απ' τον*

156 D. Holton-P. Mackridge-I. Philippaki Warburton, Greek, An essential grammar of modern language, London, 2004, f. 189.

157 Po aty, f. 190.

κλεφταρά τον ξαδερφό του...(Τ.Τ.Σ. 59) - ...jo vetëm që punët vareshin nga kushëriri i tij kusar... Parafjala librore χάριν (për hir të) e ka prejardhjen nga emri χάρις dhe përdoret me rasë gjinore për të treguar përfitim si dhe në disa shprehje të konsoliduara : Συνιστώ υπομονή **χάριν τού συμφέροντος όλων**. – *Bëj durim për hir të interesit të të gjithëve.*

Greqishtja e re zotëron një numër të madh parafjalësh me kuptim specifik. Disa prej tyre kanë prejardhje ndajfoljore. Parafjala εκτός (jashtë, përveç) është me origjinë ndajfoljore. Përdoret kryesisht me rasë gjinore: **Εκτός ελέγχου, φοβάμαι, θα πάει η κατάσταση**.(E.O. 71)- *Kam frikë se mos del jashtë kontrollit situata dhe çdo gjë shkon si mo-s më keq.*

Parafjala έναντι (kundër, përkundrejt) vjen nga εναντίον por përdoret me tjetër kuptim. Dikur përdoret si ndajfolje. Përdoret me rasën kallëzore. Bashkë me parafjalën σε përbën lokucionin parafjalor ενάντια σε. Συμφώνησαν έναντι **αμοιβής**.- *Ranë dakort përkundrejt shpërblimit.*

Ndajfolja e kohës κατόπιν (pastaj) përdoret shpesh si parafjalë me plotës emëror. Gjymtyra e prirë nga kjo parafjalë tregon vonesë në kohë dhe përdoret me emër në rasë gjinore.

Χωρίς να χάσει καιρό ο Παπαθανασίου – αλλ’ αυτή τη φορά **κατόπιν εντολής μου** – του κάνει δεύτερη αγωγή για διαζύγιο... (Τ.Τ.Σ. 92) – *Pa humbur kohë, avokati Papathanasiu (e këtë radhë sipas vendimit tim) bën kërkesën për divorc...*

Parafjalët πριν, εναντίον dhe ενώπιον kanë prejardhje ndajfoljore. Janë shndërruar si të tilla nga përdorimi i shpeshtë me elementë emëror.

Edhe ndajfolja μεταξύ (ndërmjet, midis) përdoret si parafjalë dhe haset me rasë gjinore: Του ήρθε ίλιγγος όταν βρέθηκε μετέωρος **μεταξύ ουρανού και γης**.- *Iu morën mendtë kur e gjeti veten të varur midis qiellit dhe tokës.*

Parafjalët εξαιτίας, ίσαμε dhe σαν dikur kanë qenë perifrazike dhe më pas evoluuan deri sa u bënë një fjalë e vetme.

Parafjala εξαιτίας (për shkak të) është formuar si një ngurtësim i lokucionit parafjalor εξ αιτίας. Ajo i paravendoset emrave të rasës gjinore dhe tregon shkakun e kryerjes së një veprimi: Οι αγρότες αναστατώθηκαν **εξαιτίας των νέων μέτρων**.- *Bujqit u rebeluan për shkak të masave të reja.*

PËRFUNDIME

3. Për sa i përket prejardhjes në gjuhën shqipe parafjalët ndahen në:

Të parme: *mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, prej, te(k)*. Tek këto parafjalë vihet re se përdorimet e tyre kanë shumë kuptime. Më shumë kuptime kanë parafjalët *për, në, prej, me*. Këto kuptime janë disi të përgjithshme dhe konkretizohen më shumë brenda togfjalëshit. Kuptimi leksikor tek parafjalët *mbi, nën, pa, me*, është më konkret e më i kapshëm në krahasim me të tjerat kuptimi i të cilave është më abstrakt. Në “Fonetika dhe gramatika...” thuhet se në togfjalësha të caktuar “Parafjalët e parme janë të zhveshura nga kuptimet leksikore” ose “paraqiten pa ndonjë semantikë leksikore” ose “e humbasin plotësisht kuptimin leksikor”. Por, M. Samara nuk është i këtij mendimi. Ai është i mendimit se “Do të ishte më drejt të thuhej se të gjitha ato nuk janë të zhveshura “plotësisht” nga kuptimi leksikor, se dhe ato kanë një kuptim leksikor pak a shumë të përgjithshëm, edhe po të vështrohen jashtë togfjalëshit”.

Jo të parme d.m.th. që janë formuar nga pjesë të tjera të ligjëratës: *afër, rrotull, rreth, larg, pranë, brenda, jashtë, lart*, etj. këto parafjalë ruajnë lidhje të ngushta kuptimore me fjalët prej të cilave vijnë. Rrallë mund të ndodhë që kjo lidhje kuptimore të mos jetë shumë e qartë. Këto parafjalë ndahen në dy grupe kryesore:

4. Parafjalë ndajfoljore që kanë prejardhjen prej ndajfoljesh.
5. Parafjalë emërore që kanë prejardhje prej emrave.
6. Ekzistojnë edhe disa parafjalë të tjera që formohen nga bashkimi i dy parafjalëve ose nga bashkimi i lidhëzës si me parafjalët *pas* e *mbas*. Të tilla parafjalë janë *përmbi, nëpër, përveç, sipas, simbas* dhe quhen **parafjalë të përngjitura**.
7. Sipas strukturës morfologjike parafjalët ndahen në:

Parafjalë të thjeshta. Të tilla janë të gjitha parafjalët e parme: *mbi, me, më, ndaj, në, nën, pa, për, prej, te(k)*. Këtu bëjnë pjesë dhe një numër parafjalësh jo të parme që janë formuar prej pjesëve të tjera të ligjëratës si emra e ndajfolje: *afër, brenda, gjatë, jashtë, kundër, larg, lart, para, pas, tutje, veç, anë, ballë, bri, buzë, faqe, majë, mes, rrëzë*.

Parafjalë të përngjitura. Në këtë grup bëjnë pjesë parafjalët që janë formuar nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta: *nëpër, përmbi, përveç, simbas, sipas, ndërmjet, nëpërmjet, matanë, përballë, përkrah, përmbri, përmes, përpara, përreth*.

Lokucione parafjalore. Të tilla quhen parafjalët që përbëhen prej dy a më shumë fjalësh të veçanta megjithëse ende nuk është dhënë një mendimi përfundimtar e unik mbi këtë çështje. Sipas Z. Daci, pikëpamjet rreth kësaj çështje mund të ndahen në dy grupe: lokucion quhet çdo lloj bashkimi dy-a-trifjalësh duke përfshirë dhe njësitë frazeologjike dhe lokucion quhen vetëm bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore, duke përjashtuar njësitë frazeologjike. Edhe A. Xhuvani mbështet grupin e parë dhe i quan këto parafjalë “lokucione prepozicionale” ose “shprehje parafjalore”. Ky term është përdorur edhe nga Ilia Dilo Sheperi, K. Cipo, M. Domi, Sh. Demiraj e M. Çeliku. Ndërsa grupin e dytë të pikëpamjeve e mbështesin A. Kostallari dhe J. Thomai. Janë formuar me konversion nga lokucione parafjalore: *ballë për ballë, rreth e qark, rreth e rrotull* etj., si dhe ato që kanë dalë nga togjet ndajfolje + parafjalë, parafjalë + emër, parafjalë + emër + parafjalë: *bashkë me, tok me, me përjashtim, në bazë, për arsye, në kundërshtim me, në lidhje me. Tani, bashkë me fjalët e ëmbla, i tha fjalë turpe, nga ato që përdorin djemtë e katundit, te porta e kishës, të dielave. Ai ishte përprjekur t'i shpjegonte se s'lidhej vetëm me shijet e tij mashkullore, por në radhë të parë me artin.*

8. Parafjalët e greqishtes mund t'i ndajmë në:

Një rrokëshe: *με, σε, για, ως, προς.*

Dy rrokëshe: *κατά, μετά, παρά, αντί, από, δίχως, χωρίς.*

Tre rrokëshe: *ίσαμε.*

Fillimisht parafjalët ishin ndajfolje, shumica e tyre vendore, gjë që është vënë re që nga poetët e lashtë grekë si Homeri dhe Herodoti. Ky kuptim i tyre fillestar duket akoma dhe tani, sidomos tek foljet e përbëra me parafjalë, si p.sh: **κατακαθίζω** (=καθίζω **κάτω-κατασταλάζω**), **παραστέκω** (=στέκω **κοντά, πλήσιον**) etj. Shumica e parafjalëve të greqishtes së re zakonisht përdoren me emra në rasën kallëzore. Rrallë, dhe vetëm në disa shprehje, përdoren disa prej tyre dhe me gjinore dhe me emërore.

9. Në gjuhën greke kemi parafjalë të thjeshta, pra që jepen me një fjalë të vetme. Këto parafjalë mund t'i ndajmë në dy kategori. Në kategorinë e parë futen ato parafjalë që kanë një përdorim të gjerë dhe përdoren si plotësuese të foljes. Këto parafjalë quhen **parafjalë me përdorim të përgjithshëm**. Me këtë kuptim përdoren kryesisht parafjalët *με, σε, για, από*. Përveç këtyre parafjalëve bazë, përdoren dhe një grup tjetër parafjalësh me kuptim më specifik si: *μέχρι, δια μέσου* etj., të cilat karakterizohen si **parafjalë të përdorimit specifik ose të kufizuar**. Me të njëjtin funksion përdoren edhe disa lokucione parafjalore si *μαζί με, αντί για*, etj. Parafjalët me përdorim të përgjithshëm dhe ato me përdorim të kufizuar mund t'i përkufizojmë edhe si parafjalë monolektike.

10. Në të dyja gjuhët ekzistojnë lokucione parafjalore, parafjalë ndajfoljore dhe parafjalë emërore. Si në gjuhën shqipe dhe greke numri i lokucioneve parafjalore

është i madh krahasuar me parafjalët emërore dhe ato ndajfoljore. Këto lokucione formohen kryesisht nga bashkimi i një ndajfoljeje me një parafjalë ose i një emri me parafjalë. Në gjuhën shqipe hasim edhe formimin e një lokucioni me anë të pjesores së foljes + parafjalë, si: lidhur me, krahasuar me etj. një gjë të tillë nuk e gjejmë në gjuhën greke.

11. Numri i parafjalëve ndajfoljore dhe atyre emërore në greqishte është shumë më i vogël krahasuar me ato të shqipes. Gjuha greke njih vetëm tre parafjalë emërore. Për sa i përket parafjalëve foljore gjuha shqipe ka një, *falë*, ndërsa greqishtja asnjë.

KREU VIII

PARAFJALËT LIBRORE

Shumë nga parafjalët librore përdoren në greqishten e re pa asnjë ndryshim në trajtën e tyre, por me disa ndryshime kuptimore, p.sh: *από, ώς, προς, μετά, κατά, αντί*. Kështu, parafjala *από* në gjuhën e re greke përdoret e dhe me kuptimin për të treguar frymorin mbi të cilin bie veprimi i kryer nga folja. Ndërsa në gjuhën e vjetër greke e gjenim të përdorur edhe me rasë gjinore, në gjuhën e re greke ajo nuk përdoret më me këtë rasë me përjashtim të disa shprehjeve të ngurtësuar. Disa parafjalë të tjera librore shfaqin përveç ndryshimeve në përdorim, edhe ndryshime në formë, p.sh: *εις >σε, διά >για, μετά >με*. Parafjalë si *έν, έκ*, nuk përdoren më në gjuhën e re greke, me përjashtim të disa përdorimeve specifike dhe në shprehje të ngurtësuar.

8.1. PËRDORIME SPECIFIKE TË PARAFJALËVE

Si specifike nënkuptohen ato përdorime që janë të kufizuara në një mjedis gjuhësor konkret, si për shembull përdorimi i parafjalës *διά* në pjesëtim¹⁵⁸:

Οκτώ **διά** δύο ίσον τέσσερα.

Ζυγός αριθμός **διά** ζυγού αριθμού δεν δίνει ποτέ μονό αριθμό.

Disa nga këto përdorime janë stilistikisht asnjënjëse. Të tilla janë përdorimet e parafjalëve në veprimet matematikore si *διά* në pjesëtim, *πλην* në zbritje (δέκα **πλην** δύο), *επί* në shumëzim (τέσσερα **επί** τρία) dhe *συν* në mbledhje (εφτά **συν** δύο). Mund të përmendet gjithashtu edhe përdorimi i parafjalëve librore *περί* për të shprehur marrëdhënie sasiore me përfaqësi dhe *επί* për të shprehur marrëdhënie kohore:

Είχαν μαζευτεί περί τους χίλιους διαδηλωτές.
Επί Χούντας.

Përdorime të tjera të këtyre parafjalëve kanë shpesh karakter libror. Nuk përjashtohet përdorimi i tyre në greqishten e re, por nuk hasen shpesh në gjuhën e përditshme dhe atëherë kur përdoren përçojnë stil libror.

Të tilla janë përdorimi i parafjalës *ένεκα* kur shpreh qëllim, përdorimi i *περί* për deklarinimin e temës në vend të parafjalëve *σε* dhe *για* të greqishtes së re, përdorimi i *προ* në vend të *μπροστά* të greqishtes së re, përdorimi i *άνευ* për deklarinimin e mungesës në vend të *χωρίς* të greqishtes së re.

Η άδεια δεν εγκρίθηκε **ένεκα** τής ακαταλληλότητας τού εδάφους.(stil libror)

Η άδεια δεν εγκρίθηκε **εξαιτίας** τής ακαταλληλότητας τού εδάφους.(stil asnjënjës)

¹⁵⁸ Xp. Κλαίρης – Γ. Μπαμπινιώτης, *vep. e cit.*, 922

Μιλήστε, παρακαλώ, **επί** τού θέματος.(stil libror)
Μιλήστε, παρακαλώ, **για** το θέμα.(stil asnjaneš)

Παρακολούθησα μια ενδιαφέρουσα συζήτηση **περί** φυσικού περιβάλλοντος.(stil libror)
Παρακολούθησα μια ενδιαφέρουσα συζήτηση **για** το φυσικό περιβάλλον.(stil asnjaneš)

Ο Αννίβας έφτασε **προ** των πυλών τής Ρώμης.(stil libror)
Ο Αννίβας έφτασε **μπροστά από** τις πύλες τής Ρώμης.(stil asnjaneš)

Përdorimi i parafjalëve librorë është i zgjeruar në shumë mjedise gjuhësore si në rreshtat e lajmeve e të shtypit ka mjaft shembuj të përdorimit të parafjalëve:

... στο 44' ο Κ. μέσα στην περιοχή και **προ** τού Λ. απομάκρυνε με το χέρι την μπάλα...
... ο Π.Π. υποσχέθηκε συρρίκνωση τού δημόσιου τομέα με βάση το πρόγραμμα τής παράταξης **περί** ιδιωτικοποιήσεων...

8.2. SHPREHJE TE NGURTËSUARA

Shumë nga parafjalët librorë përdoren në greqishten e re në shprehje të ngurtësuar. Disa nga këto shprehje kanë stil libror si p.sh: *εκ τού σένεγγυς, περί όνου σκιάς, έχω περί πολλού*, disa përdoren në terminologji specifike si p.sh: *εις άτοπον απαγωγή* në matematikë, *άνευ όρων* në terminologjinë ushtarake dhe disa te tjera kanë një përdorim të gjerë në të folurën e përditshme si p.sh: *εν τω μεταξύ, υπό την πίεση*.

Si në shprehjet ngurtësuar edhe në përdorimet specifike ruhen karakteristika të caktuara të strukturës së gjuhës librorë, edhe pse nuk përbëjnë pjesë të sistemit gjuhësor të greqishtes së re. Kështu, përdoret rasa dhanore (*εν πάση περιπτώσει*) ose *από* me gjinore (*από καταβολής κόσμου*), të cilat ruhen vetëm në trajtat e ngurtësuar.

Më poshtë jepen disa nga këto shprehje që përdoren më shpesh në greqishten e re.

εκ τούτου	εξ ακοής	προ παντός
εκ των ενόντων	εξ αμελείας	προ πάντων
εκ των προτέρων	εξ άπαντος	προ πολλού
εκ των υστέρων	εξ αποστάσεως	προ Χριστού
εκ των ων ουκ άνευ	εξ απροόπτου	συν γυναιζί και τέκνοις
εκ των φύσεως	εξ αριστερών	συν Θεώ

εν αγνοία	εξ αρχής	συν καιρώ
εν Αθήναις	εξ ολοκλήρου	υν τοις άλλοις
εν ανάγκη	εξ ορισμού	συν τω χρόνω
εν γνώσει	εξ όψεως	υπ' ατμόν
εν είδι	επ' άόριστον	υπ' οψιν
εν ενεργεία	επ' άπειρον	υπέρ βωμών και εστιών
εν ευθέτω χρόνω	επ' αριστερά	υπέρ πίστεως και πατρίδος
εν καιρώ	επ' αυτοφώρω	υπέρ το δέον
εν λευκώ	επ' ευκαιρία	υπό απαγόρευση
εν λόγω	επ' ονόματι	υπό κράτηση
εν μέρει	επι τής ουσίας	υπό μορφήν
εν ολίγοις	επι αποδείξει	υπό όρους
εν ονόματι	επί ίσοις όροις	υπό περιορισμό
εν όψει	επί κεφαλής	υπό σκέψη
εν πάση περιπτώσει	επί λέξει	υπό σκιάν
εν περιλήψει	επί μακρόν	υπό συζήτηση
εν πολλοίς	επί παραδείγματι	υπό την αιγίδα
εν προκειμένω	επί πιστώσει	υπό την αρχηγία
εν πρώτοις	επί ποδός	υπό την επήρεια
εν πτήσει	επί πόνου	υπό την επίβλεψη
εν ριπή οφθαλμού	επί τάπητος	υπό την πίεση
εν στολή	επί τη βάσει	υπό την προστασία
εν συγκρίσει	επί τιμή	υπό το έδαφος
εν συνεχεία	επί το έργον	υπό το μηδέν
εν συνόλω	επί τόπου	υπό τον ήλιο

8.3. PARAFJALËT MATEMATIKORE

Në këtë pikë përmbledhim të gjitha parafjalët që përdoren për të shprehur veprimet matematikore, të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit, duke fituar kështu dhe veçori lidhëzore. Disa prej të cilave janë përmendur:

12. Veprimi i mbledhjes shprehet me parafjalën *σύν*: 2 *σύν* 2, *χίλιοι σύν*
13. Veprimi i zbritjes shprehet me parafjalët *μείον*, *πλήν* (ose *από*): 4 *μείον* 2, 1000 *πλήν* 400 (2 *από* 4).
14. Veprimi i shumëzimit shprehet me parafjalën *επί*: 2 *επί*2, 2 *επί*3, 1000 *επί* 1000.
15. Veprimi i pjesëtimit shprehet me parafjalën *διά*: 4 *διά* 2, 1000 *διά* 200.
16. Deklarimi i rezultatit jepet me *asnjanësin* ndajfoljor *ίσον*, që këtu përdoret si parafjalë: 2 *σύν* 2, *ίσον* 4, 2 *μείον* 2, *ίσον* 0, 4 *πλήν* 2, *ίσον* 2, 2 *επί* 2, *ίσον*4, 4 *διά* 2, *ίσον* 2.

Renditja e parafjalëve me numërorët bëhet zakonisht në format e *asnjanësit*, në mënyrë që saktësimi i rasës të jetë i vështirë: *τρία από τρία*, *τρία επί τρία*, *τέσσερα διά τέσσερα*, *διακόσια διά διακόσια*. E njëjta gjë ndodh dhe me gjininë femërore. Me mashkulloren drejtohem i për tek kallëzorja: *εκατό (βαθμοί) από διακόσιους επί διακόσιους*. Me *διά* dhe *μείον* duket që drejtohem i për nga emërorja: *διακόσιοι διά διακόσιοι*, *μείον διακόσιοι*. Emërore duket që ndërfit dhe *ίσον*: *διακόσιοι από τετρακόσιους ίσον διακόσιοι*. Kjo na drejton në konkluzionin që parafjalët *από*, *διά*, *επί* dhe ndajfoljoret *μείον* dhe *ίσον*, korrespondojnë me foljet = *αν αφαιρέσουμε*, *αν διαιρέσουμε*, *αν πολλαπλασιάσουμε*, dhe *είναι ίσο* ose *ισούται* ose *ισοδυναμεί*.

PËRFUNDIME

Në punimin tonë me temë “Vështirim morfo – sintaksor i parafjalëve të gjuhës së re greke në krahasim me parafjalët e gjuhës shqipe” është bërë një krahasim i sistemit parafjalor të këtyre dy gjuhëve, duke synuar nxjerrjen në pah të të përbashkëtave dhe të veçantave të secilës gjuhë dhe është arritur në këto përfundime kryesore:

17. Shqipja dhe greqishtja janë dy gjuhë të ndryshme me njëra tjetrën megjithëse i përkasin të njëjtës familje gjuhësore, familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane. Megjithatë në sistemin parafjalor të tyre, në evolucionin që ka pësuar ky sistem, në rrugët e përfimit të këtij sistemi gjatë shekujve, ka mjaft gjëra të përbashkëta. Është e vështirë të përcaktohet me saktësi periudha kohore e shfaqjes së greqishtes së hershme, asaj protohelenike, por dimë që në shekullin e 13-të p.e.r, përdorej i ashtuquajtur i lineari B. Lineari B e ka prejardhjen nga lineari A, i cili u përdor nga mesi i shekullit të 18-të deri në mesin e shekullit 15-të p.e.r dhe deri më sot janë publikuar rreth 1500 tekste të shkruara në linearin A. Gjuha greke është përfutur përmes një procesi transformimesh të vazhdueshme që ka pësuar gjuha mëmë indoevropiane, në një periudhë kohore tepër të gjatë.
18. Studimet kanë nxjerrë në pah disa tipare të përbashkëta të dy gjuhëve në rrafshin indoevropian. Studimet për gjuhën greke nuk kanë pasur probleme të diskutueshme, por kanë ndjekur zhvillimin e saj gradual, kalimin në greqishten e re dhe faktorët apo veçoritë e këtij kalimi. Ndërsa për sa i përket gjuhës shqipe ka pasur dhe ka ende diskutime lidhur me origjinën, tipin e saj gjuhësor dhe vendin që zë në familjen gjuhësore indoevropiane. I pari që vërtetoi bindshëm përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoevropiane, ishte gjuhëtari gjerman F. Bopp. Ai arriti në përfundimin se shqipja është gjuhë indoevropiane, por “në elementet e saj themelore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite (indoevropiane) të kontinentit tonë.
19. Në gjuhën greke termi “parafjalë” është ndeshur qysh në lashtësi, për faktin se është ndjerë i nevojshëm krijimi i një mjeti gjuhësor për të shprehur marrëdhëniet sintaksore të emrit në fjali. Kjo ishte një fjalëz shërbyese që vendosej para një emri a përemri. Në disa gjuhë indoevropiane mund ta gjejmë dhe të paravendosur, por gjuhët që ne po krahasojmë, shqipja dhe greqishtja, e kanë të paravendosur. Ato vendosen rregullisht para një emri a përemri në një rasë të caktuar, për të shprehur lidhjet e tij sintaksore, përkatësisht me një gjymtyrë tjetër të shprehur nga një emër. Në rastin e parë togu *parafjalë+emër* kryen një funksion ndajfoljor (adverbal), ndërsa në rastin e dytë kryen një funksion ndajemëror (adominal)”. Lindja e klasës së parafjalëve kushtëzohet, si çdo dukuri,

nga disa faktorë. Këta faktorë veprojnë të veçuar, por shpesh edhe në bashkëveprim reciprok.

20. Parafjalët në familjen e gjuhëve indoevropiane janë përfutur në një fazë të caktuar të zhvillimit të kësaj familjeje gjuhësh. Ato janë përfutur qysh në një fazë të hershme parahistorike, për çka dëshmon prania e tyre në të gjitha gjuhët indoevropiane, përfshirë këtu edhe ato që kanë një dokumentim shkrimor relativisht shumë të hershëm, si indishtja e vjetër, greqishtja e vjetër, latinishtja etj. Krijimi i kësaj klase fjalësh, që kanë ardhur duke luajtur një rol gjithnjë e më të madh në të shprehurit e lidhjeve sintaksore të emrit (dhe të përemrit) në fjali, është bërë i nevojshëm nga pamjaftueshmëria e formave rasore të emrit për të shprehur të gjitha nuancat e raporteve të tij sintaksore. Si rrjedhim, në një fazë të dhënë të zhvillimit të popujve që flisnin gjuhë a dialekt indoevropian, u ndje nevoja për një mjet të ri plotësues të sistemit rasor për t'i dhënë këtij mundësi të shprehte sa më mirë e sa më qartë funksionet më të ndryshme të emrit në fjali.

Krahas reduktimit të fleksionit, lindja dhe rritja në vëllim e klasës së parafjalëve erdhi si rezultat edhe i zëvendësimit në gjuhë të sintetizimit me analitizmin.

21. Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që përdoret si fjalë shërbyese përpara një emri, një përemri a një numërori (në një rasë të caktuar) ose përpara disa ndajfoljeve, për të shprehur marrëdhëniet midis gjymtyrëve në një togfjalësh.

Tek përkufizimi i mësipërm del qartë pandryshueshmëria e kësaj pjese të ligjëratës, si dhe përdorimi i saj me një rasë të caktuar, pra tipari morfologjik dhe sintaksor i saj. Lyons duke u mbështetur në “kategorinë aristoteliane” thekson: “... pjesët e ligjëratës të rangut të parë (emër, folje, mbiemër, ndajfolje) ishin kuptimmbartëse... Pjesët e tjera të ligjëratës (parafjalët, lidhëzat etj), të marra në vetvete, nuk thoshin asgjë, por ndihmonin në kuptimin e përgjithshëm të fjalive, duke u dhënë atyre një formë ose një rend të caktuar.

22. Në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke përdorimi i parafjalëve është mjaft i shpeshtë dhe ajo në ligjëratë pozicionohet gjithmonë para grupit emëror. Në gjuhën greke nga ky rregull përjashtohen disa shprehje të caktuara të ngurtësuar me prejardhje librore, tek të cilat parafjala i prapavendoset grupit emëror, p.sh: *τιμής ένεκεν, παραδείγματος χάριν. Ημαστε στην πίσω πλευρά του σταθμού, είκοσι μέτρα από την πλατφόρμα. Με κάρφωσε με τη ματιά του. Καλπάζουμε προς τη θάλασσα. Καταφύγιο το πενκόδασος για τα ζευγαράκια.* Por, nëse grupi emëror të cilit parafjala i përket nga ana sintaksore, ka përpara tij përcaktor, parafjala shkon përpara tij: *Στο πίσω κάθισμα τα δυο παρανυμφάκια, ζευγάρι, αγόρι, κορίτσι, με*

- λουλουδιά στα μαλλιά τους. Γιατί η Κατερίνα μου και ο σύντροφός της μάς νικούσαν κατά κράτος, **με διάφορα πολλά μήκη**. Η Κατερίνα μου κι εγώ φεύγουμε από τον Καζαμία και πάμε **στα άλλα βιβλία** που έχει στο τρίτο **από κάτω ράφι**.
23. Lidhja e ngushtë që ekziston midis parafjalës dhe grupit emëror duket dhe nga vazhdimësia e drejtpërdrejtë që kanë në ligjëratë. Ndërmjet emrit dhe parafjalës ndërfiten vetëm përcaktorët e emrit të cilët janë elementë të grupit emëror: *Η Ερασμία την άκουγε, προφανώς για πρώτη φορά, να μιλάει για μάγισσες, κι είχε συγχυστεί. **Për të parën herë e shoh.***
24. Parafjala përsëritet përpara secilës gjymtyrë homogjene vetëm atëherë kur duam të theksojmë diçka më shumë: *Νοικοκύρης άνθρωπος, **με τα χωράφια του, με τα σπίτια το, με τα καλά του.** Sidomos pas vdekjes së gruas mendonte se duhej të kryente edhe rolin e saj të munguar duke i folur të birit **për moralin, për dashurinë, për besimin, për paqen, për mirëkuptimin** dhe gjëra të ngjashme, të cilat dhe atij, në jo pak raste, i kishin vlejtur dhe këtë nuk mund ta mohonte.*
25. Në gjuhën greke dhe atë shqipe gjendet një numër i madh parafjalësh. Në greqisht, duke përfshirë lokucionet dhe krijimet e reja, të cilat nuk kanë marrë ende një trajtë të qëndrueshme, si dhe variantet fonetiko-morfologjike të tyre, na del një numër i madh parafjalësh. Edhe në gjuhën shqipe shifra e parafjalëve është e lartë. Kështu Samara numëron rreth 185 parafjalë dhe lokucione parafjalore. Kuptohet që edhe në gjuhën shqipe në këtë shifër radhiten edhe variante ende të pastabilizuara ose në gramatikalizim e sipër.
26. Parafjalët e gjuhës së vjetër greke ndahen në dy grupe: **Kryesore**: janë ato fjalë që përdoren jo vetëm si parafjalë të rasave të zhdrejta, por përdoren edhe si parashtesa. Këto parafjalë janë: *αντί, ανά, από, αμφί, δια, εις, εν, εκ, επί, κατά, μετά, περί, παρά, προς, προ, υπέρ, υπό, συν.* **Parafjalë që nuk përdoren sipërbërës të parë në kompozim**: janë ato parafjalë që përdoren vetëm për të shprehur përcaktorët a rrethorët me parafjalë. Këto janë: *άνευ, άχρι, ένεκα/ένεκεν, μέχρι, πλύν, χάριν, χωρίς, ώς.*
27. Parafjalët kryesore ndahen në: parafjalë që përdoren me një rasë, që përdoren me dy rase dhe që përdoren me tre rase. Kështu, parafjalë që përdoren me një rasë janë ato të rasës gjinore: *Αντί του Κώστα ήρθε ο Μανόλης. ...για να ισχύσει ο θεσμός χωρίς να δημιουργούνται **από καιρού** εις καιρόν παρατραγούδια. Είμαι **εκ φύσεως** υπομονετική και συντηρητική στις εκδηλώσεις μου, προπάντων με ανθρώπους που δεν αγαπώ. Τα μυθηστορήματά του είχαν πάψει όλα να εκδίδονται **προ πολλού** και ήταν εντελώς ξεχασμένος.* Disa parafjalë përdoren vetëm me rasë

dhanore: *Νέα συνάντηση των υπουργών Εξωτερικών Ελλάδος και Αλβανίας βρίσκεται εν όψει. Χιλιάδες πολίτες χειροκρότησαν, συν γυναιζί και τέκνοις, τον κύριο Χ ως αυριανό πρόεδρο της χώρας τους. Me rasën kallëzore: Ανέβηκε εις το βήμα για να εκφωνήσει λόγο.*

28. Parafjalë që përdoren me dy rasa janë: *ανά, δια, κατά, υπέρ*. Parafjala *ανά* i paravendoset një emri në rasë dhanore ose në rasë kallëzore: ...*ανά τας οδούς ρύμας και τας αγνιάς...*(rasë dhanore) *Περιοδεύε με τους συνεργάτες του ανά στην Ελλάδα.* (rasë kallëzore). Parafjala *δια* paravendoset një emri në rasën gjinore ose në rasën kallëzore: *Στην ψυχή του δεν φθάνει κανείς ούτε δια ξηράς, ούτε δια θαλάσσης.*(rasa gjinore). *Φόνος δι'ασήμαντον αφορμή.* (rasa kallëzore). Parafjala *κατά* i paravendoset një emri të rasës gjinore ose një emri të rasës kallëzore: *Επίθεση κατά του εχθρού.* (rasa gjinore) *Πάμε κατά τη θάλασσα.* (rasa kallëzore) Parafjala *υπέρ* i paravendoset një emri në rasën gjinore ose një emri në rasën kallëzore: *Τάσσομαι υπέρ της δημοκρατίας.* (rasa gjinore). *Υπέρ το εκατομμύριο.* (rasa kallëzore).
29. Parafjalë që përdoren me tri rasa janë: *αμφί, επί, μετά, παρά, περί, προς, υπό*, të cilat i paravendoset një emri në rasën gjinore, dhanore dhe kallëzore. *Καθημένοι αμφί πυρ.* (rasa kallëzore) *Είμαστε συνεχώς επί ποδός πολέμου.*(rasa gjinore) *Συνελήφθησαν επ'αυτοφώρω για υπεξαίρεση χρημάτων.* (rasa dhanore). *Παρακολούθησαν τους τεχνικούς επί το έργον.* (rasa kallëzore). *Δέχομαι μετά χαράς.* (rasa gjinore). *Μετά τον σάλο που προκλήθηκε στις εφημερίδες για παράνομους διορισμούς, έγινε δικαστική διερεύνηση του θέματος.* (rasa kallëzore). *Πληροφορήθηκαν παρά των αρμοδίων.* (rasa gjinore). *Είναι δικηγόρος παρ'Αρειω Πάγω.* (rasa dhanore). *Μέρα παρά μέρα.* (rasa kallëzore) *Η συζήτηση στρέφεται γύρω από το περί ου ο λόγος τραγούδι.*(rasa gjinore). *Περί τα μεσάνυχτα ακούστηκε ένας περιέργος θόρυβος.* (rasa kallëzore) *Προς Θεού!*(rasa gjinore). *Θα σε δω προς το απόγευμα.* (rasa kallëzore). *Πήρα το μαξιλάρι μου υπό μαλής, ένα σεντόνι και μια κουβέρτα.*(rasa gjinore). *Mora jastëkun nën krahë, një çarçaf dhe një kuvertë.*
30. Gjuha shqipe dhe gjuha greke kanë numër të ndryshëm rasash. Në gjuhën shqipe kemi pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore. Gjuha greke ka katër rasa: emërore, gjinore, kallëzore dhe thirrore. Nëpër gramatika të ndryshme të gjuhës shqipe pranohet se janë katër rasat që sundohen nga parafjalë dhe pikërisht emërorja, gjinorja, kallëzorja dhe rrjedhorja. Por, prof. Çeliku mbështet idenë se edhe rasa dhanore mund të sundohet nga parafjalë. Ndërsa në gjuhën greke rasa më e sunduar nga parafjalët është kallëzorja dhe më pak gjinorja.

31. Rasa emërore duke qenë “casus rectus”, pra rasë e drejtë, rasa e një gjymtyre të pavarur në fjali, si rregull nuk duhet të ketë parafjalë. Në gjuhën greke ka një përdorim mjaft të paktë të tyre. Dhe pikërisht, gjuhëtari i njohur Τριανταφυλλίδης njih dy të tilla, parafjalën *για* dhe *από*. Përdorimi i këtyre parafjalëve në rasën emërore është mjaft i rrallë dhe vetëm në disa raste të caktuara. Ky përdorim mendohet se vjen nga fjali të thjeshtuara. Këto përdoren me emërore kur duan të tregojnë një pikënisje, gjendje ose rezultat (përfundim), dhe emri të cilit i paravendosen luan rolin e kryefjalës. Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës emërore. Parafjalët e rasës emërore përdoren edhe në rasën kallëzore. *Το ζέρω από μικρός. Γυρεύει θέση για επιστάτης.* Në rasën emërore përdoren edhe parafjalët *συν* dhe *δια*, kur u paravendosen numërorëve. Nuk shfaqin një formë rasore të qartë. *Δύο συν τρία. Έξι δια δύο.* Ndërsa në gjuhën shqipe kemi vetëm dy parafjalë që përdoren me këtë rasë, pikërisht parafjalët *nga* dhe *te(k)*. Parafjala *te(k)* shfaqet në dy variante fonetiko-drejtskrimore. Varianti *te* përdoret atëherë kur shoqëron një emër apo përemër që fillon me bashkëtingëllore, ndërsa varianti *tek* përdoret kur emri fillon me zanore: *Vite me radhë isha mësuar t’i dëgjoja violinat e jevgjve, të Peros bashkë me ato të djemve, në mbrëmje, tek oborri i jashtëm, në prani të gjithë familjes së madhe të babazotit.* Kur përdoret me parafjalë rasa emërore largohet nga funksionet e saj themelore dhe afrohet me rasat e tjera me parafjalë, pikërisht me kallëzoren dhe rrjedhoren.
32. Gjuha greke nuk ka parafjalë vetëm të rasës gjinore. Ka disa parafjalë që përdoren në situata të veçanta në rasën gjinore, por përdorim më të gjerë kanë në rasën kallëzore. Rrallë herë me rasën gjinore përdorim parafjalën *σε, σ’, για, από* kur i paravendoset një emri para të cilit nënkuptohet fjala shtëpi, ose ndonjë fjalë tjetër analoge me të. Edhe në këtë rast mendohet se këto përdorime vijnë si pasojë e thjeshtimit të fjalive më të plota. *Ήμουν στον θείον μου (στο σπίτι) Είμαι για του θείον μου. Έρχομαι από του πεθερού μου. (το σπίτι).* Parafjalët *προς, κατά, μετά, αντί, από, δια, εκ-εξ, επί, προ* përdoren me rasë gjinore vetëm në disa shprehje të ngurtësuar. Në gjuhën shqipe parafjalët që shoqërojnë rasën gjinore janë: lokucione parafjalore të formuara nga togjet parafjalë + emër si p.sh. *me anën, në këmbë, për faj, në kurriz, në dëm, me përjashtim, nga shkak, për shkak, në fushën, me rastin, në drejtim, në dobi, në të mirë, në sy, në vend, në lëmin, për nder, për hir, nga ana. Agjencitë e lajmeve ekonomike e ndërkombëtare sqarojnë se, shitjet e mëdha të dollarit erdhën për shkak të deklaratës së kryetarit të Rezervës Federale në SHBA. Lokucioni parafjalor i formuar nga parafjala *si* dhe emri pasojë: *si pasojë Peshë e importeve të naftës është rritur ndjeshëm pas vitit 2000, kryesisht si pasojë e krizave energjetike që ka pasur vit për vit ekonomia vendase.* Nga këta shembuj vëmë re se parafjalët e rasës gjinore janë lokucione emërore që përbëhen nga njëra prej parafjalëve të mirëfillta: *nga, me, në* ose *për* e cila është në krye të lokucionit.*
33. Në ndryshim nga gjuha shqipe, në të cilën ka mendime të ndryshme rreth rasës dhanore me parafjalë, në gjuhën e sotme greke nuk ka asnjë parafjalë që të përdoret me rasë dhanore. Përdorim të dendur parafjalët e rasës dhanore kanë

pasur në gjuhën e vjetër greke. Në gjuhën e re greke dhanorja përdoret vetëm në disa shprehje të fosilizuara. Sot ajo është zëvendësuar nga kallëzorja me parafjalë: *Ο πιλότος πήρε νέες οδηγίες εν πτήσει.* (στην πτήση). *Η στρατιωτική ζωή εν Ελλάδι.* (στην Ελλάδα). Në traditën gramatikore shqiptare rasa dhanore shfaqet si një rasë që përdoret pa parafjalë. Por ka edhe disa gjuhëtarë të cilët në shkrimet e tyre pranojnë përdorimin e parafjalëve edhe me këtë rasë, megjithëse pjesa më e madhe e tyre nuk i shohin si parafjalë vetëm të rasës dhanore, por si parafjalë që përdoren dhe me një rasë tjetër. Xhuvani e njëj parafjalën *krahas* si parafjalë të rasës dhanore ashtu sikurse dhe Çeliku e klasifikon në grupin e parafjalëve që përdoren me rasë dhanore. Xhuvani pranon se ekzistojnë disa parafjalë që përdoren me dhanore-rrjedhore. Në këtë grup ai përfshin parafjalë që kanë dalë nga ndajfolje dhe emra që janë përdorur më parë si ndajfolje, si dhe parafjalën *ndaj* kur ajo tregon kohë: *ndaj* mesditës, *afër* fshatit, *përmes* fshatit. Për Çelikun, parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, midis, mes, majë, rrëzë, faqe, anë, bri, krah, ballë* janë parafjalë të rasës dhanore.

34. Në gjuhën greke parafjalët e rasës kallëzore përdoren jo vetëm si lokucione parafjalore, por edhe si parafjalë të mirëfillta: *με, σε, από, κατά, παρά, για, προς, χωρίς. Αλλά δεν είναι το μόνο θέμα για το οποίο δεν έχω εξήγηση.* Rasa kallëzore është një rasë që përdoret shumë me parafjalë, madje përdorimi i saj pa parafjalë është duke u kufizuar. Pjesa më e madhe e parafjalëve të thjeshta të gjuhës shqipe përdoret me rasën kallëzore. Parafjalët më kryesore me të cilat përdoret kallëzorja janë: *në, më, me, pa, mbi, nën, nëpër, ndër, përmbi, përjashtuar, përfshirë* Dr. Gjëlpera u ul ***në një fron prej kashte, pranë një tryeze prej druri të bardhë, të mbërthyer me gozhdë.*** Gjithashtu me rasën kallëzore përdoren edhe lokucionet parafjalore që në strukturën e tyre kanë si element të fundit parafjalën *me*: *bashkë me, tok me, krahasuar me, lidhur me, ngjitur me, në lidhje me, në kundërshtim me, në krahasim me, në pajtim me, në përshtatje me, në raport me, në bashkëpunim me* etj. ...*kanë mbërritur kritika të shumta në lidhje me drejtimin që i bën.*
35. Në gjuhën shqipe diskutohet nëse parafjalët emërore *buzë, ballë, majë* etj. + *emër* (a *përemër*) janë parafjalë të rasës rrjedhore apo dhanore? Më parë ato janë trajtuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Edhe Gramatika e gjuhës shqipe, botim i Akademisë së Shkencave, nuk njeh asnjë parafjalë që të përdoret në rasën dhanore, duke i klasifikuar si parafjalë të rasës rrjedhore. Ndërsa për Çelikun këto parafjalë janë të rasës dhanore. Parafjalë të rasës rrjedhore janë përveç parafjalës së mirëfilltë *prej* edhe parafjalët emërore të thjeshta: *buzë, ballë, anë, faqe, kurriz, majë, mes, rrëzë, anë, bri* etj. Si dhe parafjalët me prejardhje ndajfoljore si: *lart, sipër, krahas, afër, larg, pranë, para, prapa, gjatë, poshtë, jashtë, përreth, nga, anëmbanë, tutje, tej, kundrejt, rrotull, drejt, krahas, veç, përmes, përballë* etj. në gjuhën greke rasa rrjedhore nuk ekziston dhe si për rrjedhojë as parafjalë të kësaj rase. Rrjedhorja e shqipes jepet në greqisht kryesisht me kallëzore me parafjalë.

36. Në gjuhën e re greke shumë parafjalë përdoren vetëm me një rasë. Por në këtë gjuhë ka edhe parafjalë të cilat përdoren me më shumë se një rasë. Këto janë parafjalë që përdoren kryesisht me dy rasa dhe shfaqin kombinimet e mëposhtme rasore:

gjinore / kallëzore
emërore / gjinore / kallëzore

Në gjuhën shqipe, në të shumtën e rasteve një parafjalë përdoret vetëm me një rasë. Shumë pak parafjalë bëjnë përjashtim nga ky rregull. Parafjalët e gjuhës shqipe që përdoren me më shumë se një rasë shfaqin këto kombinime rasore:

kallëzore / rrjedhore
gjinore / rrjedhore
dhanore / rrjedhore
dhanore / kallëzore / rrjedhore

Përdorimin e saj më të zakonshëm parafjala *për* e ka me rasën kallëzore: *për shkollë*. Me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët emërtojnë gjymtyrë ose pjesë të trupit të frymorëve: *për këmbë*. Parafjalët që përdoren dhe me dhanoren dhe me rrjedhoren përbëjnë grupin më të madh të parafjalëve që përdoren me dy rasa. Si të tilla paraqiten parafjalët emërore të thjeshta si dhe parafjalët ndajfoljore.

Po ta kërkoje e gjeje *mes* luleve. (dhanore) I pëlqente shumë të rrinte *mes* lulësh. (rrjedhore) Donte shumë të rrinte *mes* nesh. (rrjedhore)

Por jo Donte shumë të rrinte *mes* neve.

37. Grupi i parafjalëve që përdoret me tri rasa përbëhet nga një parafjalë e vetme, nga parafjala *ndaj*, e cila përdorimin e saj më të kufizuar e ka me rasën kallëzore, pasi me këtë rasë kjo parafjalë përdoret vetëm me disa emra të caktuar të cilët janë emra të nyjshëm të gjinisë asnjane: *ndaj të gdhirë*, *ndaj të ngrysur*. Parafjala *ndaj* haset më shpesh me emra dhe përemra në rasën dhanore. Ndërsa me rasën rrjedhore kjo parafjalë përdoret kur paraprin disa përemra vetorë.

Do ikim *ndaj* të ngrysur. (kallëzore)

Kujdesi *ndaj* fëmijëve nuk duhet të mungojë. (dhanore)

Ndaj të tjerëve është më i mirë. (dhanore)

Kemi shumë detyrime *ndaj* teje. (rrjedhore)

38. Karakteristikë e parafjalës *σε* të gjuhës greke është bashkimi dhe shkrirja e saj në një fjalë të vetme me nyjën shquese të emrave, të cilëve u paravendoset. Ky bashkim është një proces fonetik dhe shoqërohet me rënien e tingullit *-ε* të parafjalës. Είμαι στην Αθήνα. / Είμαι σε την Αθήνα.

39. Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, e cila nuk është në gjendje të funksionojë si e veçantë, por është pjesë e saj dhe kryen një funksion të caktuar, atë të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore brenda togfjalëshit. Ato kanë aftësinë për të shprehur në mënyrë më të diferencuar dhe specifike se rasat, marrëdhëniet dhe lidhjet midis gjymtyrëve të fjalisë, aftësi kjo që lidhet me kuptimin e tyre apo me kuptimin që ato marrin në sintagmë. Fakti që parafjalët nuk mund të përdoren si gjymtyrë më vete lidhet me semantikën e tyre të kushtëzuar. Kuptimi leksikor i

parafjalëve ka qenë një temë e debatuar, pasi disa gjuhëtarë e shohin atë të zhveshur nga ana leksikore. Sipas Janakopulos parafjalët e mirëfillta shprehin vetëm marrëdhënie sintaksore, dhe nuk kanë asnjë kuptim. Disa parafjalë kanë një kuptim shumë të përgjithshëm, i cili konkretizohet brenda togfjalëshit dhe varet nga të dyja gjymtyrët e tij:

Αυτή πάει στο Λονδίνο. / Ajo ikën në Londër. (marrëdhënie hapësinore)

Αυτή πάει σε δύο μέρες. / Ajo ikën për dy ditë. (marrëdhënie kohore)

Αυτός σκέφτεται για την οικογένειά του. / Ai mendon për familjen e tij. (marrëdhënie objektore)

Αυτός δουλεύει για την οικογένειά του. / Ai punon për familjen e tij. (marrëdhënie shkakore)

40. Në marrëdhënien parafjalë/raporte sintaksore të të dyja gjuhëve, vihet re një dukuri e dyfishtë: nga njëra anë e njëjta parafjalë shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore, të tilla janë parafjalët polisemantike:

Βγήκε από το καφενείο. / Doli nga kafeneja. (vend)

Τα έπιπλα είναι από ξύλο. / Mobiliet janë prej druri. (material)

Αρρωστήσαμε από το κρύο. / U sëmurëm nga të ftohtët. (shkak)

Shkova në shtëpi. (vend)

Do të niset në Dhjetor. (kohë)

Ishte thelluar në diçka. (kufizim)

Θα në mënyrë të shpenguar. (mënyrë)

dhe nga ana tjetër të njëjtat marrëdhënie sintaksore mund të shprehen me parafjalë të ndryshme:

Γύρισαν κατά τα μεσάνυχτα. / U kthyen rreth mesnatës. (kohë)

Τον περιμέναμε ως το πρωί. / E pritëm deri në mëngjes. (kohë)

Φεύγω για πάντα. / Po iki përgjithmonë. (kohë)

Θα σε περιμένουμε προς το βράδυ. / Do të presim nga darka. (kohë)

Νuk trembej prej asgjëje. (shkak)

Πër një pe, vajti dëm një gunë e tërë. (shkak)

Γέμια ishte tretur nga ethet. (shkak)

... dhe shoqërisë në përgjithësi, për shkak të ndikimit të padiskutueshëm të arsimit... (shkak)

41. Gjuha greke nuk njih asnjë parafjalë që të shprehë vetëm një marrëdhënie të caktuar. Në gjuhën shqipe ndodh e kundërta. Kështu, parafjala *për shkak* shpreh vetëm marrëdhënie shkakore: ... **për shkak të veshëve të ungit të madh** ...

Parafjala *me gjithë* shpreh vetëm marrëdhënie lejore: **Me gjithë përpjekjet e bëra ky rezultat nuk i justifikonte shpenzimet.**

Parafjalët shprehin marrëdhënie sintaksore të ndryshme:

a) marrëdhënie objektore: **Nëpërmjet këngës dhe recitimit ai mishëroi...**

b) Apo rrethanore si: hapësinore, kohore, shkakore, qëllimore etj

... **me qëllim njohjen** dhe përkthimin.. (marrëdhënie qëllimore) ... **para vitit 1944**, sa shkrimtarë ... (marrëdhënie kohore)

42. Ndërsa parafjalët e mirëfillta shprehin marrëdhënie të shumëllojshme, karakteristikë kjo e parafjalëve të të dyja gjuhëve, lokucionet parafjalore në veçanti shprehin një numër më të kufizuar marrëdhëniesh, madje shumë prej tyre një lloj marrëdhënie të vetme:

Και τελικά νομίζω πως, αν κάποια στιγμή εξ ανάγκης αποχωριστώ όσα αγαπώ, θα το μετανιώσω την επόμενη στιγμή. / Dhe përfundimisht mendoj se nëse detyrimisht humbas ato çka dua, do të pendohem në moment. (marrëdhënie shkakore)

“*Matura shtetërore*” **në krahasim me format e tjera** ... (marrëdhënie mënyre)

43. Një pjesë e mirë e parafjalëve si në gjuhën greke ashtu edhe në gjuhën shqipe shprehin marrëdhënie vendore dhe kjo ndodh për dy arsye: Së pari parafjalët e mirëfillta kanë lindur nga ndajfoljet e vendit, dhe si të tilla fillimisht kanë shprehur marrëdhënie hapësinore (*σε, προς, κατά, μετά, από; në, për te(k), më, mbi, nën*).

Ο Τζώνης, πάντα στην ίδια θέση, γονατιστός, με το κεφάλι σκυφτό. / Xhoni, gjithmonë në të njëjtin vend, i gjunjëzuar, kokëulur.

... *παμja e tij kur u mgjit në foltore s'na u duk e keqe.*

Së dyti, një pjesë e mirë e parafjalëve jo të parme është formuar kryesisht nga ndajfolje vendi. Të tilla janë shumë parafjalë ndajfoljore të gjuhës greke si dhe të gjitha parafjalët ndajfoljore të gjuhës shqipe me përjashtim të parafjalëve *krahas* dhe *veç*, të cilat janë formuar nga ndajfolje mënyrore dhe parafjalës *gjatë*, e cila ndonëse është formuar nga një ndajfolje kohe shpreh dhe marrëdhënie hapësinore: *δίπλα* (përbri, afër), *μακριά* (larg), *κοντά* (afër), *κατά* (kundër, drejt), *μετά* (pas), *προς* (kundrejt), *ανάμεσα* (ndërmjet, midis), *afër, larg, pranë, para, prapa, gjatë, poshtë, jashtë, përreth, sipër, lart, rreth e rrotull.*

...*με μια τρύπα ανάμεσα στα φρύδια.* / ..me një vrimë midis vetullave.

Αριφεja, e fshehur prapa derës, nxori përsëri zërin e hollë të saj.

44. Në gjuhën greke marrëdhënie hapësinore shprehin dhe disa parafjalë ndajfoljore: *βόρια* (në veri), *δυτικά* (në perëndim), *ανατολικά* (në lindje), *νότια* (në jug). *Βρίσκεται νότια της Ευρώπης.* / Gjendet në jug të Evropës.

Marrëdhënie hapësinore shprehin të gjitha parafjalët emërore të thjeshta të gjuhës shqipe të cilat kanë dalë drejtpërdrejt nga rasat e zhdrejta të emrave, si dhe ndonjë lokucion: *buzë, ballë, anë, faqe, kurriz, majë, mes, rrëzë, anë; në mes, në drejtim*

... *shëtitore buzë liqenit, kuvende katolike...*

45. Parafjalët shërbejnë edhe për të formuar kundrinën me parafjalë. Në gjuhën shqipe kundrina me parafjalë formohet me anë të parafjalëve të rasave emërore, kallëzore dhe rrjedhore. Në gjuhën greke parafjalët që shërbejnë për të formuar kundrinën me parafjalë janë më të pakta në numër dhe janë të rasës kallëzore. *Shpatat do të skuqeshin në emër të shkencës dhe vrasjet të justifikoheshin duke lexuar biblën e murtajes, shkruar nga Stefan Gjika dhe profet i të cilës ishte Otello. Ndërsa po i afrohej ndërtesës ku ndodhej atelieja, mendja i shkoi prapë te historia e çuditshme, ashtu siç ia kishte treguar Zefi. Të martohem me një gjarpër? Ikim, tha vajza e madhe duke marrë të motrën për dore. Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti. Nëpërmjet librave marrim shumë informacione lidhur me probleme të ndryshme që na shqetësojnë. Nuk është mirë të flasësh kundër miqve të tu të vërtetë. Mbjaj qëndrim të ashpër kundrejt gabimeve të miqve të mi. Otello vinte nga shkretëtira dhe ishte i ndjeshëm ndaj fatkeqësive. Δίνω ψωμί στο φτωχό. Δεν σε νομίζω για σπουδαίο άνθρωπο. Έμαθε στον Κώστα την τέχνη. Τι μαθαίνεις αυτά στα παιδιά; Απομάκρυναν το Γιάννη από το σχολείο. Μαλώνει με τον αδερφό του. Προέρχομαι από γονείς σπουδαίους. Δε σε θέλω δειλό στη μάχη.*
46. Parafjalët përdoren edhe për të formuar rrethanoë që shprehin marrëdhënie hapësinore, kohore, shkakore etj. *Flokët e verdha i binin mbi supe dhe shëndeti që trashëgonte nga e ëma ia kishte skuqur faqet që edhe nëse turpëroheshin nuk e ndryshonin ngjyrën. Προτού ανοίξει την πόρτα του ατελιέ, το βλέμμα του καρφώθηκε για μια στιγμή στο δεξιά φύλλο της. (marrëdhënie hapësinore) Ndjaj të gdhirë ai u zgjua i trembur. Η ευτυχία του κοριτσιού μετά την πρώτη νύχτα του γάμου; (marrëdhënie kohore) Kishte dëgjuar diku në një bisedë, ose kishte lexuar në kronika të vjetra, ose e kishte menduar vetë më pas, i nxitur prej bisedës a leximit, se përpara djegies së Voskopojës, zjarri ishte parandierë së pari në pëlhurat e piktorëve. Αχ, ας όψεται εκείνο το τέρας, η Ερασμία, που την κατέστρεψε με τις κατηχήσεις της. (marrëdhënie shkakore) Vinin për ngushëllim, për kureshtje, për t'u dhënë zemër, për t'i dëshpëruar më keq. Έπεσε για την πατρίδα του. (marrëdhënie qëllimi) Sikur babai im të ishte më trim dhe mos ta linte Otellon në Vlorë, ju me siguri do më kishit sjellë një dhuratë tjetër, tha Desdemona duke e parë Kasin me qepallat ulur. Έκοβε με το τσεκούρι τα ζόλα. (marrëdhënie mënyre) Në të dy anët e bodrumit, në nivelin e tokës, kishte nga një dritare në formë frëngjie, për ajrim dhe ndriçim. Για λίγη ώρα βάλθηκε να κοιτάζει το καβαλέτο με το ατελίωτο πάνω του γυμνό, καθώς και τους άταχτα κρεμασμένους παντού τριγύρω πίνακες. (marrëdhënie sasiore) Dhe shkaku ishte se*

atij i ishte dukur se misioni i tij mund të kryhej vetëm me shi. Θα μου θερίσετε το χωράφι με το μεροκάματο. (marrëdhënie kushtore)

47. Për sa i përket prejardhjes parafjalët ndahen në:

Të parme: *mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, prej, te(k); με, από, για, σε.* Tek këto parafjalë vihet re se përdorimet e tyre kanë shumë kuptime. Më shumë kuptime kanë parafjalët *për, në, prej, me.* Këto kuptime janë disi të përgjithshme dhe konkretizohen më shumë brenda togfjalëshit. Kuptimi leksikor tek parafjalët *mbi, nën, pa, me,* është më konkret e më i kapshëm në krahasim me të tjerat kuptimi i të cilave është më abstrakt. Në “Fonetika dhe gramatika...” thuhet se në togfjalësha të caktuar “Parafjalët e parme janë të zhveshura nga kuptimet leksikore” ose “paraqiten pa ndonjë semantikë leksikore” ose “e humbasin plotësisht kuptimin leksikor”. Por, M. Samara nuk është i këtij mendimi. Ai është i mendimit se “Do të ishte më drejt të thuhej se të gjitha ato nuk janë të zhveshura “plotësisht” nga kuptimi leksikor, se dhe ato kanë një kuptim leksikor pak a shumë të përgjithshëm, edhe po të vështrohen jashtë togfjalëshit”.

Jo të parme d.m.th. që janë formuar nga pjesë të tjera të ligjëratës: *afër, rrotull, rreth, larg, pranë, brenda, jashtë, lart; κοντά, μακριά, μεταξύ, μέσω, λόγω etj.* Këto parafjalë ruajnë lidhje të ngushta kuptimore me fjalët prej të cilave vijnë. Rrallë mund të ndodhë që kjo lidhje kuptimore të mos jetë shumë e qartë. Këto parafjalë ndahen në dy grupe kryesore:

Parafjalë ndajfoljore që kanë prejardhjen prej ndajfoljesh.

Parafjalë emërore që kanë prejardhje prej emrave.

Ekzistojnë edhe disa parafjalë të tjera që formohen nga bashkimi i dy parafjalëve ose nga bashkimi i lidhëzës si me parafjalët *pas* e *mbas*. Të tilla parafjalë janë *përmbi, nëpër, përveç, sipas, simbas* dhe quhen **parafjalë të përngjitura**. Në gjuhën greke kemi: *εξαιτίας, εναντίον, ίσαμε, ενόπιον.*

48. Sipas strukturës morfologjike parafjalët ndahen në:

Parafjalë të thjeshta. Të tilla janë të gjitha parafjalët e parme: *mbi, me, më, ndaj, në, nën, pa, për, prej, te(k).* Këtu bëjnë pjesë dhe një numër parafjalësh jo të parme që janë

formuar prej pjesëve të tjera të ligjëratës si emra e ndajfolje: *afër, brenda, gjatë, jashtë, kundër, larg, lart, para, pas, tutje, veç, anë, ballë, bri, buzë, faqe, majë, mes, rrëzë.*

Parafjalë të përngjitura. Në këtë grup bëjnë pjesë parafjalët që janë formuar nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta: *nëpër, përmbi, përveç, simbas, sipas, ndërmjet, nëpërmjet, matanë, përballë, përkrah, përbri, përmes, përpara, përreth.*

Lokucione parafjalore. Në të dyja gjuhët ekzistojnë lokucione parafjalore, parafjalë ndajfoljore dhe parafjalë emërore. Si në gjuhën shqipe dhe greke numri i lokucioneve parafjalore është i madh krahasuar me parafjalët emërore dhe ato ndajfoljore. Këto lokucione formohen kryesisht nga bashkimi i një ndajfoljeje me një parafjalë ose i një emri me parafjalë. Në gjuhën shqipe hasim edhe formimin e një lokucioni me anë të pjesores së foljes + parafjalë, si: *lidhur me, krahasuar me* etj. një gjë të tillë nuk e gjejmë në gjuhën greke. Të tilla quhen parafjalët që përbëhen prej dy a më shumë fjalësh të veçanta megjithëse ende nuk është dhënë një mendimi përfundimtar e unik mbi këtë çështje. Sipas Z. Daci, pikëpamjet rreth kësaj çështje mund të ndahen në dy grupe: lokucion quhet çdo lloj bashkimi dy-a-trifjalësh duke përfshirë dhe njësitë frazeologjike dhe lokucion quhen vetëm bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore, duke përjashtuar njësitë frazeologjike. Edhe A. Xhuvani mbështet grupin e parë dhe i quan këto parafjalë “lokucione prepozicionale” ose “shprehje parafjalore”. Ky term është përdorur edhe nga Ilia Dilo Sheperi, K. Cipo, M. Domi, Sh. Demiraj e M. Çeliku. Ndërsa grupin e dytë të pikëpamjeve e mbështesin A. Kostallari dhe J. Thomai. Janë formuar me konversion nga lokucione parafjalore: *ballë për ballë, rreth e qark, rreth e rrotull* etj., si dhe ato që kanë dalë nga togjet ndajfolje + parafjalë, parafjalë + emër, parafjalë + emër + parafjalë: *bashkë me, tok me, me përjashtim, në bazë, për arsye, në kundërshtim me, në lidhje me. Tani, bashkë me fjalët e ëmbla, i tha fjalë turpe, nga ato që përdorin djemtë e katundit, te porta e kishës, të dielave. Ai ishte përpjekur t'i shpjegonte se s'lidhej vetëm me shijet e tij mashkullore, por në radhë të parë me artin.*

Në gjuhën greke si lokucione përdoren: a) Parafjalët e përbëra që përdoren vetëm me shprehje emërore dhe përemra pronorë

b) Parafjalë të përbëra që formohen nga një ndajfolje vendi + parafjalë

Në grupin e parë bëjnë pjesë një numër i vogël parafjalësh të përbëra si: *αντί για, εκτός από, πριν από, ανάλογα με, μετά από, όσο για, σχετικά με, σύμφωνα με, ύστερα από* 159:

Në grupin e dytë bëjnë pjesë parafjalët kryesore që ndiqen nga një frazë emërore ose përemër në kallëzore ose mund të ndiqen nga një trajtë e shkurtër e përemrit në gjinore. Këto kombinime janë më të zakonshme kur ndajfolja shoqërohet nga një parafjalë. Kështu kemi: *ανάμεσα σε, απέναντι σε/από, γύρω από/σε, δίπλα σε, έξω από, κάτω από,*

159 D. Holton-P. Mackridge-I. Philippaki Warburton, Greek, An essential grammar of modern language, London, 2004, f. 189.

κοντά σε, μαζί με, μακριά από, μέσα σε/από, μπροστά από/σε, πάνω σε/από, πίσω από, πλάι σε.

Αντί για τον Γιάννη θα έρθει ο Κώστας στη συνεδρίαση. – Në mbledhje të vijë Kosta në vend të Janit.

Όλα αυτά συνέβαιναν τη νύχτα της Πέμπτης 5 Νοέμβρη 98, λίγο πριν από τα μεσάνυχτα. – Të gjitha këto ndodhnin natën e të enjtes, 5 nënëtor '98, fare pak kohë përpara mesnatës. Κανένας μας δεν τολμούσε να μιλήσει μπροστά του. – Asnjë prej nesh nuk guxonte të fliste para tij.

1. Numri i parafjalëve emërore në greqishte është shumë më i vogël krahasuar me ato të shqipes. Gjuha greke njeh vetëm tre parafjalë emërore: λόγω, μέσω, χάριν. Për sa i përket parafjalëve foljore gjuha shqipe ka një, *falë*, ndërsa greqishtja asnjë.
2. Klasifikimi i parafjalëve sipas karakterit të tyre sintaksor konsiston në ndarjen e tyre sipas rasave me të cilat përdoren. Në gjuhën shqipe parafjalët përdoren vetëm me një rasë të caktuar. Nga ky rregull bëjnë përjashtim parafjalët *ndaj* dhe *për*, të cilat përdoren me dy rasa. Parafjala *ndaj* përdoret kryesisht me rasën rrjedhore dhe më pak me rasën kallëzore: *ndaj teje* (rasë rrjedhore) dhe *ndaj të gdhirë* (rasë kallëzore). E kundërta ndodh me parafjalën *për*, që përdorimin më të gjerë e ka me rasën kallëzore dhe përdoret më pak me rasën rrjedhore: *për punë* (rasë kallëzore) dhe *për dore* (rasë rrjedhore).
